REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

# MIRATOHET

KRYETAR I K.K.T-së

**Z. EDI RAMA**

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

**Z. DAMIAN GJIKNURI**

Kryetar i Këshillit Bashkiak

**Z. AGIM HYSA**

Miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak

Nr. 65 Datë 30.11.2017

Kryetar i Bashkisë

**Z. NEZIR RIZVANI**

# PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR I BASHKISË MAT

*STRATEGJIA TERRITORIALE*

Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 1, Datë 02.02.2018

DPKZHT: *Z. ASTRIT DOÇI* *Z. ARBËR GJIKA*

KONSULENT "METROPOLIS.sh.p.k": *Z. BESNIK ALIAJ,* Nr.Liç.5711/4

MetroPOLIS Associated, Architecture & Planning sh.p.k.

## Tabela e Përmbajtjes

Tabela e Përmbajtjes ........ 2
Lista e Figurave ........ 4
Lista e Tabelave ........ 6
Autorësia dhe Kontributet ........ 8
Fjala përshëndetëse e kryetarit të Bashkisë ........ 9
Parathënie ........ 10
I. Sfidat e Bashkisë Mat ........ 12
1.1 Tendencat kryesore të zhvillimit të Matit ........ 12
1.1.1 Analiza historike dhe e vendbanimeve ........ 12
1.2 Territori dhe mjedisi ........ 18
1.2.1 Vlerësim i kushteve fizike ........ 18
1.2.2 Metabolizmi i territorit ........ 22
1.2.3 Mjedisi dhe ekosistemet ........ 31
1.3 Zhvillimi ekonomik ........ 62
1.3.1 Klima e Biznesit ........ 64
1.3.2 Bujqësia dhe Prodhimi ........ 65
1.3.3 Ekonomitë urbane dhe agrare ........ 70
1.4 Situata social-ekonomike ........ 71
1.4.1 Demografia ........ 71
1.4.2 Mirëqenia social-ekonomike ........ 78
1.5 Përdorimi i tokës dhe infrastrukturat ........ 90
1.5.1 Përdorimi i tokës ........ 90
1.5.2 Ujësjellës dhe Kanalizime ........ 93
1.5.3 Infrastruktura rrugore dhe transporti ........ 98
1.5.4 Menaxhimi i mbetjeve të ngurta ........ 104
1.6 Rëndësia kombëtare në territor ........ 107
1.7 Financat vendore ........ 112
1.8 Qeverisja dhe përgjegjësia sociale ........ 118
1.9 Procese dhe dokumente planifikimi të hartuara më parë ........ 121
1.10 Mbi drejtimin e zhvillimit ........ 131
1.10.1 Koncepti Rajonal i Zhvillimit ........ 131

REPUBLIKA E SHQIPERISË · AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT · TIRANE · SEKRETARIA

1.10.2 Analiza SWOT ........ 139
1.10.3 Rekomandime per Planin ........ 142
II. Një vizion për Matin ........ 147
2.1 Objektivat dhe programet strategjike të zhvillimit ........ 148
2.2 Konsiderata financiare ........ 154
III. Plani i veprimit ........ 155
3.1 Plani i veprimit ........ 156
3.2 Sistemet e Territorit ........ 171
IV. Projektet prioritare të zhvillimit ........ 173
4.1 Ndryshimet e mundshme institucionale dhe ligjore ........ 187
V. Shtojca ........ 188

Lista e Figurave

Figura 1: Kufijtë territorialë të Bashkisë Mat ... 12
Figura 2: Shembull i Kullës Matjane ... 13
Figura 3: Shpërhapja e vendbanimeve para viteve '90. ... 15
Figura 4: Shpërhapja e vendbanimeve deri në vitin 2007 ... 16
Figura 5: Shpërhapja e vendbanimeve deri në vitin 2013 ... 16
Figura 6: Krahasimi i përhapjes së vendbanimeve në tre fazat e zhvillimit ... 17
Figura 7: Pozicioni gjeografik i Bashkisë Mat në rajon ... 18
Figura 8: Harta e pjerrësive në përqindje e Bashkisë së Matit ... 19
Figura 9: Harta e relievit dhe e hidrografisë së bashkisë Mat ... 19
Figura 10: Harta e Rrezatimit Diellor ... 20
Figura 11: Harta e Reshjeve ... 21
Figura 12: Harta e Fluksit të Ushqimit ... 24
Figura 13: Harta e Fluksit të Ujit ... 26
Figura 14: Harta e Fluksit të Energjisë ... 28
Figura 15: Sasia e mbetjeve urbane për banorë në vit në bashkinë Mat sipas kategorive (Ton/Vit) ... 30
Figura 16: Harta e Fluksit të Mbetjeve ... 30
Figura 17: Burimet Ujore Mat ... 31
Figura 18: Profilet e monitorimit të gjendjes së lumenjve në Basenin e Lumit Mat ... 33
Figura 19: Erozioni fundor ndër vite në lumin Mat ... 33
Figura 20: HEC-et në Pellgun e Lumit Mat ... 34
Figura 21: Erozioni në brigjet e Lumit Mat ... 36
Figura 22: Vlerat e $NBO_5$ dhe Oksigjenit të tretur në Basenin e Matit ... 36
Figura 23: Akuiferët e Bashkisë Mat ... 39
Figura 24: Llojet e akuiferëve, Bashkia Mat ... 39
Figura 25: Burimet ndotëse të Akuiferëve në Bashkinë Mat ... 41
Figura 26: Përmbajtja e squfurit në naftë dhe benzinë (numri i mostrave në %) ... 44
Figura 27: Përdorimi i tokës pyjore e kullosore në Bashkinë Mat (ha) ... 45
Figura 28: Harta e fondit pyjor 1984 dhe 2015 ... 47
Figura 29: Venddepozitimi aktual i mbetjeve urbane, Komsi ... 61
Figura 30: Lëvizjet e brendshme të popullësisë sipas qarqeve ... 63

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT · TIRANË · SEKRETARIA

Figura 31: Shpërndarja e të punësuarve sipas sektorëve ekonomik dhe zonat e zhvillimit ekonomik ........ 71

Figura 32: Struktura moshore e popullatës, Bashkia Mat ........ 75

Figura 33: Shkalla e analfabetizmit, sipas njësive administrative, Bashkia Mat ........ 80

Figura 34: Rrezja e shërbimit për kopshtet, Bashkia Mat ........ 81

Figura 35: Rrezja e shërbimit për shkollat fillore dhe 9-Vjeçare, Bashkia Mat ........ 81

Figura 36: Rrezja e shërbimit për shkollat e Mesme, Bashkia Mat ........ 82

Figura 37: Shkolla Pjetër Budi, Burrel. ........ 84

Figura 38: Punësimi sipas nivelit arsimor fillor, të mesëm dhe universitar, Bashkia Mat ........ 85

Figura 39: Harta e përdorimit te tokës sipas kategorive bazë të përdorimit ........ 90

Figura 40: Mbivendosjevet/kundravajtjet e përdorimit të tokës ........ 93

Figura 41: Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm, Bashkia Mat ........ 95

Figura 42: Mbulimi me sistemin e kanalizimeve, Bashkia Mat ........ 97

Figura 43: Bashkia Mat në raport me infrastrukturën rajonale ........ 99

Figura 44: Transporti ndërqytetës (nisja nga Bashkia Mat, Burrel) ........ 101

Figura 45: Hierarkia e sistemit rrugor sipas funksionalitetit ........ 102

Figura 46: Cilësia e infrastrukturës rrugore Bashkia Mat ........ 103

Figura 47: Linjat e transportit publik rrethqytetas, Bashkia Mat ........ 103

Figura 48: Vend-depozitimi i mbetjeve të ngurta urbane dhe inerte Burrel ........ 106

Figura 49: Dampat e Ferro-kromit, Komsi ........ 106

Figura 50: Rëndësia Kombëtare në territor, Bashkia Mat ........ 111

Figura 51: Buxheti total i Bashkisë Mat ........ 112

Figura 52: Kontributi i sipas kategorive në ecurinë e të ardhurave totale të Bashkisë Mat (në pikë përqindjeje) dhe ndryshimi vjetor i të ardhurave (në %) ........ 113

Figura 53: Kontributi i njësive administrative në buxhetin e Bashkisë Mat ........ 114

Figura 54: Kontributi i njësive administrative në buxhetin e Bashkisë Mat ........ 114

Figura 55: Shpenzimet mesatre për banor përkundrejt mesatares së Bashkisë Mat ........ 116

Figura 56: Shpenzime totale sipas njësive administrative ........ 116

Figura 57: Shpenzimet totale sipas klasifikimit funksional ........ 117

Figura 58: Vizioni i Planit të Përgjithshëm Kombëtar ........ 121

Figura 59: Rajoni i Specializuar Dibër-Mat- Bulqizë ........ 124

Figura 60: Rajoni i Specializuar Mat, Bulqizë, Dibër ........ 125

Figura 61: Vizioni i Bashkisë Burrel, Studim 2014 ........ 128

Figura 62: Zhvillimi historik i vendbanimeve ne Rajon ........ 131
Figura 63: Prashikime të Planeve ne nivel Kombetar ........ 133
Figura 64: Sistemi Natyror dhe Baseni i Matit ........ 136
Figura 65: Skema e Korridoreve ........ 137
Figura 66: Sistemi Urban dhe Infrastrukturor ........ 138
Figura 67: Mbivendosja e Analizave ........ 139
Figura 68: Harta e Vizionit të ardhshëm në Bashkinë Mat ........ 147
Figura 69: Skema e zhvillimit të bujqësisë ........ 150
Figura 70: Skema e zhvillimit ekonomik ........ 151
Figura 71: Skema e përmirësimit mjedisor ........ 152
Figura 72: Skema e zhvillimit ekonomik_ turizmi ........ 153
Figura 73: Konvertimet e mundshme të sistemeve të territorit ........ 172
Figura 74: Fazimi i projekteve prioritare, Bashkia Mat ........ 173

Lista e Tabelave

Tabela 1: Prodhimet bujqësore dhe blektorale në territorin e Matit ........ 22
Tabela 2: Sasia e energjisë së konsumuar sipas të dhënave të OSSHE ........ 27
Tabela 3: Mbetjet që gjenerohen në Bashkinë Mat ........ 29
Tabela 4: Ujësjellësit e Bashkisë Mat dhe burimet e tyre ........ 41
Tabela 5: Aktivitetet e licensuara për shfrytëzimin e inerteve lumore në lumin Mat ........ 42
Tabela 6: Përdorimi i tokës sipas ekonomive pyjore, Bashkia Mat. ........ 46
Tabela 7: Zonat e mbrojtura në Bashkinë Mat ........ 49
Tabela 8: Flora dhe Fauna e rrezikuar në Shqipëri dhe në Bashkinë Mat ........ 53
Tabela 9: Ndarja e bashkive sipas sektorit ekonomik ........ 55
Tabela 10: Vlerësim për nivelin e erozionit potencial në tokat bujqësore të Shqipërisë ........ 56
Tabela 11: Prodhimi i Brendshëm Buto, kontributi i Qarkut të Dibrës ........ 62
Tabela 12: Numri i migrantëve të kthyer, Bashkia Mat ........ 63
Tabela 13: Të punësuarit sipas sektoreve ........ 64
Tabela 14: Grupimi i Bizneseve të vogla ........ 64
Tabela 15: Llojet e bizneseve ........ 65
Tabela 16: Popullsia shqiptare në vite ........ 71
Tabela 17: Popullsia sipas ndarjes së re administrative për bashkinë Mat ........ 72
Tabela 18: Popullsia sipas ndarjes së re administrative, 2011-2016 ........ 73

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

Tabela 19: Popullsia sipas gjinisë, bashkia Mat për vitet 2011-2016 .......... 73
Tabela 20: Raporti gjinor për bashkinë Mat, 2011-2016 .......... 74
Tabela 21: Popullsia rezidente, sipas grup-moshave .......... 75
Tabela 22: Koeficientët e varesisë .......... 76
Tabela 23: Projeksionet e popullsisë, bashkia Mat 2011-2031 .......... 77
Tabela 24: Niveli arsimor i përfunduar, Bashkia Mat .......... 79
Tabela 25: Shkalla e analfabetizmit dhe vitet mesatare të shkollimit .......... 79
Tabela 26: Shpërndarja e kopshteve sipas NjA-ve, numri të fëmijëve, edukatoreve dhe raporti fëmijë/edukatorë .......... 82
Tabela 27: Shpërndarja e shkollave 9-vjeçare sipas NjA-ve, numri të nxënësve, mësuesve dhe raporti nxënës/mësues .......... 83
Tabela 28: Shpërndarja e shkollave të mesme sipas NjA-ve, numri te nxënësve, mësuesve dhe raporti nxënës/mësues .......... 83
Tabela 29: Punësimi sipas degëve të ekonomisë, Bashkia Mat .......... 84
Tabela 30: Punësimi sipas nivelit arsimor, Bashkia Mat .......... 85
Tabela 31: Shkalla e papunësisë, Niveli Kombëtar, Qarku Dibër, Bashkia Mat dhe sipas secilës NjA .......... 86
Tabela 32: Treguesit e shërbimit shëndetësor në Bashkinë Mat .......... 87
Tabela 33: Personat me aftësi të kufizuar .......... 87
Tabela 34: Madhësia mesatare e Njësisë Ekonomike Familjare .......... 88
Tabela 35: Burimi i të ardhurave për NjEF, sipas klasifikimit dhe për çdo njësi administrative, Bashkia Mat .......... 89
Tabela 36: Treguesit e varfërisë, Qarku Dibër .......... 89
Tabela 37: Volumi i depozitimit dhe furnizimi i popullatës me ujë të pijshëm .......... 94
Tabela 38: Pus-shpimet në Bashkinë Mat .......... 95
Tabela 39 : Shpërndarja e rrugëve sipas funksionit dhe gjatësisë përkatëse. .......... 101
Tabela 40: Gjenerimi i mbetjeve sipas grupeve të prodhuesve në Bashkinë Mat, 2015 .......... 105
Tabela 41: Të ardhura sipas burimeve .......... 112
Tabela 42: Struktura e shpenzimeve sipas klasifikimit ekonomik .......... 116

**Autorësia dhe Kontributet**

Ky dokument u përgatit nga Bashkia Mat me mbështetjen financiare të Programit për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp) të Agjencisë Zvicerіane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, HELVETAS SWISS Intercooperation dhe me mbështetjen teknike të MetroPOLIS sh.p.k, nën drejtimin e Kryetarit të Bashkisë Mat, Z. Nezir Rizvani.

Grupi i punës: Besnik Aliaj, Sotir Dhamo, Dritan Shutina, Fiona Imami, Ledjo Allkaj, Rudina Toto, Merita Toska, Ada Lushi, Sherif Lushaj, Kristi Bashmili, Xhesika Hoxha, Rodion Gjoka, Malvina Disha, Ina Brata, Zenel Bajrami, Iris Hyka, Renisa Muka, Silvi Jano, Imeldi Sokoli, Gerti Delli, Ani Shtylla, Kejt Dhrami, Godiva Rrëmbeci, Eneida Çela.

Grupi i punës së Bashkisë Mat: Arber Gjika, Rustem Nuzi, Astrit Doçi, Artan Miza, Rasim Hoxha, Vebi Stana, Fatmir Kola, Agim Dushku, Shpresa Tusha, Idriz Klosi, Bukurosh Ballabani, Afrim Bardhi, Brunilda Koka, Bukurosh Ballabani, Kasem Kola, Aurel Palluci, Nazmi Mallunxa, Xhevalina Hoxha.

## Fjala përshëndetëse e kryetarit të Bashkisë

**Parathënie**

Që prej qershorit 2015, qeverisja vendore në Shqipëri është përfshirë nga reforma administrative-territoriale. Si rezultat, janë krijuar 61 Bashki të konsoliduara, të cilat përballen me sfidat e pushtetit vendor, të shumëfishuara si pasojë e rritjes së sipërfaqes dhe kompleksitetit territorial, shtimit të detyrave të reja nga reforma e decentralizimit, dhe nevojës gjithmonë në rritje për zhvillim dhe mirëqenie sociale dhe ekonomike.

Në këto kushte, Bashkia Mat, për t`iu përgjigjur sa detyrimeve ligjore, aq edhe sfidave reale, ka punuar intensivisht për të përgatitur Strategjinë e Zhvillimit të saj. Duke pasur parasysh që, jo vetëm konceptualisht, por edhe ligjërisht është pranuar nga palët se planifikimi i territorit përmban njëkohësisht edhe dimensionin strategjik dhe atë rregullator, kjo strategji përbën hapin e parë të hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Territorit të bashkisë Mat.

Dokumenti i Strategjisë së Zhvillimit të territorit hartohet nga Bashkia Mat me mbështetjen teknike të METROPOLIS sh.p.k, në kuadër të **Programit për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp)** Përmbajtja e dokumentit të Strategjisë së Zhvillimit të territorit mbështetet në ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, "Për Planifikimin e dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar dhe në aktet nënligjore të tij. Veçanërisht, si bazë referuese është Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 671, datë 29.07.2015, "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit".

Megjithatë, për shkak të natyrës mjaft komplekse dhe shumë dimensionale që ka ky dokument, duke mbuluar nevoja të territorit urban dhe rural, gjatë hartimit të tij janë referuar edhe akte të tjera ligjore e nënligjore si dhe dokumente udhëzuese. Ndër më të rëndësishmet janë:

- Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar";
- Ligji nr. 8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar";
- Ligji nr. 9317, datë 18.11.2004 "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë";
- Vendimet e KKT-së në 3 vitet e fundit, në lidhje me përcaktimin e çështjeve, zonave dhe objekteve të rëndësisë kombëtare;
- Manuali teknik " Planifikimi dhe Zhvillimi i Territorit në Shqipëri";

Metodologjia e ndjekur gjatë hartimit të këtij dokumenti është mbështetur mbi përcaktimet ligjore përsa i përket strukturës së instrumenteve (dokumenteve të planifikimit) dhe procesit që duhet të ndiqet. Kështu, për nga ana përmbajtësore, ky dokument përmban kapitullin e analizave, duke veçuar këtu analizën e metabolizmit, por edhe analiza territoriale dhe social-ekonomike, që hapin shtegun për analizat e thelluara në vijim të hartimit të Planit. Më pas, paraqiten konkluzionet përfshirë edhe analizën e pikave të forta, të dobëta, mundësive dhe rreziqeve, si dhe hapat drejt një vizioni rajonal, për kontekstin më të gjerë, në të cilin ndodhet bashkia e Matit.

Pjesa e dytë e dokumentit fokusohet në vizionin lokal të zhvillimit territorial, mjedisor e social-ekonomik, së bashku me objektivat dhe programet strategjike të zhvillimit. Më pas, është hartuar plani i veprimit me afate kohore dhe konsiderata financiare si dhe një listë e projekteve prioritare e strategjike të zhvillimit lokal territorial, për të cilat bashkia ka gatishmërinë të aplikojë për fonde dhe të përgatitë projekte teknike.

Ky dokument ndërtohet jo vetëm mbi bazën e analizave shkencore e territoriale, por edhe të nevojave dhe dëshirave të shprehura nga banorë dhe grupet e ndryshme të interesit në bashkinë Mat. Gjatë periudhës së hartimit të tij, janë realizuar 4 dëgjesa publike, nga një për çdo fazë të hartimit të dokumentit (nisma, analiza, vizioni), si dhe janë kryer takime të ngushta me ekspertë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

vendorë, përfaqësues të biznesit e aktorë të tjerë që operojnë në këtë territor. Po ashtu, janë realizuar shumë vizita në terren e institucione publike me qëllim grumbullimin sa më të efektshëm të informacionit dhe krijimin e bazës së të dhënave në sistemin gjeografik të informacionit.

Në vijim, Bashkia Mat do të punojë ngushtësisht me projektin dldp për të kaluar në hapat ligjore e teknike të hartimit të planit të përgjithshëm (përdorimi i tokës, infrastrukturat, mjedisi) dhe të rregullores së tij. Finalizimi i planit të përgjithshëm të territorit do të jetë një nga arritjet më të para të një bashkie të re, të krijuar pas reformës territoriale dhe me dëshirën e vullnetin për t`iu përgjigjur nevojave edhe afatgjata të qytetarëve, si dhe për të përballur sfidat e zhvillimit të qëndrueshëm të territorit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

# I. Sfidat e Bashkisë Mat

## 1.1 Tendencat kryesore të zhvillimit të Matit

Bashkia e re shtrihet thuajse në të njëjtin territor me krahinën etnografike të Matit dhe ka terren kodrinor dhe malor. Ajo shtrihet në të dyja krahët e lumit Mat dhe pyjet zënë pjesën më të madhe të territorit të Bashkisë së re.

Sipas Censusit të vitit 2011 numëron një popullsi prej 27,260 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrit Civil kjo Bashki numëron 38,615 banorë. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 493.5 $km^2$. Në bazë të të dhënave të Censusit densiteti i popullsisë është 55.23 banorë/ $km^2$ , ndërsa në bazë të të thënave të regjistrit civil, densiteti është 78.24 banorë/$km^2$. Kjo bashki përbëhet nga 8 njësi administrative, të cilat janë: Burrel, Baz, Derjan, Rukaj, Macukull, Komsi, Lis dhe Ulëz.

Figura 1: Kufijtë territorialë të Bashkisë Mat




**Burimi:** Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2016

### 1.1.1 Analiza historike dhe e vendbanimeve

- Analiza historike

Nga kërkimet e ndryshme arkeologjike, vihet re se krahina e Matit ka qenë e banuar që në kohëra shumë të hershme. Janë gjetur gjurmët të popullimit të kësaj treve që nga periudha e paleolitit të mesëm, në neolit e më pas. Dëshmi për këte janë studimet e bëra në shpellat e Blazit dhe në Bruç. Pra Lugina e Matit ka qenë një vend i populluar vazhdimisht në të gjitha periudhat historike.

Në periudhën e hekurit dëshmohet nga kërkimet, sidomos nga inventari i gjetur në varret e asaj kohe, se kjo trevë banohej nga fisi ilir i Pirusëve. Ky fis përmendet nga studiues të ndryshëm, si

një ndër fiset që mbetën të pavarur pas shkatërrimit të Mbretërisë Ilire nga Romaket. Pirustët i bënë ballë invazionit për shumë vite me radhe deri në shekullin II-të të erës sonë. Thuhet se pas pushtimit të Ilirisë, qendrat e mëdha të banuara qytetare, sidomos në bregdet, u romanizuan gati plotësisht, por ndryshe qëndronte puna në brendësi të vendit, në luginat e banuara në thellësi të maleve, siç ishte psh. lugina e Matit dhe vendbanimet malore në Mirditë, Pukë, Dibër e më në veri. Këtej banorët vazhduan të flasin gjuhën e tyre, respektonin hyjnitë e tyre, varrosnin të vdekurit në mënyrën e tyre të lashtë e tradicionale, punonin tokën si dikur, ruajtën veshjen dhe emrat e fëmijëve, respektonin doket e zakonet e tyre.

Të dhëna interesante për historikun e Bashkisë Mat, na japin disa regjistra të kohës së Perandorisë Osmane. Një prej tyre është Defteri syret i Esami Vilajet Dibrës (1467). Ky i përket pikërisht kohës kur vendi ishte i ndarë sipas njësive administrative Sanxhake dhe Vilajete. Vilajeti i Matit bënte pjesë në Sanxhakun e Dibrës. Vilajeti i Matit u bë një simbol i qendresës ndaj pushtuesve Osmanë. Mati ishte kryeqendra e shtetit të Shkëndërbeut. Pas Pushtimit Osman shumë fshatra u braktisën dhe këte e vërtetojnë edhe shënimet në këtë defter. Kjo për shkak të terrorit të ushtruar nga ushtria Osmane. Shumë morën malet, por ka të dhëna për emigrime massive drejt Greqisë dhe Italisë.

Gjatë kësaj periudhe vihet re diçka interesante për vendbanimet e Matit. Shumica e tyre ishte vendosur në lartësi të maleve. Kjo për shkak të mundësisë më të madhe për t'u mbrojtur nga luftrat. Ndërsa sot zonat më të ulëta janë të banuara. Këtu lindi dhe tipi i banesës Kulla Matiane.

Në mesjetë feudalët dhe bujarët, sipas shkallës ekonomike dhe nevojave, banesat e tyre i pajisnin me kulla e sharapote të ndërtuara me mure të forta. Edhe në Mat ndeshën gjurmë kullash apo kështjellash vetëm për feudalët. Pas pushtimit turk me ndryshimin e faktorëve historik, ekonomik dhe lindjen e mardhënieve të reja, u krijuan kushtet që edhe fshatarësia e lirë të ndërtonin banesa me karakter fortifikues dy deri në katër kate me sharapote, sheshena e frëngji që luanin rolin e kullës së fortifikuar kështjellë.

Figura 2: Shembull i Kullës Matjane



**Burimi:** Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2016

Pas shembjes së principatës së Kastriotëve në Mat dhe rrënimit të kalave të tyre u prishën qendrat e fortifikuara që siguronin jetën dhe lirinë e banorëve. Mbi shpatullat dhe kokën e malësorëve vërshonin ekspeditat turke, luftrat feudale, grabitjet, vëllavrasjet dhe një seri faktorësh të tjerë. Për të ruajtur të paprekur lirinë dhe pronën, banorët, nën shembullin e kullave ekzistuese feudale, krijuan prototipin e banesës kullë, që nga shekulli në shekull në përshtatje me faktorët historik, ekonomik dhe në funksion të armëve të zjarrit, pësoi evolucion. Kulla trashëgoi tiparet e kalave ilire dhe arbërore, që ndërtoheshin në vende të larta strategjike. Diktuar edhe nga rreziku i kohës, ajo u shpërnda në hapësirë duke u ndërtuar mbi kodra, ku vështronte terrenin, që në rast rreziku, jo vetëm mbronte familjen, pronën, por edhe fisin, katundin e krahinën dhe kur i kanosej rreziku i pashmangshëm tu kërkonte atyre ndihmë, e cila ishte reciproke dhe e imponuar në bazë të së drejtës dokësore e përfshirë në kanun. Kështu, kullat mbetën vatra të lira të paprekura dhe nëpërmjet sharapoteve dhe frëngjive me jehonën e armëve u imponuan pushtuesve dhe feudalëve vullnetin e malsorëve për liri. Pas Luftës së Dytë Botërore, me ndryshimin e rendit politik dhe faktorëve socialekonomik, kulla pësoi ndryshime të mëdha. Ajo humbi karakterin fortifikues. Kështu ajo u zhvesh nga sharapotet, sheshenat, frëngjitë dhe u zgjeruan apo u çelën dritare në të gjithë katet e kullës, por përsa i përket trajtës katërkandëshe, ndonëse u reduktua në dy kate, mbetet ende konservatore.

Një nga qendrat kryesore të Matit është pikërisht qyteti i Burrelit.

Qyteti i Burrelit është ngritur mbi fshatin me te njëjtin emër dhe shtrihet në një tarracë lumore që ka pamjen e një pllaje, e cila ka fushëpamje nga të gjitha anët, të zonave dhe fshatrave të krahinës së Matit. Emrin Burrel për herë të parë e ndeshim në shek. XV, në regjistrin e viti 1467 në trajtën Bujril dhe në një variant tjetër Burril. Përmes tij kalonte rruga e lashtë Dyrrah-Zgërdhesh (qytet në afërsi të Mamurasit dhe Krujës) - Qafë Shtamë - Stelush (Varosh) dhe vazhdonte për në Kosovë dhe Dibër. Ky toponim mendohet se ka lidhje me pozicionin gjeografik, një fshat i vendosur në një vend me kthesë në formën e bërrylit të krahut. Edhe në shek. XVII e gjejmë këtë vendbanim me emrin Burril. Ndërsa pas vitit 1904 atë e gjejmë në të gjitha rastet me emrin Burrel.

Burreli është banuar qysh në shek. XII para Krishtit. Këtë fakt na e jep lënda arkeologjike e gërmuar në vendin e quajtur Suka e Lepurit, në periferi të qytetit. Gjetjet e shumta arkeologjike në këtë varrezë të fillimit të periudhës së hekurit, si enë të formave e tipave të ndryshëm, objektet metalike si vegla pune, armë dhe stoli, tregojnë për një zhvillim ekonomik të hershëm.

Burreli deri në vitin 1922 ka qenë fshat, pa ndonjë rëndësi administrative. Në vitin 1922 qendra adiministrative që ndodhej në Komsi (7 km larg), u shpërngul dhe u vendos në Burrel. Pas këtij viti, gradualisht mori formën e një qendre të rëndësishme urbane. Për shkak të pozicionit strategjik, në Burrel janë vendosur gjithmonë garnizonet e ndryshme ushtarake. Më 1 Maj 1935 në qytet u vendos shkolla e Gjindarmërisë së Mbretërisë.

Në qytetin e Burrelit, asokohe qendër administrative, më 1925 u hap shkolla fillore e quajtur Internat. U ndërtuan kazerma ushtarake, një burg i sigurisë së lartë, një zyrë për punët botore, një zyrë telegrafike, një ndërtesë bashkiake, një xhami, një qendër shëndetësore si dhe disa shtëpi karakteristike siç ishte ajo e princ Xhelalit (Zogut). Në vitin 1938, edhe pse një zonë me popullsi mjaft të vogël (244 meshkuj dhe 215 femra), Burreli do të nisë punimet e parkut dhe lulishtes së qytetit, me nismë të mbretit Zogu I. Në vazhdim u ndërtua tregu, thertorja, dhe vazhduan ndërtimet për nënprefekturë, bashkinë dhe burgun e përgjithshëm Mbretëror. Më 1943 qyteti i Burrelit do të digjet i gjithi, bashkë më 30 fshtatra përreth. Në vitin 1952 Burreli filloi të marrë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

pamjen e një qyteti të vërtetë. Filluan të ndërtohen njësitë e reja të banimit, ekzistuese edhe sot, si dhe u intensifikua transporti me hapjen e rrugës së Dritës, e cila lidhte Burrelin me Ulzën dhe Milotin. Deri në vitin 1960 në Burrel ishin ndërtuar një sërë shkollash ndër të cilat dhe shkolla e mesme e përgjithshme si dhe spitali e dispanceria. Në vitin 1970, Burreli konturohej nga tre lagje kryesore, por edhe nga tre rrugë kryesore që më pas formonin dhe një gjysmë unaze të qytetit. Në fund të viteve 80'në Burrel ishin ndërtuar dhe një sërë hapësirash publike siç ishin Pallati i Kulturës, Muzeu Historik i qytetit, Biblioteka dhe Kinemaja.

- Analiza e vendbanimeve

Analiza e vendbanimeve ka për qëllimin studmin e tendencave të zhvillimit të vendbanimeve në Bashkinë Mat, përgjatë rrjedhës kohore. Janë marrë në studim tre faza kryesore: Periudha para viteve '90, '90 – 2007 dhe 2008-2013.

Për të bërë këtë analizë janë marrë në shqyrtim hartat topografike dhe ushtarake me një kufi kohor përgjithësisht 1974-1978. Nga këto harta është realizuar harta dhe grafiku i mëposhtëm.

Figura 3: Shpërhapja e vendbanimeve para viteve '90.




**Burimi:** Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2016

Siç shihet nga harta dhe grafiku i mësipërm, njësia administrative me sipërfaqe vendbanimesh më të madhe është Njësia Rukaj, e ndjekur nga ajo Macukull. Njësia administrative me sipërfaqe vendbanimesh më të vogël është Burreli dhe Uleza.

- Deri në vitin 2007

Figura 4: Shpërhapja e vendbanimeve deri në vitin 2007




**Burimi:** Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2016

Nga grafiku i mësipërm vihet re se njësia administrative me sipërfaqe më të madhe vendbanimi është Burreli dhe njësia Komsi. Ndërsa ato me sipërfaqe më të vogël vendbanimesh është njësia Derjan, Baz dhe Ulëz. Pra vihet re një shtim i vendbanimeve në Burrel, kjo për shkak të lëvizjeve të shumta migratore drejt qendrave të qyteteve ku ofroheshin dhe pjesa më e madhe e shërbimeve.

- Deri në vitin 2013

Figura 5: Shpërhapja e vendbanimeve deri në vitin 2013




**Burimi:** Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2016

Nga viti 2007 deri në vitin 2013 nuk ka ndonjë ndryshim të theksuar në statistika. Qendrat me sipërfaqen më të vogël të vendbanimeve vazhdojnë të mbeten njësitë Derjan, Ulëz dhe Baz. Ndërsa përsa i përket njësive me sipërfaqen më të madhe, vazhdojnë të jenë Burreli, Komsia dhe Lisi, por kemi një shtim më të madh të vendbanimeve në njësinë Lis dhe Komsi dhe më pak në Burrel.

Figura 6: Krahasimi i përhapjes së vendbanimeve në tre fazat e zhvillimit




**Burimi:** Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2016

Në përfundim arrijmë në konkluzionin se njësia Burrel, Komsi dhe Lis kanë pasur shtimin më të madh të sipërfaqes së vendbanimeve. Burreli ka njohur shtim më të madh në periudhën 1990-2007. Njësia Komsi ka pasur thuajse një shtim të njëtrajtshëm në periudhën 1990-2013. Lisi ka pësuar rritje më të mëdha në periudhën 2007-2013.

- Përfundime

Analiza e shpërhapjes së popullsisë në Bashkinë Mat, e fokusuar në tre periudhat kryesore para viteve '90, '90-2007 dhe 2008-2013, tregon disa rezultate që shkojnë sipas trendeve në pjesën tjetër të vendit. Para viteve '90 njësitë administrative me sipërfaqen më të madhe të vendbanimeve në territorin e Bashkisë rezultojnë Njësitë Rukaj dhe Macukull. Ndërsa sipërfaqen më të vogël e regjistrojnë Ulëza dhe Burreli. Ndërsa pas viteve '90 sipërfaqen më të madhe e kanë Burrreli dhe Komsi. Gjatë kësaj periudhe vihet re një shtim i vendbanimeve në Burrel dhe ulje në Rukaj. Nga viti 2007 deri në vitin 2013 nuk ka ndonjë ndryshim të theksuar në statistika. Qendrat me sipërfaqen më të vogël të vendbanimeve vazhdojnë të mbeten njësitë Derjan, Ulëz dhe Baz. Ndërsa njësitë me sipërfaqen më të madhe, vazhdojnë të jenë Burreli, Komsia dhe Lisi, por ka një shtim më të madh të vendbanimeve në njësinë Lis dhe Komsi dhe më pak në Burrel.

Ndryshimet e ndodhura pas viteve '90 lidhen me përmbysjen e sistemit totalitar para këtyre viteve, pasi kemi lëvizjen e lire të popullsisë. Popullsia është shpërngulur nga zonat e thella malore drejt qendrave kryesore të cilat ofrojnë reliev më të përshtatshëm dhe më të urbanizuara.

## 1.2 Territori dhe mjedisi

### 1.2.1 Vlerësim i kushteve fizike

Terreni i Bashkisë Mat është në përgjithësi terren kodrinoro- malor dhe ka lartësi nga 100 deri në 2,200 m mbi nivelin e detit. Terreni i lartë shtrihet në kufirin lindor dhe kufirin perëndimor të bashkisë, ndërkohë që qendra e bashkisë është në formën e një ultësire, që njihet si Ultësira e Burrelit[1].

Kjo ultësirë është e gjatë 40 km dhe arrin një gjerësi që varion nga 5-15 km nga Jugu në Veri. Relievi i saj është kodrinor, që lëviz në kuotat 150-500 m. Ultësira fillon nga Klosi e përfundon në Rrëshen, me shtrirje VP-JL. Në Lindje të ultësirës vendoset masivi ultrabazik i Bulqizës si dhe Gëlqerorët e Kretës, kurse në Perëndim zotërojnë Gëlqerorët Triasikë-Jurasikë dhe ofiolitet e malit të Skënderbeut e periferisë së tij.

Vendbanimet në bashki përgjithësisht janë të përqëndruara në zonën qendrore të ulët. Kjo shpërndarje ka ardhur si rrjedhojë e terrenit të lartë në kufinjtë e bashkisë për shkak të vargmaleve të ndryshme që rrethojnë zonën. Në anën perëndimore, kodrat në territorin e Bashkisë Mat janë vazhdimësia e Vargmalit të Dajtit, ndërkohë në anën lindore kemi vazhdimin e Maleve të Lurës.

Bashkia Mat lidhet me pjesët e tjera të territorit të Shqipërisë me anë të disa rrugëve interurbane kryesore. Rruga interurbane Burrel-Rrëshen e cila lidh qytetin e Burrelit me qytetin e Rrëshenit dhe që më pas shërben dhe si hyrje në autostradën "Rruga e Kombit".

Figura 7: Pozicioni gjeografik i Bashkisë Mat në rajon




**Burimi:** Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2016

- Relievi

Terreni i lartë në kufinjtë e bashkisë është për shkak të vargmaleve të ndryshëm që rrethojnë zonën. Në anën perëndimore, kodrat në territorin e Bashkisë Mat janë vazhdimësia e Vargmalit të Dajtit, ndërkohë në anën lindore kemi vazhdimin e Maleve të Lurës.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

Kjo pozitë e ndërmjet dy zonave më të larta, ka ndikuar në shpërndjarjen e vendbanimeve në bashki, pasi ato hasen më shpesh në zonën qendrore të ulët dhe përgjatë rrjedhës së lumit Mat, dhe përrenjve furnizues të tij.

Hartat e mëposhtme paraqesin leximin e terrenit përmes pjerrësisë në përqindje dhe lartësisë në metra. Sic mund të shihet nga këto lexime, kuptohet që pjesa më e lartë është pikërisht në kufinjtë lindorë dhe perëndimore. Ky lexim i territorit ndihmon për të kuptuar jo vetëm gjendjen ekzistuese në bashki, por paraqet edhe potenciale për të ardhmen për shfrytëzimin e turizmit malor.

Figura 8: Harta e pjerrësive në përqindje e Bashkisë së Matit




**Burimi:** Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2016

Figura 9: Harta e relievit dhe e hidrografisë së bashkisë Mat




**Burimi:** Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2016

- Klima

Bashkia Mat karakterizohet nga klima Mesdhetare në zonën fushore dhe ajo Mesdhetare Kontinentale në zonën malore. Zonat fushore kanë verë të nxehtë dhe të thatë, ndërsa dimri është relativisht i butë, pasi zbutja e temperaturave bëhët edhe nga prania e trupave të mëdha ujorë në zonë.

Në zonat malore, ku kemi klimë më të ashpër, temperaturat minimale në dimër arrijnë në -15 $^{o}$C dhe në verë kemi temperatura maksimale 27 $^{o}$C. Klima është me dimër të lagësht, me rreshje dëbore, ku trashësia e dëborës arrin nga 1-2 m dhe vera është e freskët dhe e thatë.

Për sa i përket rrezatimit diellor, Bashkia Mat ka një mesatare vjetore[2] që shkon nga 1,400 deri në 1,600 kËH/m$^2$. Zona lindore e bashkisë, më saktë zonat lindore të njësive administrative të Ulëzës, Bazit, dhe Komsisë janë zonat ku kemi më pak rrezatim diellor në vit, ndërkohë që pjesa e tjetër e bashkisë ka më shumë rrezatim. Mesatarja e orëve me diell në vit në këtë bashki varion nga 2,300-2,500 orë.

Nga një shikim mbi të dhënat e reshjeve të viteve të fundit[3], shohim se zonat më të thata në këtë bashki janë zonat në lindje, ndërkohë që qendra dhe zonat perëndimore të bashkisë kanë pasur më shumë reshje.

Nga analiza e mëparshme e terrenit, kuptojmë që zona është e mbrojtur nga erërat qe fryjnë nga drejtimi Lindje- Perëndim, pasi këtu kemi ngritjet më të larta në terren. Gjithsesi, territori i bashkisë është i ndikuar nga erërat Veri- Jug, pasi në këtë drejtim shtrihet edhe pjesa e ultësirës.

Megjithatë, duke qënë se po në këtë zonë kemi edhe sipërfaqet më të mëdha ujore, prania e tyre ndihmon në krijimin e një mikro klime më të butë.

Figura 10: Harta[4] e Rrezatimit Diellor




**Burimi:** AKBN[5]; **Përpunoi:** Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2016

Mirëkuptimi i këtyre faktorëve, ndihmon në përcaktimin e zonave ku do të zhvillohen si pika gjeneruese ekonomiko- financiare për bujqësinë dhe blegtorinë.

Figura 11: Harta e Reshjeve




**Burimi:** AKBN; **Përpunoi:** Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2016

- Hidrografia

Bashkia e Matit është e pasur nga ana hidrografike. Baseni i pasur i lumit të Matit kalon pothuajse në të gjithë territorin e bashkisë. Ky basen është një sistem[6] kompleks i përbërë edhe nga përrenj dhe proska sezonale të cilat gjatë periudhës së shkrirjes së dëborës dhe gjatë reshjeve intensive kthehen në të rrëmbyeshëm.

Lumi i Matit[7] buron nga mali i Kaptinës së Martaneshit. Lumi ka një gjatësi prej 144 km, një sipërfaqe pellgu ujëmbledhës 2,441 $km^2$ dhe një lartësi mesatare të pellgut prej 746 m.

Që nga burimet e deri në afërsi të Klosit, Mati kalon nëpër gryka të ngushta. Përtej Klosit lumi hyn në një luginë të gjerë në veri të Burrelit, e deri në grykën e Shkopetit ai njësohet më liqenin e Ulzës dhe atë të Shkopetit, të cilët shërbejnë si rregullatorë artificialë të regjimit të Matit. Pas grykës së Shkopetit, Mati fillon të zgjerohet derisa hapet në fushën bregdetare. Prurja mesatare shumëvjeçare e lumit Mat në derdhje në det është 103 $m^3$/sek, gjë që i përgjigjet një moduli prej 42.2 l/s/$km^2$. Koeficienti i rrjedhjes për të gjithë pellgun ujëmbledhës është 0.80. Prurjet e tij maksimalë lidhen me reshjet ë shiut e shkrirjen e borës.

Në zonë kemi edhe disa përrenj si:

- Përroi i Gostimës, NjA Komsi
- Përroi i Varoshit, NjA Lis
- Përroi i Zallit të Malthit, NjA Derjan
- Përroi i Urakës, NjA Rukaj

Liqenet e Ulzës dhe të Shkopetit janë liqenet kryesore në këtë bashki dhe janë krijuar artificialisht nga njeriu. Ato janë pasojë e ndërtimit të hidrocentraleve mbi lumin Mat. Hidrocentrali i Ulzës u vu në punë në 1958 ndërsa ai i Shkopetit në 1963. Këto hidrocentrale

përveçse bëjnë të mundur shfrytëzimin e ujit për energji, kanë krijuar edhe peizazhe liqenore të cilat paraqesin potencial për zhvillimin e turizmit në zonë.

1.2.2 Metabolizmi i territorit

Analiza e Metabolizmit trajton flukset në territor/qytet urban. Sipas Nenit 2, pika 19 e VKM nr. 671 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", metabolizmi i territorit është një model që përdoret për identifikimin dhe analizimin e flukseve të materialeve dhe energjisë brenda territoreve të caktuara. Ky model u ofron studiuesve një kuadër nëpërmjet të cilit të studiojnë ndërveprimet e sistemeve natyrore dhe njerëzore në rajone të caktuara. Gjatë kësaj analize flukset që do të merren për tu analizuar janë: fluksi i energjisë, fluksi i ujit, fluksi i ushqimit dhe fluksi i mbetjeve. Analiza realizohet duke identifikuar hyrjet dhe daljet për secilin fluks. Hyrjet dhe daljet e secilit fluks krijojnë një tablo të plotë të mënyrës së funksionimit të territorit, duke evidentuar potencialet dhe burimet që e bëjnë territorin të funksionojë si një i tërë.

Burimet e energjisë ndikojnë në të gjithë vendin, pavarësisht territorit lokal (bashkisë/ njësisë administrative) ku ndodhen. Gjithashtu këto burime menaxhohen në nivel qendror. Fluksi i ujit tregon sasinë e ujit që qarkullon në sistemin urban (bashkinë). Uji që gjendet në një sistemin urban (uji që analizon fluksi i ujit), përbëhet nga burimet nëntokësore (që nuk i përkasin territorit të një bashkie nga ana administrative) dhe burimet sipërfaqësore. Uji kalon në disa sisteme të ndryshme urbane. Në këtë rast, kur kalon në sisteme të ndryshme urbane (rasti i lumenjve), sjell me vete edhe ndotje që merr gjatë rrugës. Burimet ujore, në vendin tonë, menaxhohen në nivel baseni ujëmbledhës dhe në nivel kombëtar. Mbetjet që gjenerohen në territor janë të ndryshme. Mbetjet menaxhohen në nivel vendor dhe qendror. Fluksi i mbetjeve tregon për sasinë e prodhuar të mbetjeve në territori dhe ripërdorimin e tyre (ricikimi, përpunim dhe ripërdorim). Ushqimet janë element i jetik i territorit urban. Ato gjenerohen nga importet dhe nga prodhimet brenda vendit. Gjithashtu një pjesë e produkteve të prodhuara brenda vendit eksportohen në vendet e tjera. Fluksi i ushqimit tregon raportet ndërmjet importit, prodhimit, konsumit, eksportit dhe humbjes.

*Fluksi i Ushqimit*

Në fluksin e ushqimit të Bashkinë Mat, do të analizojmë të dhënat bujqësore dhe blegtorale, që prodhohen në territor. Produktet e prodhuara, kryesisht shkojnë në tregjet lokale dhe rajonale dhe një pjesë jo e vogël e këtyre produkteve hidhet (shpërdorohet). Në Bashkinë Mat nuk ka pika grubullimi për produket bujqësore dhe blektorale, gjithashtu nuk ka vlerë të sasisë së këtyre produkteve që shkon në tregjet rajonale dhe lokale. Të dhënat për importet dhe eksportet janë në nivel kombëtar, pra nuk ka shifra për produktet që hyjnë apo dalin në territorin e bashkive.

Struktura e tokës është e favorshme për mbjelljen e produkteve bujqësore dhe blektorale. Sipas të dhënave të bashkisë, toka bujqësore zë një sipërfaqe prej 64.6 km[28]. Në të gjithë territorin dominojnë tokat e klasave IV-V dhe VI-VII. Pra cilësia e tokës bujqësore është e lartë ose mesatare. Kulturat bujqësore më të favorshme për tu kultivuar janë kryesisht arrorët dhe fruat ndërkohë produktet blegtorale përftohen krysisht nga të dhirtat.

Tabela 1: Prodhimet bujqësore dhe blektorale në territorin e Matit

| Përbërës Niveli I | Përbërës Niveli II | Treguesit | | Njësia hapësinore | Burimi i të dhënave |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Import | Prodhim (ton) | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Prodhim Bimor** | Prodhimet e arave | Drithëra | | 6,950 | Bashkia Mat | DRB |
| | | Perime | | 29,192 | Bashkia Mat | DRB |
| | | Patate (të njoma+ të thata) | | 8,800 | Bashkia Mat | DRB |
| | | Fasule | | 3,110 | Bashkia Mat | DRB |
| | | Bimë industriale | | | Bashkia Mat | DRB |
| | | Foragjere | | 126,788 | Bashkia Mat | DRB |
| | Prodhime në serra | Perime | | 59 | Bashkia Mat | DRB |
| | Drufrutorë | Pemë frutore | | 2,392 | Bashkia Mat | DRB |
| | | Ullinj | | | Bashkia Mat | DRB |
| | | Agrume | | | Bashkia Mat | DRB |
| | | Rrush gjithësej | | | Bashkia Mat | DRB |
| **Prodhimi Blektoral** | Prodhim Blektoral | Qumësht | | 29,046 | Bashkia Mat | DRB |
| | | Mish (gjedhi, derri, shpendësh, dele, dhije) | | 3,854 | Bashkia Mat | DRB |
| | | Lesh (dhije, dele) | | 73 | Bashkia Mat | DRB |
| | | Vezë (000) | | 12,329 | Bashkia Mat | DRB |
| | | Mjaltë | | 26 | Bashkia Mat | DRB |

Burimi: Bashkia Mat, 2016[9]

Figura 12: Harta e Fluksit të Ushqimit




Burimi: Bashkia Mat, Metro POLIS dhe DLDP, 2016

*Fluksi i Ujit*

Ky fluks do të analizojë bilancin e prodhimit të ujit, burimet sipërfaqësore dhe nëntokësore në territorin e Bashkisë Mat, me konsumin të tij. Përdorimi i ujit është i gjërë. Uji përdoret për qëllime teknologjike, për pirje, *imbotilim (uji i mbushur në shishe)*, etj,. Uji përdoret nga banorët, bizneset, industritë, institucionet etj. Për të bërë një llogaritje të përafërt të sasisë së ujit që ndodhet në organizmin urban (në këtë rast, territorin e Bashkisë Mat) mund të marrim sasinë totale të ujërave në territor (burime sipërfaqësore dhe nëntokësore) dhe sasinë e përdorimit të tyre nga konsumatorë të ndryshëm.

Reshjet mesatare vjetore në Mat varjojnë nga 1500mm më 2000mm shi në vit. Sezoni me sasinë më të lartë të reshjeve është vjeshta dhe pranvera. Reshjet ndikojnë në ushqimin e akuifereve të Matit, duke rritur prurjet e burimeve ujore nëntokësore dhe sipërfaqësore. Ujërat sipërfaqësore zënë 18 $km^2$ në të gjithë sipërfaqen e territorit. Lumi më i rëndësishëm është lumit Mat. Sasia e ujërave nëntokësore llogaritet sipas prurjes së burimeve që shfrytëzohen në territor[10]. Sasia e ujërave nëntokësore që shtfrytëzohet për pijë aktualisht në territor varion nga 53.5 l/s në 263.5 l/s.

Shërbimet e ujësjellësit që operojnë në territorin e Matit, shfrytëzojnë burimin e Vinjollit dhe burimin e Gurrës së Florinjtë për të furnizuar popullsisë me ujë. ***NjA Burrel***, shërbimin e furnizimit të banorëve me ujë e realizon nëpërrmjet ndërmarrjes së Ujësjellës-Kanalizimeve Mat.

Uji që shfrytëzohet për furnizimin e banorëve merret nga burimi i Vinjollit. Sasia që nxirret nga ky burmi varion nga 40 l/s deri në 250 l/s. Ky ujësjellës furnizon gjithashtu banorët e ***NjA Lis*** dhe ***NjA Macukull***. Në ***NjA Baz,*** sipas Planit të Zhvillimit Lokal 2009-2014, 15% e popullsisë së (një pjesë e territorit të fshatit Karicë), furnizohet me ujë nga Ujësjellësi i Karicës (ndërtuar në vitin 2001). Pjesa tjetër e popullsisë përdorin puse për ujin e pijëshëm [11]. Popullsia në ***NjA Derjan*** e siguron vetë ujin e pijshëm nëpërmjet puseve[12]. Gjithashtu, popullsia në ***NjA Komsi*** e siguron vetë ujin e pijëshëm nëpërmjet puseve [13]. Në ***NjA Rukaj*** ndodhen 4 rezervuare dhe 6 burime ujore[14]. Në ***NjA Ulëz*** shërbimi i ujësjellësit ofrohet nga Sasia mesatare e ujit të gjeneruar është 133,134$m^3$/vit. Sasia e ujit që shtfrytëzohet për të furnizuar banorët me ujë është 20.52$m^3$/orë.

Në Ujësjellës-Kanalizimin Mat Sh.A. numri i abonenteve sipas enteve publike, abonenteve familjare, bizneseve janë si më poshtë:

- Nr. i abonenteve familjare në qytet është 3,197
- Nr. i abonenteve familjare në fshat është 761
- Nr. i abonenteve të biznesit është 362
- Nr. i abonenteve për entet publike është 65.

Mënyra më e përhapur për sistemin e ujërave të zeza është me gopa septike individuale në pothuajse të gjithë NjA-të. ***NjA Burrel*** dhe ***NjA Ulëz*** e ofrojnë shërbimin e kanalizimeve të ujërave të ndotura duke mbuluar rreth 80% të territorit me shërbim.

Figura 13: Harta e Fluksit të Ujit




Burimi: Metro POLIS dhe DLDP, 2016

*Fluksi i Energjisë*

Fluksi i energjisë tregon sasinë e prodhuar dhe konsumin e energjisë në territorin e Bashkisë Mat. Gjithashtu, ky fluks tregon edhe për energjinë potenciale në territor, për të minimizuar në këtë mënyrë disa burime energjie të cilat kanë konsum më të lartë. Energjitë potenciale në bashkinë Mat janë: Energjia hidrike, energjia diellore dhe energjia e biomasës. Aktualisht porodhimi i energjisë mbështetet kryesisht në energjinë hidrike dhe energjinë e biomasës, që konsiston vetëm në energji të përftuar nga djegia e druve.

- <u>Energjia Hidrike</u>

Siç theksohet edhe në fluksin e ujit, territori i Bashkisë Mat përshkohet nga elemente të rëndësishme ujore siç është lumi Mat. Mbi këtë lum janë ndërtuar dy hidrocentrale të mëdhenj me rëndësi kombëtare, Hidrocentrali i Ulëzës dhe Hidrocentrali i Shkopetit, të cilët mund të prodhojnë nga 10MW deri në 50 MW[15] energji. Gjithashtu janë ndërtuar hidroecntralë të vegjël në rrjedhat ujore të bashkisë. Fuqia prodhuese e të cilëve varion nga 0-1 MW ose nga 1-10MW.

Furnizimi i popullsisë me energji elektrike aktualisht është i tillë: ***NjA Baz,*** furnizohet me enrgji elektrike nga Nënstacioni i Ulëzës; Në ***NjA Derjan*** ndodhen dy hidrocentrale të vegjël që shfrytëzohnen për prodhimin e energjisë elektirke[16]. Furnizimi i banorëve me energji elektrike është problematik. ***NjA Komsi,*** furnizohet me enrgji elektrike nga nënstacioni i Komsisë. Në ***NjA***

***Macukull*** shfrytëzohen 2 përrenj në të cilët janë instaluar 2 HEC-e për prodhimin e energjisë elektrike. Në ***NjA Rukaj*** shfrytëzohet 1 përrua në të cilin është instaluar një HEC, për prodhimin e energjisë Elektrike.

Kosnumi i energjisë elektrike sipas të dhënave të OSSHE në Bashkinë Mat dhe Klos (vlera është e llogaritur për të dy bashkitë) është 2,291,740 kWh (të dhënat e OSSHE janë të pandara për secilën bashki veç e veç; sipas tabeleës së mëposhtëme). Humbjet në rrjet janë të larta duke qënë se rrjeti është i amortizuar dhe ka nevojë për rehabilitim dhe zëvendësim në pjesët e dëmtuara. |Nënwstacionet për shpërndarjen e energjisw elektrike në Mat janë:

- Nënstacioni i Komwsisw 220/ 110/ 10 kV
- Nënstacioni Ulëz 110/ 35/ 6kV dhe
- Nënstacioni Shutrri 110/ 35/ 6 kV (Njësia Administrative Rukaj)[17]

Tabela 2: Sasia e energjisë së konsumuar sipas të dhënave të OSSHE

| **Kategoria** | **Nr. Abonentëve** | **Energjia e konsumuar (kWh)** |
|---|---|---|
| Buxhetor dhe jo buxhetor | 212 abonente | 197 380 |
| Privat | 1093 abonente | 571 620 |
| Familjare | 10810 abonente | 1 522 740 |

Burimi: OSSHE, 2015

- <u>Energjia e diellit</u>

Mesatarja vjetore e rrezatimin varion nga 1,200 kWH/m$^2$ deri nw 1,600 kWH/m$^2$. Ndërkohë mesatarja ditore e rrezatimit diellor varion nga 3.7kWH/m$^2$ deri në 3.97 kWH/m$^2$. Siç mund të kuptohet është mjaft e favorshme të shfrytëzohet energjia diellore. Për të nxitur përdorimin e energjive alternativa, bashkia mund të përdori politika incentivuese për banorët dhe bizenest. Kjo do të reduktonte mbishfrytëzimin e lumenjëve duke instaluar HEC-e në rrjedhat ujore.

- <u>Energjia e bimoasës</u>

Referuar Direktivës 2009/28/EC, energjia e biomasës është: ndarja e produkteve të biodegradueshme, mbetjeve dhe mbeturinave me origjinë biologjike nga bujqësia (duke përfshirë lëndët e bimëve dhe kafshëve), pyjet dhe industritë që përfishjnë peshkimin dhe akuakulturën, gjithashtu ndarja biodegraduese e mbetjeve industriale bashkiake[18].

Nëpërmjet proceseve të ndryshme të transformimit si: djegia, gazifikimi dhe piroliza, biomasa shëndërrohet në biokarburant, biongrohje, ose bio-energji elektrike.

Burimet e përftimit të biomasës janë:

1. Biomasa nga bimët energjetike
   - Bimët barishtore vjetore (drithi, elbi, tërshëra, thekra dhe drithëra të tjera, panxhar sheqeri, kallam sheqeri, foragjerët, speciet barishtore të tërfilit); niseshteja e prodhuar nga farat, zhardhokët dhe kërcejet e këtyre bimëve mund të përdoren për prodhimin e biokarburanteve
   - Bimët barishtore shumëvjeçare (xunkthet dhe kallamet që rriten shpejt)
   - Bimët vajore
   - Bimët linjoceluloze (misri dhe soja, plepi, shelgu)
2. Biomasa nga mbeturinat dhe mbetjet. Materialet e mbetjeve që përdoren për të prodhuar energji, prodhohen nga industritë, mbetjet e ngurta bashkiake, sektori i bujqësisë etj,.

Përdorimi i mbetjeve për të prodhuar energji ndikon në reduktimin e sasisë së mbetjeve që hidhen në mjedis. Përmbajtja tipike energjike për këtë kategori është 10.5-11.5 MJ/kg.

- Mbetjet biogjenetike nga sektorët urbane dhe industriale
- Mbeturinat dhe mbetjet nga sektori i bujqësisë (mbeturinat e fushës dhe mbeturinat e procesit)
- Mbeturinat dhe mbetjet nga sektori i pyjeve (mbetjet e drurit nga pyjet)[19]

Aktualisht në territorin e Bashkisë Mat energjia e biomasës gjenerohet vetëm nga djegia e druve. Kjo energji e prodhuar përdoret kryesisht për ngrohej dhe gatim dhe më së shumti në zonat rurale. Pyjet në Bashkinë Mat zënë një sipërfaqe prej 37, 159ha. Në Mat biomasa mund të përftohen nga mbetjet e kafshëve dhe bimëve (në këtë mënyre shmanget edhe dëmtimi i pyjeve), mbetjet bashkiake (nëse diferencimi i tyre do filloj të bëhet që në burim), mbetjet industriale, bimët barishtore vjetore (drithi, foragjerët, tërfili), bimët barishtore shumëvjeçare (xungthet) dhe bimët linjoceluloze (misri).

Figura 14: Harta e Fluksit të Energjisë




Burimi: Metro POLIS dhe DLDP, 2016

*Fluksi i Mbetjeve*

Sipas VKM 175/11 mbetjet bashkiake ndahen në: mbetjet organike, dërrase, letër, karton, plastikë me densitet të ulët, plastikë me densitet të lartë, qelq, tekstile, metale me ngjyrë, metale pa ngjyrë, mbetje spitalore, gomë, inerte, mbetje nga materiale sanitare, mbetje nga pajisje

elektrike dhe elektronike MPEE, bateritë dhe mbetje nga produkte shtazore. Për të llogaritur sasinë e gjeneruar sipas këtyre kategorive bëhet e vështirë, pasi mbetjet nuk ndahen në burim. Megjithatë, nga të dhënat e bashkisë mbetjet bashkiake që gjenerohen në total në territorin e bashkisë Mat paraqiten si mëposhtë:

Tabela 3: Mbetjet që gjenerohen në Bashkinë Mat

| | Emertimi | Njësia | Nr.Banor | Norma kg | Kg/ditë | Kg/Ditë/vit | Ton/vit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| NjA Burrel | Nr. Banorë | frymë | 17,190 | 0.7 | 12,033 | 4,392,045 | 4,392 |
| | Biznes i vogël | copë | 547 | 10 | 5,470 | 1,996,550 | 1,997 |
| | Biznes i madh | copë | 70 | 10 | 700 | 255,500 | 256 |
| | Institucione | copë | 21 | 12 | 252 | 91,980 | 92 |
| | **Shuma** | | | | **18,455** | **6,736,075** | **6,737** |
| NjA Ulëz | Nr. Banorë | frymë | 1,875 | 0.4 | 750 | 273,750 | 274 |
| | Biznes i vogël | copë | 8 | 10 | 80 | 29,200 | 29 |
| | Biznes i madh | copë | 8 | 10 | 80 | 29,200 | 29 |
| | Institucione | copë | 6 | 12 | 72 | 26,280 | 26 |
| | **Shuma** | | | | **982** | **358,430** | **358** |
| NjA Rukaj | Nr. Banorë | frymë | 3,348 | 0.4 | 1,339 | 488,735 | 489 |
| | Biznes i vogël | copë | 10 | 10 | 100 | 36,500 | 37 |
| | Biznes i madh | copë | 1 | 10 | 10 | 3,650 | 4 |
| | Institucione | copë | 10 | 12 | 120 | 43,800 | 44 |
| | **Shuma** | | | | **1,569** | **572,685** | **574** |
| NjA Derjan | Nr. Banorë | frymë | 1,622 | 0.4 | 649 | 236,885 | 237 |
| | Biznes i vogël | copë | 4 | 10 | 40 | 14,600 | 15 |
| | Biznes i madh | copë | 2 | 10 | 20 | 7,300 | 7 |
| | Institucione | copë | 5 | 12 | 60 | 21,900 | 22 |
| | **Shuma** | | | | **769** | **280,685** | **281** |
| NjA Lis | Nr. Banorë | fryme | 4,665 | 0.4 | 1,866 | 681,090 | 681 |
| | Biznes i vogël | copë | 19 | 10 | 190 | 69,350 | 69 |
| | Biznes i madh | copë | 17 | 10 | 170 | 62,050 | 62 |
| | Institucione | copë | 9 | 12 | 108 | 39,420 | 40 |
| | **Shuma** | | | | **2,334** | **851,910** | **852** |
| NjA Komsi | Nr. Banorë | frymë | 5,209 | 0.4 | 2,084 | 760,514 | 761 |
| | Biznes i vogël | copë | 28 | 10 | 280 | 102,200 | 102 |
| | Biznes i madh | copë | 20 | 10 | 200 | 73,000 | 73 |
| | Institucione | copë | 9 | 12 | 108 | 39,420 | 39 |
| | **Shuma** | | | | **2,672** | **975,134** | **975** |
| NjA Baz | Nr. Banorë | fryme | 3,086 | 0.4 | 1,234 | 450,410 | 450 |
| | Biznes i vogël | copë | 7 | 10 | 70 | 25,550 | 26 |
| | Biznes i madh | copë | 1 | 10 | 10 | 3,650 | 4 |
| | Institucione | copë | 9 | 12 | 80 | 29,200 | 29 |
| | **Shuma** | | | | **1,394** | **508,810** | **509** |
| NjA Macukull | Nr. Banorë | fryme | 1,548 | 0.4 | 619 | 226,008 | 226 |
| | Biznes i vogël | copë | 21 | 10 | 210 | 76,650 | 77 |
| | Biznes i madh | copë | 1 | 10 | 10 | 3,650 | 4 |
| | Institucione | copë | 5 | 12 | 60 | 21,900 | 22 |
| | **Shuma** | | | | **899** | **328,208** | **329** |
| BASHKIA MAT | Nr. Banorë | frymë | 17,190 | 0.7 | 12,033 | 4,392,045 | 4,392.05 |
| | Nr. Banorë Nj.A | frymë | 21,353 | 0 | 8,541 | 3,117,538 | 3,117.54 |
| | Biznes i vogël | copë | 644 | 10 | 5,470 | 1,996,550 | 1,996.55 |
| | Biznes i madh | copë | 120 | 10 | 700 | 255,500 | 255.50 |
| | Institucione | copë | 74 | 12 | 252 | 91,980 | 91.98 |
| | **Shuma** | | | | **26,996** | **9,853,613** | **9,854** |

Burimi: Bashkia Mat, 2016

Figura 15: Sasia e mbetjeve urbane për banorë në vit në bashkinë Mat sipas kategorive (Ton/Vit)




Burimi: Bashkia Mat, 2016

Në territorin e Bashkisë Mat nuk rezulton të ketë kompani ricikluese. Vendepozitimi i mbetjeve në Mat është jashtë kushteve teknike (josanitar). Të gjitha llojet e mbetjeve depozitohen aty të padiferencuara dhe shpesh digjen duke shkaktuar ndotje në ajër dhe tokë.

Figura 16: Harta e Fluksit të Mbetjeve




Burimi: Metro POLIS dhe DLDP, 2016

### 1.2.3 Mjedisi dhe ekosistemet

- Burimet ujore dhe basenet

Burimet sipërfaqësore

Mati ka një rrjet të pasur hidrik me lumenj, rezervuarë të cilëve u shtohet edhe një rrjet i gjerë kanalesh vaditëse-kullimi. Territori i Bashkisë së re përshkohet nga Lumi Mat nga jugu në veri-perëndim dhe ka një numër të konsiderueshëm rezervuarësh në të gjitha Njësitë Administrative. Në Bashki nuk mungojnë as liqenet artificial si ai i Ulzës dhe i Shkopetit, të formuara nga ndërtimi i digave përgjatë rrjedhës së lumit Mat.

Figura 17: Burimet Ujore Mat




**Burimi:** SHGJSH; **Përpunoi:** Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2016

***Lumi Mat*** përshkon mes përmes Bashkinë e Matit. Lumi Mat hyn në Bashki në afërsi të Batrës së Vogël në jug dhe përshkon territorin e komunave Lis, Burrel, Rukaj deri në Ulzë në veri, ku del nga territori i Bashkisë në një gjatësi prej afërsisht 35.8 km. Lumi Mat buron nga mali i Kaptinës të komunës së Martaneshit, në Bashkinë e Bulqizës. Ky lum ka një gjatësi prej 144 km dhe pellgu ujëmbledhës i tij ka një sipërfaqe prej 2,441 km$^2$. Lumi i Matit formohet dhe përshkon Bashkinë e Bulqizës, më tej shërben si kufi ndarës midis Bashkisë së Klosit dhe Dibrës dhe kalon në mes të Bashkisë së Matit. Në dalje të Bashkisë së Matit kalon në Qarkun e Lezhës, bashkohet me lumin e Fanit (Fan i Madh dhe Fan i Vogël) pranë Rrëshenit e vazhdon më tej për t'u derdhur në detin Adriatik. Nga burimi deri në afërsi të Klosit lumi kalon nëpër një terren me gryka të ngushta. Në Bashkinë e Matit lumi rrjedh nëpër një luginë të gjerë deri në NjA Rukaj ku lumi njehësohet me liqenin e Ulzës dhe Shkopetit (liqene të formuar nga ndërtimi i digave) dhe më tej lumi Mat rrjedh nëpër fushën bregdetare. Lartësia mesatare e pellgut ujëmbledhës së lumit Mat është 746 m mbi nivelin e detit. Në Bashkinë e Matit ky lum ka dhe degët e tij, si : Përroi i Gostrimës (NjA Komsi), Përroi i Varoshit (NjA Lis), Përroi i Zallit të Malthit (NjA Derjan) dhe Përroi i Urakës (NjA Rukaj).

Mati ka një numër të konsiderueshëm rezervuarësh të cilët përqëndrohen kryesisht në pjesën Jugore dhe Jug-Lindore të territorit, ndërmjet vendbanimeve Komsisë dhe Bazit në pjesën Perëndimore, Derjanit dhe Macukullit në skajet më Veriore dhe Lisit në skajin Jugor. Ndër rezervuarët më të mëdhenj përmenden:

- *Rezervuari i Midhës*: ky rezervuar ndodhet në pjesën jugore të Bashkisë, në NjA Komsi.
- *Rezervuari i Rreth Bazit* i cili ndodhet në perëndim të Bashkisë Mat, i shtrirë në pjesën kodrinore të NjA Baz.
- *Rezervuari/Liqeni i Ulzës* i cili shtrihet në pjesën veri-perëndimore të bashkisë së re dhe shërben si kufi ndarës me bashkinë e Mirditës. Më konkretisht, ky rezervuar shtrihet ndërmjet NjA Rukaj në lindje dhe Baz në jug-perëndim.
- *Rezervuarë të tjerë:* rezervuarët e tjerë në territorin e bashkisë gjenden në afërsi të fshatit Derjan, Mallunxës, Shqefnit, Shoshaj, Fires, Laç dhe Vashkuqe.

***Rrjeti i kanaleve vaditëse-kullimi***: Bashkia shtrihet në pjesën kodrinore-malore të vendit, e cila dallohet për nivel lartësie mbi nivelin e detit e cila varion nga 150-500 m si dhe për një sipërfaqe të konsiderueshme bujqësore. Për përdorimin e tyre, janë hapur një numër i madh kanalesh për ujitje dhe kullim, të domosdoshëm për përdorimin e këtyre tokave për bujqësi. Me përjashtim të Burrelit, i gjithë territori i bashkisë së re mbulohet nga rrjeti vaditës-kullues.

- Gjendja e burimeve ujore sipërfaqësore (problematikat)

Në dy dhjetëvjeçarët e fundit në vendin tonë, burimet ujore dhe kryesisht lumenjtë, janë shfrytëzuar për bujqësi, industri, për materialin e tyre inert dhe për sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Si rrjedhojë, sot lumenjtë vuajnë pasojat e një keqmanaxhimi të gjatë që janë kryesisht *1) ndyshime në hidro-morfologjinë e lumenjve; 2) humbje të florës & faunës ujore, dhe 3) ndotje.*

Ndërhyrjet në lumenj janë të shumëllojshme, si në shtrat, ashtu edhe në ndryshimin ose zhvendosjen e mbulesës bimore; marrjen e materialeve inerte, rërë, zhavorr, gurë ose plisa; ndërtime afër lumenjve; hedhje apo depozitim i materialeve inerte që dalin nga prishja e objekteve ndërtimore; gërmime të ndryshme, si dhe veprimtari të tjera që prodhojnë mbetje; shkarkime të ujërave të ndotura urbane e industriale të patrajtuara, veprimtari të cilat ndalohen me ligj[20]. Të gjitha këto kanë shkaktuar dëmtime të hidromorfologjisë së lumenjve që janë vërtetuar nga studime të ndryshme, ndër të cilat, edhe nga studimet e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar rreth thellimit të shtratit të lumenjve. Një përshkrim i shkurtër i rezultateve të analizës në lumenjtë e Basenit Mat paraqitet më poshtë.

Pellgu i Lumit Mat është monitoruar në 6 pika/profile monitorimi për periudhën 2011-2015. Këto profile janë shpërndarë në Lumin Mat (2 pika) dhe në Lumin Fan (4 pika). Në lumin Mat brenda kufirit administrativ të Bashkisë Mat nuk ka profile të monitoruara.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA KOMBËTARE E TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA
REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

Figura 18: Profilet e monitorimit të gjendjes së lumenjve në Basenin e Lumit Mat




**Burimi:** SHGJSH, 2016

Gjatë këtij studimi është vënë re se në profilin e Luxhës shfaqet një akumulim i vazhdueshëm i materialit të inerteve. Kjo ka ardhur si pasojë e hedhjes së materialeve inerte në shtratin e lumit. Inertet janë hedhur nga gërmimet në rrugë apo nga ndërtimet për hapjen e tuneleve të HEC-eve mbi Lumin Fan. Në Lumin Mat mungojnë prurjet e inerteve si pasojë e ndërtimit të digës së Shkopetit.

Ndër problematikat kryesore të nxjerra në pah nga ky monitorim është prania e ***erozionit fundor*** në segmente të ndryshme të lumit, në forma dhe intensitete të ndryshme (figura më poshtë). Në të gjitha pikat ka patur erozion të theksuar fundor i cili shfaqet me *ulje të shtratit të lumit*. Më i theksuar është vënë re në *Skuraj* në vitet 2007-2015 (149 cm ulje), i ndjekur nga segmenti i lumit tek Ura e Uzinës (129.8 cm), në profilin e monitoruar në Fierzë (115 cm), dhe në Munaz me 107.1 cm.

Figura 19: Erozioni fundor ndër vite në lumin Mat




**Burimi:** SHGJSH, 2016

Nga studimi i bërë nga SHGJSH, por dhe nga analizat në terren janë vënë re problematikat kryesore, të cilat janë[21]:

- Ulje të shtratit për shkak të erozionit fundor.

- Shfrytëzimi pa kriter i inerteve në të gjithë gjatësinë e lumit.
- Shtimi i fenomeneve si rrëshqitjet, shëmbjet e brigjeve, etj.
- Ndotje të ujit (nga inertet, ndotje baktereologjike të ujit etj.
- Dëmtim të florës dhe faunës së lumit
- Dëmtim të peizazhit lumor
- Erozion të tokës bujqësore në fshatrat : Kodër Qerre, Lis, Gjalush, Vinjoll, Derjan-Urxallë, Dukagjin, Gjocaj, Shqefën, Shëlli, Vig, Batër e Madhe dhe e Vogël, Frankth etj.
- Ulje e nivelit të ujërave nëntokësore (në pusshpimet për marrjen e ujit).
- Rrezikime të objekteve inxhinierike si urat, veprat e mbrojtjes, vepra të marrjes së ujit etj.

**Dëmtimi i sistemit lumor nga HEC-et**: Pellgu i Matit (përfshirë dhe lumin Fan) është shfrytëzuar gjerësisht për prodhimin e energjisë elektrike nëpërmjet ndërtimit të HEC-ve. Në fakt, në pellgun e Matit deri më tani janë ndërtuar tre HEC-e, ndërkohë që një HEC është në ndërtim dhe 36 janë planifikuar për t'u ndërtuar.

HEC-et janë ndërtuar në dy furnizuesit kryesorë të lumit Mat (Mat dhe Fan) si dhe në degë të nivelit të dytë (degë të degëve), të cilat shërbejnë si burim kryesor ushqyes për lumenjtë kryesorë, e si rrjedhojë, edhe të lumit Mat. Njëkohësisht, ata shërbejnë edhe si burim i materialit zhavorror për lumenjtë në fjalë.

Figura 20: HEC-et në Pellgun e Lumit Mat




**Burimi**: riverëatch.eu; **Përpunoi**: Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2016

Vetëm në degën e Matit, brenda territorit të Bashkisë Mat deri më tani është janë ndërtuar dy HEC-eve, ndër të cilët HEC-i i Ulzës dhe Shkopetit ndërsa 18 HEC-e të tjerë janë planifikuar për

t'u ndërtuar. Deri në këtë moment nuk ka të dhëna rreth kohës kur është planifikuar ndërtimi i tyre.

HEC-et ndikojnë ndjeshëm në zhvillimin e një lumi. Ndër pasojat më të njohura renditen ndikimi i drejtpërdrejtë në karakteristikat fiziko-kimike dhe biologjike të tij. Konkretisht, mund të përmendim:

- *trasformimin e rrjedhës së lumit* në pjesën e sipërme të digës nga një sistem natyror lumor në *sistem të një rezervuari artificial* me ujëra të ndenjura,
- bllokimin e qarkullimit të peshqve ose specieve të tjera ujore,
- prishjen e ekuilibrave e proceseve fizike dhe habitateve në rrjedhën pas digës,
- ndryshimin e rrjedhës së lumit dhe të prurjeve të sedimentit zhavorror,
- *grumbullimin e sedimentit pas digës* që normalisht do të furnizonte ekosistemet në rrjedhën e poshtme,
- *thellimin e shtratit të lumit,* i cili ul edhe nivelin e ujit në akuifere.

Duke parë numrin e madh të HEC-eve që do të ndërtohen në Lumenjtë e Basenit të Matit (kryesisht në Mat, Fani i Madh dhe i Vogël dhe degët e tyre), mendohet se ndikimi në mjedis dhe në bujqësi në zonat përreth mund të jetë i theksuar. HEC-et mund të sjellin zvogëlimin e rrjedhës së lumit, mjaft e rëndësishme për bujqësi në stinën e verës, ose pakësimin e sasisë së ujërave të disponueshme për ujë të pijshëm dhe sektorë të tjerë, edhe pse ky mbetet objekt studimi në të ardhmen. Vetëm një njohje e mirë e strukturës së digave dhe sasisë së ujërave të rrjedhës së lumit, që ato lënë me rrjedhje të lirë, mund të japë një pasqyrë të qartë të sasisë së ujit, që banorët do të mund të kenë në përdorim në rrjedhën e poshtme të digës (pas digës) në të ardhmen.

**Dëmtime të zonës ripariane**: Si rrjedhojë e mangësive në manaxhimin e lumit apo keqpërdorimit të brezit të tokave përgjatë tij, zona ripariane e Matit ka pësuar dëmtime. Ajo është ngushtuar dhe mungojnë brezat e bimësisë së nevojshme - bimët e ulëta deri tek ato të larta. Duke qenë se rrjedha e mesme dhe e poshtme e tyre përshkon toka bujqësore të kultivuara, në të shumtën e rasteve zona ripariane është *kultivuar si tokë bujqësore*. Faktorë të tillë kanë ndikuar tek pamundësia për të mbrojtur tokën nga prurjet e lumit (përmbytjet), dhe mosndalimin e shkëmbimit të ndotjes mes tokave bujqësore e zonave të banimit kundrejt lumit nga njëra anë dhe ujërave sipërfaqësore dhe akuiferit nga ana tjetër. Gjithashtu, gjatë brigjeve të lumenjve vihet re shembja/dëmtimi i brigjeve ose gërryerja e tyre, që ka rezultuar në humbje të sipërfaqes së tokës (Figura 20). Dëmtime të zonës ripariane janë vënë re në të gjithë seksionin e lumit, i cili shtrihet përmes territorit të Bashkisë Mat, ndërkohë zona fundore e Lumit Mat (jashtë territorit të Bashkisë) ka një mungesë të theksuar të zonave ripariane.

Figura 21: Erozioni në brigjet e Lumit Mat



**Burimi**: Arkiva MetroPOLIS, 2016

**Ndotja**: Gjatë 25 viteve të fundit, në vendin tonë dhe në Bashkinë Mat, lumenjtë dhe kanalet janë përdorur edhe si burime pritëse të ujërave të ndotura krahas përdorimit të brigjeve të tyre si vend-depozitime të mbetjeve të ngurta. Në fakt, gjatë gjithë këtyre viteve, qytetet që përshkohen nga lumi Mat dhe degët e tij e kanë shfrytëzuar këtë lumë për derdhjen e drejtpërdrejtë të ujërave të ndotura urbane dhe rurale të patrajtuara duke e ndotur atë. Përveç ujërave të të ndotura, Lumi Mat ka qenë vazhdimisht nën ndikimin e industrive të ndryshme, të cilat shkarkimet e ujërave të ndotura i kryejnë drejtpërdrejtë në trupin ujor të Matit. Në dhjetëvjeçarët e kaluar në Lumin Mat janë shkarkuar ujërat e ndotura të minierave si dhe të Fabrikës së Ferro-Kromit në Komsi.

Nga monitorimi i kryer në Mat nga AKM, u vu re se ujërat e lumenjve të Basenit të Matit për vlerat e Nevojës Biologjike për Oksigjen (*NBO₅*) nuk janë brenda normave të lejuara[22]. Megjithatë, duke patur parasysh ndotjen e vazhdueshme të lumit nga ujërat e të ndotura, këto vlera tregojnë qartë nevojën për të analizuar $NBO_5$ në lidhje me parametra të tjerë dhe me vendndodhjen e burimeve kryesore të ndotjes në lumë (industrisë, ujërave të të ndotura të zonave të banuara, praninë e metaleve të rënda përkundrejt ushqyesve, etj.). Prania e klorinës dhe metaleve të rënda në ujë zakonisht ngadalëson ose zvogëlon ndjeshëm $NBO_5$, sepse pengon aktivitetin e mikro-organizmave.

Figura 22: Vlerat e $NBO_5$ dhe Oksigjenit të tretur në Basenin e Matit




**Burimi:** AKM, 2015

Si përfundim, rezultatet e monitorimit të ujit tregojnë se ujërat e lumenjve të Matit nuk janë të ndotura thellë. Meqenëse ujërat e lumenjve të basenit të Matit përdoren edhe në bujqësi dhe grumbullojnë plehrat kimike dhe kimikate të tjera të përdorura në bujqësi është e nevojshme monitorimi i vazhdueshëm i parametrave azot dhe fosfor në mënyrë që prezenca e tyre të mos kalojë vlerat e përcaktuara, pasi mund të kthehet në një faktor rreziku për cilësinë e produkteve bujqësore dhe shëndetin e njeriut.

Si rrjedhojë, projektet për shmangien e ndotjes nga lumi (p.sh. derdhjen e ujërave të të ndotura dhe mbetjeve ndustriale, si dhe plehrave kimike në tokën bujqësore) dhe për rehabilitimin e tij duhet të kenë përparësi për bashkinë, së bashku me projektet e bashkëpunimit me bashkitë e tjera që preken nga Baseni i Matit për manaxhimin e integruar të këtij baseni.

- Burimet kryesore të ndotjes së ujërave sipërfaqësore

Kontribuesit kryesore të ndotjes së lumenjve në Mat janë:

- Shkarkimi i drejtpërdrejtë i ujërave të ndotura urbane në sipërfaqe ujore (pa i'u nënshtruar proceseve të pastrimit në impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura);
- Ndotja nëpërmjet gropave septike;
- Venddepozitimi i mbetjeve të ngurta urbane anash rrugës e cila lidh Komsinë me qytetin e Burrelit (depërtimi i shllameve, shpërndarja e mbetjeve në tokë, derdhje aksidentale të mbetjeve të ngurta në ujërat e Përroit të Gostrimës);
- Shkarkimet e ujërave industriale drejpërdrejtë në trupin ujor;
- Shfrytëzimi i shtretërve të lumenjve për materiale inerte;
- Shkarkimet dhe infiltrimet e ujërave të përdorur në sektorin e bujqësisë;
- Shkarkimet e ujërave të larta (niveli i aciditetit në ujërat e shiut është gjithnjë e në rritje si edhe mikroorganizmat dhe mbetjet që mbartin si pasojë e shpëlarjes së pellgut ujëmbledhës).

Secili prej burimeve të ndotjes ka një potencial specifik të ndotjes, i cili përshkon një shteg të caktuar gjatë shpërhapjes së tij në trupin ujor dhe, si përfundim, një mjedis pritës i cili mbart këtë ndotje. Këtu vlen të theksohet se pritësit kryesor i ndotjes së lumenjve janë deti Adriatik dhe më

pak deti Jon. Veçanërisht në deltat e lumenjve vërehen nivele të larta të ndotjes nga mbetjet e ngurta duke rrezikuar kështu florën dhe faunën e të gjithë bregdetit Adriatik dhe atë të lumit Mat.

- Përfundime dhe rekomandime

Mati dallohet për terrenin e kodrinor dhe për burimet e mëdha të mineraleve duke përmendur këtu kromin, gurët gëlqeror dhe të mermerizuar, etj. Zhvillimi i industrisë së nxjerrjes dhe përpunimit të mineraleve e ka favorizuar zhvillimin e sektorit të industrisë ndër vite dhe e kanë shndërruar atë në një ndër territoret më të rëndësishme për prodhimin e mineraleve në vendin tonë. Industria e pasurimit të ferro-kromit është aktive ndër vite në territorin e Bashkisë Mat, ndaj shihet e arsyeshme që të monitorohen ujërat të cilat përdoren në proçeset teknologjike.

Ndërsa nga njëra anë Mati ka këto burime natyrore që ndikojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin e vendit, nga ana tjetër, shumë nga këto burime kanë nevojë për mbrojtje, mirëmbajtje dhe investim. Siç edhe u theksua më sipër, monitorimi i ujërave të Matit nxorri në pah problematikat e këtij lumi të cilat vijnë si pasojë e mungesës së politikave për mbrojtjen e burimeve natyrore dhe lumenjve nga aktivitetet njerëzore. Rezultatet e monitorimit treguan se ujërat e Matit janë të ndotura me nitrate meqenëse ujërat e lumenjve të basenit të Matit përdoren edhe në bujqësi.

Duke qënë se ujërat e lumit Mat përdoren si në bujqësi dhe në industri, konstatohet me rrezik shëndeti i njeriut nëpërmjet konsumit të fruta-perimeve të ndotura me ujin e lumit gjatë kultivimit. Në qoftë se nuk merren masa për uljen e ndotjes së ujërave të Matit, nga një burim uji për bujqësinë, Mati mund të kthehet në një faktor rreziku për cilësinë e produkteve bujqësore dhe shëndetin e njeriut. Si rrjedhojë, është e nevojshme që Bashkia të ndërmarrë projekte që synojnë uljen e ndotjes në lumë si projekte për parandalimin e derdhjes së ujërave të të ndotura në lumë, të mbetjeve industriale, dhe të të gjitha aktiviteteve që ndikojnë në ndotjen e ujërave të tij, duke përfshirë edhe ndotjen e ujërave nga inputet bujqësore nëpërmjet përdorimit eficent të tyre. Përveç ndotjes, është e rëndësishme që Bashkia të planifikojë projekte më përparësi për rehabilitimin e lumit, së bashku me projekte bashkëpunimi me bashkitë e tjera që preken nga Baseni i Matit për manaxhimin e integruar të këtij baseni.

- Burimet ujore nëntokësore

Qarku i Dibrës (i përbërë nga bashkitë Mat, Dibër, Bulqizë e Klos) është i pasur me burime ujore nëntokësore (akuifere). Akuiferët shtrihen në zona me përbërje të ndryshme gjeologjike. Si rrjedhojë, ata kanë kapacitete të ndryshme ujëmbajtëse[23]. Akuiferet përbëjnë burimet kryesore të furnizimit me ujë për popullsinë, industrinë, bujqësinë dhe aktivitetet të tjera ekonomike në territorin e bashkisë së Matit dhe të bashkive përreth.

Akuiferët kanë një shtrirje të gjerë në nënterritorin e bashkisë, edhe pse është e vështirë të përcaktohet me saktësi sipërfaqja e tyre për shkak të studimeve të kryera në nivel rajoni[24] (Figura 22). Akuiferet janë të llojeve të ndryshme. Megjithatë akuiferet *me poro-çarje* dhe *çarje-karst* përbëjnë burimet kryesore ujore për bashkinë. Më poshtë sillet një paraqitje grafike e llojeve të akuiferëve që shtriihen në Bashkinë e Matit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA KOMBËTARE E TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA
REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

Figura 23: Akuiferët e Bashkisë Mat



**Burimi:** SHGJSH, 2015, **Përpunoi:** Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2016

**Akuiferi me porozitet poro-çarje, me ujëpërcjellshmëri mesatare-të ulët:** Akuiferët me porozitet poro-çarje janë akuifere që shtrihen kryesisht përgjatë luginës së lumit Mat (nga Frankth deri në Gjallish në Jug deri në kufi me Qarkun e Lezhës në Veri, përkatësisht në Urakë) dhe përreth liqenit të Ulzës.

**Akuiferet me porozitet çarje-karst:** Ky akuifer shtrihet në formacione karbonatike-gëlqerore në masive malore të ndryshme. Në Mat ky akuifer përfaqësohet nga akuiferi që ka dalje në Malin e Dejës, në verlindje të fshatit Macukull. Zakonisht, ujërat e akuifereve karstike janë të një cilësie të mirë ose shumë të mirë. Akuiferi me porozitet çarje-karst ka resurse të mëdha ujore. Nga këto akuiferë dalin burime me prurje të mëdha siç janë : burimi i, burimi i Vinjollit dhe burimi i Shëlliut[25].

**Akuifer me porozitet çarjesh dhe ujëpërcjellshmëri mesatare - të ulët:** Akuiferët me porozitet çarjesh njihen për çarjen dhe ndërprerjen e shkëmbinjëve prej të cilët ndërtohen. Në Bashkinë e Matit ky akuifer shtrihet në Perëndim të *NjA të Ulzës, Bazit dhe Komsit*, gjithashtu shtrirje të akuiferit me porozitet çarje gjendet dhe në Jug-Lindje të *NjA Lis*.

Figura 24: Llojet e akuiferëve, Bashkia Mat




**Burimi:** SHGJSH; **Përpunoi:** Bashkia Mat dhe MetroPOLIS,2016

Në Bashkinë e Matit sipërfaqe më të madhe zë akuiferi me porozitet poro/çarje me ujëmbajtje mesatare-të ulët në vlerën 19,859.68 Ha, e cila ndiqet nga akuiferi me porozitet çarje (15,103.63 Ha), akuiferi me porozitet çarje-karst (10,449.92 Ha) dhe akuiferi me porozitet ndërrkokrrizor me ujëmbajtje të ulët-shumë të ulët (252.05 Ha). Një sipërfaqe prej 3,639.72 Ha përfaqësohet nga një porozitet i pamjaftueshëm për të lejuar qarkullimin e ujërave nëntokësore në mënyrë që të shfrytëzohet për përdorim nga njerëzit.

Ndotja e akuifereve nga industria e nxjerrjes së kromit dhe e pasurimit të ferro-kromit:

- Industria e nxjerrjes së kromit

Në lidhje me cilësinë e ujërave të akuiferëve, fatkeqësisht, nuk ka shumë të dhëna të viteve të fundit. Operacionet e nxjerrjes së minieraleve janë një pjesë e rëndësishme e kontrollit të mjedisit për shkak se ata ndërveprojnë me hidrologjinë. Minierat nuk ndikojnë vetëm gjatë kohës që operohet në to por edhe pas mbylljes. Vendndodhja dhe mënyra si funksionon një minierë mund të ndikojnë në kushtet mjedisore: 1) sipërfaqja dhe lëvizja e ujërave nëntokësore; 2) fluksi i ujit në minierë, i cili rrezikon të ndotet e elementët ndotës në minierë; 3) rimbushja me ujë e minierave si pasojë e infiltrimin të ujërave sipërfaqësore; 4) rritja e ndërveprimit të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore për shkak të shëmbjeve; 5) ndryshimi i bilancit të përgjithshëm ujor; etj[26].

Specifikisht, ujërat që dalin nga hapja e minierave, ulja e nivelit të ujërave nëntokësore dhe rrëshqitjet e tokës mund të krijojnë probleme mjedisore, të cilat vështirë të korrigjohen[27].

Figura 25: Burimet ndotëse të Akuiferëve në Bashkinë Mat




**Burimi:**AKBN, **Përpunoi:** Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2016

Tabela 4: Ujësjellësit e Bashkisë Mat dhe burimet e tyre

| Nr. | Qyteti / Komuna | Ujësjellësi | Qyteti / Fshati i furnizuar | Nr. i pop. së furnizuar | Pusshpimet: Vendi |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | NjA Burrel | UK Mat | Burreli | 10633 | Burimi i Vinjollit, NjA Lis |
| 2 | NjA Ulëz | | Ulëz | 875 | Burimi: Gurra e Florinjtë, NjA Ulëz |
| 3 | NjA Baz | | Baz | 2181 | Burimi: Përroi i Gjergës (Q=5l/s) dhe Kroi i Roxhajve (Q=2.8l/s), NjA Baz |

**Burimi:** Ujësjellës-Kanalizime Mat. **Përpunoi:** MetroPOLIS

- Industria e pasurimit të ferro-kromit

Sa i përket aktivitetit të Uzinës së ferro-kromit në NjA Komsi nuk ka një monitorim për cilësinë e akuiferëve në atë zonë. Nga dixhitalizimi i territorit të bashkisë Mat rezulton se shumë burime ujore dalin nga ky akuifer, që mund të përdoren nga banorët e zonës për furnizim me ujë dhe ujitje.

Materialet sterile të nxjerra nga minierat, fabrikat e pasurimit dhe skoriet e uzinave të shkrirjes së metaleve grumbullohen në masa që quhen dampa[28]. Vëllimi i mbetjeve në dampa llogaritet 25 milion $m^3$. Këto mbetje ndikojnë në cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Nga depozitimi i mbetjeve në dampa, shkarkohen në burimet ujore elementë, të tillë si: Cu[29], Zn[30], Pb[31], Cr[32], Ni[33], Fe[34], S[35], etj. që ndotin ujërat e lumenjve dhe të përrenjve, ujërat e akuiferëve si dhe tokat bujqësore. Ndikimi i këtyre ndotjeve ndjehet deri në det. Dëmtohet jashtëzakonisht shumë biodiversiteti në ujë dhe në tokë.

Një faktor mjaft i rëndësishëm që duhet theksuar në lidhje me akuiferin është *mungesa e monitorimit të ujërave të këtij akuiferi për ndotje në përgjithësi dhe për ndotje nga industria ndër vite*. Siç theksohet në seksionet e mësipërme, industria e pasurimit te kromit ka vepruar në këtë territor për më shumë se 50 vjet. Duke parë se burimet e këtij akuiferi përdoren për furnizim me ujë të pijshëm dhe ujitje nga banorët vendas, është i domosdoshëm monitorimi i akuiferëve për ndotje nga industria e pasurimit të ferro-kromit të trashëguar ndër vite.

- Burimet e ndotjes së akuifereve

Burimet e ndotjes së akuifereve në vendin tonë dhe të akuiferëve me shtrirje në Bashkinë Mat janë të shumta. Më poshtë paraqitet një përshkrim i shkurtër i burimeve kryesore të ndotjes.

**Mungesa e zonave higjieno-sanitare:**

Shfrytëzimi i ujërave nëntokësore në mënyrë jo profesionale dhe të pakontrolluar si nga popullsia, ashtu edhe nga industria rrezikon: 1) uljen e prurjeve në stacionet e pompimit, si dhe 2) prishjen e cilësisë së ujërave të akuifereve të qarkut Dibër, duke rrezikuar furnizimin me ujë të bashkisë në tërësi[36]. Mungesa e zonave higjeno-sanitare bën të mundur që e gjithë ndotja përreth pusshpimeve të kalojë drejtpërdrejt në akuifer.

**Mungesa e monitorimit të akuiferëve** në Bashkinë e Matit në mënyrë që të pasqyrohet gjendja aktuale e tyre dhe si rrjedhojë të merren masat e nevojshme dhe domosdoshme për përmirësimin e tyre.

**Ndotja e akuiferëve nëpërmjet ujit të lumit Mat:** Sipas SHGJSH-së[37], akuiferi i luginës së Matit rrezikon ndotjen nga vetë lumi Mat si pasojë e mungesës pothuajse të plotë të mbulesës ekranizuese të shtresave ujëmbajtëse në zonat e përmendura më sipër. Për këtë arsye, keqmenaxhimi i mbetjeve të ngurta e të lëngta, si dhe mungesa e marrjes së masave për mbrojtjen e ujërave sipërfaqësore të Matit nga ndotja urbane dhe industriale mund të ketë shkaktuar ndotjen e akuifereve përkatëse.

**Ndotja e akuifereve nga shfrytëzimi i inerteve lumore të Matit:** Dëmtimi i lumit Mat ndikon drejtpërdrejt në dëmtimin e akuiferit mbi të cilin rrjedh. Sipas SHGJSH-së , shfrytëzimi i zhavorreve të lumenjve dëmton rëndë burimet ujore si nga ana sasiore, ashtu edhe cilësore, sepse zvogëlon zonën e ushqimit të akuifereve dhe prish regjimin e ujërave nëntokësore në zonat e gërrmimeve, sidomos në zonën e Qyteti Burrel ku lumi Mat kalon nëpër bashkinë Mat.

Tabela 5: Aktivitetet e licensuara për shfrytëzimin e inerteve lumore në lumin Mat

| Aktiviteti | Bashkia | Qyteti/NjA/Fshati |
|---|---|---|
| Shfrytëzim inertesh | Mat | Burrel |
| Shfrytëzim inertesh | Mat | Burrel |
| Shfrytëzim inertesh | Mat | Burrel |
| Shfrytëzim inertesh | Klos | Klos |
| Shfrytëzim inertesh | Klos | Fullqet |
| Shfrytëzim inertesh | Klos | Bershin |
| Shfrytëzim inertesh | Klos | Suç |

**Burimi:** SHGJSH, 2014

**Ndotja nga karrierat për shfrytëzimin e mineraleve:** Territori i Bashkisë Mat dhe në veçanti zonat malore janë shfrytëzuar vazhdimisht në njëzet vitet e fundit për mineralet dhe veçanërisht për gurin gëlqeror, i dobishëm në sektorin e ndërtimit. Për fat të keq, lejet për shfrytëzimin e gurëve gëlqerorë janë dhënë në zonat malore të Selixës dhe në malin e Runjës. Bashkia e Matit është e njohur dhe për mineralin e kromit, shfrytëzimi i të cilit ka nisur vitet e fundit, në NjA e Ulëzës dhe Lisit.

Vetëm nga Bashkia e Matit janë dhënë 3 leje mjedisore për shfrytëzimin e gëlqerorëve në territorin e saj. Përveçse kanë prishur peizazhin në rastet kur gërmimet janë sipërfaqësore, gëlqerorët kanë ndotur edhe mjedisin me retë e pluhurit që ngrenë gjatë aktivitetit të tyre. Në kohë me reshje pluhurat e guroreve ndotin ujërat sipërfaqësore dhe sidomos ujërat e burimeve që përdoren për furnizim me ujë të pijshëm[38].

- Përfundime dhe rekomandime

Në territorin e bashkisë gjenden akuiferë të rëndësishëm me shtrirje në shkëmbinjtë zhavorrorë ose karstikë, të cilët përdoren për furnizimin e popullsisë me ujë të pijshëm. Ndërhyrjet e njeriut në vitet e fundit, pa marrë parasysh mbrojtjen e tyre, kanë ndikuar ndjeshëm në cilësinë e ujërave të këtyre akuifereve, duke shkaktuar ndotjen. Niveli i ndotjes ende nuk njihet me saktësi për shkak të mungesës së studimeve të nevojshme. Megjithatë, duke parë ndotjen e lumit Mat nga derdhja e ujërave të ndotura urbane dhe industriale, rrjedh se akuiferi me porozitet poro-çarje i cili shtrihet nën luginen e Matit mund të jetë i ndotur. Për më tepër, shtrirja e këtij akuiferi përkon me territorin e ish-Uzinës së Ferro-Kromit në Komsi, e cila është cilësuar si një nga hotspotet në vendin tonë. Ndotja e mundshme e këtij akuiferi nga industria e pasurimit të ferro-kromit nuk përjashton edhe ndotjen e anës jugore të akuiferit në territorin e Matit.

Rekomandohet marrja e masave të menjëhershme për monitorimin e cilësisë së ujërave të akuiferëve me qëllim përcaktimin e llojit të përdorimit të ujërave të tij. Paralelisht, lipset që Bashkia të ndërhyjë për identifikimin e burimeve të tjera ujore që mund të përdoren për furnizimin me ujë të banorëve në bashki dhe të investojë për ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme për furnizimin e të gjithë popullsisë me ujë.

Qarku i Dibrës ka një ndërtim të tillë gjeologjik, i cili paraqet interes të veçantë në të ardhmen për kërkimin e kromit. Kjo do të thotë se në të ardhmen territori do të ketë përdorim bujqësor dhe industrial. Përdorimi i tokës nga industria e kromit sjell përfitime ekonomike, por në të njëjtën kohë sjell edhe ndotjen e tokës, ajrit dhe ujërave nëntokësore. Si rrjedhojë, kërkohet që Bashkia e Matit të përcaktojë qartë kufirin ndarës ndërmjet tokave bujqësore dhe atyre të nxjerrjes së kromit në mënyrë që të shmanget ndotja e ujërave nëpërmjet këtij aktiviteti.

- Ajri

Ndotja e ajrit mbetet problem serioz në Shqipëri për shkak të rritjes së theksuar të numrit të makinave, numrit të mjeteve të vjetra të transportit, rritjes së trafikut në zonat urbane dhe ritmeve të shpejta të urbanizimit[39]. Ky i fundit ka çuar në një zhvillim me ritme tejet të shpejta edhe të sektorit të ndërtimeve dhe përkeqësimit të kushteve të rrugëve brenda zonave urbane.

Të dhënat rreth cilësisë së ajrit në Qytetin e Burrelit dhe Bashkinë Mat në përgjithësi mungojnë. Megjithatë, për arsyet e mësipërme, mendohet se të paktën në qytet, në afërsi të zonave me fluks trafiku të lartë, cilësia e ajrit ndryshon (përkeqësohet) nga ajo e zonave rurale, ku cilësia e ajrit është e mirë. Edhe pse nuk njihet përmbajtja e gazrave ndotës në ajër, është e mundur të arrihet

një vlerësim i përafërt i rreziqeve që i shkaktohen shëndetit të njeriut nëpërmjet ndotjes së ajrit nga disa sektorë, veçanërisht ai i transportit.

Marrë si reference të dhënat nga Raporti i Gjendjes në Mjedis për Shqipërinë dhe veçanërisht RGJM - 2015 të cilat tregojnë se ka tejkalim të normave të elementëve ndotës në ajër, mund të themi se faktor në këtë situatë, krahas shkarkimeve në atmosferë nga industritë, mjetet e transportit publik dhe privat si dhe nga ndërhyrjet infrastrukturore, është edhe mungesa e gjelbërimit dhe hapsirave për rekreacion të cilat kryejnë, ndër të tjera, edhe funksionin e filtrimit të ajrit të ndotur dhe prodhimin e sasive të vogla të $O_2$ me rëndësi në cilësinë e ajrit në qëndrat urbane.

- Burimet e ndotjes së ajrit

Siç u theksua më sipër, burimet e ndotjes së ajrit janë të ndryshme (urbanizimi, mjetet e transportit, industria, etj.). Megjithatë, në Bashkinë Mat, ndotja nga makinat mbetet burimi kryesor. Më poshtë paraqitet një përshkrim i shkurtër i burimeve kryesore të ndotjes së ajrit në Mat.

**Ndotja nga mjetet e trasportit:** Sipas RGJM-së në Bashkinë Mat, ndikim të rëndësishëm në ndotjen e ajrit në mjedis në territorin e Bashkisë kanë mjetet e trasportit të cilat shkarkojnë në ajër një numër të konsiderueshëm gazrash të dëmshme.

Nga llogaritjet e Agjencisë Amerikane të Mjedisit, një makinë e tonazhit të vogël (makinat për transport njerëzish deri në 12-vendëshe) shkarkon rreth ***5 ton $CO_2$ në vit*** (4.7 metër ton)[40].

**Rritja e numrit të makinave:** Numri i makinave ka ardhur duke u shtuar nga viti në vit në mënyrë të theksuar në rang vendi. Nëse në vitin 2000 numëroheshin rreth 55 makina /1,000 banorë, në vitin 2010 numri i makinave në Shqipëri arriti 120.8 makina për 1,000 banorë[41].

**Ndotja nga cilësia jo e mirë e lëndës djegëse:** Në vendin tonë, lënda djegëse për mjetet e transportit nuk është e mirë dhe kjo është e dukshme edhe vizualisht. Për më tepër, është vërtetuar edhe nga Inspektorati Qëndror Teknik.

Në periudhën Janar-Shtator 2014, Inspektorati Qendror Teknik (sipas të dhënave të publikuar nga AKM-ja) ka monitoruar cilësinë e lëndës djegëse në vend, konkretisht të *naftës*[42], *benzinës dhe solar-mazutit*.

Figura 26: Përmbajtja e squfurit në naftë dhe benzinë (numri i mostrave në %)




**Burimi:** AKM (IQT[43]) ; **Përpunoi:** Bashkia Mat dhe PLGP/MetroPOLIS, 2016[44]

Si përfundim, në bazë të rezultateve të mësipërme rrjedh se të dyja llojet e lëndës djegëse që përdoren në vendin tonë (nafta dhe benzina) kanë përmbajtje të lartë të squfurit. Ndryshimi i vetëm qëndron në faktin se përmbajtja e squfurit, në rastin e naftës, arrin kufinj më të lartë se sa në rastin e benzinës.

**Ndotja nga vjetërsia e mjeteve të transportit:** Sipas Ministrisë së Mjedisit dhe UNDP-së, Shqipëria ka rreth 350,000 makina pjesa më e madhe e të cilave janë makina të përdorura[45]. Me rritjen dramatike të numrit të makinave dhe mbi të gjitha të numrit të makinave të vjetra, trafiku në zonat urbane është tashmë një ndër shkaqet kryesore të ndotjes së ajrit[46].

**Ndotje nga burime të tjera: vend-depozitimet e mbetjeve, industria etj**.: Depozitimi i mbetjeve kryesisht shkarkon në ajër gazin metan, i cili ka aromë të keqe dhe, në përqëndrim të lartë, është irritues dhe shkakton probleme në sistemin e frymëmarrjes dhe në sistemin nervor.

- Pyjet, zonat e mbrojtura dhe biodiversiteti

Kushtet klimatike, hidrologjike dhe gjeomorfologjike në territorin e Bashkisë Mat kanë mundësuar rritjen e një larmishmërie drurësh dhe shkurresh.

Ndër to veçohen: Dushku, Pisha e egër, Pisha e zezë, Ahu, Dëllinja dhe Shkoza, të cilat përbëjnë disa nga llojet që janë përshtatur më së miri në territorin e Bashkisë si dhe ndikojnë në përmirësimin e klimës që karakterizon këtë zonë dhë kanë rëndësi të lartë për ekonominë e zonave dhe mirëqënien e popullsisë lokale.

Në fillim të vitit 2016, fondi pyjor dhe kullosor kaloi në pronësi të Bashkisë Mat, me përjashtim të sipërfaqes së fondit pyjor e kullosor që është pjesë e territorit të zonave të mbrojtura (VKM nr. 433, datë 8/6/2016 "Për transferimin e pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë").

Sot, Bashkia Mat ka në pronësi të saj 35,159 ha sipërfaqe pyjore, 2,999 ha kullosore dhe 1,333.5 ha sipërfaqe me bimë pyjore. Sipërfaqe të konsiderueshmë zënë tokat improduktive dhe ato djerrë, përkatësisht 2,888.9 ha dhe 254.1 ha.

Figura 27: Përdorimi i tokës pyjore e kullosore në Bashkinë Mat (ha)




**Burimi**: Bashkia Mat; **Përpunoi**: Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2016

Sipas ndarjes së ekonomive pyjore (EP) në territorin e Bashkisë Mat vërehet qartë dallimi i sipërfaqeve pyjore në çdo NJA. EP me sipërfaqe më të madhe të fondit pyjore paraqitet ajo e Derjanit, në NJA-në me te njejtin emër, e cila ka sipërfaqe prej 10,765.46 ha, nga e cila 7,860.86 ha është pyllë, 74.4 ha me bimësi pyjore, 1,925.08 ha kullotë dhe pjesa tjetër në djerrë, improduktive dhe sipërfaqe ujore.

EK-ja e Komsi ka një sipërfaqe të përgjithshme rreth 6,813 ha, nga e cila 5,306 ha është pyllë dhe rreth 441 ha janë sipërfaqe kullosore.

Ekonomitë pyjore të tjera paraqiten me sipërfaqe më të vogël të mbuluar me pyje dhe kullota, sipas sipërfaqes më të madhe renditen: EP Ulëz, EP Mbas – Deje, EP Trodhën, EP Qaf-Shtamë, EP Balgjaj, EP Kurdar dhe në fund me sipërfaqen më të vogël renditet ekonomia pyjore e Kunorës.

Tabela 6: Përdorimi i tokës sipas ekonomive pyjore, Bashkia Mat.

| | Balgjaj | Derjan | Komsi | Kunorë | Mbas - Deje | Qaf-Shtamë | Trodhën | Ulëz | Kurdar |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| B. Pyjore | 42.7 | 74.4 | 603.25 | | 156 | 121.79 | | | |
| Djerr | 28 | | | | 201.8 | 24.3 | | 355.44 | |
| Inproduktive | 51.8 | 905.12 | 462.16 | 27.5 | 450.63 | 99.21 | 394.5 | 494.4 | 3.5 |
| Kullotë | 9.75 | 1,925.08 | 441.85 | 20.5 | 438.13 | 106.72 | 52 | 5 | |
| Pyll | 588.16 | 7,860.86 | 5,306.37 | 208 | 2,869.84 | 1,130.74 | 3,497 | 5,948.2 | 270.3 |
| Ujore | | | | | 2.4 | 2.7 | | | |
| Totali | 720.41 | 10,765.46 | 6,813.63 | 256 | 4,118.8 | 1,485.46 | 3,943.5 | 6,803.04 | 273.8 |

**Burimi:** Bashkia Mat; Pëpunoi: Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2016

Në territorin e Bashkisë nuk është bërë inventarizimi periodik i fondit pyjor, ndaj shumë të dhëna mungojnë. Ndër të tjera mungojnë informacionet mbi sipërfaqet e llojeve të pyjeve që ndodhen brenda teritorit të bashkisë, mosha dhe gjendja aktuale e tyre.

Nga informacione të siguruara nga specialistët e Drejtorisë së Pyjeve Mat, mund të themi që fondi pyjor në teritorin e bashkisë Mat dominohet nga Dushku, Pisha e zezë, pisha e egër dhe Ahu. Gjithashtu në teritorin e bashkisë një sipërfaqe e konsiderueshme mbulohet nga shkurret dhe kullotat, në të cilat mbizotrojnë Shkoza, Dëllinja dhe bimët barishtore.

Mosha mesatare e pyjeve në territorin e bashkisë është 18-25 vjecarë, e cila ndryshon në pjesë të caktuara të territorit. Në zonat që janë të aksesueshmë nga automjetet e transportit mosha është më e re, pasi janë bërë prerje massive. Në pjesët e territorit që nuk kanë aksesueshmëri, pyjet vazhdojnë të jenë në një moshë relativisht të madhe, nuk përjashtohen dhe disa pjesë ku pyjet konsiderohen të plakur.

Prerja e pyjeve është një fenomen i cili haset në të gjithë territorin e bashkisë, kryesisht në zonat të cilat janë lehtësisht të aksesueshme nga automjetet e transportit. Krahas problematikave të ndryshme, në veçanti prerjet e viteve të fundit, sipërfaqet me pyje dushku vazhdojnë të ruajnë një gjendje të mirë.

Nga analiza e kryer në programin e GIS për evidentimin dhe krahasimin e sipërfaqes pyjore në dy periudha, sipas hartave të EP-ve të vitit 1984 -1985 dhe ortofotos së vitit 2015, vërehet një rritje e lehtë e sipërfaqes pyjore në territorin e bashkisë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA KOMBËTARE E TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

Sipas hartave kadastrale të fondit pyjor të vitit 1984-1985 rezulton një sipërfaqe fondi pyjor prej 36,310 ha. Ndërkohë sipas dixhitalizimit të kryer nga ortofoto e vitit 2015 rezulton një sipërfaqe prej 38,023 ha. Nga krahasimi i këtyre dy periudhave rezulton së sipërfaqet pyjore në territorin e bashkisë janë shtuar më rreth 1,713 ha, kjo e shprehur në përqindje është një rritje prej 4.7%.

Edhe pse krahasimi i dy periudhave rezulton në bilanc pozitiv, vlen të theksohet që sipërfaqe të gjera pyjesh tashmë janë në faze ripërtëritëse, pra në një moshë relativisht të re. Shfrytëzimi i tyre do të kishte ndikim negativ në zhvillimin e qëndrueshëm të tyre.

Figura 28: Harta e fondit pyjor 1984 dhe 2015




**Burimi:** Drejtoria e Shërbimit Pyjor Mat; **Përpunoi:** Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2016

Ndonëse analiza është kryer në GIS, duhet të merret parasysh ekzistenca e një marzhi të vogël gabimi për shak se hartat e vjetra janë të një teknologjie të vjetër, lexueshmëria e legjendës dhe simbolikës është e vështirë. Për më tepër ka një marzh gabimi te mbivendosja/përshtatja me ortofoton e vitit 2015, si edhe një marzh gabimi si pasojë e ndryshimeve në territor. Vizitat e vazhdueshme në terren dhe konsultat mes specialistëve të pyjores dhe banorëve/pronarëve mund ta zgjidhin këtë ngërç dhe të saktësojnë informacionin/analizën e mëtejshme.

- Problematikat kryesore të fondit pyjor

- Kapacitete institucionale të pa plotësuara;
- Mungesa e invetarizimit periodik i fondit pyjor e kullosor;
- Prerja e pyjeve;
- Djegia e pyjeve;
- Sëmundjet në pyje;

- Tjetersimi i sipërfaqeve të fondit pyjor.

- Përfundime dhe rekomandime

Mirëadministrimi i Pyjeve dhe Kullotave nga Bashkia Mat, sigurimi në realizimin e reformës së decentralizimit të kompetencave në administrimin e pyjeve dhe kullotave publike dhe dixhitalizimi i hartave të fondit pyjor nën administrim mbeten pikënisjet drejt suksesit për përmirësimin e gjendjes aktuale të Pyjeve. Njësitë Administrative nëpërmjet planeve të manaxhimit të pyjeve dhe kullotave mund t'i ofrojnë banorëve të tyre mundësi punësimi në periudha kur ka aktivitete të punimeve pyjore. NjA-të, nëpërmjet mbjelljes dhe rimbjelljes së drunjëve të lartë mund të përfitojnë më shumë të ardhura, mbështetje financiare në realizimin e projekteve, si dhe të ardhura të vazhdueshme e të sigurta nga shitja e kapaciteteve të lira të karbonit.

Për ruajtjen dhe mbarështimin e fondit pyjor e kullosor në territorin e Bashkisë së Matit rekomandohet të merren një sërrë masash, disa prej të cilave mund të jenë:

- Ndërhyrja e menjëhershme për të luftuar proçesionaren (larvat) e Pishës së zezë;
- Hartimi i një Plani Veprimi për rehabilitimitimin e sipërfaqeve të djegura;
- Marrja e masave paraprake për parandalimin e fenomeneve të zjarrit;
- Mbajtja nën kontroll e sëmundjeve dhe e dëmtuesve.

- Zonat e mbrojtura, monumentet e natyrës dhe Biodiversiteti

Zonat e mbrojtura përfaqësojnë territore tokësore, ujore, detare e bregdetare të caktuara për mbrojtjen e diversitetit biologjik, të pasurive natyrore dhe kulturore, bashkëshoqëruese, të cilat manaxhohen në rrugë ligjore dhe nëpërmjet metodave shkencore bashkëkohore[47].

Zonat e mbrojtura natyrore dhe turistike në vendin tonë janë konsideruar si pjesë tokësore dhe ujore të mbrojtura për shkak të shumëllojshmërisë biologjike të pasurive natyrore dhe kulturore që ofrojnë. Këto zona mbrohen me ligj[48] dhe zënë rreth 16%[49] të territorit të vendit.

Një territor i caktuar duhet të plotësojë të paktën një nga këto kritere:[50] 1) të ketë diversitet të lartë të llojeve dhe/ose të habitateve, 2) të ketë dendësi të ulët të llojeve dhe/ose habitateve, 3) të ketë përfaqësueshmëri, 4) të ketë minimumin kritik të madhësisë së ekosistemit, 5) të ketë natyralitet, trashëgimi dhe integritet, 6) të ketë vlera shkencore; 7) të karakterizohet nga prekshmëria ekologjike/llojet e prekshme, 8) të karakterizohet nga papërsëritshmëria/llojet endemike, 9) të mos rrezikohet nga ndërhyrjet e veprimtarive njerëzore, dhe 10) të ketë mundësi për ruajtjen e jetës së egër.

- Zonat e mbrojtura në Bashkinë Mat

Në territorin e Bashkisë së re të Matit gjenden pasuri të shumta natyrore. Format e larmishme të relievit dhe luhatjet e lartësive kanë ndikuar në formimin e mikroklimave të ndryshme të cilat ofrojnë mundësinë për zhvillimin e florës dhe faunës në territor. Në afërsi të territorit të bashkisë gjenden pjesë të Parkut Kombëtar Qafë Shtamë dhe Zall Gjocaj, të cilët shquhen për larmi të lartë biologjike me endemizma dhe subendemizma. Gjithashtu, në territorin e bashkisë gjenden 37 Monumente Natyre dhe Gjeo-monumente, të cilët shtojnë edhe më tepër rëndësinë e pasurisë natyrore në këtë zone. Monumentet e Natyrës ndahen në 9 gjeo-monumente dhe 28 Monumente natyre. Në përgjithësi zonat e mbrojtura në territorin e Bashkisë kanë një gjendje të mirë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA KOMBËTARE E TERRITORIT TIRANE SEKRETARIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TE TERRITORIT TIRANE SEKRETARIA

biologjike dhe estetike. Në tabelën më poshtë gjenden të listuara Zonat e Mbrojtura në territorin e Bashkisë Mat dhe karakteristikat kryesore të tyre.

Tabela 7: Zonat e mbrojtura në Bashkinë Mat

| Emërtimi i ZM-së | Kategoria | Përshkrim i shkurtër | Rëndësia | Foto |
|---|---|---|---|---|
| Kategoria II – Park Kombëtar | | | | |
| Zall Gjocaj | II | Biodiversitet të pasur me endemizma dhe subendemizma | Shkencore, biologjike, ekologjike, ekonomik, kulturore, didaktike dhe turistike |  |
| Qafë Shtamë | II | Biodiversitet të pasur me endemizma dhe subendemizma | Shkencore, biologjike, ekologjike, ekonomik, kulturore, didaktike dhe turistike |  |
| Kategoria III – Monument Natyre dhe Gjeo - Monumente | | | | |
| Guri i Gjatë – Urxall | III | Përbën një gur ranor dhe konglomeratik, me formë të veçantë | Ka vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike), didaktike, ekologjike dhe kulturore |  |
| Kepi i Skënderbeut Varosh | III | Përbën një gur gëlqeror, me formë të veçantë, afërsisht formën e një kërpudhe | Ka vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, historike), didaktike, ekologjike dhe kulturore |  |
| Kanioni i Urakës | III | Përfaqëson një kanion rreth 3 km të gjatë në gëlqerorët e kretës së sipërme | Ka vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike e biologjike), didaktike, kulturore, ekologjike dhe turistike |  |
| Rrapi i Marqethit | III | Përbën një dru rrapi të veçuar, me trung dhe kurorë të veçantë (ombrelle) me lartësi 20 m dhe diametër të trungut 120 – 130 cm dhe moshë mbi 180 vjeçare | Ka vlera shkencore (biologjike dhe ekologjike), kulturore, didaktike dhe turistike | |
| Lisi i Qershizës | III | Përbën një dru qarri, me trung dhe kurorë të veçantë ombrellore dhe mjaft të hapur mbi territorin e varrezave të fshatit | Ka vlera shkencore (biologjike dhe ekologjike), kulturore, didaktike dhe turistike |  |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Maja e Boshtrës (Macukull) | III | Përbën një gur ranor me moshë tortoniane, me formë të veçantë (piramidale), i formua nga proceset e erozionit dhe era | Ka vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike), didaktike dhe kulturore |  |
| Gurri i Vashës | III | Përbën një gur gëlqeror me moshë kreta e sipërme, me formë të veçantë (kërpudhe), i formua nga proceset e karstit dhe era | Ka vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike), didaktike, ekologjike dhe kulturore. |  |
| Lisi i Tushës, Frankth | III | Përbën një dru lisi, me trung dhe kurorë të veçantë (kërpudhe) me lartësi 20 m dhe diametër të trungut rreth 2,4 m | Ka vlera shkencore (biologjike dhe ekologjike), kulturore, didaktike dhe turistike |  |
| Lisi i Bershinit | III | Përbën një dru bunge i veçuar, me lartësi 18 m, diametër të trungut 100 cm e perimetër të tij 290 cm. | Ka vlera shkencore (biologjike dhe ekologjike), kulturore, didaktike, fetare dhe turistike |  |
| Kanioni i Filmit | III | Përfaqëson një kanion në gëlqerorët e kretës së sipërme, të formuar nga veprimtaria erozive e lumit me të njëjtin emër. | Ka vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike e biologjike), didaktike, kulturore, ekologjike dhe turistike |  |
| Kroi i Gjeneralit (Gur i Bardhë) | III | Përbën një burim karstik, që del në kontaktin litologjik midis gëlqerorëve të triasit të sipërmë -jura e poshtëme | Ka vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike), kulturore, didaktike dhe turistike |  |
| Tisat e Mbasdejës | III | Përbën një grup drurësh tisi, që rrezikohen të zhduken, me trung dhe kurorë të veçantë (piramide) 10 – 13 m, trashësia e trungut është 18 – 20 cm | Ka vlera shkencore (biologjike dhe ekologjike), kulturore, didaktike dhe turistike |  |
| Burimi i Shutresë | III | Përbën një burim të madh karstik, që del në kontaktin litologjik midis gëlqerorëve të kretës së sipërm dhe terrigjenëve | Ka vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike), kulturore, didaktike |  |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Lisi Qafë Shënkollit | III | Përbën disa drurë lisi, me trung dhe kurorë të veçantë (piramidale), me lartësi 21 m dhe diametër të trungut rrethrreth 1 m | Kanë vlera shkencore (biologjike dhe ekologjike), kulturore, didaktike dhe turistike |  |
| Lisi Macukull (Varrit të Mirë) | III | Lartësia e tij është rreth 20 m, diametri i trungut është 80 cm dhe perimetri i tij është 220 cm | Ka vlera shkencore (biologjike), didaktike, turistike e fetare |  |
| Lisi te varret e Shqypit (Barbullej): | III | Përfaqëson një dru qarri të veçuar me kurorë të rregullt ombrellore e moshë 230 vjeçare | Ka vlera biologjike, didaktike, estetike me rëndësi lokale |  |
| Lisi i kodër varreve (Urxuall): | III | Përfaqëson një dru shparthi të veçuar | Ka vlera biologjike, didaktike e fetare |  |
| Lisi i Teqesë së Domit | III | Përfaqëson një dru të veçuar shparthi me lartësi 8 m, diametër të trungut rreth 50 cm dhe perimetër të tij rreth 130 cm | Vlerat e tij janë biologjike, didaktike e fetare. |  |
| Rrapi i Çelës – Patin | III | Përfaqëson një dru të veçuar me lartësi 18 m, trung me diametër i 70 cm dhe perimetër 250 cm | Ka vlera biologjike, didaktike, estetike e turistike |  |
| Rrapi i Zabelit – Gurrë e Madhe | III | rrap shumëshekullor, me trung dhe kurorë monumentale natyrore | Ka vlera biologjike, didaktike, estetike e turistike | |
| IV Park Natyror | | | | |
| Liqeni I Ulzës | IV | | |  |

**Burimi:** AKZM 2016; **Përpunoi:** MetroPOLIS, 2016

- Problematikat kryesore të ZM-ve Mat

AKZM-ja dhe AdZM-ja janë duke bërë përpjekje serioze në drejtim të manaxhimit të qëndrueshëm të zonave të mbrojtura në Bashkinë e Mat. Megjithatë, problematikat mbeten ende të shumta, ndër të cilat përmendim:

- *Rreziku i përhapjes së zjarreve* është i pranishëm pothuajse gjatë gjithë sezonit të nxehtë, kryesisht në zonën e Kuturmanit, apo dhe në zona të largëta, të cilat paraqesin vështirësi për t'u kontrolluar[51].
- *Gjuetia e paligjshme*është një problem aktual në Shebenik – Jabllanicë, Polis-Stravaj dhe në zona të tjera të thella qëështë vështirë të kontrollohen.
- *Manaxhimi joefektiv i aktiviteteve* turistike që kryhen në të gjitha zonat e mbrojtura, edhe pse në nivele të ulëta, lënë pas mbetje të ngurta, të cilat shpërndahen.
- *Ndërtimi i HEC-eve,* të cilët shfrytëzojnë ujin, duke e devijuar atë, ka sjellë probleme të shumta në habitatet e zonave të mbrojtura.
- *Kullotja* është prezente pothuaj në të gjithë Zonat e Mbrojtura të Bashkisë Mat.
- *Erozioni* është një fenomen i pranishëm në zonat kodrinore malore, kryesisht erozioni i shpateve të zhveshura, apo në brigjet e përrenjve apo lumenjve, që kalojnë në zonat e mbrojtura.

- Përfundime dhe rekomandime

Bashkia Mat është e pasur me rezervate natyrore dhe monumente natyre të shumëllojshme, të cilat përbëjnë një pasuri të konsiderueshme për zhvillimin e turizmit në Bashki. Megjithatë, këto zona kanë pësuar dëmtime të ndryshme në vitet e shkuara, si prerje abuzive të pyjeve në territorin e tyre, zjarre, ndërtime të ndryshme, zhvillimtë aktivitetit të guroreve, mbikullotja dhe fenomene të tjera natyrore si erozioni dhe shembjet e ndryshme të dherave.

Duke patur parasysh që zonat e mbrojtura janë të rëndësishme, jo vetëm sepse shërbejnë si habitate të një biodiversiteti të larmishëm, por edhe sepse mund të favorizojnë zhvillimin e ekonomisë në Bashki nëpërmjet turizmit, rekomandohet që organet kompetente në Bashki të tregojnë një kujdes të veçantë, përpara se ato të humbin vlerat biologjike dhe peizazhistike që mbartin. Më konkretisht, rekomandohet bashkëpunimi i Bashkisë Mat me AdZM-në Dibër për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të planeve të manaxhimit për çdo zonë të mbrojtur dhe monument natyre, hartimin e planit të emergjencave për zjarre dhe rreziqe të tjera si dhe bashkëpunimin me universitetet të ndryshme me qëllim promovimin e vlerave shkencore, biologjike, faunistike dhe floristike të zonave të mbrojtura dhe zhvillimin e eko-turizmit dhe aktiviteteve të tjera, që mundësojnë mbledhjen e të ardhurave financiare për manaxhimin e tyre.

- Biodiversiteti në Bashkinë Mat

Sipas Ligjit nr. 9587/2006 "Për Mbrojtjen e Biodiversitet", me biodiversitet ose larmi biologjike nënkuptojmë shumëllojshmërinë e organizmave të gjallë të të gjitha llojeve, duke përfshirë, ndër të tjera, ekosistemet tokësore, detare dhe ekosistemet e tjera ujore, si dhe komplekset ekologjike, ku ato bëjnë pjesë[52]. Ky term përfshin shumëllojshmërinë brenda dhe ndërmjet llojeve dhe shumëllojshmërinë e ekosistemeve.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA
REPUBLIKA E SHQIPËRISË TIRANË SEKRETARIA

Shqipëria është një vend i vogël. Megjithatë, ajo dallohet për larmi të peizazheve dhe larmi biologjike[53], duke u radhitur në vendet e Europës që shquhen për biodiversitet të lartë.

Shqipëria ka një shumëllojshmëri të ekosistemeve dhe habitateve. Në territorin e vendit gjenden ekosistemet detare, zonat bregdetare, lumenjtë, liqenet, shkurret me gjelbërim të përhershëm apo gjetherënëse, pyje halore dhe fletore, kullota alpine dhe subalpine, si dhe ekosistemet e larta malore.

Larmishmëria e relievit dhe klima e përshtatshme ka bërë të mundur zhvillimin e një faune dhe flore të pasur në territorin e bashkisë. Në territorin e Matit dhe rrethinat haset një numër i konsiderueshëm i llojeve të kafshëve dhe shpendëve, kryesisht të gjitarëve të mëdhenj, thëllëna dhe shumë shpendë dhe kafshë të tjera.

Gjithashtu, territori i bashkisë shquhet për pasuri floristike, kryesisht në drurë të lartë, shkurre dhe bimë të kultivuara. Në brendësi të territorit hasen një sërë llojësh, duke filluar nga shkurret shkoza, dhe deri tek dushqet, ahishtat, pishat dhe kullotat alpine.

Numri i specieve floristike dhe faunistike, që gjenden në Bashki dhe habitatet e tyre, nuk njihet mirë. Megjithatë, njihet numri i specieve të rrezikuara (Libri i Kuq i Florës dhe Faunës Shqiptare, 2007) i cili shkon në 73 specie (rreth 10.5% e specieve të rrezikuara në vend).

Këto i përkasin kryesisht specieve të florës, insekteve dhe shpendëve.

Tabela 8: Flora dhe Fauna e rrezikuar në Shqipëri dhe në Bashkinë Mat

| Flora dhe Fauna e Rrezikuar në Shqipëri dhe Bashkinë Matit[54] | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Kategoritë Taksonomike | Nr. Total i Specieve në vend | Nr. Specieve të rrezikuara në vend | Nr. Specieve të Rrezikuara në B. Mat | % Specieve të Rrezikuara në B. Mat |
| Kërpudha | 800 | 16 | 1 | 6.25 |
| Bimësi | 3,228 | 363 | 32 | 8.8 |
| Insekte | 680 | 108 | 11 | 10.2 |
| Zvarranikë | 37 | 37 | 3 | 8.1 |
| Shpendë | 330 | 120 | 18 | 15 |
| Gjitarë | 91 | 46 | 8 | 17.3 |
| Totali | 5,166 | 690 | 73 | 10.5 |

**Burimi**: Libri i Kuq i Florës dhe Faunës Shqiptare; **Përpunoi**: MetroPOLIS, 2016

- Fauna në Bashkinë Mat

Territori i Bashkisë Mat karakterizohet nga një faunë e pasur, kafshë e shpendë të ndryshme. Ndër vite, në territorin e bashkisë është ushtruar presion i vazhdueshëm mbi faunën, kryesisht në formën e gjuetisë së pa kontrolluar dhe dëmtimit të habitatit nga aktivitetet e ndryshme njerëzore. Si rrjedhojë është ulur ndjeshëm numri i specieve faunistike dhe disa prej tyre rezultojnë të rrezikuara.

Nuk ka një numër të saktë mbi speciet që mund të gjenden në territorin e Bashkisë Mat. Nga të dhëna të siguruara nga vëzhgime në terren, diskutime me banorët e zonës dhe specialistët pranë

zyrave të Bashkisë mund të thuhet se në brendësi të territorit ka një numër të lartë speciesh faunistrike.

Në territorin e Matit janë të pranishëm gjitarë të vegjël/mëdhenj dhe lakuriqë nate, disa lloje mishëngrënësish, ndër të cilët përmendet: Ariu i murrmë, Ujku, Çakalli, Macia e egër, Baldosa, etj. Një numër i konsiderueshëm shpendësh strehohen kryesisht në zonat pyjore dhe shkurreta, Në sipërfaqet shkëmbore strehohen disa lloje shpendësh kryesisht rrëmbenjës. Disa nga shpendët tipikë të cilët gjendën në zonë janë: Huta e zezë bishtgërshërë, Kali i qyqes, Gjeraqina, Shqiponja e malit, Kukuvajka e pyjeve, Qukapik larosh kurrizbardhë, Sqepkuqi, Kuqalashi çafkëzi, etj.

Zonat ripariane të lumit Mat (kryesisht ato të pa dëmtuara) strehojnë një numër të konsiderueshmë speciesh, kryesisht insektet, duke qënë së ky habitat është tepër i përshtatshëm për to.

Shkaqet kryesore, që rrezikojnë zhdukjen e specieve të faunës në territorin e Bashkisë Mat, janë tregëtimi i specieve të ndryshme, koleksionimi i disa lloje speciesh, kryesisht fluturave, prishja e habitatit, ndotja e habitatit, zhvillimi i bujqësisë dhe përdorimi i plehrave dhe kimikateve në masë të madhe, zhvillimi i turizmit, shqetësimi i habitatit, zgjerimi i zonave urbane, gjuetia e paligjshme, pakësimi i ushqimit, shqetësimi i vendit të folezimit, trafikimi i specieve të rralla, fragmentimi i habitateve, degradimi i pyjeve etj. Në vijim, shkaqet do të trajtohen më gjerësisht duke i analizuar specifikisht.

- Flora në Bashkinë Mat

Territori i Bashkisë Mat dhe zonat përreth shquhen për larmishmëri floristike. Territori i bashkisë shquhet për pasuri të shumta natyrore, ku përfshihen trupat ujorë, kodrat dhe malet e larta, shkurretat mesdhetare, pyjet gjethe gjerë dhe halorë, kullotat dhe shumë bimë të tjera barishtore. Në brendësi të territorit të bashkisë (sipas Librit të Kuq të Florës Shqiptare) gjenden rreth 33 specie të rrezikuara, kryesisht bime barishtore dhe me pak shkurre dhe pemë. Ndër të tjera specie të rrezikuara përmendim Mëlqinjë (*Berberis Vulgaris*), Dishëll (*Dictamus albus*), Bar zemre (*Gentiana Lutea*), Dëllinjë e zezë (*Juniperus Communis*), etj.

- Problematikat kryesore të biodiversitetit në Bashki

Gjendja e florës dhe faunës në zonën e Matit paraqet problematika të ndryshme, kryesisht për shkak të zhvillimit të aktivitetit njerëzor në territorin e Bashkisë. Ndërhyrjet kryesore dhe ato të cilat kanë ndikim më të theksuar në biodiversitetin e zonës janë të renditura në vijim:

- Zhvillimi industrial dhe pasojat e ish-aktiviteteve industriale, kanë qënë kontribuesit kryesorë të ndotjes së ajrit dhe ujit.
- Urbanizimi: Kërkesa gjithnjë e në rritje për zona banimi, ku në dy dekadat e fundit kjo kërkesë është reflektuar në shtimin e zonave urbane informale dhe në shpërhapje, duke zënë sipërfaqe të zonave natyrore e bujqësore, kryesisht përreth qytetit të Burrelit.
- Fragmentimi i habitateve nga ndërtimi i infrastrukturës rrugore apo i veprave të ndryshme ka çuar në fragmentimin e habitateve ose ndërprerjen e vazhdueshmërisë së zonave natyrore i cili vjen si rrjedhoje e ndërtimit të infrastrukturës në toka bujqësore e natyrore, pa marrë parasysh parimet e mbrojtjes së mjedisit.

REPUBLIKA E SHQIPERISE AGJENCIA E ZHVILLIMIT TE TERRITORIT TIRANE SEKRETARIA

REPUBLIKA E SHQIPERISE AGJENCIA KOMBETARE E TERRITORIT TIRANE SEKRETARIA

- Gjuetia e paligjshme ka pasur një ndikim të ndjeshëm në biodiversitet, gjë që ndihet edhe sot, pas dy viteve të ndalimit të saj (moratoriumi i gjuetisë). Për fat të mirë, moratoriumi është zgjatur edhe për 5 vite të tjera.
- Zhvillimi i bujqësisë së shkallës: Zhvillimi i bujqësisë, ka qenë kërcënimi kryesor ndaj biodiversitetit gjatë sistemit të shkuar (periudha e regjimit komunist), hapja e tokave të reja bujqësore, shpyllëzimi për këtë qëllim dhe përdorimi i kimikateve bujqësore.
- Shpyllëzimi ka qënë dhe mbetet një problem kryesor i prishjes së habitateve.
- Kullotja e bagëtisë, në përgjithësi ka një ndikim negativ në zhvillimin e bimësisë, kryesisht në bimët dhe shkurret e ulëta, të cilat shërbejnë si ushqim për bagëtinë.
- Peshkimi i pakontrolluar, kryesisht përgjatë lumit Mat, ka ndikuar në uljen e numrit të popullatës së peshqve pa lënë pas edhe peshkimin në liqene apo rezervuarë, të cilët kanë tashmë një jetë natyrore të zhvilluar.

Shpallja e moratoriumit 5-vjeçar të gjuetisë dhe moratoriumit 10-vjeçar të pyjeve mendohet se do të mbrojë biodiversitetin në përgjithësi dhe do të shtojë numrin e specieve floristike dhe faunistike në territorin e Bashkisë.

- Toka

Toka Bujqësore dhe bujqësia

Tabela 9: Ndarja e bashkive sipas sektorit ekonomik

| Kodi | Bashkia | Tipologjia | Sip. km$^2$ | Banorë |
|---|---|---|---|---|
| 14 | Qyteti i Burrelit | Qendër lokale | 14.11 | 10862 |
| 32 | Ulëz | Njësitë vendore jo-urbane me drejtim minerar ose energjitik | 102.64 | 1229 |
| 41 | Rukaj | Njësi vendore bujqësore mikse fushore | 36.33 | 2507 |
| 42 | Baz, Komsi, Macukull | Njësi vendore bujqësore mikse malore | 227.86 | 8076 |
| 44 | Derjan, Lis | Njësi vendore bujqësore malore | 112.12 | 4926 |
| Totali | | | 493.5 | 27600 |

**Burimi**: CENSUS, 2011; **Përpunoi**: Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2016

Sipas tabelës së mësipërme, të paktën 56% e popullsisë ka si aktivitet bazë bujqësinë, por shifra mund të jetë edhe më e lartë, nëse llogaritjet kryhen sipas deklarimeve të punësimit, e jo klasifikimit tipologjik të bashkisë.

Bashkia e Matit nuk ka sipërfaqe të mëdha tokash bujqësore, që mund të shërbejnë për kultivimin intensiv të bimëve. Megjithatë, Bashkia përfshin një larmi të gjerë tokash në territorin e saj (fushore, kodrinore dhe malore), të cilat përdoren për prodhimin e ***drithërave*** (grurit, misrit, tagjirës), pemtarisë, perimeve, vreshtarisë (rrushit) dhe blegtorisë (rritja e bagëtive të imta e të trasha si lopët, derri dhe dhentë). Bashkia dallohet edhe për ***drurët frutorët,*** të tilla si qershitë, pjeshkët, nektarinat, kajsitë, fiqtë, hurmat, shegët, gështenjat, arrat, thanat, hurmat, etj.

- Problematikat e Tokave Bujqësore në Mat

**Erozioni i tokave bujqësore, shkarjet, shembjet:** Bashkia e Matit shtrihet në një zonë me reliev të larmishëm fushor, kodrinor dhe malor, ku zonat fushore janë të kufizuara përgjatë luginës së lumit Mat dhe përgjatë përrenjve. Si rrjedhojë, duke qenë se një pjesë e mirë e tokave bujqësore shtrihen në reliev jofushor, ato janë të prirura ndaj erozionit, shkarjeve dhe shembjeve.

Për sa i përket ***erozionit*** në tokat bujqësore, ndërsa në vendin tonë rreziku potencial i erozionit konsiderohet mesatar dhe i lartë, në Rrethin e Matit është vlerësuar si *i lartë*[55].

Tabela 10: Vlerësim për nivelin e erozionit potencial në tokat bujqësore të Shqipërisë

| Rrethet | Sip (Ha) | Indeksi i erodibilitetit | | | | Indeksi i rrezikut potencial të tokës | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Absol. | Rel. | Indeksi i erozionit të tokës | Indeksi i pjerrësisë | Absol. | Rel. | Vlerësimi |
| Lezhë | 15461 | 6.7 | 3 | 3 | 1.12 | 10.1 | 2 | Mesatar |
| Mat | 11389 | 7.8 | 3 | 2 | 2.52 | 15.1 | 3 | I lartë |
| Dibër | 23315 | 7.5 | 3 | 2 | 2.04 | 12.2 | 3 | I lartë |

**Burimi:** AKM 2013; **Përpunoi:** Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2016

Bashkia ka shumë fshatra të ndodhura në terren kodrinor e malor, sidomos në zonën e NjA-ve Lis, Macukull, Derjan, Baz dhe Komsi të cilat janë të ndjeshme ndaj erozionit. Shkaqet e erozionit në tokat bujqësore të kultivuara në Bashkinë e Matit janë natyrore dhe të shaktuara nga ndërhyrjet e papërshtatshme të njeriut gjatë përdorimit të saj (keq-manaxhimi). Disa nga këto ndërhyrje mund të lidhen kryesisht me:

- Kultivimin e tokave me pjerrësi të mesme e të theksuar, që rezulton në rrëshqitje, ndihmuar kjo dhe nga fenomene të motit;
- Mënyra e kultivimit të tokës bujqësore kodrinore në të njëjtin drejtim me pjerrësinë dhe me zhveshje totale të tokës gjatë plugimit;
- Djegia e mbetjeve të bimëve të kultivuara, si praktikë e thjeshtë për pastrimin e saj, por që shkatërron plehun organik dhe zhvesh tërësisht tokën nga bimësia që shërben si masë mbrojtëse për të;
- Tarracimi i papërshtatshëm i zonave kodrinore-malore me zhveshje të tokës etj.

Kjo sepse në tokat bujqësore në Bashkinë Matit dhe pothuajse në gjithë vendin tonë, bujqërit ose fermerët vazhdojnë të përdorin praktika bujqësore të papërshtatshme si zhveshja e tokës nga bimësia e stinëve të mëparshme gjatë plugimit, pa marrë parasysh se një gjë e tillë e varfëron tokën dhe e shndërron atë në tokë të ndjeshme ndaj erozionit, në rastin më të parë të reshjeve me intensitet të lartë apo të stuhive të erës.

Tokat e rajonit të Matit janë të rrezikuara edhe nga mundësitë e ***shkarjeve*** dhe ***shembjeve***[56], një formë e rrezikut gjeologjik. Disa nga shkaqet e shkarjes së tokës që indentifikon AKM-ja në Bashki janë: relievi i thyer, reshjet, dëmtimi i bimësisë natyrore, braktisja e tokave bujqësore etj. Për shkak të reshjeve dhe mungesës së manaxhimit të ujërave sipërfaqesore dhe nëntokësore, risku i shkarjeve të tokës mbetet i lartë[57].

**Gërryerja e tokës në brigjet e lumenjve:** Dëmtimet në brigjet e lumenjeve janë rezultat i shfrytëzimit të materialeve inerte në shtretërit e lumenjeve, dëmtimit të objekteve mbrojtëse dhe dëmtimit të bimësisë përgjatë shtratit dhe mbushjes së shtratit të tyre me mbetje urbane. Nga

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

studimet e kryera në nivel kombëtar është konstatuar një nivel i lartë i humbjes së tokës në brigjet e lumenjve, mirëmbajtja e lumenjve është konstatuar e dobët, si rrjedhojë gjendja është serioze[58].

**Zvogëlimi i sipërfaqes së tokës bujqësore për shkak të ndërtimeve të ndryshme**: Pjesa më e madhe e ndërtimeve, edhe pse nuk kemi shifra të sakta është shtrirë në toka bujqësore përgjatë gjithë territorit të Bashkisë.

**Ulja e rendimentit të tokave për shkak të përdorimit intensiv të saj**: Sot, bujqësia në vendin tonë përballet me ndryshime të mëdha, gjë e cila nënkupton: kultivimin e tokës bujqësore përgjatë gjithë vitit me përdorimin e makinerive moderne e inputeve bujqësore të panjohura më parë si dhe shtimin e kulturave bujqësore të reja.

**Ndotja e tokës:** Në Bashkinë e Matit ndotja e tokës ka ndodhur në seksione të caktuara të territorit, kryesisht në zona industriale, në zonat e depozitimit të mbetjeve si dhe në zona të tjera. Si zona të ndotura, në Bashkinë Matit dallohet ish-Uzina e Ferro-Kromit, në aktivitet edhe sot, venddepozitimi i mbetjeve pranë Burrelit, në jug të qytetit dhe vend-depozitime të tjera jashtë kushteve teknike dhe higjieno-sanitare të shpërndara në territorin e NjA-ve të ndryshme.

- Përfundime e rekomandime

Bashkia e Matit ka një larmi të gjerë tokash në territorin e saj (fushore, kodrinore dhe malore), të cilat përdoren për prodhimin e ***drithërave*** (grurit, misrit), pemëtarisë, perimeve, vreshtarisë (rrushit) dhe blegtorisë (rritja e bagetive të imta e të trasha si lopët, derri dhe dhentë). Bashkia dallohet edhe për pemëtari dhe ***ullishtet***, të cilat janë një traditë e trashëguar ndërshekuj. Megjithatë, Bashkia përballet edhe me nevojën e shmangies së **degradimit të tokës**, që në Mat është fenomen i zakonshëm për shkak të tokave të buta dhe me pjerrësi të theksuar. Ky fenomen theksohet edhe më tej në rastet e punimit të tokave në pjerrësi nga banorët, duke shkaktuar erozion, shkarje dhe shembje të tokës. Për shkak të reshjeve dhe mungesës së manaxhimit të ujërave sipërfaqesore dhe nëntokësore, risku i shkarjeve të tokës mbetet i lartë[59]. Gjatë viteve të fundit, në Mat mbetet i lartë edhe rreziku i erozionit së tokës, i cili shoqërohet edhe me depozitime të ngurta kohërave me shi[60]. Dëmtimet në brigjet e lumenjve janë rezultat i shfrytëzimit të materialeve inerte në shtretërit e lumenjve, dëmtimit të objekteve mbrojtëse dhe dëmtimit të bimësisë përgjatë shtratit të tyre. Niveli i humbjes së tokës në brigjet e lumenjve është i lartë, ndërkohë që mirëmbajtja e lumit është anashkaluar. Gjendja rëndohet sidomos në rastet kur ka reshje të shumta e të rrëmbyeshme[61]. Njëkohësisht, Bashkia po përballet me probleme si: zvogëlim i sipërfaqes së tokës bujqësore për shkak të kthimit të saj në truall ose tokë me përdorime të tjera. Në zona të caktuara, si zona përreth Ish-Uzinës së Ferro-Kromit, që ka vepruar kryesisht në të shkuarën, nuk mungon ndotja.

Për të rritur prodhimin bujqësor në territorin e Bashkisë pa cënuar qëndrueshmërinë e tokave, lipset që Bashkia të ofrojë shërbimin e agronomisë nëpër fshatra bujqësore. Duke u ofruar informacionin e duhur bujqve. Ky shërbim i ndihmon ata që të shtojnë prodhimin bujqësor nëpërmjet praktikave moderne bujqësore, edhe në toka kodrinore si ato të Matit. Me qëllim shmangien e degradimit të mëtejshëm të tokës bujqësore dhe jo buqësore, nevojitet që Bashkia të promovojë zhvillimin rural brenda territorit dhe të garantojë zhvillimin e një bujqësie më të qëndrueshme nëpërmjet praktikave prodhuese të qëndrueshme që respektojnë mjedisin, siç është përcaktuar në Politikën e Përbashkët për Bujqësinë të BE-së[62].

Njëkohësisht, rekomandohet që Bashkia të hartojë planin e zhvillimit territorial duke patur parasysh parimin e mbrojtjes së tokës bujqësore (shndërrimin e tokës bujqësore në truall vetëm në raste kur janë konsumuar të gjitha mundësitë e tjera). Me qëllim shmangien e rrezikut që mund t'u kanoset banorëve të Bashkisë nëpërmjet konsumit të produkteve ushqimore të kultivuara në toka të ndotura, rekomandohet që përreth dhe në brendësi të zonave të ndotura në territorin e Bashkisë, të kryhen studime që synojnë përcaktimin e nivelit dhe shtrirjes gjeografike të ndotjes dhe të merren masa të menjëhershme për rehabilitimin e tyre.

- Ndyshimet Klimatike dhe rreziqet

Në vendet e Europës Juglindore, përfshirë Shqipërinë, pasojat e ndryshimeve klimatike do të shprehen në forma të ndryshme si:

- Një rritje e temperaturës me 1.7 – 3.5°C deri në vitin 2100,
- Një ulje e sasisë së reshjeve dhe ndryshim të regjimit të tyre (-3.84 deri në -18.13% deri në vitin 2100)[63].

Këto fenomene parashikohet të kenë pasoja të theksuara në zhvillimin e rajonit, sepse kanë mundësi të shkaktojnë ngritjen e nivelit të detit duke krijuar erozion detar, përmbytje, pakësim të ujërave nëpër lumenj e liqene gjatë vitit dhe përmbytje në periudha të caktuara për shkak të shtimit të reshjeve me intensitet të lartë, ndryshimeve në stinën e kultivimit në bujqësi, ndryshim të habitateve, paksim në numër dhe lloj të specieve, shtim të llojeve të huaja invazive së bashku me rritjen e sëmundjeve infektive[64].

Gjithashtu, probleme të shumta do të hasen në komunitetet lokale dhe ato rajonale që varen nga shërbimet që ofron ekosistemi, uji i pijshëm, karburanti, materialet për ndërtim dhe të korrat. Ndër pasojat më të theksuara të ndryshimeve klimatike, që parashikohet të ndodhin në rajon, renditen më poshtë[65]:

- Mungesa e ujit të pastër për shkak të uljes të sasisë së reshjeve dhe rritjes së temperaturave.
- Në zonat malore ku rritja e temperaturës do të shkaktojë shkrirjen e shpejtë të akujve dhe dëborës parashikohet fryrja e rrjedhave të lumit dhe ndikimet zinxhir që rrjedhin nga kjo.
- Zonat bregdetare do të përballen me pasojat që vijnë nga rritja e nivelit të detit kombinuar me rritjen e rrezikut nga fenomene klimatike si stuhitë apo reshjet intensive.

Në skenarët e rritjes së temperaturës, në vitin 2050 parashikohet një rritje mesatare e temperaturës me 1.7°C dhe skenari maksimal 2.2°C. Ndërsa në vitin 2080, temperatura mund të rritet me 2.8°C dhe vlera maksimale e vlerësuar arrin shifrën 3.5°C. Në vitin 2100, temperatura mesatare vjetore parashikohet të rritet me 2.4-4.1°C.

Përveç rritjes së temperaturave në përgjithësi, parashikohet edhe shtimi i fenomeneve ekstreme të motit siç janë numri i ditëve me temperaturë >35°C pa ndërprerje, numri i ditëve me valë të nxehta dhe numri i ditëve me temperaturë të ftohtë pa ndërprerje.

Si pasojë e rritjes së temperaturës, dhe rritjes së numrit të ditëve me valë të nxehta, vendi do të përballet me thatësirë të konsiderueshme dhe mot të nxehtë. Ndikim të menjëhershëm do të këtë në rritjen e mesatares vjetore të vdekshmërisë, kryesisht për moshat e treta; në kërkesën në rritje për ujë të pastër; dhe probleme me përshtatjen e kulturave bujqësore me klimën.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA KOMBËTARE E TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA
REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

**Ulja e sasisë së reshjeve**: Një problem i rëndësishëm, që pritet të vijë bashkë me ndryshimet klimatike, tashmë të vërtetuara shkencërisht, është ulja e sasisë së reshjeve vjetore dhe shpërndarja e tyre përgjatë vitit.

Në vitet e ardhshme pritet që sasia e reshjeve të ulet rreth 14.37% në vitin 2080, dhe deri në mbi 18% në vitin 2100. Në vitet e ardhshme parashikohet që periudhat e thatësirës të shtohen së tepërmi, si pasojë e uljes së sasisë mesatare të reshjeve vjetore dhe shpërndarjes së tyre përgjatë vitit.

Rritja e temperaturave në territorin e Bashkisë Mat do të ketë një sërë problemesh kryesisht në zhvillimin e bujqësisë dhe në biodiversitet. Për zhvillimin sa më të qëndrueshëm të biodiversitetit duhen marrë masa në kohë sa më të hershme, për përshtatjen e bujqësisë dhe gjetjen e mënyrave për plotësimin e nevojës me ujë për vaditje..

- Përfundime dhe rekomandime

Ndryshimet klimatike tashmë janë një realitet. Ky ndryshim i klimës ka ndikim të madh në shumë fusha të zhvillimit të vendit, sidomos në atë bujqësor dhe energjitik. Vetëm sektori i bujqësisë ka rreth 50% të punësuarve në Shqipëri. Gjithashtu, kontributi i këtij sektori ne PPB arrin në 24%[66]. Në këtë kontekst,shihet më se e rëndësishme të merren masa të rëndësishme për planifikimin e zhvillimit të sektorit të bujqësisë dhe industrisë duke patur parasysh ndryshimet klimatike. Disa nga këto masa në bujqësi përfshijnë përshtatjen e kulturave bujqësore me ndryshimet e klimës, manaxhimin e duhur të burimeve ujore, rritjen e kapaciteteve kulluese dhe ato ujitëse, masa për parandalimin dhe kontrollin e zjarreve, mbrojtja ndaj erozionit të tokës etj.

Edhe për Bashkinë Mat, sektorët që do të preken më shumë nga ndryshimet klimatike janë bujqësia, energjia, biodiversiteti, toka dhe ekosistemet ujore[67]. Bashkia Mat nuk është një territor bregdetar, por në të kalojnë ujërat e lumit Mat, të cilat në kushtet e rritjes së nivelit do të dëmtojnë tokat bujqësore pranë rrjedhës së tij apo edhe vendbanimet e ndryshme. Për këtë arsye, duhen marrë masa për fortifikimin e barrierave të brigjeve të lumenjve, kryesisht në zonat më problematike, të cilat janë të prekuar edhe nga erozioni lumor. Gjithashtu duhen marrë masa për përmbushjen e nevojave ushqimore në raste ekstreme, ku kulturat bujqësore dëmtohen nga përmbytjet masive dhe nga periudhat e gjata të thatësirës.

- Zonat e nxehta mjedisore dhe aktiviteti industrial

Në Bashkinë e Matit gjendet ish Uzina e Ferro-kromit e cila është klasifikuar si një Hotspot mjedsor dhe shtrihet në NjA Komsi.

**Ish Uzina e pasurimit të Ferro-kromit Burrel:** Është përcaktuar si një vatër e nxehtë mjedisore në vendit tonë[68] sepse mbart mbetje industriale të rrezikshme. Ky aktivitet mbart një potencial dhe një rrezik mjaft të lartë për ndotjen me metale të rënda, specifikisht mbetje të Cr, si edhe elementë të tjerë, të cilët derivojnë nga procesi i larjes, pastrimit, përpunimit dhe pasurimit të kromit.

Referuar *Raportit të Gjendjes në Mjedis* të vitit 2014 monitorimi i kryer në zonën përreth Ish Uzinës ka nxjerrë në dukje ndotjen me elementë të ndryshëm, mbi normën. Ndotja është monitoruar në 8 pika, me drejtimin lindor dhe jugor të objektit industrial, në distancë nga 100m deri në 1,400m. Sipas këtij studimi, për metalet e rënda si Cr[69], Ni[70] dhe Cu[71] ndikimi në tokë është shumë i lartë. Ndotja e lartë me metalet Ca[72] dhe Pb[73] është monitoruar në disa pika, përqëndrimet e të cilave i kalojnë limitet toksike. Përmbajtja e metalit të Ni e kalon 3 herë

normat e vendosura të BE-së, përqndrimet e Cr (kromit) variojnë nga 623-764ppm, ndërsa vlerat e bakrit i kalojnë limitet të ashtëquajtura kritike.

Uzina e Shkrirjes së Ferrokromit në Komsi ka zhvilluar aktivitetin e saj nga vitin 1976 deri në 1996. Nga aktiviteti i saj prodhues janë shkarkuar në atmosferë për çdo ton ferro-krom të prodhuar rreth 1000 $m^3$ gaz[74].Përbërësit kryesor të gazit janë CO, $H_4$, CnHm, $CO_2$ dhe $N_2$. Furrat gjithshtu shkarkojnë në ajër dhe element të tillë si NOx, $NH_3$, dhe POM.

Problematike paraqitet gjendja e ujërave të kësaj zone, pasi rrezikshmëria paraqitet e lartë pasi njerëzit kanë kontakt të drejtpërdrejtë me të.

Aktualisht kjo Uzinë vazhdon aktivitetin e saj. Fabrika ka ndryshuar procesin e prodhimit dhe teknologjinë, gjë që supozon ndikim më të ulët në mjedis. Megjithatë, si rrjedhojë e mungesës së të dhënave, është e pamundur që të përcaktohet ndryshimi aktual i ndikimit në mjedis të fabrikës.

**Ish Stacioni i Makinave dhe Traktorëve:** Ndërtimi dhe përdorimi i stacioneve të makinave dhe traktorëve në Shqipëri filloi rreth viteve 1960 dhe këto hapësira ndaluan së përdoruri për këtë qëllim në fillim të viteve 90'. Ish SMT ka një sipërfaqe 45,911 $m^2$ dhe pozicionohet shumë pranë qytetit të Burrelit. Kjo hapësirë nuk është përcktuar si një vatër e nxehtë mjedisore, por sipërfaqja e saj paraqet nje potencial të lartë rreziku për mjedisin, në veçanti për tokën. STM përdoreshin për vendosjen e makinave bujqësore dhe traktorëve, por dhe riparimin e tyre në këto hapësira. Parashikohet që toka në këto hapësira është ndotur nga shkarkimet e vajrave të makinës apo nga derdhjet aksidentale të lëndës djegëse që ato përdornin.

- Ndotje të tjera industriale

**Dampat e fabrikës së pasurimit të Ferro-kromit**[75] **:** Nga industria e pasurimit të mineralit të kromit prodhohen dhe mbetje industriale, të cilat depozitohen në mjedis duke krijuar dampat. Në Komsi janë të vendosur dy dampa, në Fshatin Frankth të NjA Komsi[76], të cilat kanë krijuar stoqe me mijëra $m^3$ të quajtura skorie të ferro-kromit. Ekspozimi i skorieve në mënyrë të vazhdueshme ndaj agjentëve atmosferikë krijon ndikime të mëdha në mjedis, sidomos duke rritur mineralizimin në tokë dhe më tej duke u transportuar në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore.

**Stoqet e mineraleve të kromit:** Në të gjitha minierat e Qarkut Dibër në hyrje të galerive krijohen stoqe e mineralizimit të kromit. Stoqet e mineralit janë të përkohshëm, por duke patur parasysh që përqëndrimet e elementëve të kromit, nikelit, kobaltit, etj., janë të larta, ato paraqesin rrezik të lartë gjatë qëndrimit në mjedis të hapur. Kushtet atmosferike ndikojnë duke shkaktuar shpëlarjen e stoqeve dhe duke rritur praninë e elementëve ndotës në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore.

**Shkarkimet e lëngshme industriale**: Krahas aktiviteteve madhore industriale, në territorin e Bashkisë Mat janë identifikuar disa aktivitete më të kufizuara, të cilat ndotjen dhe mbetjen e gjeneruar e shkarkojnë në ujërat e lumit Mat apo përrenjve më të afërt.

**Venddepozitimi i mbetjeve urbane, Komsi:** Ky venddepozitim shtrihet përgjatë rrugës që të çon në Komsi, në një largësi shumë të vogël nga Varrezat e Dëshmorëve dhe 440m nga Përroi i Gostrimës. Mbetjet që grumbullohen, hidhen dhe digjen gjatë ditës e natës. Djegia shkakton probleme për banorët e zonës, ku përveç tymit shkarkohen dhe gaze të cilat shkaktojnë sëmundje tek njerëzit. Ky venddepozitim shërben dhe për hedhjen e kafshëve të ngordhura, duke paraqitur rrezik nga ndotja mikrobiologjike.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT SEKRETARIA TIRANË

Figura 29: Venddepozitimi aktual i mbetjeve urbane, Komsi



**Burimi**: Arkiva MetroPOLIS, 2016

- Përfundime dhe rekomandime

Bashkia Mat trashëgon një zonë të ndotura nga aktivitete industriale në të shkuarën, e cila klasifikohet si vatër e nxehtë mjedisore. Kjo është zona e Uzinës së Pasurimit së Ferro-kromit shumë pranë qytetit të Burrelit. Për më tepër, në Mat ndodhet edhe ish SMT brenda në qytetin e Burrelit, edhe pse nuk është renditur si hotspot, pasi ndikimi i saj nuk është klasifikuar si i lartë. Deri më tani, janë mbetjet e gjeneruara nga industria e pasurimit të Ferro-kromit në Komsi nuk janë trajtuar si mbetje industriale, por përfundojnë në venddepozitimet e mbetjeve të ngurta urbane ose skorjet përdoren për shtrimin e rrugëve nëpër fshatrat pranë.

Në Bashki ka edhe aktivitetet industriale dhe jo vetëm, që kanë një ndikim të theksuar në mjedis në rast se nuk merren masat e duhura. Këtu mund të përmendim venddepozitimin e mbetjeve urbane e cila ka nevojë urgjente për rehabilitim, dampat e shkarkimeve industriale të së shkuarës, ish Stacioni i Makinave dhe Traktorëve mbeten vatra të mundshme ndotjeje të mjedisit, në rast se nuk merren masat e duhura mjedisore.

Duke patur parasysh rreziqet që i kanosen shëndetit të njeriut dhe mjedisit, rekomandohet që Bashkia të marrë masa për pastrimin dhe rehabilitimin e zonës së nxehtë mjedisore dhe kontrollin e ndotjes nga industria që zhvillohet në Bashkinë Mat dhe venddepozitimi i mbetjeve etj.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
TIRANË

## 1.3 Zhvillimi ekonomik

Në vitin 2012 PBB (në rang kombëtar) me çmime korrente ishte 1.335,5 miliardë lekë, duke shënuar një rritje prej rreth 1.6 % krahasuar me vitin 2011. Sipas qarqeve, pesha më e ulët ndaj totalit të PBB-së në rang vendi u shënua në qarkun Kukës me 2.1 % dhe në qarkun Gjirokastër me 2.2 %. Ndërsa peshën më të madhe të PBB-së e shënoi qarku Tiranë me 38.2 % me një vlerë totale të PBB-së prej 510 miliardë lekë. (Vjetari statistikor rajonal 2015)

Në vitin 2013 ekonomia shqiptare shënoi një rritje në terma real (në volum) prej +1.39 % krahasuar me vitin 2012. Deflatori i PBB-së për vitin 2013 ishte +0.79 %. Mbështetur mbi këto rezultate, PBB për frymë në vitin 2013 arriti në 471 mijë lekë (ose 3.358 €) nga 460 mijë lekë (ose 3.312 €) që ishte në vitin 2012.

Sipas PBB-së me metodën e prodhimit, rritjet në terma real për degët kryesore të ekonomisë në vitin 2013, janë: bujqësia, gjuetia, pyjet dhe peshkimi me +0.61 %, Industria me +7.90 %, Ndërtimi +1,13 % dhe Shërbimet me +0,08 %.

Në degët përbërëse të shërbimeve, Transporti dhe Post-komunikacioni paraqiten me rënie, përkatësisht me -8,05 % dhe -8,03 %, ndërsa degët Tregti, Hotele dhe restorante dhe Shërbimet e tjera shënojnë rritje prej +0,62 % dhe +1,67 %.

Peshën më të madhe në ekonomi për vitin 2013 vazhdojnë ta zënë Shërbimet gjithsej me 43,8 % të PBB, pasuar nga Industria dhe Ndërtimi 23,6 % dhe Bujqësia, Gjuetia, Pyjet dhe Peshkimi me 19,64 %

Tabela 11: Prodhimi i Brendshëm Buto, kontributi i Qarkut të Dibrës

| Qarku | PBB cmime korrente (milion lekë) | Struktura ndaj PBB-së(%) | PBB për frymë (në lek) | Struktura e indeksit për frymë ndaj PBB-së (%) |
|---|---|---|---|---|
| Gjithsej | 1.335.489 | 100 | 460.436 | 100 |
| Tiranë | 510.093 | 38,2 | 649.737 | 141,1 |
| Dibër | 43.236 | 3,2 | 309.670 | 67,3 |

**Burimi**: INSTAT, 2012

Për Qarkun e Dibrës në vitin 2012 PBB me cmime korrente ishte 43.236 milion lekë, dhe pesha ndaj totalit të PBB-së në rang vendi ishte 3,2 %. Krahasuar me Qarkun e Tiranës që zë peshën më të madhe të PBB-së në rang vendi (38.2 %), dhe Qarkun e Kukësit që zë peshën më të ulët të PBB-së në rang vendi me 2.1 %, themi se PBB për frymë në qarkun e Dibër ishte 309 mijë lek, nën mesataren e vendit (460 mijë lek). Këto shifra dëshmojnë për një ekonomi të dobët në rang qarku, ku kontributi i së cilës renditet minimal krahasuar me qarqet e tjera të vendit.

Territoret grumbulluese dhe zbrazëse

Ndryshimet e popullsisë së qarqeve, normat e rritjes apo të zvogëlimit të popullsisë së tyre ndikohen jo vetëm nga dy komponentët kryesorë të ndryshimit të popullsisë gjithsej, por edhe nga lëvizjet e brendshme të popullsisë. Gjatë këtyre pesë viteve të fundit, Shqipëria ka përjetuar ndryshime të dukshme, jo vetëm që popullsia banuese ka pësuar ulje nga 2,913,017 në vitin 2010 në 2,894,476 në vitin 2014, por një pjesë e konsiderueshme e popullsisë ka lëvizur brenda Shqipërisë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

Figura 30: Lëvizjet e brendshme të popullësisë sipas qarqeve




**Burimi:** INSTAT, 2012

Dibra, Berati dhe Kukësi janë qarqet të cilat paraqesin një normë bruto të emigracionit neto shumë të ulët, respektivisht -11.2, -9.6 dhe -9.6 për mijë. Këto qarqe kanë një balancë të thellë negative të migracionit të brendshëm, përjetojnë flukse shumë më të larta dalëse të popullsisë krahasimisht me ato hyrëse. Më konkretisht raporti midis të ardhurve dhe të larguarve për Qarkun Dibër, në vitin 2014 ishte 30% të ardhur dhe 70% të larguar. Përkatësisht vlerat 30% shpjegohen me numrin e personave të cilët janë zhendosur nga zonat e thella malore drejt qendrave të qyteteve përbërse të qarkut Dibër.

Me një vlerë kaq të lartë migrimi dhe shifra tejet të ulëta të migrantëve të kthyer (shih tabelën më poshtë), Bashkia Mat bën pjesë në kategorinë e territoreve zbrazëse, ku analizat demografike, analizat social ekonomike, normat e punësimit etj, dëshmojnë për një popullësi gjithnjë e në rënie, dhe tkurrje e ndjeshme e forcës punëtore.

Tabela 12: Numri i migrantëve të kthyer, Bashkia Mat

| | Migrantët e kthyer |
|---|---|
| Shqipëria | 139,827 |
| Qarku Dibër | 3,589 |
| Bashkia Mat | 580 |
| Burrel | 305 |
| Baz | 36 |
| Derjan | 0 |
| Rukaj | 40 |
| Macukull | 23 |
| Komsi | 49 |
| Lis | 93 |
| Ulëz | 25 |

**Burimi:** Instat, 2015; **Përpunoi:** Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2016

### 1.3.1 Klima e Biznesit

Tabela 13: Të punësuarit sipas sektoreve

| Aktiviteti ekonomik në % | Burrel | Ulëz | Rukaj | Derjan | Lis | Komsi | Baz | Macukull |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Bujqësi pyje dhe peshkim | 7.3 | 6.9 | 44.1 | 1.3 | 15.6 | 67.3 | 64.7 | 63.8 |
| Tregti me shumicë dhe pakicë | 12.2 | 0.5 | 5.4 | 0.0 | 8.9 | 5.0 | 2.3 | 3.3 |
| Ndërtim | 3.0 | 3.2 | 3.9 | 2.6 | 5.8 | 3.5 | 3.6 | 2.8 |
| Industri | 12.4 | 53.2 | 6.9 | 13.2 | 16.4 | 6.8 | 6.2 | 3.3 |
| Shërbime | 62.1 | 27.7 | 35.3 | 68.4 | 44.4 | 15.5 | 22.2 | 25.4 |
| E papërcaktuar | 3.1 | 8.5 | 4.4 | 14.5 | 8.9 | 1.8 | 1.0 | 1.4 |

**Burimi:** INSTAT, 2012

Në Bashkinë Mat mbizotërojnë ndërmarrjet e orientuara drejt shërbimeve të cilat zënë 118.4%. Pjesa më e madhe e tyre është e përqëndruar në Njësinë Administrative Derjan dhe Burrel dhe i referohen kryesisht tregtimit të produkteve ushqimore, konfeksioneve dhe artikujve të ndryshëm etj.Vendin e dytë për nga rëndësia e zë bujqësisa pyjet dhe peshkimi me përqëndrimin më të madh Komsi, Baz dhe Macukull.

Biznesi dhe Aktivitetet tregëtare

Në Bashkinë e Matit operojnë gjithsej 524 biznese të vogla të specifikuara sipas llojit në tabelën më poshtë. Numrin më të lartë të bizneseve e ka qyteti i Burrelit i ndjekur më pas nga njësia administrative Komsi. Në të gjitha njësitë administrative, aktiviteti dominues është ai i aktikviteteve sociale dhe rekreative, më saktësisht ai i bareve dhe restoranteve, i cili ndiqet nga ushqimoret dhe më pak me profesionet e lira. Peshë të rëndësishme në aktivitetin ekonomik të qytetit të Burrelit, luajnë dhe agjencitë e transportit. Nga analiza e mësipërme kuptojmë se, ekonomitë familjare varen krejtësisht nga sektori i ofrimit të shërbimeve, duke lënë mënjanë eksplorimin e fushave të tjera si bujqësia familjare, peërpunimi i drurit, artizanati etj.

Tabela 14: Grupimi i Bizneseve të vogla

| Lloji biznesit | Burrel | Ulëz | Rukaj | Derjan | Lis | Komsi | Baz | Macukull |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. Bizneseve të vogla | 415 | 8 | 8 | 4 | 16 | 33 | 7 | 21 |
| Shërbime shëndetësore | 12 | | | | | | 1 | |
| Ushqimore | 74 | 1 | | 4 | 5 | 1 | | |
| Aktivitete Sociale/rekreacioni | 94 | 7 | 2 | | 8 | 13 | 2 | 1 |
| Agjensitë/transporti | 25 | | | | | | | |
| Servise | 9 | | | | 1 | 9 | | |
| Sektori i përpunimit | 13 | | | | 2 | 3 | | 11 |
| Profesione të lira | 47 | | | | | | | |
| Sërbime të tjera | 141 | | 6 | | | 7 | 4 | 9 |

**Burimi:** Bashkia Mat, 2016

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

Krahas bizneseve të mëdha në Bashkinë e Matit operojnë dhe 13 Biznese VIP. Në listën e tyre renditen telefonitë celulare, aktivitetet bankare, dhe dy kompanitë e prodhimit të energjisë elektrike dhe aktiviteti industrial i uzinës së Ferro-Kromit. Pavarsisht kategorizimit të këtyre kompanive, kontributi i tyre në ekonominë lokale është fare i vogël.

Tabela 15: Llojet e bizneseve

| Lloji biznesit | Burrel | Ulëz | Rukaj | Derjan | Lis | Komsi | Baz | Macukull |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. Bizneseve të vogla | 415 | 8 | 8 | 4 | 16 | 33 | 7 | 21 |
| Nr. Bizneseve VIP | 9 | 1 | 1 | | | 2 | | |
| Nr. Bizneseve të mëdha | 71 | 1 | | 2 | 7 | 10 | 1 | 1 |
| Shërbime shëndetësore | 4 | | | | | | | |
| Ushqimore | 9 | | | | | | | |
| Aktivitete Sociale/rekreacioni | 3 | | | | | | | |
| Agjensitë/transporti | 2 | | | | | | | |
| Servise | | | | | | | | |
| Sektori I përpunimit | 35 | | | 2 | 4 | 6 | | 1 |
| Profesione të lira | | | | | | | | |
| Sërbime të tjera | 18 | 4 | | | 3 | 4 | 1 | |

**Burimi:** Bashkia Mat, 2016

### 1.3.2 Bujqësia dhe Prodhimi

Bujqësia në Bashkinë e Matit, mbetet sektor i rëndësishëm per punësimin, sigurimin e të ardhurave per rreth 60% te popullsisë së bashkisë dhe në kushtet e aktiviteteve të tjera të kufizuara industriale. Megjithëse sektori i bujqësisë mbetet i pa zhvilluar, me rendimente të ulëta në prodhimin bujqesor e blegdoral. Performanca ekonomike e sektorit bujqësor dhe niveli i zhvillimit rural në Bashkinë e Matit mbetet e ulët dhe larg potencialeve së paku për disa drejtime si kultivimi dhe rritja e prodhimit të pemtarise, ku kushtet klimatike dhe tokësore janë më të përshtatshme se sa për bimët e arave. Ka disa faktore si fermat e vogla dhe të fragmentuara, sistemet ujitjes dhe aftësia ujitëse më pak se 30 %, nivelit të ulët të teknologjive, funksionimit të pjesshëm të zinxhirit të prodhim-grumbullimit si dhe produktivitetit total të faktorëve të prodhimit.

Krahasimisht me bashkitë e tjera përbërëse të qarkut dhe rajonit, Bashkia Matit mbetet më pak e zhvilluar në eksportet e ulëta minimale bujqësore, aktivitete shumë të kufizuara jashtë bujqësisë, investime të pa përfillshme për bujqësinë, në veçanti për tokën, ku në mbi 90 % të sipërfaqës së përgjithshme të tokës bujqësore është nga kategoria e V-të deri në kategorinë e X. Prandaj nevoiten investime, veçanerisht në nivelin e ujitjes për ngritjen e kapacitetit prodhues, përmirësime të strukturës së prodhimit bujqësor.

Në Bashkinë Mat, sektori bujqësor është përqëndruar konsiderueshëm rreth bujqësisë familjare, pavarësisht përpjekjeve të qeverisë për ngritjen e kooperativave dhe formave të tjera të bashkëpunimit bujqësor. Në Qarkun e Dibrës, veprojnë rreth 33 mije ferma, madhësia mesatare e fermave familjare rezulton në 1.2 ha dhe e shpërndarë në 4-5 vende. Rreth 40 % e numrit total të fermave bujqësore që gjenden në bashkine e Matit janë më pak nga 1 ha dhe madhësia e parcelave më e vogel se 0.2 ha. Në Bashkinë e Matit

dominojnë fermat familjare dhe shumë pak ferma të specializuara. Fermat familjare janë kontribuesi më i rëndësishëm për sigurinë e ushqimit, duke prodhuar ushqimin për vetë-konsum si dhe pjesërisht për treg. Kontributi i tyre në punësim është i rëndësishëm duke qënë se shumica e fermave individuale shërbejë si burimi kryesor i të ardhurave për të vetë-punësuarit në këtë sektor.

Megjithatë Bashkia e Matit edhe më parë (ish rrethi Matit) renditej rrethi 21-të nga 26 rrethe te vendit në prodhimin e përgjithshëm bujqësor për frymë të popullsisë. Në këtë kuptim nevoitet që bujqësia në Bashkinë e Matit të orientohet në drejtim të zhvillimit të pemtarisë, vreshtarisë, aktiviteteve jashtë bujqesisë, një rajonizim më i mirë i prodhimit bujqësor, zhvillimit të blegtorisë, pasi ngarkesa e blegtorisë për çdo 100 ha mbetet e ulët. Ka sipërfaqe të pa përfillshme me kultivimin në sera rreth 1 ha, nga ku sigurohen produkte që nuk plotësojnë as nevojat e konsumit. Bujqësia, si sektor ekonomik, në kushtet e mungesës të aktiviteteve të tjera dhe të reduktimit të sektorit të industrisë, duhet të marrë një zhvillim të qendrueshëm, prodhimi dhe përpunimi, të lindin eksportet e disa produkteve sidomos blegtorale, turizmi rural, aktivitetet jashtë fermës. Disa njësi si Komsi gjenden në kushte me të përshtatshme klimatike e tokësore, me 13 % të sipërfaqes në fushë dhe 87 % në kodër dhe mal.

Deri në vitin 1990, në Rrethin e Matit (që ka pak ndryshime sepse në përbërjen e bashkisë nuk është përfshirë Klosi), në popullsinë e përgjithshme prej 76 mijë banorë, popullsia në qytet përfshinte 17.7 % dhe në fshat 82.3 %. Deri në 1990, është konsideruar një rreth industrial bujqësor, ku dominonte prodhimi përgjithshëm industrial në raport me prodhimin e përgjithshëm bujqësor.

Në përgjithësi, sektori bujqësor në të gjithë tërritorin shqiptar karakterizohet nga niveli i lartë i fragmentimit. E njëjta dukuri ndodh edhe në Bashkinë e Matit. Ferma bujqesore të vogla, ku dominojnë fermat deri në 1 ha, të coptuara në disa parcela. Për fermat e vogla dhe të fragmentuara, veçanërisht në zonën kodrinore e malore rritet kostoja e prodhimit, karburantit, transportit (në masën 20-40 %); ulet produktiviteti i tokës dhe në shumë raste parcelat braktisen për shkak të largësisë; krijohen vështirësi në lidhje me ujitjen, kullimin, zbatimin e teknologjive bujqësore dhe grumbullimin e prodhimit. Fermat e vogla dalin në treg me sasi të vogla të produkteve bujqësore. Përsa i përket madhësisë së parcelës konsiderohet të jetë e vogël, pasi është e pamundur të organizohet prodhimi pa kosto shtesë. Prandaj futja e tregut të tokës, rritja e madhësisë së fermës konsiderohet si një faktor i rëndësishëm për të përmirësuar peshën ekonomike në sektorin bujqësor. Akoma nuk kanë gjetur zbatim nismat e kooperimit mes fermerëve. Nevojat kryesore për produkte blegtorale dhe bujqësore mbulohen nga burime vendore dhe importi. Ka potenciale tokësore të pa përdorura në masën 20-30 %. Zhvillimi i blegtorisë mbetet mundësi për rritjen e prodhimit bujqësor, të ardhurave dhe produkteve të përpunuara. Po kështu ka rezerva në rritjen e gjedhit për çdo 100 ha tokë, veçanërisht të lopës që bazohet në rritjen e rendimentit dhe prodhimit të foragjereve, por edhe të bagëtive të imta.

**Rajonizimi i kulturave dhe skemat mbështetëse për bujqësinë**

Rajonizimi i prodhimit bujqësor nënkupton vendosjen e kulturave bujqësore, pemtarisë, vreshtarisë në përputhje me relievin, tipet e tokës, kushtet klimatike, praktikat bujqësore, duke siguruar prodhimin më të lartë dhe eficencën ekonomike.. Megjithatë, për të sjellë variacione rajonale në bujqësi, është realizuar rajonizimi i kulturave bujqësore, ku rrethe

të caktuara, në bazë të kushteve specifike, si reliev, klimë e përshtatshme, lloji i tokës, traditë kultivuese, etj, janë specializuar sipas përparësisë drejt disa kulturave të veçanta. Bashkia e Matit nevojitet të bëjë ndryshime strukturore, duke dhënë përparësi zhvillimit të pemtarisë, blegtorisë së imët, vreshtarisë. Ndër prodhimet kryesore të pemtarisë janë molla, dardha, kumbulla, qershia, ftoj, kajsi, shegë, gështenjë etj me një prodhim vjetor prej rreth 2500 ton. Por pemtaria ka tre problem: (i) pemtari e shpërndarë dhe në blloqe, (ii) rendimente të ulta, (iii) sipërfaqe të kufizuara, (iv) nevoja për një rajonizim më të mirë dhe mundësi për rritjen e sipërfaqes dhe rritjes së prodhimit jo më pak se 2 herë nga prodhimi aktual. Kulturat bujqësore më të favorshme për tu kultivuar janë kryesisht arrorët dhe pemët frutore, ndërkohë produktet blegtorale, kryesisht nga bagetitë e imta. Deri në 1990, blegtoria përbënte 55 % të prodhimit bujqësor, që tregon për rezervat e aktuale të metëjshme të rritjes së këtij sektori.

Në kushtet e rendimenteve të ulëta dhe të fragmentimit të lartë të tokës, struktura e kultivimit të kulturave në rrethin e Matit ka pësuar ndryshime si ulja e sipërfaqes së kultivuar me grurë, megjithese mbetet një mundësi në zonën e kodrave të uleta, miseri në pjesën e luginës së Matit. Rritja dhe kultivimi i perimeve konsiderohet të sjellë të ardhura të larta ekonomike, në nivel lokal, por edhe për shtimin e të ardhurave të fermerëve, duke qënë dhe një drejtim prioritar i prodhimit bimor, i shprehur në Strategjinë Ndërsektoriale të Zhvillimit Rural dhe Bujqësisë. Kulturat kryesore që kultivohen në vend janë: domatja, trangulli, bostani, speci, patllixhani, lule lakra, karrota, qepa, hudhra, spinaqi dhe sallata. Rendimentet mesatare në Bashkinë Mat në bujqësi janë të ulëta.

Bashkia e Matit bën pjesë në atë grupim, ku zonat rurale kanë rendimente të ulëta dhe me indeks të ulët hershmërie. Prodhimet bujqësore dhe blektorale në **territorin e Matit**, janë të kufizuara në prodhimtari dhe në llojet e produkteve si drithëra, perime, fasule, foragjere, patate, pemë frutore, prodhime blegtorale (qumësht, mish, vezë, mjaltë).

Megjithëse Bashkia e Matit (për shkak te terrenit kodrinor-malor) ka si përparësi kryesore rajonizmin e pemëve frutore, kumbullës dhe shegës që vazhdojnë të sigurojnë rendiment me të larta prodhimi, molla, vreshti. Kurse, analiza dhe vlerësimi i produktivitetit të vreshtarisë tregon se duke konsideruar përshtatshmërinë e kësaj bime me kushtet klimatike dhe tokësore, rajonizimi i saj duhet të jetë kryesisht në zonën kodrinore të bashkisë. Kushtet e favorshme klimaterike të zonës e bëjnë të mundur shtimin e sipërfaqes së gështenjës të kultivuar në sipërfaqe të gjëra.

Kulturat e mundëshme në bashki, të mundëshme për tu eksportuar janë rrushi tradicional, disa produkte blegtorale. Duke konsideruar kapacitetet për mbarështrimin e gjedhit (lopës), Bashkia e Matit nuk futet në grupin e parë për shkak të terrenit dhe ka kushte për rritjen e numrit të krerëve të bagëtive të imta për çdo 100 ha tokë bujqësore, për rritjen e viçave dhe derrit për mish duhet bërë me prioritet.

**Prodhimet organike**

Me qëllim rritjen e të ardhurave dhe turizmit lokal, kërkesa për produktet bio-organike është e lartë nga turistët ndaj bashkia duhet të fokusohet në zhvillimin e këtij sektori si një avantazh konkurrues si në bujqësi dhe në blegtori. "Prodhime organike" janë të gjitha veprimet e përfshira për prodhimin e produkteve "Bio", në mbështetje të përdorimit harmonik të kushteve të mjedisit dhe të kryera në përputhje me rregullat e përshkruara në ligjin nr.9199, datë 26.2.2004 "**Për prodhimin, përpunimin, certifikimin dhe**

**tregtimin e produkteve bio**". Një nga parimet kryesore për prodhimet organike, ndër shumë specifikave të tjera, lidhet me sasinë totale të plehrave kimikë, e cila nuk mund t'i kalojë 170 kg azot për vit/hektarë të përdorur në një zonë bujqësore. Sipas studimit të ndërmarrë nga Ministria e Bujqësisë **produktet** relativisht më të lehta për t'u prodhuar **bio në zonat veriore** janë: bimët mjekësore; **perime** si qepa, domatja, speci, patllixhani, lakra, lulelakra, sallatrat, brokoli, spinaqi, erëzat e guzhinës, patatja; **nga frutat si** shega, gështenja; si **produkte blegtorale**, mishi i viçit në alpe, mishi qingjave dhe kecave, djathi dhisë dhe mjalti. Mbështetja e prodhimeve organike duhet të orientohet në zonat kodrinore dhe malore ku ndotjet janë më të pakta dhe mjedisi ruhet më mirë. Bashkia e Matit vlerësohet për mundesi për prodhimin e produkteve bio për faktin se synon të zhvilloje turizmin, siguron të ardhura më të larta për njësi të prodhimit, aktivitet që mund të shtrihet kryesisht në pemtari, blegdori dhe perime. Në territorin e bashkisë, lugina e Matit, me lartësi më të ulët nga niveli i detit, lipset të ketë një trajtim të veçantë pasi është me potenciale në kapacitetin prodhues dhe ku mund të punësohen më shumë punëtorë nga qyteti.

**Infrastruktura Bujqësore**

Ka nevojë të ndërtohen disa qendra të grumbullimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore e blegtorale, bimeve medicinale, rritja e sipërfaqeve të serrave diellore , rrugët e brendshme, sistemi i ujitjes që aktualisht është nën 30 % , mirëmbajtja e rezervuarëve, rehabilitimin e digave të rezervuareve, përmirësimi i tokave acide. Fokusi kryesor lokal dhe kombëtar në lidhje me inovacionet në infrastrukturën bujqësore lidhet me ripërtëritjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, si dhe me pastrimin e kanaleve dytësore e tretësore, përmirësimi dhe konsolidimi infrastrukturës bujqësore për shkak të nevojave të menjëhershme në këtë drejtim. Risi të reja në këtë fushë për të ardhmen mund të konsiderohet edhe mbështetja për të filluar aktivitete të reja (start-up) të prodhimeve plotësuese ose alternative bujqësore dhe blegtorale, që nuk janë domosdoshmërisht pjesë e traditave disa vjeçare kultivuese si prsh: prodhimi i bimëve mjeksorë, erëzave, bimëve dekorative, kërpudhave, kërminjëve, prodhimi i produkteve bujqësore specifike për biokarburant, ect, ose aktivitete që nuk lidhen detyrimisht me produktin bujqësor apo blegtoral, por tregtimi i tyre mund të zhvillohet në portën e fermës, agro-turizëm dhe aktivitete shoqëruese (kalërimi, peshkimi, gjuetia).

Risi të reja në këtë fushë për të ardhmen mund të konsiderohet edhe mbështetje për të filluar aktivitete të reja të prodhimeve plotësuese ose alternative të diversifikimit të ekonomisë rurale, që nuk janë domosdoshmërisht pjesë e traditave disa vjeçare kultivuese si prsh: prodhimi i bimëve mjeksorë, erëzave, bimëve dekorative, kërpudhave, kërminjëve, prodhimi i produkteve bujqësore specifike për biokarburant, etj. ose aktivitete që nuk lidhen detyrimisht me produktin bujqësor apo blegtoral, por tregtimi i tyre mund të zhvillohet në portën e fermës, agro-turizëm dhe aktivitete shoqëruese (kalërimi, peshkimi, gjuetia). Fshatrat kodrinore dhe malore të Bashkisë së Matit mbartin potencial të lartë për specializimin e drejtimeve bujqesore në pemëtari, eksporte, turizëm, diversifikimin e ekonomise rural, por kanë nevojë për një zhvillim kompleks për lidhjen e qëndrave të fshatrave të zonës, krijimin e akseve gjenerative dhe korridoreve që nuk dëmtojnë habitatet, rritin efiçencën e burimeve, qendrat e grumbullimit, krijimi i linjave të përpunimit të produkteve dhe përfitimi nga polet ekonomike.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

- Sfidat dhe Konkluzionet

Përshtatja e strukturës së bujqësisë në përputhje me karakteristikat dhe mundesitë e territorit sipas zonave: fushore, kodrinore dhe malore. Zona fushore përshtatet më mirë me zhvillimin e perimeve dhe gjedhit për prodhimin e qumështit, blegtorisë së imët dhe pemtarisë në zonën kodrinore-malore.

Shtimi i aftësise ujitëse që është një faktor kufizues i zhvillimit të bujqësisë, përmirësimi i teknologjisë së ujitjes në formë të ujitjes me pika.

Bujqësia intensive kërkon njohje të thella të teknologjive bujqësore, përmirësimin e tokave acide, mirëmbajtjen e sistemit të kullimit dhe ujitjes, mbrojtjen e tokës, konsolidimi mbi pronësinë. Me qëllim shmangien e degradimit të mëtejshëm të tokës bujqësore dhe jo bujqësore, nevojitet promovimi i zhvillimitrural brenda territorit dhe të garantojë zhvillimin e një bujqësie më të qëndrueshme nëpërmjet praktikave prodhuese të qëndrueshme që respektojnë mjedisin, siç përcaktohet në Politikën e Përbashkët të BE-së për Bujqësinë.

Ruajtja e tokës bujqësore të këtij rajoni është kryefjala e zhvillimit të aktivitetit bujqësor dhe duhet të fuqizohet përmes aplikimit të bujqësisë organike, konsolidimit të produkteve bujqësore (në pamundësi të konsolidimit të fermave), ndërtimit të tregjeve rajonale dhe mbështetjes kombëtare për zhvillimin e bujqësisë dhe produktit vendas si dhe vendosjen e balancave të drejta e të qëndrueshme rurale–urbane.

- Përfundimi i procesit të rregjistrimit të pronësisë
- Ngritja e laboratoreve për zbatimin e teknologjive bujqësore mbi bazën e analizave të tokës dhe përdorimit të kimikateve mbi këto analiza për mbrojtjen e mjedisit.

Sistemi bujqësor të sigurojë ruajtjen maksimale të tokës bujqësore, vendosja e rrjetit të zinxhirit ekonomik bujqësor: prodhim-grumbullim, përpunim-eksport me synim rritjen e vlerës në ekonomi dhe zmadhimin e fermave.

Në bazë të kushteve konkrete, në territorin e bashkisë bëhet efektive zbatimi i sistemeve bujqësore të diferencuara për zonën fushore dhe për zonën kodrinore. Në zonën kodrinore e malore që zë pjesën kryesore të territorit prioritet mbetet zhvillimi i pemëtarise dhe vreshtarisë e blegdorise , kurse në zonën fushore bimët e arave, shtimi i gjedhit në blegtori, serrave të perimeve. Meqenëse kodrat dhe malet zënë rreth 80% të sipërfaqes së tokës bujqësore është shumë e rëndësishme që zhvillimi i bujqësisë të ecë në **dy binarë paralelë: bujqësi shkallë/intensive** dhe **bujqësi familjare**. Kjo e fundit është bujqësia që është praktikuar në vendin tonë për shekuj me radhë dhe që sot është përqendruar kryesisht në zonat malore-kodrinore. Përveç sigurimit të mbijetesës së popullatave të zonave me reliev të thyer, kjo bujqësi ka treguar se është e qëndrueshme ndaj faktorëve klimatikë dhe ekonomikë dhe luan një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e mjedisit (në veçanti të tokave, pyjeve e burimeve ujore) në zonat ku praktikohet.

Masa të tjera mund të jenë edhe mbështetja e drejtpërdrejtë financiare e bujqve dhe fermerëve. Bujqit duhen mbështetur që të kryejnë eksperimentime lidhur me diversifikimin e të mbjellave, futjen e varietete të ndryshme agronomike të qëndrueshme

ndaj ndryshimeve klimatike, ndërtimin e sistemeve të lajmërimit për mbrojtjen nga temperaturat tejet të ulëta (ngricat) dhe të larta (thatësirave), etj.

1.3.3 Ekonomitë urbane dhe agrare

Nga pikëpamja e politikëbërjes, zhvillimi ekonomik mund të përkufizohet si përpjekje të cilat synojnë të përmirësojnë mirëqenien ekonomike dhe cilësinë e jetës për qytetarët duke krijuar dhe/ose mundësuar vende të reja pune dhe rritjen e të ardhurave të përgjithshme.

Me **zhvillim ekonomik rural** do të kuptojmë të gjitha ato njësi territoriale e rajone me përparësi ekonomitë agrare[77] të prodhimit dhe përpunimit, ku me rural kuptohet çdo njësi jo urbane. Ndryshe nga kjo, **ekonomitë urbane** janë ato ekonomi të orientuara kryesisht nga ofrimi i shërbimeve, administratës dhe shërbimeve tregtare.

Analizat e zhvillimit ekonomik dhe rural fokusohen në vlerësimin e karakteristikave të cilat mundësojnë dhe formësojnë ekonomitë aglomeruese dhe efektet përkatëse të tyre në qeverisjen rajonale dhe vendore. Për evidentimin e ekonomive aglomeruese dhe rurale janë përdorur analiza ekonometrike, të cilat i referohen dy treguesve të rëndësishëm: ***densitetit të punësimit***[78] dhe ***produktivitetit***[79].

Duke patur parasysh gjetjet e dy treguesve të mësipërm, konkludojmë se Bashkia e Matit është një bashki e orientuar kryesisht drejt Ekonomive agrare, me përjashtim të qytetit të Burrelit, i cili për nga numri i të punësuarve, arrin vlera më të larta në sektorin e shërbimeve. E klasifikuar si e tillë, Bashkia Mat, krahas zhvillimit të bujqësisë, dhe rritjes së kapacitetit të këtij sektori, duhet të synojë dhe përmirësimin dhe zhvillimin e mëtejshem të sektorit të turizmit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA KOMBËTARE E TERRITORIT TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

Figura 31: Shpërndarja e të punësuarve sipas sektorëve ekonomik dhe zonat e zhvillimit ekonomik




Burimi: Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2017

## 1.4 Situata social-ekonomike

### 1.4.1 Demografia

Ndryshimet politike në Shqipëri në vitet '90, u shoqëruan me një emigrim masiv të popullatës që ishte dhe faktori kryesor në ndryshimin rrënjësor demografik të saj. Popullata shqiptare e pas viteve '90 pësoi një rritje negative (-0.3% në vit) në periudhën 1989-2001, nga një rritje vjetore positive prej 2% në periudhën 1979-1989.

Megjithëse pas census it të vitit 2001, emigrimi pritej të reduktohej në mënyrë të konsiderueshme, censusi i vitit 2011 tregoi se emigrimi vazhdoi në një shkallë masive, duke mbetur sërisht faktori më i rëndësishëm në humbjen neto të popullsisë me rreth 270 mijë persona në periudhën ndërmjet censuseve të viteve 2001-2011.

Tabela 16: Popullsia shqiptare në vite

| Treguesit e popullsisë në vite | 1979 | 1989 | 2001 | 2011 |
|---|---|---|---|---|
| Numri i popullsisë (në mijë) | 2.59 | 3.18 | 3.069 | 2.8 |
| Ndryshimi ndërmjet censusëve (në mijë) | | 590 | -111 | -269 |
| Ndryshimi ndërmjet censusëve (në %) | | 22,8 | -3,5 | -8,8 |
| Ndryshimi vjetor mesatar ndërmjet censusëve (në mijë) | | 58 | -11 | -26 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Ndryshimi vjetor mesatar ndërmjet censusëve (në %) | | 2,0 | -0,3 | -0,9 |

**Burimi:** INSTAT, Census, 2011

Popullsia e Shqipërisë më 1 Janar 2016 arriti në 2,886,026 banorë duke pësuar një rënie prej 0.2% krahasuar me vitin e kaluar, ose rreth (-6%) krahasuar me vitin 2001. Ndryshimet në rënie të popullsisë i "dedikohen" pakësimit të shtesës natyrore vjetore të popullsisë dhe fenomentit të migracionit neto i cili vazhdon të vlerësohet si vlerë negative.

Nga kjo popullsi, 1.46 milion janë meshkuj dhe 1.42 milion janë femra dhe për rrjedhojë koeficienti gjinor është 103 meshkuj për çdo 100 femra. Ky tregues po ti referohemi analizës 15 vjeçare të tij për periudhën 2000-2015, pas vlerës prej 100, për periudhën 2002-2011 (100 meshkuj për cdo 100 femra) në vitin 2012 e në vazhdim, vlerat në rritje të treguesit gjinor, flasin për një dominancë të lehtë të popullsisë së meshkujve ndaj femrave.

Zhvillimet e fundit demografike tregojnë se popullsia e Shqipërisë po zvogëlohet, ndërkohë që struktura e saj tregon se popullsia po shkon drejt plakjes. Kjo si pasojë e rritjes së jetëgjatësisë, dhe nga ana tjetër e lindshmërisë e cila edhe pse po rritet lehtshëm, vazhdon të jetë nën nivelin e zëvendësimit.

- Popullsia dhe treguesit demogafik në Bashkinë Mat

Zbatimi i ligjit 115/2014 për ndarjen e re administrative, sipas të cilit kemi një rikompozim të ri të Bashkive, nuk implikon ndryshime në totalin e popullsisë në nivel qarku, por është shoqëruar me ndryshime drastike të numrit të popullsisë të njësive vendore në nivel Bashkie e Komunash.

Ndërkohë që popullsia në nivel kombëtar dhe rajonal ka pësuar rënie, popullsia në "bashkitë e reja" përgjithësisht është më shumë se dyfishuar për shkak të bashkimit të ish njësive vendore duke sjellë në këtë mënyrë apriori shumfishimin e problematikave që lidhen me mirëmenaxhimin e burimeve natyrore, pasurore dhe njerëzore të këtyre njësive vendore.

Mbështetur në të dhënat e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë të vitit 2011, si dhe në përputhje me ndarjen e re administrative, popullsia e Bashkive ka pësuar ndryshimet në vijim:

Tabela 17: Popullsia sipas ndarjes së re administrative për bashkinë Mat

| Popullsia sipas qarqëve | Viti 2011* | | (01/01/2016) |
|---|---|---|---|
| | Ishte | Bëhet | |
| QARKU DIBER | 137,047 | 144,194 | 134,153 |
| Bashkia Mat | 27,600 | 29,039 | 27,017 |

**Burimi:** Te dhënat për qarqët INSTAT, në nivel bashkie, komunash - llogaritje të autorit

Bashkia Mat, është një nga 4 Bashkitë e qarkut Dibër me një numër të popullsisë rezidente prej 27 mijë, vlerësuar në fillim të vitit 2016. Nga këndvështrimi i shpërndarjes strukturore të popullsisë së qarkut, në Bashkinë Mat, banojnë rreth 20% përqind e popullatës gjithsej të qarkut Diber, ndërkohë që pjesa tjetër e popullatës rreth 80% është e shpërndarë në bashkitë e tjera, Dibër, Bulqizë e Klos respektivisht me rreth, 45%, 23%, dhe 12%.

Popullsia rezidente e bashkisë Mat, si rrjedhojë e ndarjes së re administrative është rritur me rreth 60% duke shënuar një numër popullsie stok në fillim të vitit 2016, në rreth 27mijë banorë* nga 29 mije banorë të regjistruar në vitin 2011. Rreth 39% e popullisë së bashkisë është e vendosur në qytetin e Burrelit dhe klasifikohet si popullsi urbane ndërkohë dhe pjesa tjetër e saj prej 65% klasifikohet si popullsi rurale dhe është e shpërndarë në 7 komunat. Nga këto komuna, 2 prej tyre komunat, Komsi dhe Lis kanë sëbashku rreth 30% të popullsisë rurale, ndërkohë që shpërndarja e popullsisë në pjesën e mbetur të komunave lëviz brenda intervalit (4-9%) të popullatës së Bashkisë.

Tabela 18: Popullsia sipas ndarjes së re administrative, 2011-2016

| Popullsia | 2011 | 2016 |
|---|---|---|
| Bashkia Mat | 29,039 | 27,017 |
| Burrel | 11,428 | 10,633 |
| Baz | 2,344 | 2,181 |
| Derjan | 1,159 | 1,079 |
| Rukaj | 2,638 | 2,454 |
| Macukull | 1,647 | 1,532 |
| Komsi | 4,506 | 4,193 |
| Lis | 4,023 | 3,743 |
| Ulëz | 1,293 | 1,203 |
| Qarku Diber | 144,194 | 134,153 |




**Burimi:** Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, komunash-llogaritje të autorit

**Popullsia e bashkisë Mat, krahasuar me vitin 2011, ka pësuar rënie** me rreth 2000 banorë, ose 7% me pak, rënie e cila si fenomen tashmë është prezent pothuaj në të gjitha njësite vendore të vendit (përjashtuar këtu qarkun Tiranë dhe Durres) pas viteve "90".

Shkaqet e rënies së popullsisë në bashkinë Mat lidhen me faktorët e emigrimit,uljes së ritmeve të shtesës natyrore të popullsisë si dhe ritmeve të larta të migrimit të brendshëm, duke ndjekur të njëjtin model, sikundër në njësite e tjera vendore të vendit.

**Popullsia e bashkisë Mat, nga këndvështrimi i raportit gjinor,** ruan një diferencë të lehtë, krahasuar me nivelin kombëtar, përsa i përket raportit të popullsisë sipas gjinisë në meshkuj e femra.

Tabela 19: Popullsia sipas gjinisë, bashkia Mat për vitet 2011-2016

| Popullsia, qarku, bashkia, komunat | Viti 2011 | | | Viti 2016 | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Gjithsej | Meshkuj | Femra | Gjithsej | Meshkuj | Femra |
| Bashkia Mat | 29,039 | 14,665 | 14,374 | 27,017 | 13,644 | 13,374 |
| Burrel | 11,428 | 5,830 | 5,598 | 10,633 | 5,424 | 5,209 |
| Baz | 2,344 | 1,137 | 1,207 | 2,181 | 1,058 | 1,123 |
| Derjan | 1,159 | 576 | 584 | 1,079 | 535 | 543 |
| Rukaj | 2,638 | 1,323 | 1,315 | 2,454 | 1,230 | 1,224 |
| Macukull | 1,647 | 806 | 841 | 1,532 | 750 | 782 |
| Komsi | 4,506 | 2,305 | 2,201 | 4,193 | 2,145 | 2,048 |
| Lis | 4,023 | 2,050 | 1,974 | 3,743 | 1,907 | 1,836 |
| Ulëz | 1,293 | 639 | 654 | 1,203 | 594 | 609 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Qarku Diber | 144,194 | 73,310 | 70,884 | 134,153 | 69,644 | 64,509 |

**Burimi:** Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, komunash-llogaritje të autorit

Rrjedhimisht, mbështetur në të dhënat e popullsisë për dy vitet 2011-2016, treguesi demografik i koeficientit gjinor (meshkuj /femra*100) për Bashkinë Mat ,tregon se edhe për vitin 2016 ky raport vlerësohet në të njejtin nivel sikundër dhe në vitin 2011 dhe serisht është në favor të popullatës së meshkujve. Ndërkohë që ky koeficient paraqitet më afër vlerave mesatare në nivel kombëtar dhe më i ulët në vlerë se mesatarja e koeficientit gjinor në qarkun Dibër.

Ky tregues merr vlera akoma më të larta nga viti në vit, ndërmjet komunave nëse e analizojmë brënda strukturës administrative te bashkisë se Matit. Në këto vlera të larta veçojme komunat Komsi dhe Lis ku treguesi shënon vlerat 105 dhe 104 meshkuj për çdo 100 femra.

Ndërkohë vlen të shënohet vlerat e ulta të koeficientit gjinor në komunat Baz e Macukull ku treguesi flet për një dominance të lehtë të popullsisë së femrave ndaj meshkujve, respektivisht 94 dhe 95 meshkuj për cdo 100 femra.

Vlerat në rritje të raportit gjinor, veçanërisht në komunat si pjesë përbërëse të bashkisë, mund te spjegohen me rritjen e dominancës së popullsisë rurale ndaj asaj urbane në bashkinë/qarkun e Dibrës. Aktualisht, për vitin 2016, struktura urban/rurale e qarkut bashkisë në raportin 27%:73%, ndërsa në bashkinë Mat ky raport vlerësohet në masën 35%:65%.

Tabela 20: Raporti gjinor për bashkinë Mat, 2011-2016

| Popullsia, qarku, bashkia, komunat | koeficienti gjinor në % | |
|---|---|---|
| | 2011 | 2016 |
| Bashkia Mat | 102 | 102 |
| Burrel | 104 | 104 |
| Baz | 94 | 94 |
| Derjan | 99 | 99 |
| Rukaj | 101 | 101 |
| Macukull | 96 | 96 |
| Komsi | 105 | 105 |
| Lis | 104 | 104 |
| Ulëz | 98 | 98 |
| Qarku Diber | 103 | 108 |

**Burimi:** Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, komunash-llogaritje të autorit

Ndërkohë që vendi që prej vitit 2008 ka një strukturë urban/rurale në favor të zonave urbane dhe për vitin 2016, rreth 58% e popullatës kombëtare klasifikohet si popullate urbane.Një tjetër faktor që ka ndikuar në rritjen e vlerave të raportit gjinor mund të konsiderohet edhe shfaqja e fenomenit të abortit selektiv, duke favorizuar fëmijët meshkuj.

**Një tjetër tregues rëndësishëm demografik është struktura moshore e popullatës.** Analiza e strukturës moshore të popullatës si dhe mosha mesatare e re e saj, tregojnë se

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

aktualisht popullata e bashkisë Mat vazhdon të jetë akoma një popullsi e re sikundër edhe popullata shqiptare në tërësi.

Për vitin 2016 struktura moshore e popullatës së bashkisë Mat, tregon se 66% e saj i takon grupmoshës (15-64) vjeç dhe 23% grupmosha (0-14) vjeç të dhëna këto shumë optimiste dhe që evidentojnë se bashkia/qarku ka një potencial te lartë te popullsisë në moshë punë ekonomikisht aktive, por se sa e angazhuar është ajo realisht në performancën ekonomike të zonës, kjo duhet analizuar sëbashku edhe me te dhënat për punësimin.

Tabela 21: Popullsia rezidente, sipas grup-moshave

| Popullsia, qarku, bashkia, komunat | Viti 2011 | | | | Viti 2016 | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Gjithsej | 0-14 | 15-64 | 65+ | Gjithsej | 0-14 | 15-64 | 65+ |
| Bashkia Mat | 29,039 | 6,629 | 19,285 | 3,126 | 27,017 | 6,167 | 17,942 | 2,908 |
| Burrel | 11,428 | 2,696 | 7,775 | 957 | 10,633 | 2,508 | 7,234 | 891 |
| Baz | 2,344 | 493 | 1,530 | 321 | 2,181 | 459 | 1,423 | 299 |
| Derjan | 1,159 | 246 | 772 | 141 | 1,079 | 229 | 719 | 131 |
| Rukaj | 2,638 | 591 | 1,691 | 356 | 2,454 | 550 | 1,573 | 331 |
| Macukull | 1,647 | 366 | 1,091 | 189 | 1,532 | 341 | 1,015 | 176 |
| Komsi | 4,506 | 1,075 | 2,906 | 525 | 4,193 | 1,000 | 2,704 | 488 |
| Lis | 4,023 | 910 | 2,669 | 444 | 3,743 | 847 | 2,483 | 413 |
| Ulëz | 1,293 | 250 | 850 | 193 | 1,203 | 233 | 791 | 179 |
| Qarku Diber | 144,194 | 36,014 | 95,233 | 12,947 | 134,153 | 33,506 | 88,602 | 12,045 |

**Burimi:** Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, komunash-llogaritje të autorit

Analiza e strukturës moshore të popullatës në nivel komunash që përfshihen brënda bashkisë, tregon së popullata e kësaj grupmoshë është e pranishme me të njëjtat nivele (64-68%) edhe në komunat. Gjithsesi, ndërmjet tyre, konstatojme se komuna Ulëz ka nivelin më të ulët të grupmoshës së re (0-14 vjec) me 19% dhe nivelin më të lartë të grupmoshës së vjetër (+65), me 15%.

Figura 32: Struktura moshore e popullatës, Bashkia Mat




**Burimi:** Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel Bashkie, komunash-llogaritje të autorit



Nëpërmjet të dhënave të ndarjes së popullsisë sipas grupmoshave, mundësohet gjithashtu edhe llogaritja e treguesve te varesisë, tregues këta shumë të rëndësishëm në analizën socio-ekonomike. ***Analiza e këtyre treguesve është e rëndësishme për të vlerësur burimet potenciale njerëzore që mund të përfshihen në tregun e punës dhe rrjedhimisht të ndikojnë në përmirësimin e performancës ekonomike të zonës në studim.***

Sa më e vogël te jetë vlera e ketij treguesi, aq më shumë mund të rritet potencialisht performanca ekonomike, ndërkohë, koeficienti i varësisë së të rinjve dhe i varësisë së të moshuarve, tregojnë repektivisht raportin e popullsisë së grupmoshave 0-14 vjeç dhe 65 vjeç e lart kundrejt popullsisë në moshën 15-64 vjeç. Gjithashtu interpretimi ekonomik i treguesit te varesisë së te rinjve, është i ngjashem me treguesin e varesisë totale, pra një tregues i lartë shpreh optimizëm në drejtim te rritjes së numrit te popullsisë active në një përiudhe te ardhshme, ndërkohë që rritja e tregusit të varësisë së te moshuarve, është "sinjal" për alokim fondesh-investimesh për te lehtësuar e përmiresuar jetësën dhe mireqënien e kësaj kategori të popullsisë.

Konkretisht, për Bashkinë Mat, treguesit e varësisë moshore totale, e varësisë së të rinjve dhe varesisë së te moshuarve paraqiten si në tabelen në vijim (tab.5). Mbështetur në këta tregues konstatojme së treguesi i varesisë totale për Bashkinë e Matit shënon vlerën 51 (pra 51 banorë të moshës joaktive ( 0-14 vjec dhe +65vjec) "përballohen" nga 100 banorë të moshës aktive për punë(15-64 vjec) ,ndërkohë që vlera e ketij treguesi në nivel kombëtar është 47.

Viti 2011 është viti në të cilën ky tregues ka shënuar vleren e tij më të ulët (1979-2011) si në nivel kombëtar ashtu dhe në nivel njësie vendoren, duke treguar në këtë mënyrë së Bashkia ndodhet në të ashtuquajturën episod i "dividendit demografik" dhe kjo si rezultat i një numri të lartë popullsie potencialisht ekonomikisht aktive (15-65) përkundrejt një numri të ulët popullsie të re (0-14) dhe të moshuar (+65).

Tabela 22: Koeficientët e varesisë

| | KOEFICIENTET E VARESISË 2016 | | |
|---|---|---|---|
| Bashkia Mat | Varësia totale | varësia e të rinjve | varësia e të moshuarve |
| Bashkia Mat | 51 | 34 | 16 |
| Burrel | 47 | 35 | 12 |
| Baz | 53 | 32 | 21 |
| Derjan | 50 | 32 | 18 |
| Rukaj | 56 | 35 | 21 |
| Macukull | 51 | 34 | 17 |
| Komsi | 55 | 37 | 18 |
| Lis | 51 | 34 | 17 |
| Ulëz | 52 | 29 | 23 |
| Qarku Diber | 51 | 38 | 14 |

**Burimi:** Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, komunash-llogaritje të autorit

Edhe për vitin 2016, treguesit e varësisë për Bashkinë Mat vazhdojnë të performojnë një nivel relativisht të ulët duke demonstruar në këtë mënyrë akoma vazhdimësinë

fenomenit të “dividentit demografik”. Këto vlera janë të përafërta me vlerat mesatare në nivel qarku, ndërkohë që krahasuar me vlerat mesatare në nivel kombëtar, këta tregues paraqiten më të favorizuar, për shkak të pranisë më të madhe të grup-moshës së re dhe pranisë më të ulët të grupmoshës së të moshuarve.

Nëse Bashkia/qarku do të përfitojë nga ky “dividend demografik” kjo varet nga efektiviteti i politikave social ekonomike te politikbërësit, përfshire ketu në mënyrë te vecante edhe arsimimin dhe kualifikimin e mjaftueshëm të fuqisë puntore për të mundësuar integrimin e saj në punë produktive të cilat me pastaj do të ndikojnë jo vetëm në përmirësimin e përformancës ekonomike por edhe në rritjen e mirëqënies së popullatës.

Ndërkohë që koeficienti varesisë totale, flet për egzistencen e “dividendit demografik”, analiza e treguesve të tjerë të varesisë tregojnë një rritje e konsiderueshme në numrin e përsonave të moshuar 65 vjeç e lart, (nga 9% në 17%) dhe një rënie e grup-moshave te reja, (nga 60% në 35%) duke demonstruar qartazi për shfaqjen e “shenjave” në hyrjen në një faze të re demografike të popullsisë, ate të “plakjes”. Rritja e grupmoshës (+65), shoqërohet dhe me nevojën e rritjes së investimeve për të lehtësuar e përmirësuar aspektin socio-ekonomik te kësaj kategorie të popullsisë.

Prandaj analizat demografike te popullatës janë shumë të nevojshme për te kuptuar në kohë ndryshimet thelbesore në aspektin demografik sepse këto ndryshime shoqërohen me implikime madhore në çështjet e zhvillimit ekonomik, social, urban e mjedisor të vendit në tërësi e rajoneve në veçanti.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm në studimet demografike është edhe përgatitja e projeksioneve të popullsisë, për të paktën 2 dekada. Projeksionet e popullsisë ofrojnë informacion në lidhje me numrin e ardhshëm, strukturën demografike dhe shpërndarjen territoriale të banorëve sipas hipotezave më të mundshme të prirjeve në sjelljen demografike. Ato janë me interes për shoqërinë në përgjithësi dhe shërbejnë si bazë për planifikimin e zhvillimit socio-ekonomik të vendit/zonave, përfshire këtu edhe studimin e tregut.

Tabela 23: Projeksionet e popullsisë, bashkia Mat 2011-2031

| Popullsia, qarku, bashkia, komunat,2011-2031 | 2011 | 2015 | 2016 | 2021 | 2026 | 2031 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Bashkia Mat | 29,039 | 27,478 | 27,017 | 23,525 | 21,295 | 19,269 |
| Burrel | 11,428 | 10,814 | 10,633 | 9,258 | 8,381 | 7,583 |
| Baz | 2,344 | 2,218 | 2,181 | 1,899 | 1,719 | 1,555 |
| Derjan | 1,159 | 1,097 | 1,079 | 939 | 850 | 769 |
| Rukaj | 2,638 | 2,496 | 2,454 | 2,137 | 1,934 | 1,750 |
| Macukull | 1,647 | 1,558 | 1,532 | 1,334 | 1,208 | 1,093 |
| Komsi | 4,506 | 4,264 | 4,193 | 3,651 | 3,305 | 2,990 |
| Lis | 4,023 | 3,807 | 3,743 | 3,259 | 2,950 | 2,670 |
| Ulëz | 1,293 | 1,224 | 1,203 | 1,048 | 948 | 858 |
| Qarku Diber | 144,194 | 136,443 | 134,153 | 116,812 | 105,741 | 95,680 |

**Burimi**: Të dhënat për qarqet INSTAT, në nivel bashkie, komunash-llogaritje të autorit

Sipas këtyre të dhënave vlerësohet se popullsia e Bashkisë Mat , sikundër edhe ajo e qarkut, do të pësojë një rënie të konsiderueshme e cila si mesatare vjetore ( periudha 2015-2031) llogaritet të jetë rreth 2.6%, ndërkohë që rënia e popullsisë e krahasuar me vitin 2015, vlerësohet te jetë akoma me e madhe në rreth 30%. Parashikimi në rënie i numrit të popullsisë rezidente përgjatë përiudhës 2015-2031, është i pranishëm në të gjitha njësitë vendore të qarkut/bashkisë, duke ruajtur të njëjtin ritëm mesatar rënie sikundër edhe Bashkia.

Një nga faktorët që mendohet së do te vazhdojë te ndikojë në përcaktimin e stokut të numrit të popullsisë rezidente edhe në vitet e ardhshme, është faktori migrim, vazhdueshmëria, e të cilit për periudhën 2011-2031, argumentohet me perspektivën e një largimi të vazhdueshëm të të rinjve nga sektori bujqësor, në migrimet e studentëve që transformohen në një qëndrim afatgjatë përtej studimeve, si dhe në rëndësinë e normave patriarkale në krijimin e familjeve, që do të ruajë një migrim të lartë të femrave në moshë të re.

Konkluzione të analizës demografike të popullsisë, Bashkia Mat

- Popullsia e Bashkisë së Matit, në 1 janar 2016 regjistroi një popullsi rezidente prej 27 mijë banorë, nga të cilët 13.6 mijë meshkuj dhe 13.4 mijë femra, ose me një koeficient të raportit gjinor prej (102). Rreth 39% e popullsisë së bashkisë, klasifikohet si popullsi urbane dhe diferenca prej 61% si popullsi rurale. Sipas strukturës moshore rreth 66% e kësaj popullate i përket grupmoshës (15-64) vjeç dhe 23% e saj grupmoshës (0-14) vjeç, tregues këto shumë optimiste lidhur me potencialin e lartë të popullsisë ekonomikisht aktive, përfshirja e të cilëve në tregun e punës do të ndikojë në rritjen dhe përmiresimin e performancës ekonomike të zonës dhe mirëqënien e popullatës. Struktura aktuale demografike e popullsisë rezidente si dhe mosha e saj mesatare, tregojne se popullsia e Bashkisë është akoma një popullsi e re.
- Gjithsesi procesi i vazhdueshëm i emigrimit, ritmet e larta të migrimit të brëndshëm si dhe rënia e lindshmërisë e vdekshmërisë, kanë ndikuar jo vetëm në rënien e numrit të popullsisë por edhe në ndyshimin drastik të strukturës së saj demografike.
- Sipas projeksioneve të popullsisë-skenari i rritjes së mesme- popullsia e qarkut/Bashkisë do të pësojë rënie, me një ritem mesatar vjetor, rreth 2.6% dhe si faktor kryesor mendohet të jetë migracioni i brendshëm.
- Popullsia rezidente e bashkisë Mat deri në vitin 2021, do të performojë një tregues të ulët të varësisë totale duke ruajtur të ashtuquajturin fenomenin e "dividentit demografik".

1.4.2 Mirëqenia social-ekonomike

- Arsimi

Në Bashkinë Mat 55.2% e popullsisë ka përfunduar arsimin bazik (fillor dhe 8 ose 9-vjeçar), vlerë kjo pak më e lartë krahasuar me mesataren kombëtare prej 52.1% por më e ulët krahasuar me vlerën 65.8% të shënuar në nivel Qarku. Megjithatë sa i përket arsimit

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

të mesëm dhe atij universitar e pasuniversitar, Bashkia Mat paraqet vlera thuajse të njëjta me mesataren në rang kombëtar, dhe vlera më positive krahasuar me Qarkun e Dibrës.

Vlerën më të lartë të arsimit të përfunduar fillor e paraqet Njësia Administrative Macukull, e ndjekur nga NjA Baz, dhe me vlerën më të ulët në qytetin e Burrelit. Sa i përket arsimit të mesëm dhe atij universitar, qyteti i Burrelit shënon vlerat 41.42% dhe 13.46% përkatësisht, vlera këto edhe më të larta se mesatarja në nivel kombëtar dhe ajo në rang qarku. Qartësisht mund të kuptohet një lloj disbalance mes ofrimit të mundësive për shkollim në qytetin e burrelit dhe njësive të tjera administrative, në të cilat pjesa më e madhe e popullsisë ka arritur të përfundoje vetëm arsimin fillor, dukuru e cila karakterizohet në njësitë administrative me karakter rural (rreth 60-70%)

Tabela 24: Niveli arsimor i përfunduar, Bashkia Mat

| | Niveli arsimor i përfunduar: | | |
|---|---|---|---|
| | fillor dhe 8 ose 9-vjeçar (%) | i mesëm (%) | universitar dhe pasuniversitar (%) |
| Shqipëria | 52.1 | 31.4 | 11.8 |
| Qarku Dibër | 65.8 | 24.26 | 5.2 |
| Bashkia Mat | 55.2 | 31.4 | 7.6 |
| Burrel | 39.00 | 41.42 | 13.46 |
| Baz | 67.82 | 23.08 | 3.64 |
| Derjan | 62.33 | 28.92 | 4.84 |
| Rukaj | 62.98 | 26.84 | 5.04 |
| Macukull | 72.14 | 17.34 | 2.47 |
| Komsi | 63.23 | 27.63 | 4.29 |
| Lis | 69.72 | 22.07 | 3.04 |
| Ulëz | 57.11 | 31.79 | 3.33 |

**Burimi:** INSTAT, 2015

Shkalla e analfabetizmit në qark (3.22 %) dhe veçanërisht në bashkinë Mat (3.6%), edhe pse krahasueshmërisht e ngjashme me bashkitë e tjera si Elbasani, Lezha, Kruja, është relativisht më e lartë se mesatarja në rang vendi (2.8%).

Tabela 25: Shkalla e analfabetizmit dhe vitet mesatare të shkollimit

| | Shkalla e analfabetizmit (%) | Vitet mesatare të shkollimit (vite) |
|---|---|---|
| Shqipëria | 2.8 | 10.2 |
| Qarku Dibër | 3.22 | 9.50 |
| Bashkia Mat | 3.6 | 9.9 |
| Burrel | 2.7 | 10.93 |
| Baz | 4.6 | 9.03 |
| Derjan | 2.8 | 9.55 |
| Rukaj | 4.9 | 9.28 |
| Macukull | 5.1 | 8.70 |
| Komsi | 3.2 | 9.33 |
| Lis | 4.1 | 9.11 |
| Ulëz | 6.0 | 9.25 |

**Burimi:** INSTAT, 2015

Figura 33: Shkalla e analfabetizmit, sipas njësive administrative, Bashkia Mat




**Burimi:** INSTAT, 2015; **Përgatiti:** Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2016

**Njësia Administrative Burrel** shënon shifrën më të ulët të shkallës së analfabetizmit 2.7% (krahasuar me nivelin kombëtar, qarkun, bashkinë dhe njësitë administrative) dhe shifrën më të lartë të raportit të numrit të viteve të shkollës (të kryera me sukses prej personave të moshës 15 vjeç e lart, ndaj numrit gjithsej të personave 15 vjeç e lart) 10.93 vite. Shifrën më të lartë të shkallës së analfabetizmit e shënon **Njësia Administrative Ulëz**, 6.0 %. **Njësia Administrative Macukull** shënon shifrën më të ulët të të raportit të numrit të viteve mesatare të shkollimit 8.70 vite, krahasuar me nivelin kombëtar, qarkun, bashkinë dhe njësitë administrative.

Bashkia Mat është një nga bashkitë me normën më të madhe të emigrimit dhe migrimit të brendshëm. Të dhënat në tabelat e mësipërme dëshmojnë për një forcë puntore, kryesisht banuese në njësitë me karakter rural brenda bashkisë, e cila nuk ka kualifike të mjatueshme për të konkurruar në tregun e punës. Për më tepër kjo dukuri e oriention forcën punëtore kryesisht drejt sektorit ekonomik bujqësor, ku kualifikimet e kërkuara janë më të vogla.

- Shpërndarja e institucioneve arsimore në territorin e Bashkisë Mat

Për të kuptuar më shumë mbi situatën në sektorin e arsimit në bashkinë Elbasan, është analizuar edhe cilësia e këtij shërbimi të ofruar duke marrë parasysh dy indikatorë: rrezen e shërbimit[80] dhe raportin mësues/nxënës.

Shkollat 9-vjeçare

Sipas standarteve të planifikimit, rrezja e shërbimit për shkollat 9-vjeçare duhet të jetë 500-600m në zonat urbane dhe 1,000-1,500m në zonat rurale[81]. Në bashkinë Mat ofrojnë shërbmin 37 shkolla fillore, nga të cilat dy janë të vendosura në qytetin e Burrelit. Sic mund te lexohet dhe nga harta mëposhtë, Fshatrat Dej-Macukull (Macukull), Kodër-Qerre (Burrel) dhe Madhesh (Ulëz) nuk mbulohen nga ky shërbim.

Figura 34: Rrezja e shërbimit për kopshtet, Bashkia Mat




**Burimi:** Ministria e Arsimit, 2015, **Përgatiti:** Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2016

Figura 35: Rrezja e shërbimit për shkollat fillore dhe 9-Vjeçare, Bashkia Mat




**Burimi:** Ministria e Arsimit, 2015, **Përgatiti:** Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2016

Shkollat e mesme

Sipas standarteve të planifikimit, rrezja e shërbimit për shkollat e mesme duhet të jetë 1,000-1,500m në zonat urbane dhe 2,000-4,500m në zonat rurale[82]. Në Bashkinë Mat ofrojnë shërbimin 8 shkolla të mesme, 2 prej të cilave janë të vendosura në qytetin e Burrelit. Megjithëse rrezja e shërbimit duket se mbulon mirë pjesën më të madhe të

territorit, Njësitë administrative Komsi dhe Macukull nuk mbulohen nga shërbimi i arsimit të mesëm.

Figura 36: Rrezja e shërbimit për shkollat e Mesme, Bashkia Mat




**Burimi**: Ministria e Arsimit, 2015, **Përgatiti**: Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2016

Raporti nxënës mësues

Kopshte

Raporti fëmijë/edukatorë në nivel kombëtar është 18.25 sipas strategjisë kombëtare të zhvillimit të arsimit parauniversitar në Shqipëri dhe synimi është të ulet ky raport në 18 për vitin 2017 dhe 2020[83]. Nga kjo pikëpamje, Bashkia Mat shfaqet e avantazhuar, krahasimisht me bashkitë e tjera fqinje, duke përmbushur kështu nivelin kombëtar.

Tabela 26: Shpërndarja e kopshteve sipas NjA-ve, numri të fëmijëve, edukatoreve dhe raporti fëmijë/edukatorë

| | Nja. Administrative | Nr. Kopshte | Nr fëmijesh | Nr. edukatoresh | Raporti femijë/edukatorë |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Burrel | 4 | 447 | 31 | 14 |
| 2 | Baz | 4 | 66 | 4 | 17 |
| 3 | Derjan | 1 | 12 | 1 | 12 |
| 4 | Lis | 6 | 103 | 6 | 17 |
| 5 | Komsi | 4 | 76 | 4 | 19 |
| 6 | Rukaj | 5 | 67 | 5 | 13 |
| 7 | Macukull | 2 | 35 | 2 | 18 |
| 8 | Ulëz | 2 | 24 | 2 | 12 |

**Burimi**: Bashkia Mat, 2016

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

Sipas të dhënave të Bankës Botërore 2013, mestarja e Bashkimit Europian (BE) e raportit nxënës/mësues për shkollat fillore është afërsisht 13.4, kurse e Shqipërisë në rang kombëtar është afërsisht 19[84].

Tabela 27: Shpërndarja e shkollave 9-vjeçare sipas NjA-ve, numri të nxënësve, mësuesve dhe raporti nxënës/mësues

| | Nja. Administrative | Nr. Shkolla | Nr. nxënësish | Nr. mësuesish | Raporti nxënes/mësues | Nr. i klasave |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Burrel | 3 | 1638 | 109 | 15 | 66 |
| 2 | Baz | 3 | 215 | 30 | 7 | 16 |
| 3 | Derjan | 3 | 90 | 12 | 8 | 9 |
| 4 | Lis | 6 | 316 | 35 | 9 | 25 |
| 5 | Komsi | 6 | 333 | 37 | 9 | 25 |
| 6 | Rukaj | 6 | 268 | 33 | 8 | 21 |
| 7 | Macukull | 4 | 135 | 19 | 7 | 12 |
| 8 | Ulëz | 3 | 72 | 16 | 5 | 8 |

**Burimi**: Bashkia Mat, 2016

Shkollat e mesme

Për edukimin e mesëm Shqipëria në rang kombëtar ka një raport mësues/nxënës 14, kurse niveli mesatar në Bashkimin Europian është 11.8[85]. Edhe në rastin e sherbimit në shkollat e mesme, vec qytetit të Burrelit ku raporti është pak mbi mesataren, në të gjithë njësitë administrative jo vetëm përmbushet niveli kombëtar për raportin nxënës mësues, por përmbushet dhe niveli mesatar në Bashkimin Europian.

Tabela 28: Shpërndarja e shkollave të mesme sipas NjA-ve, numri te nxënësve, mësuesve dhe raporti nxënës/mësues

| | Nja. Administrative | Nr. Shkolla | Nr. nxënësish | Nr. mësuesish | Raporti nxënes/mësues | Nr. i klasave |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Burrel | 2 | 902 | 57 | 16 | 30 |
| 2 | Baz | 1 | 89 | 8 | 11 | 4 |
| 3 | Derjan | 1 | 60 | 8 | 8 | 3 |
| 4 | Lis | 1 | 84 | 10 | 8 | 4 |
| 5 | Komsi | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 6 | Rukaj | 1 | 106 | 9 | 12 | 5 |
| 7 | Macukull | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 8 | Ulëz | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

**Burimi**: Bashkia Mat, 2016

Gjendja e infrastrukturës së institucioneve arsimore

Nga vlerësimi i gjendjes infrastrukturore të të gjitha institucioneve arsimore (kopshte, shkolla 9-vjeçare dhe të mesme) rezulton se ato kanë nevoja të mëdha për investime, që shkon nga rikonstruksion i plotë deri te nevojat prioritare për mirëmbajtje. Përveç institucioneve arsimore në qytetin e Burrelit, kopshtet dhe shkollat në njësitë e tjera administrative shfaqin të paktën një kusht në rrezik. Duke marrë parasysh dhe faktorët e

tjerë të sipërpërmëndur, propozohet ndërmarrja e investimeve të menjëhershme për përmisimin e kushteve të institucioneve arsimore.

Figura 37: Shkolla Pjetër Budi, Burrel.



**Burimi**: Ëikimapia, 2016

Në Bashkinë Mat, evidentohen 15 raste, ku shërbimi arsimor ofrohet në të njëjtat ambiente si për shkollat fillore dhe 9-vjeçare ashtu edhe për kopshtin. Ky gërshetim, përkthehet në sipërfaqe më të vogla për hapësira të gjelbërta të nevojshme për kopshtet, mungesë e hapësirës së nevojshme për laboratore, palestra etj.

- Punësimi

Punësimi në sektorin shtetëror, në nivel kombëtar, i matur sipas burimeve administrative, nga viti 2010 në vitin 2014 ka rënë me 1 %. E kundërta vihet re për punësimin në sektorin privat jo-bujqësor, ku tendenca përgjatë viteve 2010-2014 është në rritje. (Vjetari Statistikor Rajonal 2015)

- Paga mesatare mujore
- Punësimi sipas degëve të ekonomisë

**Bashkia Mat**, sektorin kryesor të ekonomisë ka shërbimet 54.5 % duke u pasuar nga bujqësia dhe industria. **Njësia Administrative Derjan** shënon numrin më të lartë të punësuarëve në sektorin e shërbimeve krahasuar me nivelin kombëtar, qarkun, bashkinë dhe njësitë administrative. **Njësia Administrative Komsi** shënon numrin më të lartë të të punësuarëve në bujqësi.

Tabela 29: Punësimi sipas degëve të ekonomisë, Bashkia Mat

| | Punësimi sipas degëve të ekonomisë | | |
|---|---|---|---|
| | industri (%) | shërbime (%) | bujqësi (%) |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

| | | | |
|---|---|---|---|
| Shqipëria | 20.4 | 53.5 | 26.1 |
| Qarku Dibër | 14.0 | 39.1 | 46.9 |
| Bashkia Mat | 15.1 | 54.5 | 30.4 |
| Burrel | 15.4 | 77.3 | 7.3 |
| Baz | 9.8 | 25.5 | 64.7 |
| Derjan | 15.8 | 82.9 | 1.3 |
| Rukaj | 10.8 | 45.1 | 44.1 |
| Macukull | 6.1 | 30.0 | 63.8 |
| Komsi | 10.3 | 22.4 | 67.3 |
| Lis | 22.2 | 62.2 | 15.6 |
| Ulëz | 56.4 | 36.7 | 6.9 |

**Burimi:** INSTAT, 2015; **Përgatiti:** Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2016

Tabela 30: Punësimi sipas nivelit arsimor, Bashkia Mat

| | Punësimi sipas nivelit arsimor | | |
|---|---|---|---|
| | fillor dhe 8/9-vjeçar (%) | i mesëm dhe profesional (%) | universitar dhe pasuniversitar (%) |
| Shqipëria | 38.1 | 31.4 | 11.8 |
| Qarku Dibër | 53.2 | 32.6 | 13.3 |
| Bashkia Mat | 34.3 | 43.3 | 22.1 |
| Burrel | 14.72 | 51.26 | 33.8 |
| Baz | 54.90 | 33.33 | 11.1 |
| Derjan | 11.84 | 57.89 | 30.3 |
| Rukaj | 30.32 | 56.91 | 12.2 |
| Macukull | 58.69 | 32.86 | 7.0 |
| Komsi | 62.77 | 30.59 | 6.2 |
| Lis | 37.78 | 43.11 | 18.7 |
| Ulëz | 30.32 | 56.91 | 12.2 |

**Burimi:** INSTAT, 2015; **Përgatiti:** Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2016

Figura 38: Punësimi sipas nivelit arsimor fillor, të mesëm dhe universitar, Bashkia Mat



**Burimi:** INSTAT, 2015; **Përgatiti:** Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2016

Në **Bashkinë Mat** punësimi sipas nivelit arsimor të mesëm dhe profesional është më i lartë 43.3 %, krahasuar me punësimin sipas nivelit arsimor fillor dhe universitar.

**Njësia Administrative Derjan** shënon numrin më të ulët të të punësuarëve me arsim fillor/ 8 ose 9-vjeçar 11.84 %, dhe numrin më të lartë të të punësuarëve me arsim të

mesëm dhe profesional 57.89 %, krahasuar me nivelin kombëtar, Qarkun Dibër, Bashkinë Mat dhe Njësitë Administrative të bashkisë. Shifrën më të lartë të të punësuarëve me arsim universitar dhe pasuniversitar, (krahasuar me nivelin kombëtar, Qarkun Dibër, Bashkinë Mat dhe Njësitë Administrative të bashkisë), e shënon **Njësia Administartive Burrel** 33.8 %.

**Njësia Administrative Komsi** shënon shifrën më të lartë të punësuarëve me arsim fillor/ 8 ose 9-vjeçar 62.77 %, dhe shifrën më të ulët të punësuarëve me arsim të mesëm/profesional dhe universitar/pasuniversitar, përkatësisht 30.59 % dhe 6.2 % (krahasuar me nivelin kombëtar, Qarkun Dibër, Bashkinë Mat dhe Njësitë Administrative të bashkisë).

- Shkalla e papunësisë

Nga viti 2010 në vitin 2014 numri i punëkërkuesve të papunë të regjistruar në zyrat e punësimit ka rënë me 1,3 %. Në përgjithësi, për të gjitha qarqet, përqindja që zënë femrat në numrin gjithsej të punëkërkuesve të papunë të regjistruar është 51 %. Të rinjtë e moshës 15-24 vjeç, për periudhën 2012-2014 përbëjnë 16 % të punëkërkuesve të papunë të regjistruar gjithsej.

Tabela 31: Shkalla e papunësisë, Niveli Kombëtar, Qarku Dibër, Bashkia Mat dhe sipas secilës NjA

| | Shkalla e papunësisë % | Shkalla e papunësisë te të rinjtë % | Shkalla e papunësisë: femra % | Shkalla e papunësisë: meshkuj % |
|---|---|---|---|---|
| Shqipëria | 29.3 | 52.9 | 31.4 | 27.9 |
| Qarku Dibër | 34.4 | 60.6 | 34.9 | 34.2 |
| Bashkia Mat | 45.0 | 75.5 | 44.1 | 45.6 |
| Burrel | 45.7 | 85.0 | 48.7 | 43.3 |
| Baz | 39.3 | 58.9 | 28.6 | 48.0 |
| Derjan | 55.6 | 81.4 | 36.6 | 61.5 |
| Rukaj | 45.0 | 66.2 | 35.9 | 49.2 |
| Macukull | 31.9 | 78.3 | 36.1 | 30.1 |
| Komsi | 27.8 | 52.9 | 25.0 | 30.0 |
| Lis | 75.5 | 94.2 | 78.1 | 74.4 |
| Ulëz | 50.9 | 81.4 | 47.7 | 52.5 |

**Burimi:** INSTAT, 2015

Shifrat më të lartë të papunësisë, papunësinë tek të rinjtë, papunësisë tek femrat dhe meshkujt e shënon **Njësia Administrative Lis**, krahasuar me nivelin kombëtar, Qarkun Dibër, Bashkinë Mat dhe njësitë administrative të bashkisë. **Njësia Administrative Komsi** shënon shifrën më të ulët të papunësisë, papunësisë tek të rinjtë dhe papunësinë tek meshkujt dhe femrat, të dhëna të krahasuara në nivel kombëtar, qark, bashki dhe njësitë administrative të Bashkisë Mat.

- **Shëndetësia**

Shpërndarja e shërbimit shëndetësor

Sektori i shërbimit shëndetësore në Bashkinë Mat përbëhet nga 1 spital, 8 qendra shëndetësore dhe 39 ambulanca. Shqipëria është një nga vëndet e Ballkanit me numrin më të vogël të stafit mjekësor, me 1.14 mjekë për 1000 banorë (ËHO, 2014) ose 1 mjek për 887 banorë[86]. Kurse, mesatarja në BE është 3.4 mjekë për 1000 banorë ose 1 mjek për 295 banorë[87]. Ndërkohë në Bashkinë Mat ky raport është afërsisht 2 herë më i lartë pasi 1 mjek i shërben statistikisht 1501 banorëve.

Tabela 32: Treguesit e shërbimit shëndetësor në Bashkinë Mat

| Njësia | Nr. banorësh | Qendra shëndetësore | Ambulanca | Raporti b./ambulanca | Nr. Mjekësh | Raport b./mjekë |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Burrel | 10,633 | 1 | 3 | 2658 | 8 | 1329 |
| Macukull | 1,532 | 1 | 5 | 255 | 1 | 1532 |
| Komsi | 4,193 | 1 | 10 | 381 | 3 | 1398 |
| Rukaj | 2,454 | 1 | 7 | 307 | 1 | 2454 |
| Derjan | 1,079 | 1 | 6 | 154 | 1 | 1079 |
| Ulëz | 1,203 | 1 | 3 | 301 | 1 | 1203 |
| Baz | 2,181 | 1 | | 2181 | 1 | 2181 |
| Lis | 3,743 | 1 | 5 | 624 | 2 | 1872 |
| Total | 27,018 | 8 | 39 | 575 | 18 | 1501 |

**Burimi:** Bashkia Mat, 2016

- Personat me aftësi të kufizuar

Personat me aftësi të kufizuar në Bashkinë Mat janë pothuajse njësojë me nivelin kombëtar. 6.2% e popullisisë deklarojnë se kanë të paktën një aftësi të kufizuar, e përkthyer kjo në 1675 banorë. Numri më i madh është i personave që kanë aftësi të kufizuar në lëvizje me 3.8 % në nivel Bashkie.

Tabela 33: Personat me aftësi të kufizuar

| Personat me aftësi të kufizuara: | Bashkia Mat | Shqipëria |
|---|---|---|
| Në shikim | 2.2 % | 2.3 % |
| Në dëgjim | 1.8 % | 1.7 % |
| Në kujtesë | 2.0 % | 1.8 % |
| Në kujdesin e përditshëm | 2.1 % | 1.8 % |
| Në komunikim | 1.7 % | 1.5 % |
| Në lëvizje | 3.8 % | 3.7 % |
| Personat me të paktën një aftësi të kufizuar | 6.3 % | 6.2 % |




**Burimi:** INSTAT 2012

- Përfundime

Shërbimi shëndetësor në Bashkinë Mat ofrohet nga 1 spital, nga 8 qendra shëndetësore dhe 39 ambulanca. Shpërndarja e këtyre institucioneve është relativisht e mirë dhe mbulon pjesën më të madhe të territorit, mungesa e stafit të nevojshëm mjekësor dhe shpërndarja jouniformë e tyre është një dukuri e theksuar pothuajse në të gjithë territorin e bashkisë Mat. Rreth 6.3 % e popullsisë banuese në territorin e Bashkisë Mat ose rreth 1,675 persona kanë deklaruar se kanë të paktën një aftësi të kufizuar.

- Mirëqënia ekonomike

Ndërsa madhësia mesatare e Njësisë Ekonomike Familjare në rang vendi është 3.9 persona, Qarku i Dibrës paraqet një vlerë prej 4.63 persona, e përkthyer kjo në Bashkinë Mat me një madhësi mesatare prej 4.2 persona. Njësia Administrative Macukull shënon shifrën më të lartë të personave për NJEF 4.88 persona, krahasuar me treguesit për Shqipëri, Qarkun e Dibrës, Bashkinë e Matit dhe Njësitë Administrative të Bashkisë.

Tabela 34: Madhësia mesatare e Njësisë Ekonomike Familjare

| Madhësia mesatare e Njësisë Ekonomike Familjare (persona) | |
|---|---|
| Shqipëria | 3.9 |
| Qarku Dibër | 4.63 |
| Bashkia Mat | 4.2 |
| Burrel | 3.77 |
| Baz | 4.57 |
| Derjan | 4.61 |
| Rukaj | 4.61 |
| Macukull | 4.88 |
| Komsi | 4.34 |
| Lis | 4.39 |
| Ulëz | 3.98 |

**Burimi**: INSTAT, 2015

Bazuar në të dhënat e INSTAT për vitin 2015, për Bashkinë Mat, Njësitë Ekonomike Familjare (NJEF) të cilat burimin kryesor të të ardhurave e sigurojnë prej punës së paguar ose vetëpunësimit janë 36.2 % (Shqipëria 56.4 %). 63.3 % e NJEF-ve të Bashkisë Mat, burimin kryesor të të ardhurave e sigurojnë prej ndihmës sociale dhe të gjitha llojeve të pensioneve.

Shifrën më të lartë të NJEF-ve (krahasuar në nivel kombëtar, qarku, bashki dhe njësitë admninistartive) të cilat të ardhurat kryesore i sigurojnë prej ndihmës sociale, e shënon **NJA Macukull** 51.71 % (Shqipëria 11.7 %). **Qarku Dibër** (krahasuar në nivel qarku, bashki dhe njësitë admninistartive) shënon vlerën më të lartë të NJEF-ve të cilat të ardhurat kryesore i gjenerojnë prej remitancave 7.97 % (Shqipëria 8.6 %). **Njësia Administrative Baz** shënon shifrën më të lartë të NJEF-ve (krahasuar në nivel kombëtar, qarku, bashki dhe njësitë admninistartive) të cilat të ardhurat kryesore i sigurojnë prej të gjitha llojeve të pensioneve 48.36 % (Shqipëria 31.84 %). Gjithashtu shënon shifrën më të ulet të NJEF-ve (krahasuar në nivel kombëtar, qarku, bashki dhe njësitë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT SEKRETARIA TIRANE

admninistartive) të cilat të ardhurat kryesore i sigurojnë prej punës së paguar ose vetëpunësimit 15.95 % (Shqipëria 56.4 %).

Këto të dhëna tregojnë se afërsisht gjysma e popullsisë siguron të ardhurat jo nga puna e paguar ose vetëpunësimi, por nga shteti në formën e ndihmave sociale dhe pensioneve dhe nga para të dërguara nga jashtë shtetit.

Tabela 35: Burimi i të ardhurave për NjEF, sipas klasifikimit dhe për çdo njësi administrative, Bashkia Mat

| | Ndihmë sociale dhe përfitime (%) | Para të dërguara nga jashtë shtetit (%) | Të gjitha llojet e pensioneve (%) | Puna e paguar ose vetpunësimi (%) |
|---|---|---|---|---|
| Shqipëria | 11.7 | 8.6 | 31.84 | 56.4 |
| Qarku Dibër | 35.20 | 7.97 | 32.0 | 44.0 |
| Bashkia Mat | 29.4 | 5.3 | 33.9 | 36.2 |
| Burrel | 23.78 | 5.2 | 27.95 | 49.43 |
| Baz | 35.66 | 4.71 | 48.36 | 15.95 |
| Derjan | 46.86 | 1.26 | 41.84 | 17.57 |
| Rukaj | 43.38 | 5.88 | 40.81 | 20.40 |
| Macukull | 51.71 | 2.18 | 32.71 | 20.56 |
| Komsi | 23.30 | 6.48 | 38.10 | 42.45 |
| Lis | 32.45 | 6.65 | 31.19 | 18.00 |
| Ulëz | 21.36 | 3.88 | 43.37 | 36.65 |

**Burimi:** INSTAT, 2015

- Varfëria

Për matjen e nivelit të varfërisë mund të përdoren tre tregues: përqindja e varfërisë, hendeku dhe ashpërsia. Në rastin e qarkut të Fierit, ku bën pjesë rrethi i Lushnjës, përqindja e varfërisë në vitin 2012 është 17,1%. Hendeku i varfërisë, i cili tregon diferencën nga linja e varfërisë, në vitin 2012 ishte 3.4%, çka dëshmon se në mënyrë që të varfërit të arrijnë linjën e varfërisë, do duhej të shumëfishonin të ardhurat me 3,4 herë më shumë. Së fundmi, ashpërsia, e cila tregon nivelin e pabarazisë mes të varfërve dhe popullsisë mbi nivelin e varfërisë, në qarkun e Fierit është 1%.

Tabela 36: Treguesit e varfërisë, Qarku Dibër

| | Treguesit e varfërisë | | |
|---|---|---|---|
| Qarku | Përqindja | Hendeku | Ashpërsia |
| Dibër | 12.7 | 2.3 | 0.7 |
| Gjithsej | 14.3 | 3.0 | 1.0 |

**Burimi:** Vjetari statistikor, INSTAT, 2015

## 1.5 Përdorimi i tokës dhe infrastrukturat

### 1.5.1 Përdorimi i tokës

Figura 39: Harta e përdorimit te tokës sipas kategorive bazë të përdorimit




**Burimi:** Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2016

Analiza e përdorimit të tokës është bërë duke zonuar sipas 14 kategorive bazë, me nënkategoritë dhe funksionet përkatëse. Gjetjet kryesore në lidhje me përhapjen e tyre sipas ndarjeve sipas Njësive Administrative janë si mëposhtme:

**NJA Derjan** ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 43 km$^2$, me kategori bazë dominuese natyrore të ndërthurur me bujqësoren. Sistemi natyror i përfaqësuar nga pyjet,(e dendura dhe të rralla) ku dominojnë pyjet e rralla, mbulon pjesën veri-lindore dhe jug-lindore të territorit të Bashkisë. Funksioni ekzistues i pjesës më të madhe të territorit është pylli i përzjerë.

Ndërkaq tokat bujqësore janë të pozicionuara kryesisht pranë fshatrave; Derjan, Urxallë, Dukagjin, Gjocaj dhe Lami i Madh.

Për sa i përket zonave të banuara Njësia ka 7 fshatra; Derjan, Urxallë, Barbullej, Dukagjin, Gjoçaj, Lam i Madh, Zhall-Gjoçaj. Kryesisht janë të pozicionuara pranë nënkategorisë shkurre e rrallë. Pjesa më e madhe e tyre ndodhet në pjesën lindore të bashkisë aty ku dhe relievi është më i favorshëm.

**NJA Macukull** ka një sipërfaqe prej 85 km$^2$ me pozicion në Lindje të Bashkisë.Kategoritë bazë të përdorimit të tokës janë natyrore dhe bujqësore. Kategoria Natyrore zë pjesën më të madhe të territorit si kategori bazë. Nënkategoria më dominuese

është pyje të rralla lidhur kjo me terrenin malor që zë një pjesë të kosiderueshme të Njësisë.

Njësia ka 5 fshatra; Macukull, Dej Macukull, Shëlli, Vig, Shqefën. Fshatrat janë të shpërhapura dhe ndodhen kryesisht pranë nënkategorisë natyrore shkurre të rralla.

Tokat bujqësore ndodhet pranë zonave të banuara që shtrihen më së shumti në Veri-Perëndim dhe Perëndim-Jug. Nënkategoria kryesore e tyre është bujqësore e kultivuar me funksion ekzistues ara dhe arrore.

**NJA Lis** ka një sipërfaqe prej 68 km$^2$ dhe ndodhet në Jug të Bashkisë.

Njësia ka si kategori bazë Natyroren të ndërthurur me Bujqësoren. Kategoria Natyrore shtrihet ne të gjithë territorin dhe mbulon pjesën më të madhe të tij.

Tokat bujqësore ndodhen në pjesën qëndrore dhe perëndimore më së shumti. Nënkategoria më e përhapur e Natyrores është shkurrja e rrallë dhe pyjet e dendura. Shkurret e rralla ndodhen më së shumti në pjesën perëndimore dhe qendrore, ndërsa pyjet e dendura në pjesën përëndimore të Njësisë.

Njësia ka 7 fshatra; Lis, Vinjoll, Gjalish, Burgajet, Zenisht, Shoshaj, Mallunxë. Fshatrat më të rëndësishëm ndodhen në pjësën qendrore dhe perëndimore të Njësisë. Si kategori bazë rrethohen më së shumti nga tokat bujqësore.

Kryesisht bizneset e rendësishme janë të pozicionuara përgjatë lumit Mat ku ndodhet dhe rruga kryesore që lidhet me qytetin e Burrelit si dhe me pjesën tjetër të fshatrave të Lisit. Ndër bizneset më me rëndësi përmendim pikat e karburantit.

**NJA Komsi** ka një sipërfaqe prej 82.6 km$^2$.

Njësia ka si kategori bazë Natyroren dhe bujqesoren. Pjesa më e madhe që është natyrore mbulohet me nënkategorinë shkurre të rralla.

Njësia ka 9 fshatra; Komsi, Kodër Qerre, Frankth, Selixë, German, Batër e Vogël, Batër e Madhe, Midhë, Fshati Burrel, Zall-Shoshaj

Të cilat shtrhen në pjesën Lindore të Njësisë afër qytetit të Burrelit. Eshtë e rrethuar nga tokat bujqësore te cilat janë më së shumti të kultivuara dhe me funskion ekzitues Are.

**Qyteti Burreli** me sipërfaqe **14** km$^2$ është qëndra më e rëndëdsishme e Bashkisë Mat. Kategoria bazë më e përhapur është bujqësorja e ndërthurur me shërbimet dhe natyroren.

Tokat bujqësore janë të përhapura në të gjithë njësinë, pranë shtëpive si dhe ara në zonat fushore. Nënkategoria më e përhapur është bujqësore e kultivuar dhe bujqësore jo e kultivuar. Tek funksioni ekzistues kryesisht arë dhe jo e kultivuar.

Duke qenë qëndra kryesore e Bashkisë, këtu ndodhen institucionet, shërbimet kryesore, bizneset më të rëndësishem.

Zonat e banuara ndodhen në pjesën jugore të Njësisë dhe zënë një pjesë të mirë të territorit. Nënkategoria më e përhapur është ajo e banimit gjithashtu dhe si funksion ekzistues.

Pjesa natyrore ndodhet ne pjesën veriore me nenkategori mbizotëruese shkurren e dendur dhe pyjet e rralla me funksion ekzistues pyje te përzjera.

**NjA Ulëz**

Në NjA Ulëz duke u bazar edhe në terrenin kodrinor- malor që ka sipërfaqja me e madhe është e përdorimit natyror në një përqindje prej gati 80%. Në pjesën Veri- Lindore të NjA-së terreni vjen duke zbutur në këtë mënyrë dhe përdorimet e tokës natyrore dhe bujqesore alternorhen me njëri- tjetrin. Po në këtë pjesë të territorit ndodhen dhe fshatrat kryesore të NjA-së të cilët janë: Bushkash, Kokërdhok,Blat dhe Stojan si dhe qyteza e Ulzës, përbëjnë përdorimin e tokës banim. Një sipërfaqe të konsiderueshme ka dhe përdorimi i ujërave ku futet pjesa e liqeneve artificialeve të hidrocentraleve të Ulzës dhe të Shkopetit. Përdorimet si sherbime, institucione arsim dhe shendetsi i gjejmë kryesisht në qendrat e fshatrave kryesore.

**NjA Baz**

NjA Baz kryesisht ka terren malor-kodrinor të theksuar në zonën Jug- Perëndimore. Terreni vjen duke u zbutur në drejtim të veri-lindjes duke i u afruar luginës së Lumit Mat. Përdorimi kryesor i tokës në këtë NjA është përdorimi natyror që ndodhet në të gjithë shtrirjen e NjA-së, kryesisht në pjesën Jug- Perëndimore dhe në pjesën Veri-Lindore në të cilën alternohet me përdorimet bujqësore, në pjesën Veri-Lindore ndodhen dhe fshatrat kryesor të NjA-së që janë fashtrat Baz, Rreth-Baz, Fushë-Baz, Karicë dhe Dritë të cilët përbëjnë përdorimin e tokës banim. Përdorimet si shërbime, institucione arsim dhe shëndetsi i gjejmë kryesisht në qendrat e fshatrave kryesore.

**NjA Rukaj**

Në këtë NjA përdorimet e tokës janë më të ndërthurura me njëra- tjetrën. Vërehet një alternim i përdorimeve natyrore me ato bujqësore në pjesën më të madhe të NjA-së. Zonat veriore, jugore dhe jug-lindore kanë përdorime kryesisht natyrore. Pjesa qendrore e NjA-së ka kryesisht përdorime të alternuara ndërmjet natyroreve dhe bujqësoreve por me shumicë perdorimin bujqësor. Në pjesën qendrore të NjA-së ndodhen dhe fshatrat Rukaj, Rremull,Prrellë, Bruç dhe Urakë të cilët përbëjnë dhe përdorimin banim. Perdorimet si shërbime, institucione, arsim dhe shëndetësi i gjejmë kryesisht në qendrat e fshatrave kryesore.

- Mbivendosjevet/kundravajtjet e përdorimit të tokës

Nga shpërndarja në territor e përdorimeve të ndryshme, vërehen disa mospërputhje të dukshme, sic është përdorimi i veçantë me funksion ekzistues varrezë pranë zonave të banuara. Mosrepektimi i kushteve higjeno- sanitare dhe distancave sipas VKM 671.

Dukuria e shpërhapjes urbane në tokën bujqësore dhe atë natyrore është shumë e përhapur, duke sjellë një konflikt përdorimi pasi nuk përdoret toka për prodhim dhe nxitet shpërhapja më tej e saj. Efektet kryesore janë fillimisht ekonomike, pasi e bën të vështirë sigurimin e infrastrukturës dhe shërbimeve përkatesë.

Dukuria e fragmentizimit të tokave bujqësore dhe natyrore gjithashtu është një dukuri e njohur në Bashkinë Mat, e cila sjell dëmtim të tokës bujqësore duke ulur rendimentin e saj. Në këtë mënyrë bëhet e vështirë dhe kujdesi kundrejt tyre sa ç'mund të ishtë në rast se tokat bujqësore do të ishin të konsoliduara.

Ish Fabrika e Ferrokromit në afërsi të lumit e cila ndot duke shkarkuar metale të rënda tek ujërat sipëfaqësor, është duke ndikuar gjithashtu dhe në dëmtimin e tokës.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT SEKRETARIA TIRANË

Mospërputhshmëria e përdorminit banim me industrine (Ish Fabrika e Ferrokromit) duke zhurmat, ndotja e ajrit si dhe Vibrimet ose shperthimet

Figura 40: Mbivendosjevet/kundravajtjet e përdorimit të tokës




**Burimi:** Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2016

## 1.5.2 Ujësjellës dhe Kanalizime

- Furnizimi me ujë

Aktualisht, sektori i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura urbane operon nëpërmjet shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Mat, e cila ofron shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik dhe gjithashtu siguron largimin e ujërave të ndotura.

Bashkia e Matit siguron furnizimin e popullatës me ujë për konsum publik në pjesën më të madhe madhe nga burimi i Vinjollit në malin e Dejës rreth 13.5km[88] në lindje të Qytetit Mat në një lartësi prej 750 m mbi nivelin e detit. Prurja maksimale e këtij burimi 250 l/s, ndërkohë që prurja minimale e burimit është 40 l/s.

Klorinimi ndodh në depon kryesore në NjA Lis, i cili injektohet direkt në rrjetin e transmetimit. Burimi i Vinjollit i plotëson kërkesa e qytetit të Burrelit për furnizimin me ujë të pijshëm. Cilësia e ujit nga burimi Vinjollit që përdoret për furnizimin e popullatës paraqitet mjaft e mirë, kjo sepse burimi del në shkëmbinjtë mergeloro-ranoro-konglomeratike nga akuiferi me porozitet çarje-karst. Këto ujëra janë të një cilësie të mirë si rrjedhojë e një sërë faktorëve, ndër më të rëndësishmit mund të përmendim i)

mungesën e infiltrimeve të ujërave të ndotura në akuiferin nga i cili furnizohet ky burim dhe ii) respektimin e zonave higjeno-sanitare.

Kapaciteti stokues i ujit të pijshëm për popullatën e Bashkisë Mat përfaqësohet nga 11 rezervuarë kryesorë dhe disa të vegjël që u shërbejnë komuniteteve në fshatra, volumi i përgjithshëm prej 3,625 $m^3$ paraqitet nga tabela e mëposhtme:

Tabela 37: Volumi i depozitimit dhe furnizimi i popullatës me ujë të pijshëm

| NjA | Rezervuar/Depo | Volumi ($m^3$) | Vjetërsia (vite) | Lartësia (m.m.n.d) | Konstruksioni |
|---|---|---|---|---|---|
| Burrel | Lis 1 | 2000 | | 620 | beton-arme |
| | Lis 2 | 100 | | 430 | beton-arme |
| | Burgajet | 100 | | 280 | beton-arme |
| | Mallunxë | 100 | | 338 | beton-arme |
| | Zenisht | 100 | | 144 | beton-arme |
| | Gjalishte | 40 | | 550 | beton-arme |
| | Shoshaj 1 | 1000 | | 250 | beton-arme |
| | Shoshaj 2 | 40 | | 154 | beton-arme |
| Ulëz | Lundre | 20 | 2014-2016 | | |
| | Qaf Ulëz | 50 | 2014-2016 | | |
| | Bushkash | 75 | 2014-2016 | | |

**Burimi**: Ujësjellës-Kanalizime Mat; **Përgatiti**: Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2016

Duke qënë gjithnjë në gjendje pune, rezervuarët, stacionet e pompimit, klorifikatori dhe vetë sistemi i tubacioneve nuk iu janë nënshtruar rregullisht proceseve mirëmbajtëse si pastrim-shpëlarje dhe dezinfektim.

Gjithashtu agjentët atmosferikë si edhe në disa raste vegjetacioni kanë ndikuar negativisht në higjenën e këtyre elementëve. Siguria e tyre është një aspekt tjetër i cili nuk shfaq besueshmëri duke marrë parasysh faktin se në këto elementë mund të kenë akses edhe persona të paautorizuar.

VKM-ja nr. 102, datë 16.03.1992, "Për normat e përdorimit dhe çmimin e ujit të pijshëm në qytet dhe në fshat" përcakton që normat e përdorimit të ujit të pijshëm për efekt pagese për përdoruesit familjarë, të cilët nuk kanë matës, të jetë 150 litra ujë në ditë për frymë.

Norma e konsumit për popullatën ndryshon nga 90-120 litra ujë në ditë për frymë sipas kategorive (Banesa, Institucione, Biznese).

Gjatë kësaj llogaritjeje janë marrë parasysh humbjet në rrjet, të cilat për qytetin e Burrelit përllogariet të jenë në masën deri në 50 %.

NjA-të të cilat ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë në këtë Bashki në masën 97% të popullatës së tyre residente janë NjA-ja Ulëz dhe Lis. Në NjA-të Lis dhe Macukull, uji sigurohet nëpërmjet magjistralit i cili furnizon Burrelin me ujë nga burimi i Vinjollit nga mali i Dejës. Sa i përket qytetit të Burrelit, pjesa më e madhe e popullsisë është e lidhur me rrjetin e ujësjellësit. 60% e sistemit të tubacioneve janë zëvendësuar duke përmirësuar ndjeshëm cilësinë e shpërndarjes të ujit të pijshëm.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

Figura 41: Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm, Bashkia Mat




**Burimi:** Ujësjellës-Kanalizime,**Përpunoi:** Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2016

Sa i përket qytetit të Burrelit, pjesa më e madhe e popullsisë është e lidhur me rrjetin e ujësjellësit. 60% e sistemit të tubacioneve janë zëvendësuar duke përmirësuar ndjeshëm cilësinë e shpërndarjes të ujit të pijshëm.

Gjendja paraqitet si në figurën e mëposhtme:

- Pus-shpimet

Popullsia banuese në zonat e pashërbyera ka ndërmarrë në mënyrë të organizuar, ose individuale iniciativën për të realizuar pus-shpime, për të përmbushur nevojat e përditshme, për ujë të pijshëm dhe konsum sekondar.

Bashkia Mat dhe ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizimeve, mbështetet kryesisht tek prurjet që vijnë nga burimi Vinjollit, por gjithashtu edhe nga puset në NjA-të e Baz, Macukull dhe Ulzës për furnizimin me ujë për konsum publik të banorëve në qytet dhe fshatrat fqinje. Në të njëjtën linjë operojnë edhe NjA-të e tjera të cilat e kanë mbështetur shërbimin e furnizimit duke shfrytëzuar pus-shpime apo burime sipërfaqësore brenda territorit të tyre dhe afër qendrave të banuara.

Tabela 38: Pus-shpimet në Bashkinë Mat

| Nr. | Qyteti / NjA | Ujësjellësi | Qyteti / NjA - Fshati i furnizuar | Pus-shpimet: Vendndodhja |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Qyteti Burrelit | U.K. Burrel | Qyteti i Burrelit | Burimi Vinjollit (ne juglindje të Matit) |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | Puset në fshatin Vinjoll |
| 2 | NjA Ulëz | | | Gurra e Florinjtë, me prurje 5.7 l/s |

**Burimi:** Ujësjellës-Kanalizime,**Përpunoi:** Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2016

Masa që duhen ndërmarrë për rritjen e efiçencës së këtij sistemi kanë të bëjnë kryesisht me kontrollin dhe monitorimin e vazhdueshëm të sasisë së ujit të pijshëm të prodhuar dhe të faturuar.

- Problematikat në sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm.

Për sa i përket problematikave që hasen në sektorin e furnizimit me ujë, ato janë të llojeve të ndryshme dhe përfshijnë kryesisht:

- Mungesa e shtrirjes të sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm, në të gjithë territorin e Bashkisë Mat.
- Gjendjen jo të mirë të sistemit aktual për shkak të tubacione të vjetëruara, ose të bllokuara. Pavarsisht, se është realizuar rehabilitimi i 60% të sistemit të ujësjellësit në bashki.
- Humbjet në sistem: aktualisht humbjet vlerësohen të jenë midis 40-50%. Këto humbje në bazë të strategjisë kombëtare të furnizimit me ujë të popullatës duhet të reduktohen deri në masën 30%.

- Sistemi i Kanalizimeve

Shërbimi i grumbullimit të ujërave të ndotura urbane ofrohet në qytetin e Burrelit dhe në NjA-në Ulëz nëpërmjet sistemit të kanalizimeve. Sa i përket qytetit të Burrelit shërbimi i ofruar është në nivele të pakënaqshme, kjo për shkak se sistemi i kanalizimeve të ujërave të ndotura është në pjesën më të madhe i bllokuar, i dëmtuar si pasojë e vjetërsisë së tij. Vitet e fundit janë bërë ndërhyrje duke rikonstruktuar vetëm 40% të sistemit të kanalizimeve në Burrel.

Ky sistem është i kombinuar, mbledh si shkarkimet e ujërave të ndotura urbane, industriale dhe ujërat shiut. Nuk ofrohet asnjë nivel trajtimi i këtyre ujërave dhe shkarkimet ndodhin mbi trupat ujore sipërfaqësore më të afërta, në rastin konkret në lumin Mat.

Sa i përket NjA Ulëz, sistemi i kanalizimeve është i ri dhe i mirëmbajtur por nuk e mbulon të gjithë NjA. Ky sistem nuk paraqet probleme në kuadër të largimit të ujërave të ndotura nga territori i NjA Ulëz.

Megjithatë në disa fshatra ende përdoren gropa septike jashtë kushteve higjeno-sanitare për largimin e ujërave të ndotura urbane nga shtëpitë.

Aktualisht janë të identifikuara tre pika kryesore shkarkimi në lumin Mat. Gjatësia totale e tubave të kanalizimit është 21.8 km me diametra që variojnë nga 200 deri në 1,000 mm. Kanalet janë kryesisht tuba betoni pa bazament dhe me bashkime me llaç. Pothuaj 60% e rrjetit është shtrire para vitit 1980.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

Figura 42: Mbulimi me sistemin e kanalizimeve, Bashkia Mat




**Burimi**: Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2016

**Zonat Urbane:** Sot, Bashkia Mat mbulon me shërbimin e kanalizimit të ujërave të ndotura rreth 80% të popullsisë së qytetit të Burrelit. Shkarkimi i ujërave të ndotura drejtpërdrejtë në lumin Mat, përbën një problem mjaft të rëndësishëm mjedisor, duke shkaktuar ndotje të ujërave nëntokësore apo bregdetare ku lumi Mat ka grykëderdhjen.

**Zonat Rurale:** Në zonën rurale të Bashkisë Mat nuk ekziston asnjë sistem i organizuar inxhinierik i mbledhjes dhe largimit të ujërave të ndotura. Ujërat e ndotura të çdo shtëpie largohen në gropa individuale në oborret e shtëpive, të cilat nuk respektojnë standardet higjeno-sanitare të gropave septike me ose pa filtrim. Në mjaft raste largimi i ujërave të ndotura nga këto gropa bëhet në kanale të hapura kulluese që kalojnë pranë shtëpive të tyre dhe janë në kundërshtim me kushtet teknike e sanitare të largimit të tyre.

Shkarkimi dhe trajtimi i ujërave urbane dhe industriale është një ndër problemet kryesore që haset sot në Bashkinë Mat për arsye se të gjithë kolektorët i shkarkojnë ujërat e ndotura të patrajtuara në sipërfaqe ujore sipërfaqësore[89]. Përzierja e lëndëve ndotëse organike dhe inorganike (ujërat e ndotur urban e ato industrial) si edhe largimi i tyre deri në grykëderdhje përbën një shqetësim të madh mjedisor e shoqëror për të gjithë banorët e zonës.

- Problematikat

Sikurse u pa më sipër, rrjeti i kanalizimeve në Bashki është relativisht i amortizuar dhe nuk përmbush me efiçencë funksionin bazë. Përveç Qytetit të Burrelit dhe NjA Ulëz, pjesa tjetër e Bashkisë nuk mbulohet me rrjet kanalizimesh. Për më tepër, edhe në zonat

ku ky rrjet shtrihet, hasen shumë probleme. Kjo për shkak se sistemi i kanalizimeve të ujërave të ndotura është masën 60% i vjetëruar, duke shkaktuar kështu ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe kanaleve kullues e vaditës, si pasojë e derdhjes së ujërave të ndotura të patrajtuara në mjedis.

Si përfundim mund të thuhet se në Bashkinë Mat:

- Kanalizimi i ujërave të ndotura është i pjesshëm dhe ofrohet vetëm në zonën urbane në Burrel dhe Ulëz.
- Shërbimi i orfuar është në nivele të pakënaqshme, pasi sistemi i kanalizimeve të ujërave të ndotura është në pjesën më të madhë i bllokuar, i dëmtuar, ose i shtrirë jashtë standardeve higjeno-sanitare.
- Ujërat e ndotura urbane vazhdojnë të ndosin pjesën më të madhe të ujërave sipërfaqësore si pasojë e shkarkimit të apatrajtuar të tyre drejtpërdrejtë në lumin Mat.
- Zonat Rurale nuk kanë rrjet kanalizimesh të ujërave të ndotura (largimi i ujërave bëhet nëpërmjet gropave septike, jashtë standardeve higjieno-sanitare).
- Mungesa e impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura urbane ka shkaktuar gjithmonë probleme, duke shkarkuar ndotjen direkt në ujërat sipërfaqësore. Krahas me ndërtimin e tij duhet të parashikohet reahbilitimin ose ndërtimi i sistemit të ri të grumbullimit të ujërave të ndotura. Në mënyrë që të bëhet përzgjedhja e duhur e metodologjisë dhe teknikës së përshtatshme për trajtimin e ujërave të ndotura, fillimisht duhet të bëhën studime për të përcakturën natyrën e ujit të ndotur, që do të futet në impiant për t'u trajtuar.
- Nevojitet që sistemi i grumbullimit të ujërave të ndotura të projekohet i ndarë nga sistemi i cili pret ujërat e larta, kjo për arsye të shmangies së mbingarkesës e cila shpesh rezulton në përmbytje dhe daljen në sipërfaqe të ujërave të ndotura.
- Nevojiten të gjenden zgjidhje për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave në zonat rurale, për të eleminuar përdorimin e gropave septikë jashtë kushteve higjeno-sanitare. Vazhdimisht praktikohen mënyra të ndryshme të cilat janë mjaft efektive sa i përket eleminimit të ndotjes duke minimizuar kështu ndotjen që shkarkohet nga gropat septike.
- Duke vlerësuar së Mati gjeneron ujëra të ndotura industriale, sidomos ato të cilat futen në proceset e pasurimit të ferro-kromit, bartin elementë si metale të rënda, të cilat kanë impakt të drejtpërdrejtë në botën ujore me të cilën vihen në kontakt. Si rrjedhojë, propozohet që këto ujëra të kenë një sistem të dedikuar grumbullimi – trajtimi – monitorimi e shkarkimi.

### 1.5.3 Infrastruktura rrugore dhe transporti

Bashkia e Matit pozicionohet në pjesën jugore të qarkut të Dibrës. Përsa i përket korridoreve ndërkombëtarë që lidhin vendin tonë me vendet e rajonit, kjo bashki nuk ka akses në mënyrë të drejtpërdrejtë, por qyteti i Burrelit është afërsisht 60 min larg këtyre korridoreve siç janë rruga e Kombit si dhe Korridori i kaltër (Autostrada Adriatiko-Joniane).

Në bashkinë e Matit kalojnë rrugët shtetërore:

***Rruga shtetërore 6 (SH6)*** - fillon në Milot dhe përfundon në Peshkopi. Kjo rrugë ka një gjatësi 125 km. Nga rruga nacionale Burreli (qendra e bashkisë së Matit) është e pozicionuar në km e 44 e cila llogaritet afërsisht në 60 min nga autostrada A3 (rruga e kombit, Route E851) nga niset SH6[90]. Kjo rrugë kalon pranë hidrocentraleve të Ulzës dhe të Shkopetit. Segmenti Burrel- Ulëz është relativisht i mirë ndërkohë që nga Uléza në Milot rruga ka nevojë për përmirësim. Është një ndër akset kryesore të cilat lidhin jo vetëm Burrelin, por edhe Peshkopinë e Bulqizën.

***Rruga Shtetërore 34 (SH34)*** - e cila nis nga rruga e shtetërore (SH30) ku në urën e Lumit Fan nis rruga SH34 për në Rreshen e cila vazhdon deri në degëzimin në Perlat Qendër, ku më pas ky itinerar vazhdon drejt jugut për tu bashkuar në Burrel me rrugën shtetërore SH36 e cila bashkohet në Burrel me rrugën SH6 ku vazhdon drejt Peshkopisë. Nga ky itenerar, qyteti i Burrelit është i pozicionuar 35 km dhe afërsisht 50 minuta[91].

***Rruga Shtetërore 38 (SH38)*** - nis nga Fushë-Kruja vazhdon në Krujë me pas në Burrel ku bashkohet me rrugën Shtetërore 6 (SH6). Gjatësia e këtij itinerari është 55.7 km dhe afërsisht 100 min duke parë terrenin e vështirë ku kalon kjo infrastrukturë.

Figura 43: Bashkia Mat në raport me infrastrukturën rajonale




**Burimi:** Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2016

- Transporti ndërqytetas (Interurban)

Transporti publik ndërqytetas luan një rol të rëndësishëm për mënyrën e lëvizjes (bashkëveprimit) së Bashkive me njëra tjetrën. Transporti publik ndërqytetas është kopetencë e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës.

Transporti ndërqytetar përkufizohet si:

Transport i udhëtarëve me autobus, i cili kryhet në linjat kryesore dhe linjat ushqyese, të parashikuara në rrjetin e linjave të miratuara nga ministri. Linjat kryesore shërbejnë për të plotësuar nevojat e lëvizjes së popullsisë që lidhin bashkitë, si më poshtë:

- bashkitë qendër të qarqeve të ndryshme;
- një Bashki qendër qarku me Bashkitë jo qendër qarku të një qarku tjetër ose dy Bashki jo qendër qarku të qarqeve të ndryshme[92].

Transporti në linjat kryesore kryhet pa ndalime ose me ndalime në stacionet e përcaktuara gjatë itinerarit të linjës. Linjat ushqyese lidhin dy bashki brenda një qarku, me qëndrime në stacionet e përcaktuara gjatë itinerarit të linjës, të përcaktuara në rrjetin e linjave.Transporti ndërqytetës kryhet nga persona juridikë, të organizuar në shoqëri transporti e të pajisur me licencë. Rrjeti i linjave ndërqytetëse (kryesore dhe ushqyese), stacionet e qëndrimit dhe numri i orareve për secilën linjë miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për transportin çdo tre vjet[93].

Nga analiza e transportit ndërqytetës (interurban), sipas informacioneve të marra nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, lëvizshmërinë më të shpeshtë Bashkia e Matit e ka me Tiranën. Nga skema e paraqitur më poshtë shohim që Bashkia Mat ka 6 orare në ditë që shkojnë drejt Tiranës dhe 1 orar në ditë drejt Shkodrës dhe Durrësit. Linjat e transportit ndërqytetas nisen nga sheshi Demokracia. Në linjat që priten të zbatohen në Janar të vitit 2017,

Këto të dhëna tregojnë që lëvizshmerinë më të madhe Bashkia e Matit e ka me kryeqytetit e vendit, ku nga informacionet e Bashkisë theksohet që drejt kryeqytetit lëvizin më shumë se 450 udhëtarë në ditë. Në Durrës dhe në Shkodër udhëtojnë më shumë së 15 udhëtarë në ditë. Rruga nacionale SH 6 ka fluksin më të madh të mjeteve që shkojnë drejt Bashkisë Mat dhe anasjelltas duke e krahasuar me rrugën nacionale SH 34 që vjen nga Rrësheni e cila është më pak e aksesueshnme përshkak të gjendjes jo të mirë të kësaj infrastrukture.

Linja Burrel-Klos-Peshkopi është e vetmja linjë e cila propozohet nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës që pritet të sjellë akses më të mirë ndërmjet Qarkut të Dibrës (Linjë ushqyese) dhe numri i udhëtareve pritet të rritet duke iu referuar informacioneve nga Bashkia Mat ku theksohet që ndërveprimi më Bashkinë e Klosit është i madh duke u bazuar në numrin e banorëve që levizin në këto dy Bashki duke përdorur kryesisht transportin publik.

Përsa i përket tarifave të transportit mbi udhëtaret, zbatohen mbi bazën e dispozitave të ligjit "për çmimet dhe tarifat". Tarifat e transportit të udhëtareve me subvension nga shteti miratohen nga Keshilli i Ministrave[94].

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT SEKRETARIA TIRANË

Figura 44: Transporti ndërqytetës (nisja nga Bashkia Mat, Burrel)




**Burimi**: Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës; **Përpunoi**: Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2016

- Analiza sipas funksionalitetit

Në aspektin e funksionit të akseve rrugore, mbizotërojnë rrugët rurale/peisazhistike (41.3 % të totalit), si dhe rrugët bujqësore (29 %). Kjo dëshmon për një potencial të madh bujqësor dhe peisazhistik, që mund të integrohen nëpërmjet itinerareve të mundshme rajonale, duke krijuar një lidhje të mirë të zonave që kanë potencial të turizmit malor. Sistemi rrugor i bashkisë ka nevojë për përmirësime të shumta, kryesisht në lidhje me rrjetin kombëtar.

Tabela *39* : Shpërndarja e rrugëve sipas funksionit dhe gjatësisë përkatëse.

| Gjatësia e rrugës (km) | Ekzistuese |
|---|---|
| Arterie | 47.6 |
| Bujqesore | 334.5 |
| E brendshme kryesore | 81.6 |
| E brendshme dytësore | 29.5 |
| Kolektor | 172.2 |
| Korridor shumëfunksional | 1.3 |
| Peisazhistike | 492.5 |
| Rekreative | 26.8 |
| Shërbimi | 6.7 |
| Total | 1192.7 |

**Burimi**: Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2016



Figura 45: Hierarkia e sistemit rrugor sipas funksionalitetit




**Burimi**: Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2016

Gjëndja e infrastrukturës rrugore

Krahas llojit dhe funksionit të akseve rrugore, kjo analizë merr në konsideratë edhe gjendjen fizike të infrastrukturës, në aspekt të cilësisë së shtrimit, pranisë së trotuareve, sinjalistikës, etj. Nga ky evidentim[95] rezulton se në Bashkinë e Matit vetëm 131.7 kilometra rrugorë janë të shtruar dhe 1,061.2 km janë të pashtruar. Rrugët e shturara janë kryesisht rrugët nacionale që lidhin bashkinë e Matit me bashkitë kufitare si dhe me pjesën tjetër të vendit. Kjo ndodh për arsye së pjesa më e madhe e rrugëve janë rrugë lokale (gjerësi nën 6 metra) dhe shtihen kryesisht në terren të thyer.

- Lëvizshmëria (Mobiliteti) dhe transporti publik rrethqytetas

Të dhënat statistikore për përdorimin e automjetit apo transportit publik, (INSTAT, 2011) tregojnë se 66 % e banorëve të Bashkisë Mat shkojnë në punë në këmbë ose me biçikletë, 7.4 % me autobus, minibus ose taksi dhe vetëm 21.9 % me automjete personale (makina ose motoçikleta). Kjo dëshmon për një kulturë automobilistike jo të mirë.

Duke u bazuar në informacionet e bashkisë Mat, transporti rrethqytatas përbëhet nga 2 linja te licensuara për transportin taxi 8+1. Stacioni më i rëndësishëm nga nisen këto linja është te sheshi para Muzeut. Linjat janë Frankth-Burrel-Frankth e cila lidh njësinë administrative Komsi me qytetin e Burrelit. Linja tjetër është Rukaj-Burrel-Rukaj e cila lidh qytetin e Burrelit me pjesën veriore të Bashkisë. Ky lloj transporti shtrihet në një gjatësi 25.2 km[96] linear. Nga linjat ekzistuese shihet që pjesa lindore dhe perëndimore nuk ka akses nga shërbimi i transportit publik i cili është shumë i rëndësishëm në funksionimin normal të Bashkisë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

Figura 46: Cilësia e infrastrukturës rrugore Bashkia Mat




**Burimi**: Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2016

Figura 47: Linjat e transportit publik rrethqytetas, Bashkia Mat




**Burimi**: Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2016

### 1.5.4 Menaxhimi i mbetjeve të ngurta

Me manaxhim të mbetjeve nënkuptohet grumbullimi i mbetjeve të ngurta nga pikat e grumbullimit të mbetjeve, shpërndarë në funksion të dëndësisë së popullatës dhe aktiviteteve private e shtetërore dhe, transportimi dhe trajtimi i tyre, si edhe depozitimi i tyre përfundimtar.

Bashkia Mat aktualisht mbulon me shërbim të menaxhimit të mbetjeve vetëm NjA-në e Burrelit dhe pjesërisht NjA-në Ulëz. Në NjA-në Burrel grumbullimi dhe largimi i mbetjeve kryet nëpërmjet sipërmarjes private, ndërsa NjA Ulëz e kryen vetë këtë shërbim. Përveç NjA-së Burrel dhe pjesërisht Ulëz, në të gjitha NjA-të e tjera nuk ofrohet shërbimi i grumbullimit të mbetjeve urbane. Menaxhimi i mbetjeve në NjA-në Burrel dhe Ulëz bëhët me skemë tepër bazike, ku proçeset e mbetjeve kalojnë nga gjeneruesi në pika grumbullimi, mbledhja dhe depozitimi ne fushën e depozitimit të mbetjeve, e cila është e pa menaxhuar.

Sot, Bashkia Mat mbulon me shërbimin e grumbullimit dhe largimit të mbetjeve të ngurta urbane (MNU) 44.6% të popullsisë, e cila është e njëjtë me numrin e popullsisë të NjA-së Burrel dhe qytezës së Ulëzës. NjA-të në të cilat nuk ofrohet shërbimi i grumbullimit dhe largimit të MNU-së,janë gjetur zgjidhje individuale nga banorët, të cilët i depozitojnë ato në pika të pa autorizuara dhe shpesh herë përgjatë rrjedhave të përrenjëve dhe lumenjëve.

Grumbullimi i mbetjeve të ngurta urbane në NjA-në e Burrelit kryehet në 56 pika grumbullimi të miratuara, me 87 copë kontenierë metalik 1.1 $m^3$[97]. Ndërsa grumbullimi në qytezën e Ulëzës kryhet me 10 kontenier 0.7 $m^3$. Në të dyja këto NjA pikat e grumbullimit të mbetjeve janë të pozicionuar në vende ku janë të arritshme nga makina e transportit të mbetjeve të ngurta urbane. Në NjA-në e Burrelit tërheqja e mbetjeve kryhet në intervalin një herë në ditë dhe në pika afër institucioneve dhe bizneseve që gjenerojnë sasi të konsiderueshme kryhet në intervalin dy herë në ditë, ndërsa në qytezën Ulëz mbetjet tërhiqen 1 herë në ditë.

Vend depozitimi i mbetjeve ndodhet rreth 1.7 km (vijë ajrore) larg nga qëndra e qytetit të Burrelit, përgjatë rrugës automobilistike Burrel – Komsi, në të cilin depozitohen mbetjet e gjeneruara nga NjA-ja Burrel. Vend-depozitimi është në kushte jo të përshtatshme teknike e mjedisore. Vend-depozitimi është i pa menaxhuar dhe jashtë standarti, në krah të rrugës automobilistike, duke i shkarkuar mbetjet direkt nga rruga në një pjesë të pjerrët në drejtim të lindjes. Krahas ndikimeve negative në tokë, ujër dhe ajër, mbetjet në të digjen, duke rritur shkallën e dëmtimit të përbërësve të mjedisit dhe ndikimit në shëndetin e banorëve. NjA-të e tjera të Bashkisë Mat, nuk kanë vend-depozitime të përcaktuara duke rritur hapsirat e shpërndarjes së mbetjeve në pika më të vogla dhe vështirësuar mbledhjen dhe pastrimin e tyre.

- Gjenerimi i mbetjeve të ngurta urbane

Gjat viti të shkuar Bashkia Mat ka gjeneruar rreth 9,853.6 t/vit [98], thënë ndryshe, 26.9 t/ditë. Norma mesata e prodhimit të mbetjeve në territorin e Bashkisë varion nga 0.4 kg/ditë në zonat rurale deri në 0.7 kg/ditë në qytetin e Burrelit. Norma e gjenerimit për bizneset është 10 kg/ditë, kjo për bizneset e vogla dhe të mëdha, ndërsa për institucionet

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

është 12 kg/ditë. NjA-ja Burrel prodhon 18.4 t/ditë mbetje urbane, ose rreth 68% të mbetjeve të gjeneruara në territorin e Bashkisë.

Sasia më e madhe e mbetjeve të prodhuara në territorin e bashkisë vijnë nga sektori familjar, e ndjekur nga biznesi i vogël, biznesi i madh dhe me sasinë më të vogël të gjeneruar renditen institucionet. Nga sasia totale e mbetjeve të prodhuara në territorin e bashkisë rreth 76% e tyre prodhohet nga sektori familjar, rreth 20% nga biznesi i vogel, 3% nga biznesi i madh dhe rreth 1% nga institucionet.

Tabela 40: Gjenerimi i mbetjeve sipas grupeve të prodhuesve në Bashkinë Mat, 2015

| Bashkia MAT | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Emërtimi | Njësia | Nr. | Norma kg | kg/dite | Për 365 ditë |
| 1 | Nr. Banorë | frymë | 17,190 | 0.7 | 12,033 | 4,392,045 |
| 1.1 | Nr. Banorë Nj.Adm | frymë | 21,353 | 0.4 | 8,541.2 | 3,117,538 |
| 2 | Biznes i vogël | copë | 644 | 10 | 5,470 | 1,996,550 |
| 3 | Biznes i madh | copë | 120 | 10 | 700 | 255,500 |
| 4 | Institucione | copë | 74 | 12 | 252 | 91,980 |
| | Shuma | | | | 26,996.2 | 9,853,613 |

**Burimi**: Bashkia Mat, 2016

Mbetjet e prodhuara nga NjA-të varet kryesisht nga numri i popullsisë në to, pasi sasia më e madhe e prodhuar e mbetjeve vjen nga prodhimet familjare, që do të thotë, që sektori i biznesit, apo sektorë të tjera janë kanë sasi më të ulët prodhimi mbetjesh sesa sektori familjar. Siç edhe është përmendur më lart, NjA Burrel ka sasinë më të madhe të gjenerimit të mbetjeve, më pas ndiqet nga NjA-të Komsi, Lis, Rukaj, Baz, Ulëz, Macukull dhe në fund Derjan.

- Vend-Depozitimi i mbetjeve urbane

Mbetjet urbane në territorin e Bashkisë Mat depozitohen në vend-depozitime të ndryshme, NjA-të i depozitojnë në pika të vogla, kryesisht përgjat shtretërve të përrenjëve dhe lumenjëve. NjA Burrel i depoziton mbetjet në një fushë mbetjesh të pa standartizuar. Vend-depozitimi i mbetjeve Ndodhet 1.7 km vjië ajrore nga qëndra e qytetit të Burrelit, përgjatë rrugës automobilistike që lidh Burrelin me Komsinë, pranë varezave të Deshmorëve. Vend-depozitimi aktual paraqet një sërë problematikash, duke filluar me ndikimet në shtresat e tokës e deri në ndotjen e ujrave nëntokësorë. Gjithashtu ky vend-depozitim ka ndikim të lartë në përkeqësimin e cilësisë së ajrit, qoftë nga gazi metan që clirohet nga dekompozimi i mbetjeve dhe nga bloza e tymi që shkarkohet nga djekja e tyre.

Në krah të vend-depozitimit të mbetjeve ndodhet dhe pika e depozitimit të inerteve, kryesisht të dherave të cilët kanë dalë nga proceset e ndërtimeve, por që bashkë me to janë përzjerë dhe ndotës të cilët kanë ndikim negative në mjedisin përreth.

Duke vëzhguar me kujdes ecurinë e këtyre dy vend-depozitimeve, qoftë atë të mbetjeve të ngurta urbane dhe ato të inerteve, vërehet një zmadhim i konsiderueshëm i sipërfaqes së tyre. Krahasimi i bërë nëpërmjet pamjeve satelitore[99] tregon që sipërfaqja e vend-

depozitimit të mbetjeve nga viti 2003 deri në vitin 2015 ka nje rritje të konsiderueshme të siperfaqes, siç mund të verehet edhe në figurën më poshtë.

Figura 48: Vend-depozitimi i mbetjeve të ngurta urbane dhe inerte Burrel




**Burimi:** GoogleEarth; **Përpunoi:** Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2016

- Mbetjet industriale

**Dampat e fabrikave të pasurimit:** Përfaqësojnë mbetje industriale të industrisë përpunuese të mineralit të kromit. Në NjA-në Komsi është krijuar një stok disa mijëra $m^3$ mbetje nga industria e shkrirjes së mineralit të kromi të quajtura skorie të ferrokromit. Këto mbetje teknologjike janë trajtuar në vende të veçanta në funksion të ruajtjes së ambientit. Në këtë drejtim deri diku ja kanë arritur qëllimit. Megjithatë ekspozimi i tyre për një kohe shumë të gjatë nën ndikimin e agjenteve atmosferike ka krijuar edhe impakt negative.

Mineralizimi i shpëlarë në vazhdimësi depërton në shtresat e tokës duke krijuar një impakt në ujërat nëntokësor. Nga ana tjetër duke shpëlarë në vazhdimësi edhe ujërat sipërfaqësor njësoj si në stoqet e minierave transportojnë elementë të dëmshëm në ujërat e lumenjve për në tokat bujqësore nëpërmjet sistemit të vaditjes apo në basenet e hidrocentraleve.

Figura 49: Dampat e Ferro-kromit, Komsi




**Burimi:** GoogleEarth; **Përpunoi:** Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2016

- Përfundime dhe rekomandime

Fillimisht, Bashkia Mat ka nevojë për të hartuar Planin e Manaxhimit të Integruar të Mbetjeve Urbane, kjo si nevojë për një studim të plotë mbi shtrirjen e infrastrukturës së shërbimit të manaxhimit të mbetjeve në të gjithë territorin e Bashkisë.

Vend-depozitimi aktual duhet t'i nënshtrohet rehabilitimit mjedisor të tij, dhe të mendohet për të gjetur një zgjidhje për vend depozitimin e ri të mbetjeve, i cili duhet të jetë në standartet e një landfilli sanitar të menaxhuar. Mbetjet industriale, edhe pse nuk janë përgjegjësi e bashkisë, institucionet vendore duhet të hyjnë në diskutime për të gjetur një zgjidhje sa më të përshtatshme, kryesisht në dampat e uzinës së fero-kromit në Komsi. Aktualish nuk ka të dhëna mbi sasinë dhe mënyrat e riciklimit të mbetjeve në territorin e bashkisë, riciklimi ndodh në mënyrë joformale, ndaj shikohet e arsyeshme që bashkë me hartimin e planit të menaxhimit të mbetjeve të formalizohet sektori i riciklimit. Zonat me nivel të lartë ndotjeje, sidomos industriale, në NjA-në Komsi përbën një problem serioz për mjedisin dhe shëndetin publik të banorëve. Mbetjet e trashëguara në këto zona duhet të jenë pjesë e skemës së re, që duhet të përvetësojë Bashkia e Mat për manaxhimin e integruar të mbetjeve. Shërbimi i grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane nevojitet të shtrihet në të gjithë territorin e Bashkisë Mat.

1.6 Rëndësia kombëtare në territor

- Monumente Kulturore

Parku Kombëtar Qafë Shtama shtrihet në kufirin perëndimor të Bashkisë Mat dhe një sipërfaqe tepër e vogël e Parkut shtrihen në Njësinë Administrative Komsi. Parku është një aset i rëndësishëm dhe potencial për zhvillimin e turizmit malor dhe ekoturizmit në bashki. Zona e mbrojtur ka sipërfaqe prej rreth 20 km$^2$, e shpallur si e tillë prej vitit 1966. Ajo gjendet rreth 20 km në jug-perëndim të Burrelit.

"Dera e Qytezës së Komsis" (Nj.A. Komsi) është shpallur monument kulture i kategorisë të I, vendimin e qeverisë nr. 2854, në datë 08.08.1980. Gjithashtu në njësinë Rukaj ndodhen tre monumente kulture të kategorisë së I-rë të shpallura me vendim nr. 266/1, të datës 16.02.1979, "Shpella e Pëllumbave në Luginën e Valit", "Shpella e Blazit në Luginën e Valit" dhe "Shpella e Nezirit në Luginën e Valit". Janë shpella të krijuara në shkëmbinj gëlqerorë si rezultat i gërryerjeve karstike.

"Vendi ku u Mbajt Kuvendi i Dukagjinit dhe Gjurmët e Kishës së Atjeshme" monument kulture i kategorisë së I, i shpallur me vendimin nr.1886 të datës 16.02.1973 në njësinë administrative Derjan. "Banesa e Rustem (Dyl) Kryekurtit" në njësinë administrative Macukull. Është monument kulture i kategorisë së I, i shpallur me vendimin nr.1886 të datës 16.02.1973.

- Zona të mbrojtura natyrore

Në territorin e Bashkisë Mat shtrihet Parku Kombëtar i Liqenit të Ulzës me sipërfaqe 4,206 ha i shpallur monument natyror i kategorisë IV me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.16, datë 30.04.2013. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 676 datë 20.12.2002 përcakton 16 monumente natyrore të cilat shtrihen në territorin e Bashkisë Mat:

- Guri i Gjatë – Urxall (Derjan)
- Kepi i Skënderbeut Varosh (Macukull)
- Kanioni i Urakës (Derjan)
- Rrapi i Marqethit (Lis)
- Lisi i Qershizës (Ulëz)
- Maja e Boshtrës (Macukull)
- Gurri i Vashës (Macukull)
- Lisi i Tushës (Komsi)
- Kanioni i Filmit (Derjan)
- Tisat e Mbasdejës (Lis)
- Burimi i Shutresë (Rukaj)
- Lisi Qafë Shënkollit (Derjan)
- Lisi Macukull (Macukull)
- Lisi te varret e Shqypit (Derjan)
- Lisi i kodër (Derjan)
- Lisi i Teqesë së Domit (Komsi)

- Menaxhim i integruar i burimeve ujore

Lumi i Matit shtrihet me një gjatësi 25.8 km përgjatë territorit të Bashkisë së Matit. Të gjitha burimet ujore sëbashku me të gjitha brigjet dhe shtretërit e trupave të ujit pa përjashtim, sipas specifikimit të ligjit ligjit nr.111, datë 15.11.2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", janë në pronësi të shtetit dhe në administrim të organeve shtetërore. Përgjatë trupave ujore, ky ligj specifikon distanca sigurie në dy breza në varësi të këndit të bregut më pak ose më shumë se 10%. Zona A shtrihet nga 5 m deri në 20 m (përkatësisht për brigje të pjerrëta e të sheshta) dhe përdoret për qëllime publike me dispozita të veçanta. Zona B shtrihet nga 100 m deri në 200 m (përkatësisht për brigje të pjerrëta e të sheshta) dhe çdo veprimtari e zhvilluar përcaktohet nga organet e administrimit e menaxhimit të burimeve ujore.

Sistemet e kanalizimeve dhe dranzhimit për mbarëvajtjen e tokave bujqësorë rregullohen nëpermjet ligjit nr.8518 i datës 30.07.1999 "Për ujitjen dhe kullimin" i ndryshuar. Sistemet e kullimit që janë pronë shtetërore mund të kalojnë në përdorim apo në pronësi të një federate, organizate ose bordi pa ndryshuar destinacionin vetëm me vendim të Këshillit të Ministrave (Neni 9). Sipas strategjisë të decentralizimit dhe ligjit për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor nr. 131/2014, sistemet dytësore dhe tretësore të ujitjes dhe kullimit i kalojnë në administrim bashkive si funksion i vetë.

Ligji nr. 9115, datë 24.7.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura" i ndryshuar, përcakton rregullat e trajtimit mjedisor të ujërave të ndotura, duke përfshirë ujërat e ndotura urbane, ujërat e ndotura industriale, ujerat nga kullimi i tokave bujqësore dhe ujërat e ndotura të çdo lloji. Sipas VKM nr. 671, datë 29.07.2015, distancat minimale të mbrojtjes nga impiantet për trajtimin e ujërave të zeza janë 200 m për kapacitet më pak se 5,000 banorë dhe 1,000 m për kapacitet 1,000 – 50,000 banorë.

- Tokat Bujqësore

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETAR

Territori i bashkisë së Matit ka një sipërfaqe të konsiderueshme prej 5,967 ha tokë bujqësore. Sipas legjislacionit në fuqi dhe ligjit nr. 131/2014 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", specifikohet mbrojtja nga ndërtimet, mbrojtja e shtretërve dhe brigjeve të lumenjve për parandalimin e erozionit si dhe zbatimi i një praktike të mirë bujqësore. Sipas këtij ligji, kthimi i tokës bujqësore në tokë urbane, mund të propozohet vetëm përmes një dokumenti planifikimi, sipas legjislacionit të planifikimit. Ndërtimi është i ndaluar përveç ndërtimeve të përkohshme, të cilat nuk janë të lidhura në mënyrë të qëndrueshme dhe të përhershme me tokën dhe që janë të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit bujqësor dhe blegtoral, të cilësuara në Vendimin e KM nr. 283, datë 1.4.2015 "Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore". Në të gjitha kategoritë e bonitetit miratimi i kalimit të sipërfaqes për ndërtim bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe në asnjë rast nuk lejohet ndryshimi i destinacionit të objektit ndërtimor.

Po ashtu, ligji nr. 16/2012, "Per disa shtesa në ligjin 8752, date 26.3.2001," Për krijimin dhe funksionimine strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës", cilëson që në tokat bujqësore mundësohet kalimi në sipërfaqe për ndërtime me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm për rastet e domosdoshme si infrastukturë (rrugore, hekurudhore, arjore, detare), hidrocentrale, varreza si dhe raste të tjera të cituara tek neni 11/1. Shtesa e sipërfaqes nuk mund të jetë më e madhe se 3 ha dhe kërkesa për shtesë bëhet vetëm një herë. Kalimi i tokës bujqësore (boniteti V deri në X) në kategori të tokës urbane (truall) bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave për sipërfaqe deri në 30 ha dhe me ligj të veçantë për sipërfaqe mbi 30 ha. Ndërkohë pika 4/5 e nenit 11/1 shpreh që kalimi i tokave bujqësore në kategori të resurseve të tjera, si pyll, tokë pyjore, kullotë dhe livadh, si dhe anasjelltas bëhet me miratimin e përbashkët të ministrave përkatës, që i administrojnë këto resurse për sipërfaqe deri në 5 ha dhe me miratimin e Këshillit të Ministrave për sipërfaqe mbi 5 ha.

- Pyjet, drufrutorët dhe kullotat

Përcaktuar në ligjin nr. 48/2016 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar, "Toka pyjore" janë sipërfaqe toke me drurë, shkurre e bimësi tjetër jopyjore, me shkallë mbulimi nga 5 deri në 30 për qind, sëbashku me sipërfaqet e tjera që sigurojnë funksionet e pyllit. Bashkia e Matit ka 12,045 ha sipërfaqe pyjore me pronësi publike dhe private. Fondi pyjor publik zotërohet e administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Pyjor dhe organet e qeverisjes vendore. Pjesë e këtij fondi pyjor kombëtar, mund të kërkohen nga subjekte juridike ose fizike apo nga organet e qeverisjes vendore, për t'u kthyer në truall për destinacione specifike të parashikuara në ligjin e mësipërm: me miratim të ministrit për sipërfaqe deri në 1 ha; me vendim të Këshillit të Ministrave për sipërfaqe nga 1 deri në 100 ha; dhe me ligj të veçantë për sipërfaqe mbi 100 ha. Sipas përcaktimeve të ligjit ligji nr. 16/2012, "Për disa shtesa në ligjin 8752, datë 26.3.2001," Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës", pjesë të fondit pyjor kombëtar kthehen në kategorinë e resursit të tokës bujqësore vetëm për mbjelljen e këtyre sipërfaqeve me kultura të drurëve, të cilët janë pjesë e programeve dhe të politikave prioritare shtetërore afatgjata. Nërsa për të ndryshuar vëllimin e tokës pyjore nevojitet miratimi i organeve të shërbimit pyjor, kalimi i resursit të tokës së

pafrytshme, që është në pronësi private apo të organeve të qeverisje vendore, bëhet me kërkesë të pronarit apo organit të qeverisjes vendore dhe miratohet nga ministri përkatës.

Në bazë të ligjit 7929 datë 11.05.1995 "Për mbrojtjen e drufrutoreve", pemët frutore, vreshtat, agrumet dhe ullishtet, pavarësisht se në pronësi të kujt janë, janë pasuri kombëtare dhe mbrohen me ligj nga shteti. Pasuria shtetërore drufrutore e ish-ndërmarrjeve bujqësore, i është dhënë në administrim organeve të pushtetit lokal me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 473 datë 14.10.1999.

Fondi kullosor i përbëre nga kullotat dhe livadhet në pronësi publike dhe private është burim natyror dhe pjesë e pasurisë kombëtare. Ai mbrohet, administrohet dhe përdoret sipas kërkesave të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor", i ndryshuar e të akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. Heqja e një kullote, apo livadhi nga fondi kullosor, ose ndryshimi i destinacionit për një sipërfaqe kullote bëhet me miratimin e ministrit për sipërfaqe deri në 1 ha dhe me vendim të Këshillit të Ministrave për sipërfaqe mbi 1 ha.

- Zonat industriale

Zona e ish Stacionit të Makinave dhe Traktoreve (SMT) Burrel, ka kaluar në proces privatizimi ku një pjesë është në përdorim nga subjekte private. Uzina e Shkrirjes së Ferrokromit në Burrel ka zhvilluar aktivitetin e saj nga vitin 1976 deri në vitin 1996. Ajo ndodhet në njësinë administrative Komsi. Në territorin e Bashkisë Mat ndodhen dy hidrocentralet e Ulzës dhe të Shkopetit. Janë ndër hidrocentralet e para të ndërtuara në Shqipëri në vitet 1950-1960. Hidrocentralet janë ndërtuar duke përdorur teknologjinë ruse, janë me diga të vendosura në shkëmb. Gjatë viteve kanë pasur investime për mirëmbajtjen e digës dhe të pajisjeve. Hidrocentrali i Ulzës ka një fuqia të instaluar prej 25,000 kv dhe një prodhim energjie vjetore prej 120,000,000 KËh. Diga e H/C ka një gjatësia prej 264 m, dhe gjërësia 57 m, ndërkohë lartësia është 64 m. Hidrocentrali i Shkopetit ka një fuqi të instaluar prej 24,000 KË dhe prodhim energjie vjetor prej 94,000,000 KËh. Të dy konsiderohen ndër hidrocentralet më të mëdhenj të Shqipërisë pas hidrocentraleve të kaskadës së Drinit. Në vitet e fundit është shtuar interesi edhe për ndërtimin e hidrocentraleve të reja private në zonën e Bashkisë Mat. Një vendim i këshillit të ministrave i marrë me datë 20 Korrik 2016, ka miratuar kontratat shtesë të koncesioneve të formës "bot" ndërtim-operim-transferim, për ndërtimin e 8 hidrocentraleve në rrjedhën e lumit Mat. Sipas vendimit të Këshillit të ministrave, bëhet fjalë për hidrocentralet të emërtuara "Gjoni", "Blishta", "Klosi", "Domi", "Luci", "Shoshaj, "Zenishti" dhe "Burreli", koncesionet e të cilave janë dhënë që në tetor të vitit 2012. Dy hidrocentralet e para të kësaj liste të re janë në ndërtim e sipër dhe konçesionin e ka një kompani shqiptare.

Ndërkohë për pjesën tjetër të listës konçesionin e ka marrë një kompani austriake, por që ende nuk ka filluar zbatimin e projekteve në terren. Nga lista e botuar ajo që bie në sy është se lumi i Matit po shfrytëzohet në maksimum për prodhim energjie. Sipas listës i bie që mesatarisht në çdo 5-6 kilometra rrjedhë të këtij lumi të ketë një hidrocentral. Ky konçension është ngritur si shqetësim qytetar edhe në mbledhjet e Këshillit të Bashkisë Mat. Këshilltarët e pranishëm të konsultuar edhe me specialist, janë shprehur se ky projekt mund të jetë shkatërrues për të gjithë luginën e Matit. Ata kërkuan që administrate vendore të sigurojë një dokument ku ta paraqesë në këshillë. Gjithashtu në

Bashkinë e Matit gjenden dhe burime minerare si krom, kuarc dhe nikel. Në total janë 12 burime, nga të cilat janë në gjëndje pune 3 burime për shfrytëzimin e kromit dhe 2 burime për shfrytëzimin e kuarcit. Sipas VKM nr. 671 datë 29.07.2015 objektet industriale, ato të prodhimit, transmetimit e shpërndarjes së energjisë elektrike, përveçse kur është përcaktuar ndryshe në legjislacionin e posaçëm, kanë një gjerësi minimale të zonës mbrojtëse sanitare prej 50 m përgjatë gjithë vijës kufizuese të saj dhe një distancë minimale të mbrojtjes prej 200 m. Këto vlera rriten sipas llojit të objektit e tekonologjisë së përdorur, si dhe shkallës së ndotjes së zonës industriale gjatë projektimit të saj.

Figura 50: Rëndësia Kombëtare në territor, Bashkia Mat




**Burimi:** Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2016

- Konkluzione dhe Rekomandime

Bashkia Mat ka një sërë pontencialesh të rëndësisë së veçantë kombëtare të cilat gjenden brenda territorit të saj. Gjithësesi, këto elementë nuk shfrytëzohen në mënyrën e duhur për të rritur të ardhurat ekonomike të banorëve. Veçanërisht, monumentet e kulturës nuk kanë akses të mirëfilltë dhe i mungon promovimi. Gjithashtu, edhe potencialet natyrore nuk kanë një akses të mirë si dhe nuk kanë infrastruktura mbështetëse të cilat të lejojnë zhvillimin e turizmit.

Ndërkohë, përsa i përket shfrytëzimit të energjitikës, Bashkia Mat ka burime të shumta ujore të cilat mund të shfrytëzohen për hidrocentrale ashtu si sygjerohet në Planin e Përgjithshëm Kombëtar. Gjithësesi, këto hidrocentrale duhet të kenë kujdes të veçantë

përsa i përket dëmtimit të mjedisit dhe të ekosistemeve. Po ashtu, edhe përsa i përket mineraleve shfrytëzimi i tyre është i vogël dhe me teknologji të vjetëruara. Një potencial i madh që duhet të promovohet dhe shfrytëzohet më mirë nga bashkia për të rritur punësimin në këtë zonë është pikërisht ky sektor. Në këtë kontekst edhe shfrytëzimi i disa pjesëve të territorit për gurë dekorativë duhet të jetë një nga prioritetet e bashkisë.

## 1.7 Financat vendore

Për realizimin e kësaj analize u përdorën të dhëna nga portali për financat vendore[100] i cili ka për burim informacioni Sistemin e Menaxhimit të Informacionit Financiar të Qeverisë (Sistemi i Thesarit) pranë Ministrisë së Financave për periudhën 2010-2015 dhe Bashkia Mat për vlerat e planifikuara për vitin 2016. Të dhënat financiare janë të disponueshme në nivel ish-komune në monedhë vendase dhe për efekte analize u konsoliduan në nivel bashkie (Bashkia e re Mat).

Performanca e të ardhurave totale të Bashkisë Mat rezulton të ketë ndjekur një prirje përmirësuese deri në vitin 2014 dhe të jëtë përkeqësuar disi përgjatë dy viteve në vijim. Burimet financiare totale (transferta ndërqeveritar[101] dhe burime të veta vendore[102]) në dispozicion të Bashkisë së re të Mat janë luhatur në nivelin 540.6-737.6 milionë lekë në vit gjatë periudhës 2010-2016[103].

Figura 51: Buxheti total i Bashkisë Mat




**Burimi:** www.financatvendore.al

Kështu, në vitin 2013, të ardhurat e Bashkisë Mat u rritën me rreth 14.3% dhe 19.3% në vitet 2013 dhe 2014 respektivisht. Ecuria pozitive dhe në rritje e të ardhurave u frenua në vitin 2015, ku në total u shënua një ngushtim me rreth 9.6% e të ardhurave totale. Kjo tendencë pritet të vijojë edhe në vitin 2016, nisur nga të dhënat e buxhetit për vitin 2016 (këto janë të dhëna të planifikuara). Në terma sasiorë, buxheti i Bashkisë Mat vlerësohet të jetë rreth 663.1 milionë lekë, në rrënie me rreth 0.6% krahasur vlerën totale të të ardhurave të një viti më parë.

Tabela 41: Të ardhura sipas burimeve

| Në mijë lekë | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Të ardhura nga burime vendore | 84,881 | 93,752 | 90,529 | 109,25 9 | 128,01 9 | 160,97 2 | 146,09 5 |
| Të ardhura nga transferta ndërqeveritare | 626,91 5 | 467,75 2 | 450,13 9 | 508,98 2 | 609,63 0 | 505,89 5 | 517,01 5 |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Total | 711,796 | 561,504 | 540,668 | 618,241 | 737,648 | 666,867 | 663,110 |
| Pesha të kategorive ndaj totalit të të ardhurave (në %) | | | | | | | |
| Të ardhura nga burime vendore | 11.9% | 16.7% | 16.7% | 17.7% | 17.4% | 24.1% | 22.0% |
| Të ardhura nga transferta ndërqeveritare | 88.1% | 83.3% | 83.3% | 82.3% | 82.6% | 75.9% | 78.0% |

**Burimi:** www.financatvendore.al

Në linja të përgjithshme, përcaktues në performancën financiare të Bashkisë Mat rezultojnë të jenë të ardhurat nga transfertat ndërqeveritare. Ato përfaqësuan mesatarisht gjatë periudhës në analizë rreth 81.9% të të ardhurave totale. Ndërkohë, të ardhurat nga burimet e veta vendore kanë zënë një peshë të luhatshme nga viti në vit në totalin e të ardhurave të Bashkisë së re Mat (mesatarja për periudhën e konsideruar është rreth 18.1%). Niveli më i ulët u regjistrua në vitin 2010 (11.9%) ndërsa ai më i lartë në vitin 2015 (24.1%).

Figura 52: Kontributi i sipas kategorive në ecurinë e të ardhurave totale të Bashkisë Mat (në pikë përqindjeje) dhe ndryshimi vjetor i të ardhurave (në %)




**Burimi:** www.financatvendore.al dhe Bashkia Mat

Ndarja në të ardhura nga burime të veta vendore dhe nga transferta ndërqeveritare përdoret gjerësisht si një tregues i autonomisë financiare të njësive të qeverisjes vendore. Bazuar në të dhënat e ekspozuara në tabelën e mësipërme rezulton se, Bashkia Mat është e karakterizuar nga një nivel i ulët i autonomisë financiare. Ky rezultat vlen për të gjithë periudhën e marrë në analizë. Varësia financiare bën që projektet për investime kapitale të jenë subjekt pothuajse tërësisht i vendimeve të qeverisë qendrore. Përdorimi i instrumentit të huasë bankare mund të jetë një mënyrë për të rritur autonominë financiare dhe për të realizuar investime kapitale por, kosto në terma interesash dhe mundësia e ri-pagimit të kryegjësë nuk duhet të rëndojnë planet e ardhshme për investime kapitale të njësisë së qeverisjes vendore.

Në vijim të miratimit dhe implementimit të ligjit nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo – territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", Bashkia Mat rezultoi të jetë e formuar nga Bashkia Burrel dhe 7 ish – komuna. Në total janë 8 njësi administrative të cilat u shkrinë për të formuar një njësi të re administrativo-

territoriale, Bashkinë Mat. Ndonëse tashmë ligjërisht ato përfaqësojnë një njësi të vetme, njësitë mbartin një nivel heterogjeneiteti të konsiderueshëm, përfshi këtu dhe kapacitetin për të gjeneruar të ardhura. Në totalin e të ardhurave, peshën më të madhe e zënë të ardhurat e mbledhura në njësinë administrative Burrel, e cila në periudhën e konsideruar kontribuoi me rreth 53.0% në të ardhurat totale të Bashkisë Mat. Njësitë e tjera administrative përfaqësuan të gjitha sëbashku mesatarisht rreth 47% të të ardhurave totale.

Figura 53: Kontributi i njësive administrative në buxhetin e Bashkisë Mat




**Burimi:** www.financatvendore.al dhe Bashkia Mat

Në kontributin sipas njësive adminsitrative në totalin e të ardhurave vihet re që NjA. Burrel ka rritur kontributin e saj ndër vite, nga rreth 47.5% në vitin 2012 në rreth 77.7% në vitin 2015. Roli gjithnjë e më i ulët në gjenerimin e të ardhurave për njësitë adminsitrative të tjera shton vështirësitë për ofrimin e shërbimeve dhe infrastrukturës së nevojshme për komunitetin.

Figura 54: Kontributi i njësive administrative në buxhetin e Bashkisë Mat




**Burimi:** www.financatvendore.al dhe Bashkia Mat

Analiza strukturore e të ardhurave totale në dispozicion të bashkisë Mat, ashtu si dhe u theksua më lart rezulton të mbizotërohet nga fondet që qeveria qendrore i transferon pushtetit vendor në trajtën e transfertave të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara. Në total, për vitin 2015, Bashkia Mat përftoi rreth 517.1 milionë lekë nga transfertat ndërqeveritare, në rritje me rreth 2.2% në terma vjetorë. Brenda kategorisë së transfertave ndërqeveritare,

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

peshën kryesore e zënë të ardhurat nga transferta e kushtëzuar[104] (mesatarja e 5 viteve është 66.3%), pesha e së cilës ndaj totalit të të ardhurave ndërqeveritare rezulton të ketë ruajtur pothuajse të njëjtin nivel përgjatë periudhës në analizë. Pjesa më e madhe e transfertës së kushtëzuar vjen nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në trajtën e transfertës për buxhetet familjare dhe individët në nevojë. Të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar përfaqësuan mesatarisht rreth 32.2% të të ardhurave ndërqeveritare gjatë pesë viteve në analizë. Të ardhurat nga taksat e ndara rezultojnë në një nivel të ulët ndaj totalit të të ardhurave ndërqeveritare dhe të luhatshme përgjatë viteve 2010 - 2015 (mesatarisht përfaqësojnë rreth 1.5% të të ardhurave ndërqeveritare).

Performanca e të ardhurave nga burimet vendore rezulton të kenë qenë në përmirësim përgjatë periudhës së konsideruar. Megjithatë, në raport ndaj të ardhurave totale, të ardhurat nga burimet vendore janë të ulëta.

Në tre vitet e fundit, të ardhurat e veta të Bashkisë Mat u rritën mesatarisht me rreth 10.4% në terma vjetorë. Në vitin 2015 norma e rritjes së të ardhurave u ngadalësua në rreth 0.6% në terma vjetorë nga rreth 17.5% që ishte vitin e mëparshëm. Sipas kategorive përbërëse, niveli i të ardhurave vendore u përcaktua më së shumti prej performacës së të ardhurave nga taksat vendore. Kahu i zhvillimeve në të ardhurat nga taksat dhe tatimet për periudhën 2010-2015 duket të jetë përcaktuar nga luhatja (rritje apo rënie) në të ardhurat nga *taksa vendore mbi biznesin e vogël/tatim i thjeshtuar mbi fitimin dhe* të *ardhurat nga tatimi mbi ndërtesat* dhe *tokën bujqësore*. Ndër përbërësit e tjerë të klasifikuar si të ardhura vendore, tarifat vendore, janë elementi i dytë me peshën më të madhe në totalin e të ardhurave vendore (mesatarisht rreth 31% ndaj totalit të të ardhurave vendore në pesë vitet e fundit). Rritja progresive e të ardhurave nga tarifa e shërbimit kontribuoi pozitivisht në ecurinë e përgjithshme të të ardhurave nga tarifat vendore dhe të ardhurat vendore në total. Ndonëse me potencial, asetet në pronësi të bashkisë Mat (qera dhe/ose shitje) kontribuan vetëm me mesatarisht 9.2% të të ardhurave vendore gjatë periudhës së konsideruar.

Bazuar në nivelin e të ardhurave të gjeneruara nga burimet e veta vendore si dhe nga transfertat ndërqeveritare, Bashkia Mat shpenzoi mesatarisht rreth 16,427.0 lekë për banor përgjatë periudhës 2010-2015[105]. Në nivel njësie adminsitrative, shpenzimet mesatare për banor rezultojnë të kenë qenë mbi mesatren në bhësitë administrative Derjan dhe Macukull.

Shpërndarja e e shpenzimeve totale sipas njësive adminsitrative përbërëse tregon për një përqëndrim gjithnjë e në rritje të tyre në njësinë adminsitrative Burrel. Në terma mesatarë, në njësinë administrative Burrel u alokua rreth 45.7% e buxhetit total në dispozicion, vlerë kjo që për vitin 2015 shënoi 71.7%. Ndërkohë, pesha e shpenzimeve të alokuara nëpër njësitë e tjera adminsitrative rezulton të jetë tkurrje përgjatë periudhës së konsideruar.

Figura 55: Shpenzimet mesatre për banor përkundrejt mesatares së Bashkisë Mat




**Burimi:** www.financatvendore.al dhe Bashkia Mat

Figura 56: Shpenzime totale sipas njësive administrative




**Burimi:** www.financatvendore.al dhe Bashkia Mat

Struktura e shpenzimeve të Bashkisë Mat sipas klafikimit ekonomik rezulton të jetë e mbizotëruar nga shpenzimet korrente të cilat përfaqësuan mesatarisht rreth 76.3% të shpenzimeve totale gjatë përiudhës 2010-2015. Brenda kësaj kategorie, mesatarisht rreth 16.9% ndaj totalit përfaqësohet nga shpenzimet për paga dhe sigurime ndërsa rreth 59.4% nga shpenzimet e tjera operative. Këto dy kategori paraqesin elasticitet të ulët ndaj kufizimeve të mundshme buxhetore dhe në raste shkurtimesh të buxhetit, përgjithësisht janë shpenzimet kapitale ato që preken më shumë. Shpenziemt kapitale kanë përfaqësuar mesatarisht rreth 23.7% të shpenzimeve totale gjatë periudhës në analizë.

Tabela 42: Struktura e shpenzimeve sipas klasifikimit ekonomik

| | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Paga | 15.0% | 19.7% | 18.6% | 17.2% | 14.8% | 15.9% |
| Operative | 55.5% | 64.2% | 62.6% | 56.3% | 59.0% | 59.1% |
| Kapitale | 29.6% | 16.1% | 18.8% | 26.5% | 26.2% | 25.0% |

**Burimi:** www.financatvendore.al dhe Bashkia Mat

Në ndarjen e shpenzimeve sipas funksioneve, qëllimit të përdorimit të fondeve në dispozicion apo programeve buxhetore[106], struktura e shpenzimeve të bashkisë Mat rezulton të dominohet nga shpenzimet për funksionet e *"mbrojtjes sociale"*, *"shërbimet e përgjithshme publike"*, *"çështjet ekonomike"*, *"strehimi dhe komoditetet e komunitetit"*.

Figura 57: Shpenzimet totale sipas klasifikimit funksional




**Burimi:** www.financatvendore.al dhe Bashkia Mat

Në ndarjen sipas funksioneve, *"mbrojtja sociale"* rezulton programi në të cilin përthithet një pjesë e konsiderueshme e fondeve në dispozicion të Bashkisë Mat (mesatarja e periudhës 2010-2015 është rreth 44.7% ndaj totalit të shpenzimeve të kryera). Mbi 90% e fondeve të caktuara për mbrojtjen sociale (kryesisht *ndihmë ekonomike* dhe *pagesa për personat me aftësi të kufizuara*) vijnë nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në trajtën e transfertës së kushtëzuar (pra përdoren ekskluzivisht për destinacionin e dhënë). Programi buxhetor *"shërbime të përgjithshme publike"* përfaqësoi mesatarisht rreth 19.9% të shpenzimeve totale përgjatë periudhës 2010 - 2015. Brenda këtij programi, shpenzimet për administratën dhe institucioneve të varësisë të klasifikuara në zërim *"planifikim, menaxhim dhe administrim"* zënë peshën kryesore ndër vitet e konsideruar. Shpenzimet e destinuara për programin për *"çështjet ekonomike"* përfaqësuan mesatarisht rreth 17.1% ndaj totalit të shpenzimeve të kryera nga bashkia Mat për periudhën 2010-2015. Ndër vite shpenzimet në këtë program buxhetor kanë qenë të luhatshme dhe përfaqësohen më së shumti nga shpenzime kapitale për menaxhimin e transportit rrugor dhe përmirësimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit.

- Rekomandimi

Analiza historike e financave për Bashkinë Mat, evidenton karakteristika të rëndësishme përsa i përket kapaciteteve për gjenerim të ardhurash nga njëra anë dhe nevojave për shërbime dhe investime nga ana tjetër. Me zbatimin e reformës adminsitrative – territoriale, Bashkia Mat përballet me një sfidë tejet të madhe, ndoshta deri diku përtej kapaciteteve të saj. Në njësitë administrative diferencat zhvillimore dhe infrastrukturore janë të mëdha ndaj dhe nevojat për investime paraqiten të qenësishme. Bashkia Mat, nisur nga demografia e bizneseve dhe e familjeve nuk arrin t'i mbulojë këto nevoja vetëm

me burime vendore të ardhurash. Për më tepër që, njësitë administrative rezulton të kenë gjeneruar një nivel shumë të ulët të ardhurash në kohë dhe nuk vlerësohet që situata të këtë patur apo të ketë përimrësime në vijim. Planifikimi strategjik i investimeve kapitale në funksion të ofrimit dhe të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve publike në territoret në administrim rezulton i domosdoshëm dhe një parakusht për zhvillimin ekonomik vendor.

Ndaj, vlerësohet thelbësor fuqizimi dhe përmirësimi i performancës financiare në kahun e të ardhurave (veçanërisht rritja e bazës së tatueshme dhe tatimpaguesve) si dhe racionalizimi në kahun e shpenzimeve (kryesisht ato korente). Krahas burimeve të veta, përdorimi i instrumenteve financiarë si huaja nga sistemi bankar (në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi), fondet nga donatorët e huaj (apo vendas), apo edhe format e partneritetit publik-privat paraqesin një mundësi reale për realizimin e investimeve kapitale. Në këtë drejtim, vlerësohet e domosdoshme rritja e kapaciteteve të bashkisë në drejtim të hartimit, menaxhimit, zbatimit dhe monitorimit të projekteve të investimeve nëpërmjet këtyre formave të financimit.

1.8 Qeverisja dhe përgjegjësia sociale

- Decentralizimi i Qeverisjes dhe Strukturat Përkatëse

Më 29 Korrik 2015, Këshilli i Ministrave aprovoi Strategjinë Ndërsektoriale për Decentralizim dhe Qeverisje Vendore. Në këtë strategji prezantohet vizioni i Qeverisë Shqiptare për fuqizimin e demokracisë dhe avancimin e procesit të decentralizimit në përputhje me vizionin dhe objektivat e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim dhe standardet e Bashkimit Evropian (BE). Me tregues krahasimisht të ulët të decentralizimit fiskal në rajon (me vetëm 2.2% të PPB-së[107]), dhe efiçiencë, cilësi dhe standarde të dobëta në ofrim shërbimesh, kjo strategji, e parë në mënyrë holistike bashkë me reformën administrative territoriale dhe ligjin e ri organik për organizimin dhe funksionimin e qeverisë vendore[108], shihet si një hap përpara për qeverisjen vendore.

Një risi thelbësore e ligjit të ri organik për qeverisjen vendore është prezantimi i parimit të decentralizimit asimetrik bazuar në parimin e *subsidiaritetit*. Bashkitë me kapacitete njerëzore dhe financiare të përshtatshme kanë mundësi të kërkojnë decentralizimin e kompetencave të caktuara.

Më specifikisht, kjo strategji parashtron katër objektiva strategjikë:

- Përmirësimin e efiçiencës së përgjithshme të strukturave të qeverisë vendore – konsolidimi financiar dhe administrative i 61 bashkive pas adoptimit të ligjit të ri për ndarjen administrative territoriale; dhe mbështetje infrastrukturore dhe institucionale për 12 qarqet dhe 61 bashkitë e reja pas zgjedhjeve vendore të vitit 2015.
- Fuqizimi i financave vendore dhe rritja e autonomisë fiskale – që synon reformimin e sistemit të të ardhurave vendore dhe përmirësimin e manaxhimit të financave vendore.
- Mundësimi i zhvillimit të qendrueshëm lokal;
- Fuqizimi i qeverisjes së mirë në nivel lokal.

Pas miratimit të Ligjit nr. 115/2014, datë 31.07.2014 "Mbi ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", qeverisja vendore në Shqipëri është organizuar në dy nivele, ku *bashkia*, njësia bazë, përbën nivelin e parë të qeverisë, ndërsa *qarku* përbën nivelin e dytë. Në ndryshim nga 373 bashkitë e komunat përpara ndarjes territoriale, aktualisht ka 61 bashki, të cilat përbëhen nga njësi administrative, të organizuara në qytete dhe fshate. Ndarja në qarqe (12) mbetet në fuqi, ku çdo qark ka mesatarisht 5 bashki. Ndërsa funksionet dhe përgjegjësitë e bashkive janë rishikuar në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale të Decentralizimit dhe Qeverisjes Vendore, roli i qarkut mbetet ende i paqartë.

- Vështirësitë e Qeverisjes Vendore

Sfidat me të cilat përballen sot 61 bashkitë e krijuara nga ndarja e re administrative-territoriale janë njëherësh të trashëguara, por dhe të lidhura ngushtësisht me reformën territoriale[109], (konsolidim nga 373 në 61 NjQV[110]). Bashkia e Matit, e shtrirë në qendër të vendit, ka pësuar një rritje prej 3,900%, me një territor prej 493.5 $km^2$ në krahasim me shtrirjen 22.18 $km^2$ përpara reformës. Nisur nga burimet në dispozicion, dhe konteksti, disa nga vështirësitë më të mëdha të Bashkisë Mat mund të përmblidhen si më poshtë:

-*Territore të reja më të mëdha për planifikim, manaxhim dhe për administrim shërbimesh.* Me zgjerimin e territorit (e renditur e shtata në vend për nga madhësia), Bashkisë së Matit do t'i duhet të ofrojë shërbime për një popullsi rreth 1.8 herë më të madhe se më parë, (27,600 banorë në 8 njësi administrative, krahas qytetit të Matit). Në këto kushte, bashkia përballet me nevojën për planifikim urban e rural, shtimin e kërkesës për ofrim shërbimesh, rritjen e rrezes së ofrimit të tyre, si dhe diversifikimin e llojit të shërbimeve të ofruara për shkak të karakterit urban dhe rural dhe zgjerimit të kompetencave (pyjet, kullotat, rrjeti dytësor i kullimit e vaditjes, etj.).

- *Ndryshim, ose diversifikim i prioriteteve të zhvillimit.* Në kushtet e një territori të ri, me disa qendërsi urbane dhe karakter të theksuar malor, rishikimi i prioriteteve të zhvillimit ekonomik lokal është një hap urgjent për t`u ndërmarrë. Do të duhet që vizioni, objektivat, programet, projektet prioritare dhe të gjitha dokumentet e lidhura me zhvillimin (përdorimi i tokës, planit të infrastrukturës, rregulloret, etj.) të formulohen dhe të reflektojnë qartësisht karakteristikat e territorit të ri të bashkisë Mat.

- Mungesë kapacitetesh institucionale, përfshirë këtu administratën vendore, për të garantuar kryerjen e proceseve në mënyrë efektive dhe efiçiente. Cilësia dhe aftësimi i burimeve njerëzore të bashkisë mbetet sfidë, sidomos në kushtet ku stafi, veçanërisht ai teknik, do të duhet të kryejë procese të një natyre të diversifikuar dhe shkalle më të gjerë. Me një territor më të madh për të administruar, stafi duhet të aftësohet për të koordinuar veprimet për 8 njësitë përbërëse të bashkisë, përkatësisht: Burrel, Baz, Derjan, Ulëz, Komsi, Rukaj, Macukull, Lis. Mbështetja teknike dhe ngritja e kapaciteteve e deritanishme shpesh ka rezultuar me humbje për shkak të ndryshimit të stafit sipas ndryshimit politik në bashki. Funksionet dhe përgjegjësitë (ekzistuese e të reja) që i kalojnë bashkive në kuadër të strategjisë së decentralizimit dhe ligjit organik, parashtrojnë nevojën për ngritje të kapaciteteve institucionale me fokus në: administrimin e shërbimit përkatës, manaxhim të financave publike, statistikë, planifikim strategjik, shkrim dhe manaxhim projekti, qeverisje territoriale, etj. Adresimi i kësaj sfide shihet si

veçanërisht e lidhur me arritjen e përmirësimit të efiçiencës së përgjithshme të strukturës së bashkisë Mat.

- *Autonomia fiskale:* Zgjerimi i portofolit të kompetencave dhe përgjegjësive të bashkisë shoqërohet me sfidën e burimeve të pamjaftueshme. Mes transfertave të pakushtëzuara, të rezultuara si të ulëta, të paqëndrueshme dhe vazhdimisht në rënienë Bashkinë Mat për vitin 2014 (përpara reformës)[111], dhe të ardhurave të veta të bashkisë, do të duhet të përmbushen funksionet e veta dhe ato të përbashkëta. Kjo sfidë nënvizon dhe nevojën për të përmirësuar aftësinë për mbledhur të ardhurat veçanërisht nga taksat dhe tarifat, si psh. taksa e pronës, taksa e pastrim-gjelbërimit, etj.

- Sfida Mjedisore: Mungesa e një inventari të hollësishëm të territoreve dhe pikave burimore (brenda territorit të saj) me rrezik ndotjeje për tokën bujqësore, ajrin, akuiferet, etj., dhe për pasojë dhe mungesa e projekteve parandaluese dhe rehabilituese. Përtej hartimit të një inventari të plotë dhe projekteve parandaluese apo rehabilituese, do të duhet që njëkohësisht, Bashkia të bashkëpunojë me bashkitë e tjera dhe me institucionet qendrore të mjedisit dhe të burimeve natyrore për mbrojtjen e tyre nga ndotja e shkaktuar përtej kufijve të saj.

Vështirësi të tjera të bashkisë Mat përfshijnë: *paqartësi për sa i takon funksioneve dhe kompetencave të përbashkëta* pamundësi për t'u përfaqësuar nga një shoqatë bashkish e legjitimuar dhe pranuar nga të gjitha forcat politike, në procese konsultimi dhe dialogu në nivel qeverisje vendore, dhe sigurimi i përfaqësimit të popullsisë në procese të planifikimit dhe buxhetimit me pjesëmarrje (por jo vetëm).

- Perceptimet Qytetare në lidhje me qeverisjen e tyre vendore, format e organizimit komunitar dhe bashkësia e OJF-ve, instrumente të transparencës, etj.

Bashkia e Matit ka të paktën 5 organizata të rregjistruara të shoqërisë civile[112], që mbulojnë një spektër të gjerë çështjesh, përfshirë: të drejtat e fëmijëve, të drejtat e gruas, familje në varfëri ekstreme, njerëz më aftësi të kufizuara, etj.

Nisur nga studimet, rezulton që lidhja shoqëri civile/ institucione të tjera që operojnë në Bashki (kryesisht përpara reformës, por dhe gjatë 2014 e në vazhdim), të jetë krahasimisht e mirë. Megjithatë, sfida si mungesa e financimit nga pushteti vendor, ngritja e kapaciteteve të vetë OSHC -ve[113] dhe nevoja për asistencë teknike janë po aq prezente dhe në këto organizata. Disa nga format më të aplikuara të bashkëpunimit OSHC- Bashki, janë praktikat e buxhetimit me pjesëmarrje prej vitit 2005, dhe buxhetimit gjinor me pjesëmarrje prej vitit 2009, konsultimet në kuadër të hartimeve të dokumenteve strategjikë, etj.

Krahas përfaqësimit përmes aktiviteteve të OSHC-ve, pjesëmarrja dhe përfaqësimi i qytetarëve në bashkinë Mat sigurohet përmes mekanizmave të mbështetur në kuadër të Planit të Përgjithshëm Vendor, ku me marrjen e nismës, u konstituua më 1 Dhjetor 2016 Forumi Këshillmor Vendor. Ky grupim përbën "zemrën" e forumit këshillimor qytetar që Bashkia ka mundësuar të krijohet për të ndjekur dhe konsultuar procesin e hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të territorit të saj (forumi këshillimor është detyrim ligjor sipas rregullores së planifikimit të territorit, miratuar në vitin 2015 me VKM nr. 671).

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

1.9 Procese dhe dokumente planifikimi të hartuara më parë

- Plani i Përgjithshëm Kombëtar (PPK)

Plani i Përgjithshëm Kombëtar (PPK) "Shqipëria 2030", është instrumenti më i lartë i planifikimit territorial në Shqipëri i cili adreson në mënyrë të integruar çështjet e planifikimit, duke e parë territorin shqiptar si një të tërë.

Figura 58: Vizioni i Planit të Përgjithshëm Kombëtar



**Burimi**: Plani i Përgjithshëm Kombëtar, AKPT 2016

Vizioni për Shqipërinë:

"Shqipëria një qendër e integruar në sistemin ekonomik dhe infrastrukturor Europian, një ekonomi e shumëllojshme dhe konkuruese në hapsirën Ballkanike, një shtet që synon barazinë në akses, infrastrukturë, ekonomi dhe dije e cila siguron mbrojtje të trashëgimisë natyrore, historike dhe kulturore me synimin për t'u shndërruar në një destinacion autentik."

Në kuadër të sistemit natyror, PPK ofron gjithashtu direktiva edhe përsa i përket mbetjeve, ujit, pyjeve dhe ajrit si më poshtë:

Mbetjet

- Rritja e sasisë së mbetjeve që shkojnë në landfill në masën 45%;
- Riciklimi dhe kompostimi i mbetjeve urbane në masën 55 %;
- Zbatimi i planeve të rehabilitimit për 9 hospotet prioritare dhe hartimi i planeve për hotspotet e mbetura;

AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Uji

- Të realizohet mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së ujërave nëpërmjet zbatimit të Planeve të Menaxhimit të Burimeve Ujore brenda vitit 2020;
- Monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë së ujërave sipërfaqesore dhe nëntokësore nga institucionet përgjegjëse në bashkëpunim me MM;
- Rehabilitimi i shtretërve të dëmtuar të lumenjeve me 25 % deri në vitin 2020;
- Menaxhimi i ujërave sipërfaqesore dhe nëntokësore me qëllim reduktimin 95 % krahasuar me vitin 2011 të ndotjes së tyre.

Pyjet

- Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve pyjore dhe kullosore;
- Gjithëpërfshirja e aktorëve lokal në menaxhimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të këtij sektori;
- Vendosja e skemave për pagesa në ekosistem;
- Sigurimi i kuadrit rregullator, institucional dhe ekonomik për zbatimin e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve;
- Të arrihet transpozimi i plote i plotë (100 %) i legjislacionit europian, në fushën e pyjeve;
- Mbulimi 100% me plane mbarështrimi për të gjitha ekonomitë pyjore në nivel kombëtar
- Ulja me 40% të prerjeve të paligjshmeve të fondit pyjor;
- Rehabilitimi nëpërmjet pyllëzimit dhe ripyllëzim të sipërfaqeve të djegura si dhe rehabilitimin e kullotave me mbjellje foragjerë e drusore në masën deri 15 % të sipërfaqes pyjore dhe kullosore deri në vitin 2020;
- Parandalimit të gërryerjes se mëtejshme të tokës pyjore dhe kullosore në 25 % të sipërfaqes, deri në 2020.

Ajri

- Ulja me 40% e nivelit të ndotjes në zonat urbane;
- Arritja e niveleve të ndotësve të ajrit, bazuar në shëndetin human, në vlerat përkatëse: për NOx - 40 $\mu/ m^3$, për PM10 - 40 $\mu/ m^3$, për PM2,5-25 $\mu g/m^3$ dhe 20 $\mu g/m^3$ dhe $SO_2$-125 $\mu/m^3$ për 24 orë ose 20 $\mu/ m^3$ në vit.

Përsa i përket sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural, Plani i Përgjithshëm Kombëtar ka tre objektiva kryesore të shoqëruara me politika dhe direktiva të cilat kanë impakt edhe në Bashkinë Mat:

**Objektivi 1 - Eficiençë për një sektor bujqësor konkurues,** politikat që mbështet Plani Kombëtar në drejtim të sektorit bujqësor janë:

**Ruajtja** e tokës bujqësore, **Konsolidimi** i saj dhe **Modernizimi** i teknikave të punimit të tokës, dhe aktiviteteve të lidhura me sektorin bujqësor.

Për arritjen e objektivit të mësipërm janë parashikuar:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

- Ruajtja maksimale e fondit të tokës bujqësore, me anë të politikave të densifikimit të zhvillimit urban.
- Vendosja e një rrjeti të suksesshëm të zinxhirit ekonomik bujqësor: prodhimi-grumbullim- përpunim- eksportim, me qëllim rritjen e vlerës së zinxhirit ekonomik.
- Ulja e kostos dhe rritje e cilësisë nëpërmjet investimeve në teknologjinë e prodhimit për modernizimin e saj; investime në infrastrukturën e mirëmbajtjes, kanale ujitëse, vaditëse, hidrovore etj.
- Bujqësi – Turizëm - ku veçantia e sektorit turistik shqipëtar identifikohet edhe nga produktet bujqësore karakteristike në shije e cilësi.
- Bujqësi – Transport - infrastruktura e transportit i shërben rrjetit eficient të shpërndarjes dhe grumbullimit të prodhimeve bujqësore.
- Bujqësi – Energji - ku energjia e përdorur në përpunimin e produkteve bujqësore shkon drejt përdorimit të burimeve të rinovueshme.
- Krijimi i qendrave/poleve bujqësore dhe profilizimi i këtyre të fundit sipas karakteristikave të prodhimit bujqësor.

  PPK propozon krijimin e markave të produkteve karakteristike bujqësore shqipëtare "*Made in Albania*" ndër të cilat do të përfshihen produkte të cilat gjenden në territorin e Bashkisë Mat si: bimët Mjekësore, Vreshtaria, Gështenjat, Produktet bujqësore e blegtorale të përpunuara.

**Objektivi 2- Zhvillimi i Poleve Bujqësore / Agro-Përpunim**

Këto qëndra bujqësore rekomandohen minimalisht të përmbushin shërbimet e mëposhtme:

- Ofrimin e hapësirave të mjaftueshme depozitimi për të përballuar sasinë e prodhimit bujqësor në stinët përkatëse.
- Sigurimin e kushteve dhe teknologjive përkatëse për agro-përpunimin e produkteve bujqësore duke mundësuar procesin e kontrollimit të cilësisë së ushqimit sipas standarteve të Bashkimit Europian.
- Sigurimin e teknologjive të avancuara në fushën e kërkimit dhe të zhvillimit të farave dhe fidaneve me qëllim zhvillimin e sektorit bujqësor në ritmet e Bashkimit Europian.
- Sigurimin e teknologjisë dhe të personave të specializuar në fushën e marketingut të produktit bujqësor.

**Objektiva 3 –Bio-Bujqësia / Bujqësia Organike**

Bujqësia organike në vendin tonë, falë kushteve klimatike, gjeomorfologjisë së tokës bujqësore si dhe njohurive tradicionale të fermerëve vendas posedon avantazhe shumë të favorshme për t'u zgjeruar dhe rritur akoma më shumë si nëndegë e sektorit të bujqësise. Tregu mesdhetar dhe ai Europian për shkak të zhvillimit të turizmit kulinar dhe elitare shfaq tendenca pozitive në konsumimin gjithmonë e më tepër të produkteve bio-organike.

Plani i Përgjithshëm Kombëtar, e sheh Bashkinë Mat si pjesë e ***polit të specializuar ekonomik Dibër – Mat – Bulqizë.***

Figura 59: Rajoni i Specializuar Dibër-Mat- Bulqizë



**Burimi:** Plani i Përgjithshëm Kombëtar, AKPT 2016

Vlerat e specializimit të këtij rajoni qëndrojnë në ***nxjerrjen dhe përpunimin e pasurive minerareve***, si dhe në zhvillimin e industrisë dhe teknologjisë përpunuese të minerareve. Ky rajon ka edhe vlera komplekse të tilla si ato të turizmit malor, natyror dhe atij balnear. Për sa i përket sistemit urban, qendrat e këtij rajoni janë kategorizuar si më poshtë:

- Bashkia **Dibër** si qendër primare
- Bashkia **Bulqizë** si qendër sekondare
- Bashkitë **Mat** dhe **Klos** si qendra terciare

Rajoni përshkohet nga korridori kryesor kombëtar, ai i Rrugës së Arbërit, që lidh Shqipërinë me Maqedoninë, si dhe nga akse të tjera interurbane që lidhin qendrat e këtij rajoni me zonat përreth si Tiranën, Kukësin dhe Librazhin. Rajoni është i pasur nga ana hidrike. Brenda këtij rajoni përfshihen tre hidrocentrale kryesore, si ai i Lurës, Ulzës dhe i Lapaj. Me rëndësi per furnizimin me energji elektrike jo vetëm per rajonin, por edhe me gjëre, paraqet ndërtimi hidrocentralit të Skavicës.

Për sa i përket pasurive minerare, rajoni dallohet për rezervat e kromit në pjesën lindore dhe jugore të tij, si dhe disa pasurive jometalore. Në zonën e Bulqizës ndodhen tre miniera kromi, kurse në zonën e Karmës ndodhet miniera e Bakrit dhe fabrika e pasurimit të Kromit në bashkinë e Matit.

Liqenet akullnajore të Lurës, Luzni Bulac, Bjeshkët e Oroshit, liqeni i Ulzës dhe Brezi Korab-Koritnik janë të shpallura si zona të mbrojtura. Në këtë brez zonash të mbrojtura ndodhen edhe dy parqe kombëtare, ai i Lurës dhe i Zall – Gjocës që dallohen për peisazhet piktoreske.

Rajoni dallohet për një terren të përshtatshëm për zhvillimin e turizmit të tillë si:

- liqenor - përgjatë liqeneve të Lurës, Kacnicës, Ulzës, liqenit të Balgjajt dhe atij të Zi;
- ekoturizmi - peizazhet piktoreske të Parqeve Kombëtare, Fusha e Pelave, dhe ushqimet tradicionale të zonës së Matit me bazë mishi dhe Jufkat;
- natyror - ujëvarat e zonës dhe peisazhet panoramike;

- kulturor - kullat e Matit dhe urat veneciane, kështjellat e Shkopetit, Petralbës, varret arkeologjike të qytetërime ilire, si dhe ura e Vashës në Klos;

Figura 60: Rajoni i Specializuar Mat, Bulqizë, Dibër



**Burimi**: Plani i Përgjithshëm Kombëtar, AKPT 2016

- Strategjia e Zhvillimit Rajonal Qarku Dibër 2012-2016

Vizioni i Strategjisë së Zhvillimit Rajonal për Rajonin e Dibrës është "Kthimi i Rajonit të Dibrës në një rajon ku individët dhe bizneset të jenë të aftë dhe të suksesshëm, të përfitojnë nga burimet natyrore dhe të zhvillohen ekonomikisht duke siguruar një jetë cilësore për vete dhe familjet e tyre". Një nga objektivat strategjike fokusohet tek zhvillimi i turizmit në rajon. Objektiva strategjike 2 thekson "të zgjerojë pjesën prodhuese të ekonomisë rajonale, veçanërisht në fushat ku mund të gjenerohen të ardhura siç janë agro-biznesi, turizmi, energjia elektrike, etj., duke siguruar shërbimet bazë për bizneset dhe krijimin e një klime miqësore për ta". Në kuadrin e kësaj objektive, janë identifikuar masat specifike lidhur me zhvillimin e turizmit, të cilat përfshijnë:

- Krijimi i një zinxhiri/rrjeti të bizneseve për sigurimin e shërbimeve turistike (ose të një grupi biznesesh nëpërmjet promovimit të vendosjes së etiketave,kategorive dhe pajisjeve që kontribuojnë në zgjerimin e zonave , shërbimeve dhe qëllimeve).
- Zhvillimi, të paktën, i një produkti të ri ku të përfshihet potenciali i turizmit rajonal (ujrat termale, alpinizmi, turizmi kulturor, etj).
- Rritja e kapacitetit të pronarëve të bizneseve lidhur me shërbimet turistike për vizitorët (akomodimi, ushqimi, argëtimi).

- Zhvillimi i materialeve promocionale lidhur me potencialin e turizmit rajonal.
- Zhvillimi i produktit turistik bazuar në trashëgiminë kulturore (kishat, manastiret, traditat, etj.)
- Nxitja e prodhimit të suvenireve tradicioanale origjinale.
- Zhvillimi dhe zbatimi i projekteve të përbashkëta rajonale lidhur me shenjat dhe shtigjet turistike si dhe çiklizmin malor ose rrugëve për ngjitje në male.

- Plani i Menaxhimit të Basenit të Matit (2010)

Programi i masave në planin e menaxhimit të pellgut të një lumi është përgjithësisht një çështje kryesore, perderisa masat që do të duhet te përshkruhen janë ato që nevojiten për arritjen e situate të mire ekologjike në përputhje me tëresine e objektivave të legjislacionit dhe objektivave të përcaktuara për rezervat ujore dhe zonat e mbrojtura. Disa nga veprimet më urgjente themelore që do të ndermerren si pjesë e përgatitjes së planeve të ardhshme të menaxhimit e në përputhje me DKU kërkojnë:

- rritje në aktivitetet për monitorimin e përgjithshem të ujit dhe shpërndarjen e burimeve monetare për të rritur kapacitetin e analizimit dhe akreditimin e laboratorëve.
- krijimin e monitorimit ekologjike siç nevojitet për përputhjen me DKU.
- identifikimin formale dhe karakterizimin e rezervave ujore (ndjekje të procedurave siç u përshkruan në këtë plan pilot), duke përfshirë përcaktimin e situatës ekologjike të ujërave sipërfaqësore dhe situatën kimike dhe sasior të rezervave ujore nëntokësore.
- Vlerësimin e rrezikut të rrjedhave te ujit nga pellgjet ujëmbajtëse në zonën bregdetare dhe vende të tjera ku situata sasior e ujërave nëntokësore mund të jetë në rrezik.

Bazuar në problemet specifike të hasura gjatë përgatitjes së këtij plani mund të përcaktohet një listë e përgjithshme e masave të propozuara si më poshtë:

| Kategoria | Masat |
|---|---|
| Ligjore dhe institucionale | Rregullimi i kufijëve te Basenit Mat duke përfshirë edhe Rrethet Kurbin dhe Lezhë |
| | Rregullimi i kufijtë te dixhitalizuar midis Qarqeve, Komunave dhe Bashkive |
| | Delegimi i pergjegjesive të qartë dhe shperndarja e burimeve te nevojshme financiare për të Autoritetit Lumore në Lezhë |
| | Te sqarojë përgjegjësitë ndërmjet Prefekturës, Qarqeve, Komunave dhe Kompanive të ujesjellesit |
| | Ndërmarrja e trajnimit për menaxhimin e basenit lumor për Autoriteti Lumor Lezhë dhe të tjerët. |
| Ekonomike | Riorganizimin e ndërmarrjeve të ujesjellesit në njësi kryesore |
| | Rishikimi i tarifave ndertimore për shërbimet e ujesjellesit |
| | Te vlerësojë kufijtë e kapacitetit të financimit ne të ardhmen për shërbimet e ujesjellesit në Basenin e Matit. |
| Teknike | Te përshkruaj dhe të karakterizoje të gjitha rezervat sipërfaqsore ujore dhe rezervat e<br>ujërave nëntokësore |
| | Te ofroje parametrat kufitare te vlerave te situates sasiore, kimike dhe |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT SEKRETARIA TIRANË

| | |
|---|---|
| | ekologjike për të gjitha llojet e rezervave ujore |
| | Të vazhdojë monitorimin dhe mbikqyrjen sic është përshkruara në këtë plan |
| | Të nxisë programe hulumtuese të monitorimit hetues përshkruhet në këtë plan për të gjitha llojet e rezervave ujore qe mendohet të jenë në rrezik të mosperputhjes me situaten e mire ekologjike |
| | Pas dy viteve të monitorimit hulumtues te ri-vlerësoj të gjitha hipotezat mbi rreziqet e mos arritjes së situates së mirë të ujit në rezervat ujore |
| | Të nxisë programe hulumtuese të monitorimit për zonat e nxehta sic përshkruhen në këtë plan |
| | Pas dy viteve të monitorimit hulumtues te rivleresojë të gjitha hipotezat e ndikimeve prej ketyre pikave te nxehta |
| | Bazuar në informacionet e reja nga monitorimet mbikqyrese dhe hulumtuese gjatë një periudhe dy vjecare të bëjë analizën e rrezikshmerise në të gjitha rezervat ujore |
| | Të ofrojë një serie të re të masave që kerkohen për arritjen e situates së mirë të ujit në rezervat ujore. |

- Plani Rregullues i Burrelit (viti 1989)

Ky plan rregullues parashikonte një rikonceptim të qytetit ekzistues duke i dhënë proritet zhvillimit infrastrukturor dhe lidhjes së të gjitha zonave të banimit me një sistem të pasur rrugor i cili konturohej me ***unazën e madhe të qytetit***. Ky i fundit projekt i cili ka mbetur i papërfunduar edhe sot. Ky plan gjithashtu parashikon dhe shtim të sipërfaqeve të gjelbërta, krahas asaj ekzistuese të parkut mbretëresha Geraldinë, dhe zonën Jugore (sot kjo zonë ka marrë një karakter urban, e dëndësuar me ndërtesa të pas viteve 90' në tipologjinë e vilave në periferinë e saj). Ndër të tjera ky projekt parashikon zonën e stadiumit të qytetit si dhe riorganizim të zonës industriale të SMT.

- Studim mbi "Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Burrel" (2013)

Ky studim u hartua nga Bashkia Burrel në bashkëpunim me Universitetin POLIS në vitin 2013.

"Burreli një qytet me rrënjë të forta historike dhe tradite, njihet si qyteti i prejardhjes së Mbretit Zog. Burreli dhe Tirana të konceptuar dhe të projektuar pothuajse në të njejtën kohë ndajnë sëbashku shumë elementë hapesirë-formues, si nga pikëpamja e organizimit të tyre, me dy akset kryesore që luajnë rolin e kardo-dekumanus-it romak, por dhe në raportin që të dy këto qytete kanë në lidhje me marrëdhënien e hapësirës urbane me elementët natyrorë. Burreli qëndron në një plato – pjatë e cila formohet nga marrëdhenia e terrenit me lumin. Lum i cili për Burrelin qëndron si vektori kryesor i gjenerimit të qytetit ashtu siç dhe lumi i Lanës është elementi ndarës, por dhe lidhës direkt i kryeqytetit të Shqipërisë.

Edhe pse Tirana si kryeqytet ka një lidhje direkte me qytetin port të Durresit ashtu dhe vetë Burreli është konceptuar në lidhje direkte me Durrësin si vazhdim i bulevardit kryesor të tij. Nga ky aspekt Burreli edhe përse nuk ka përfituar direkt nga strukturat infrastrukturore të këtyre 30 viteve të fundit. Ai mbart elementë të rëndësishëm natyrorë dhe administrativ në rrethin e Matit si nga pikëpamja e vendodhjes strategjike, por dhe nga aspekti i burimeve që ai zotëron. Duke marrë parasysh dhe planet për infrastrukturën e re rajonale kombëtare që do zbatohet vitet në vijim me rrugën e Arbërit, por dhe

propozime të tjera që vijojnë nga përmbushja e vizionit të Mbretit Zog, Burreli mund të kthehet nga një fuqi në heshtje në një protagonist të rrethit të Matit, por dhe të Shqipërisë së Mesme/Veriore"

Figura 61: Vizioni i Bashkisë Burrel, Studim 2014




**Burimi**: Bashkia Mat dhe Universiteti POLIS, 2014

Ky vizion bazohej në disa koncepte zhvillimi si:

- Burreli si qyteti i Turizmit alternativ.
- Burreli si pol i ri shërbimesh.
- Burreli si një qytet social.
- Burreli si një qytet këmbësor dhe i gjelbër.
- Burreli si një qytet miqësor ndaj mjedisit.

- Strategjia e Zhvillimit të Qëndrueshëm Burrel 2012-2030

Ky plan strategjik është vizualizimi në letër dhe në projekt i vizionit për Burrelin. Drejtimet kryesore që plani strategjik paraqet janë:

- Korniza për të zhvilluar qytetin për të përmbushur nevojat dhe aspiratat e qytetarëve tanë dhe brezave që do të vijnë për mirëqenie e siguri në një mjedis të gjelbëruar e modern.
- Për të rigjallëruar origjinën e trashëgiminë e mbretit të Shqiptarëve.
- Për të shprehur solidaritet dhe progres për komunitetin.
- Për dinamizëm ekonomik dhe partneritet jetik me sipërmarrjet.
- Për të arritur një ekuilibër mes vizionit frymëzues dhe realizimit të zbatimit të saktë.
- Kuadri i qartë na jep besimin për të shkuar përpara dhe për të bërë kaq shumë për fëmijët tanë që të ndjehemi krenarë për perspektivën që i krijojmë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
SEKRETARIA
TIRANË

- Për të promovuar turizmin dhe kthimin në një destinacion të pëlqyeshëm për këdo që e viziton.
- Për të ndryshuar mendësinë dhe për t'u ofruar më shumë shanse të rinjve të kontribuojnë për administratën publike.
- Për të promovuar profesionalizmin dhe rritjen e kapaciteteve me një stil jetese të shëndetshëm dhe që ofron mundësi integrimi në epokën e internetit dhe të medias sociale, pavarësisht vendndodhjes.
- Për një jetë të shëndetshme dhe kuptimplotë.

Vizioni i Burrelit 2030:

"Burreli qendër e rëndësishme e kulturës Iliro-Arbërore, qytet mbretëror, me zhvillim të qëndrueshëm e rritje ekonomike konkurruese, që nxit punësimin dhe ngjall interesin e të rinjve, qytet i gjelbëruar me infrastrukturë urbane moderne, ku zhvillimi dhe integrimi i barabartë i njerëzve dhe komuniteteve nxit harmoninë, solidaritetin dhe progresin".

Qëllimet e komunitetit të Burrelit

- ***Zhvillimi i Ekonomisë*** - Qytet me rritje ekonomike që siguron mirëqenie, mundësi të barabarta sipërmarrjeje dhe promovim të aftësive të të rinjve, qendër agropërpunimi të produkteve rajonale, që mbështet artizanatin, turizmin dhe inkurajon biznesin modern e të rrjetëzuar në një mjedis me konkurrencë të ndershme.
- ***Urbanistika, Infrastruktura*** - Qytet me zhvillim të ekulibruar dhe të integruar të territorit, që garanton lidhje të shpejta drejt poleve ekonomike rajonale dhe hapësirave urbane të mirë-shpërndara, me infrastrukturë e shërbime moderne e mjedisore për komunitetet, bizneset e vizitorët, të cilët shijojnë një qytet të bukur e në harmoni me natyrën dhe tiparet arkitekturore të trashëguara.
- ***Zhvillimi Njerëzor, Cilësia e Jetës*** - Komunitet me jetë cilësore e dinamike, që integron dhe harmonizon nevojat e pritshmëritë e të gjitha grup-moshave, me njerëz që aftësohen për t'i kontribuar zhvillimit dhe inovacionit, me komunitete që ruajnë e përçojnë vlerat tek të rinjtë, e ku bashkëpunimi rrit prurjet dhe shanset e përparimit për të gjithë.
- ***Mjedisi*** - Qytet miqësor me mjedisin, i gjelbër e i pastër, ku mbrohet e pasurohet natyra dhe ekosistemet në funksion të jetës së shëndetshme.
- ***Kultura*** - Ruajtja dhe zhvillimi i identitetit të qytetit, i zakoneve e traditave të trevës matjane si pasuri shpirtërore që përçon vlerat e trashëgimisë etnokulturore në qytet dhe në mjediset e tjera kulturore e turistike, dhe avancimi i kulturës bashkëkohore në jetën e komunitetit.

- Dokumente planifikimi të hartuar në nivel njësie administrative (ish Komuna)

Gjatë viteve të fundit janë hartuar gjithashtu dokumente planifikimi edhe për njësitë administrative (ish Komunat), Rukaj, Macukull, Baz, Ulëz, Komsi dhe Derjan.

- **Plani Strategjik i Zhvillimit i Nj. A. Rukaj,** i hartuar nga Komuna me mbështetjen e Qarkut Dibër, për vitin 2014 propozon:

Sigurimin e zhvillimit ekonomik lokal përmes zhvillimit të blegtorisë dhe bujqësisë, si dhe menaxhimit të mirë të burimeve natyrore, hidrike dhe turistike. Përmirësimi dhe ngritja e një infrastrukture të përshtatshme dhe funksionale. Sigurimi i një zhvillimi të kënaqshëm social, me kushte të mira për arsimin, shëndetësinë dhe kulturën. Fuqizimi i qeverisjes së mirë lokale, e aftë që t'u përgjigjet kërkesave të zhvillimit dhe të komunitetit me cilësi, profesionalizëm dhe transparencë.

- **Vizioni i Nj.A. Macukull** për vitin 2014, nga Plani Strategjik i Zhvillimit i hartuar në bashkëpunim me Qarkun Dibër është:

Njësia Macukull një zonë me rrugë të rregulluara, ujësjellës, energji elektrike. Me shkolla dhe shërbim shëndetësor që plotëson kërkesat e banorëve të Macukullit, me pyjet e mbrojtura dhe të gjeneruara me pyje të rinj. Me një njësi administrative e qeverisur mirë. Një krahinë ku njerëzit janë krenarë për Macukullin, për bukurinë, historinë, traditën dhe ku mund të jetojnë me ajrin e pastër, bukuritë e saj në mirëqenie me të ardhurat që do vijnë nga Turizmi dhe pasuritë e tjera natyrore.

- **Plani i Zhvillimit Lokal i hartuar nga Nj.A. Ulëz** në bashkëpunim me Qarkun Dibër, për vitin 2014. Propozon investime në infrastruktura publike (rrjeti rrugor, institucione arsimore, kulturore) për zhvillimin ekonomik, social dhe turistik.
- **Plani i Zhvillimit Lokal i hartuar nga Nj.A. Komsi** në bashkëpunim me Qarkun Dibër, për vitin 2014 trajton me prioritet: Zhvillimin Ekonomik; Zhvillimin e Infrastrukturës dhe Shërbimeve; Zhvillimin Social dhe Qeverisjen e Mirë.
- Objektivat e përcaktuar në Planin Strategjik të Zhvillimit Nj.A. Derjan, për vitin 2014 janë:

Sigurimi i zhvillimit ekonomik lokal përmes zhvillimit të blegtorisë dhe buqjësisë, si dhe menaxhimit të mirë të burimeve natyrore minerale, hidrike dhe turistike. Përmirësimi dhe ngritja e një infrastrukture të përshtatshme dhe funksionale për komunitetin e Derjanit. Sigurimi i një zhvillimi të kënaqshëm social, me kushte të mira për arsimin, shëndetësinë, dhe kulturën. Fuqizimi i qeverisjes së mirë lokale, e aftë që t'u përgjigjet kërkesave të zhvillimit dhe të komunitetit me cilësi, profesionalizëm dhe transparencë.

- **Plani i Zhvillimit Lokal i hartuar nga Nj.A. Baz** në bashkëpunim me Qarkun Dibër, për vitin 2014 propozon: Fuqizimi i qeverisjes së mirë lokale dhe shtimi i projekteve dhe aktiviteteve në dobi të qytetarëve të njësisë. Sigurimi i zhvillimit ekonomik lokal përmes zhvillimit të bujqësisë, blektorisë, turizmit lokal, menaxhimit të mirë të burimeve natyrore dhe biznesit. Përmirësimi dhe ngritja e një infastrukture të re dhe funksionale. Sigurimi i një zhvillimi të kënaqshëm social, me kushte të mira për arsimin, shëndetësinë, kulturën, sportin etj

- Konkluzione dhe rekomandime

Bazuar në analizën e planeve ekzistuese të niveleve kombëtare, rajonale (qarku dibër) dhe planeve historike të hartuara për Burrelin dallohet qartë një konvergjence midis politikave dhe objektivave të këtyre planeve në sektorë specifikë. Si të tillë mund të

REPUBLIKA E SHQIPERISE AGJENCIA E ZHVILLIMIT TE TERRITORIT TIRANE SEKRETARIA

thuhet se disa nga prioritetet kryesore të cilat rrjedhin nga kjo analizë për Bashkinë Mat janë:

- Përmirësimi i aksesueshmërisë në nivel rajonal e kombëtar të Bashkisë Mat.
- Fokusimi ekonomik në bujqësi, veçanërisht tek produktet BIO dhe përmirësimi i infrastrukturës mbështetëse për zhvillimin e sektorit.
- Bazuar në PPK një fokus të veçantë ekonomik duhet të ketë dhe energjitika. Në këtë kontekst shihen me prioritet hidrocentralet dhe shfrytëzimi i minerareve. Gjithësesi, ky sektor duhet të jetë i kujdesshëm në lidhje me mosdëmtimin e mjedisit.
- Përmirësimi i ndjeshëm i cilësisë së zhvillimit urban.
- Fokus në eko-turizëm dhe në turizmin rural, malor.
- Fokus në mbrojtjen e burimeve natyrore.

## 1.10 Mbi drejtimin e zhvillimit

### 1.10.1 Koncepti Rajonal i Zhvillimit

Krahina e Matit nga ana etnografike përbën një unitet më vete me karakteristikat përkatëse që e dallojnë nga krahinat e tjera të Shqipërisë, si në dialektin e të folurës, në veshjet popullore, në zakone në mënyrën e ndërtimit të banesave etj.[114] Krahina e Matit është një muze i vërtetë arkeologjik dhe djep i lashtë i kulturës ilire. Kultura tumulare e varreve në Mat përfshin periudhat e bronxit të mesëm e deri në shekujt e parë të erës tonë. Kultura ilire e Matit arriti nivele më të larta me krijimin e qytezave ilire siç ishte ajo e Xibrit.

Figura 62: Zhvillimi historik i vendbanimeve ne Rajon



**Burimi**: MetroPOLIS, 2016

Mendohet, që Krahina e Matit është dhe zanafilla e shtetit të Arbrit. Në shekullin e XI, emri arbër, arbëreshë filloi të përmendet jo vetëm brenda por edhe jashtë vendit, ndërsa shkrimtarja Ana Komnena i përcakton afërsisht kufijtë gjeografikë të Arbërisë si më poshtë: një territor që shtrihet midis Durrësit e Drinit. Mati është padyshim vendbanimi më i rëndësishëm i principatës së Kastrijotëve. Mati (në 1923) bënte pjesë në nënprefekturën e Dibrës.

Për të hartuar një vizion zhvillimi për territorin e bashkisë, nevojitet koncepti i zhvillimit të rajonit në të cilin ndodhet Mati. Arsyet për këtë renditen si më poshtë:

- Mati nuk funksion si një ishull, por si pjesë përbërëse e rajonit të cilit i përket. Ekonomia e Matit dhe pozicionimi i saj në rajon varen nga ekonomitë rrethuese dhe marrëdhënia plotësuese-konkurruese e Lushnjës me këto ekonomi;
- Territori vendor kufizohet nga infrastruktura dhe akse e korridore rrugore, të cilat kanë rëndësi kombëtare dhe/ose rajonale. Çdo vendim për territorin vendor ndikohet nga këto akse e korridore. Një pjesë e mirë e tyre merren të gatshme nga studime dhe projekte e plane kombëtare (si p.sh. Plani i Përgjithshëm Kombëtar i territorit, planet sektoriale për transportin, energjinë, etj.), por një pjesë janë subjekt propozimi;
- Plani i Përgjithshëm Kombëtar i territorit si dhe disa plane sektoriale përcaktojnë vendime që prekin drejtpërdrejt ose jo edhe territorin e bashkisë së Matit dhe çdo vendim të PPV-së së Mat;

Sipas Planit të Përgjithshëm Kombëtar të territorit, rajoni në të cilin bën pjesë Mati ka një karakter zhvillimi që bazohet në kombinimin mes Industrisë, Ekonomive Bujqësore (prodhuese dhe përpunuese), ekonomisë së turizmit (ende në hapat e parë) dhe funksioneve urbane. Sigurimi i balancës mes këtyre ekonomive përbën sfidë për vizionin e ardhshëm të zhvillimit urban e rural të territorit të Matit. Faktikisht, për mënyrën se si janë zhvilluar deri më sot, këto ekonomi kanë prodhuar më së shumti konflikte mbi burimet se sa harmoni dhe bashkëjetesë. Është detyrë e konceptit të vizionit të zhvillimit të territorit që të propozojë se si mund të garantohet balanca mes tyre.

REPUBLIKA E SHQIPERISE AGJENCIA E ZHVILLIMIT TE TERRITORIT TIRANE SEKRETARIA

Figura 63: Prashikime të Planeve ne nivel Kombetar




**Burimi:** Planet Kombëtare dhe studimi i Policentrizmit, **Përpunoi:** MetroPOLIS, 2016

Turizmi mund të marrë forma të ndryshme në këtë rajon, që variojnë nga turizmi liqenor, në atë ekologjik, natyror, bujqësor, malor dhe historik/kulturor. Kjo larmi mbështetet nga burimet natyrore dhe nga konteksti historik i zhvillimit.

Aktualisht potenciali turistik përfaqësohet nga rrjeti i zonave të mbrojtura natyrore, zona liqenore (Ulëza) dhe malore, vendbanime me zona historike (Macukull, Derjan,Rukaj), qendra kryesore me larmi funksionesh (Burreli), një tërësi monumentesh kulture dhe monumentesh natyrore të shpërndara në territor, si dhe vendbanime rurale në funksion të turizmit:

- Liqeni i Ulëzës dhe i Shkopetit

Parqe kombëtare[115]:

- Parku Kombëtar i Qafë Shtamës
- Parku Kombëtar i Zall Gjoçaj
- Parku Kombëtar i Ulëzës

Monumente natyrore[116]:

- Guri i Gjatë (Derjan)
- Kepi i Skëndërbeut Varosh (Macukull)
- Kanioni i Urakës (Derjan)
- Rrapi i Marqethit (Lis)
- Lisi i Qershizës (Ulëz)
- Maja e Boshtrës (Macukull)
- Gurri i Vashës (Macukull)
- Lisi i Tushës (Komsi)

- Kanioni i Filmit (Derjan)
- Tisat e Mbasdejës (Lis)
- Burimi i Shutrresë (Rukaj)
- Lisi i Qafë Shënkollit (Derjan)
- Lisi Macukull (Macukull)
- Lisi te Varret e Shqypit (Derjan)
- Lisi i Kodrës (Derjan)
- Lisi i Teqesë së Domit (Komsi)

Nga leximi i shpërndarjes së potencialeve turistike (të kombinuara me format e tjera të zhvillimit ekonomik, veçanërisht bujqësia), vihet re presioni që shkakton ndotja e mjedisit mbi një pjesë të mirë të këtyre potencialeve dhe territoreve rreth tyre. Kështu, nisur nga analizat e cilësisë së ujërave sipërfaqësore për Matin, kemi evidentuar zonat ku shtrihet ndikimi i ndotjes së lumit, sipas pikave kryesore burim ndotjeje në territor.

Sipas këtij leximi, në basenin e Matit, zona me presion të lartë të ndotjes nis që në qytetin e Bulqizës dhe vjen duke u intesifikuar deri në derdhje, me pika të nxehta në Klos dhe Burrel. Në basenin e Matit pika e parë e nxehtë evidentohet në qytetin e Bulqizës, ku janë të përqëndruara një numër i madh i aktiviteteve të shfrytëzimit minerar të cilat shkarkojnë ujërat e ndotura industriale në ujërat sipërfaqësore, për t`u intesifikuar në NjA Komsi ku përroi i Gostimës merr me vete edhe ndotjen e shkaktuar nga Uzina e Pasurimit të Ferrokromit. Si rezultat i ndotjes së lumit dhe ndikimit të zonave industriale, rrezikohen tokat bujqësore në të dy anët e Lumit të Matit, në zonën fushore të Bashkisë Mat.

Së fundi, edhe pse një skenar i largët, një nga problemet me të cilat mund të përballet rajoni është përmbytja si rezultat i ndryshimeve klimatike. Shenjat e para të përmbytjeve kanë filluar të vihen re dhe në ditët e sotme. Përmirësimi i cilësisë së pyjeve, shtimi i sipërfaqeve pyjore, do të ndihmonin në uljen e rrezikut ndaj përmbytjeve dhe parandalimin e tyre në të ardhmen.

Analiza e mësipërme parashtron disa çështje me rëndësi për vizionin e ardhshëm të zhvillimit të rajonit dhe sigurisht edhe të bashkisë:

- Çfarë karakteri do të kenë qendërsitë urbane të niveleve të ndryshme në bashki?
- Cili është rrjeti i lëvizjes që i shërben më mirë bashkisë nga pikëpamja e zhvillimit dhe lidhshmërisë dhe cila është hierarkia e tij?
- Çfarë karakteri do të kenë korridoret e lëvizjes dhe cilat janë zonat e fashat e zhvillimit territorial në bashki?
- Cili është vizioni për mbarështimin e zonave të mbrojtura natyrore?
- Çfarë masash do të merren për të ndaluar çlirimin e mëtejshëm të ndotjes nga burimet përkatëse dhe depërtimin e saj në territor, veçanërisht në zonat më të rrezikuara, dhe si përkthehen këto masa në vizionin e zhvillimit të rajonit?
- Cili është pozicionimi midis tre ekonomive të zhvillimit: bujqësore, të turizmit dhe të industrisë dhe si lidhet ky pozicion me vendimmarrjen për zgjerimin e fushës së shfrytëzimit të nxjerrjes së mineraleve dhe ndërtimit të HEC-eve të vogla përgjatë rrjedhave lumore?

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT SEKRETARIA TIRANË

Koncepti i zhvillimit të Matit bazohet mbi adresimin e çështjeve të mësipërme. Ky koncept nuk mund të zgjidhë sfidën e balancës midis tre ekonomive pa një vendimmarrje kombëtare. Megjithatë, duke iu referuar edhe PPK-së, koncepti i vizionit rajonal ndërtohet si më poshtë:

i) I gjithë territori shtrihet në basenin e rëndësishëm të Lumit të Matit, ku (historikisht) lumi, si shtylla kurrizore e basenit, ka formuluar marrëdhënien e njeriut/vendbanimeve me natyrën. Pavarsisht se zhvillimet infrastrukturore kanë thyer disa nga pengesat natyrore, me qëllim krijimin e lidhjeve më të shpejta me Tiranën, Bashkia Mat funksionon si një organizëm i vetëm me Bashkinë Klos (kjo edhe për arsyen se historikisht këto dy bashki janë konceptuar si pjesë e pandarë e tyre, pjesë e Rrethit të Matit).

ii) **Rajoni kufizohet nga një rrjet kombëtar rrugësh.** Korridoret në të cilat rezulton ky rrjet **lidhin qendrat kryesore urbane të pjesës Veriore të Shqipërisë, thyejnë pengesat natyrore** ose shfrytëzojnë terrenin/topografinë dhe **formëzojnë karakterin ekonomik dhe të përdorimit të tokës në rajonin Verior.** ***Korridori Blu***, vendos në një aks të shpejtë të gjitha qendrat kryesore të pjesës perëndimore të Shqipërisë dke nisur nga Shkodra, Lezha, Kruja, Durrësi e më tej në Lushnje, Fier, Gjirokastër. Në mënyrë tangenciale me përmirësimin e cilësisë së aksit Krujë-Burrel, bashkia e Matit do të ketë mundësinë e krijimit të një lidhje më të shpejtë me këtë korridor. E ashtuquajtura ***"Rruga e Kombit"***, është dhe aksi më i rëndësishëm jo vetëm për Rajonin por dhe për Bashkinë e Matit veçanërisht. 2 rrugët interurbane ajo e Shkopetit dhe Burrel-Rrëshen, lidhen drjetëpërdrejtë me këtë aks, duke shkurtuar në këtë mënyrë ndjeshëm kohën e udhëtimit nga qendra e Bashkisë deri në lidhjen me Tiranën, Kukësin, e më tej deri në Kosovë. ***Rruga e Arbrit***, nuk krijon lidhje të drejtëpërdrejtë me asnjë nga territoret e Bashkisë së Matit. Megjithëse kjo rrugë impakton në mënyrë të drejtëpërdrejt Bashkinë e Klosit, duke shkurtuar ndjeshëm kohën e udhëtimit dhe duke afruar lidhjen me kryeqytetin, në të njëjtën kohë duke ringjallur dhe gjurmët historike, për nga afërsia që Bashkia e Matit (dhe veçanërisht qendra e saj Burreli), ka me Bashkinë e Klosit, përfundimi me sukses i këtij aksi do të ketë një impakt të qënësishëm në zhvillimin e Rajonit (Klos-Burrel-Bulqizë). Së fundmi, Bashkia e Matit, do të kufizohet (ende një projekt-ide) nga ***Unaza Lindore*** e cila do të krijojë lidhje më të shpejta më të sigurta dhe më të drejtëpërdrejta nga Kukësi drejt Dibrës (ku lidhet më pas edhe me Bashkinë e Matit) e vijon deri në Librazh, Pogradec e deri në një lidhje të mundshme me Maqedoninë.

Figura 64: Sistemi Natyror dhe Baseni i Matit




**Burimi:** Agjensia e Baseneve Ujore, **Përpunoi:** MetroPOLIS, 2016

iii) Lidhja mes qendrave të banuara brenda Bashkisë së Matit bëhet e mundur vetëm nëpërmjet dy akseve rajonale të Shkopetit dhe Burrel-Rëshenit, nga të cilat dalin lidhje të rëndësishme infrastrukturore për të krijuar një rrjet orbitaleshën që lidhin të gjitha vendbanimet e Rrethit të Matit (e parë kjo në një sistem ku Klosi është pjesë e pandashme).

iv) **Itinerarct alternative natyrore/bujqësore/turistike janë zemra e profilit ekonomik të rajonit.** Këto itinerare nuk kanë për qëllim aksesin e shpejtë, por përkundrazi synojnë të **mbërthejnë banorët dhe vizitorët brenda rajonit, të rritin kohën e ndërveprimit të tyre me vlerat natyrore e historike të tij e të fuqizojnë rrjedhshmërinë e aktivitetit bujqësor brenda rajonit.**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TE TERRITORIT
TIRANE
SEKRETARIA

Figura 65: Skema e Korridoreve




**Burimi:** MetroPOLIS, 2016

v) **Një rrjet i pasur zonash të mbrojtura natyrore** (një pjesë e të cilave ndodhen brenda Brezit të Gjelbër Evropian) mbështjellin si kurorë të gjithë rajonin, duke shërbyer edhe si kufizuesit natyrorë të tij. Zonat fillojnë në veri nga Parku Kombëtar i Ulëzës, në Lindje me Parkun Kombëtar të Qafë-Shtamës, dhe kufizohet në krahun tjetër në VeriLindje me Parkun Kombëtar të Zallit të Gjoçajve dhe Liqenet e mrekullueshme të Lurës. Brenda rajoni ndodhen edhe një sërë zonash natyrore të mbrojtura (më të vogla në sipërfaqe se kurora mbështjellëse) si dhe qendërsi urbane me vlera historike e kulturore dhe monumente kulture. Për t'iu përgjigjur nevojës që ka Shqipëria për të rritur sipërfaqen e mbrojtur natyrore, në këtë rajon **fuqizohet lugina e Matit, ndërsa zonave të mbrojtura aktuale u shtohen edhe sipërfaqet e identifikuara rreth tyre si zonat Emerald.**

vi) **Ruajtja e aseteve natyrore të rajonit në funksion të qëndrueshmërisë së zhvillimit aftësisë vetë-ripërtëritëse** është një nga objektivat kryesore të këtij koncepti rajonal të zhvillimit.

vii) **Rritja inteligjente e zonës urbane dhe e qyteteve si motori i ekonomisë urbane** është një nga shtyllat e zhvillimit të qëndrueshëm të rajonit. **Qendrat urbane rigjenerohen dhe rizhvillohen** përmes projektesh që kanë në thelb: densifikimin përmes **mbushjes urbane**; krijimit të **rrjetit arterial të lëvizjes urbane; mbrojtjes së hapësirës natyrore e bujqësore rrethqytetëse**; krijimit të **zonave të shtrirjes së qytetit në 15-20 vitet** e ardhshme mbi bazën e projektimeve realiste të popullsisë dhe të bollshme për të lejuar zhvillime infrastrukturore e për të shmangur zhvillime të pakontrolluara dhe spekuluese mbi tregun e tokës.

Figura 66: Sistemi Urban dhe Infrastrukturor




**Burimi:** MetroPOLIS, 2016

Nga pikëpamja ekonomike qendrat urbane dhe vendbanimet kanë potencialin e krijimit të një rrjeti i cili do të funksionojë mbi parimin e plotësueshmërisë dhe konkurueshmërisë. Burreli evidentohet në këtë kuadro si qendra e "madhe" urbane me karakter shumëfunksional, të ngjashëm me qendrat e Bashkive të mëdha në Rajon, si Lezha, Peshkopia, Shkodra etj. Ndonëse në mungesë të presionit të zhvillimit urban dhe ekonomik, qendra si Burreli orientohen përgjithësisht drejt densifikimit dhe zgjerimit, ku qytetarët plotësojnë të gjitha nevojat për shërbime (banim, arsim, kulturë, turizëm, industri, shëndetësi, etj.). Njësitë e tjera administrative të Bashkisë së Madhe të Matit **janë qendra me karakter të shumëfishtë**, që lëviz nga prioriteti për zhvillimin e **industrisë, tek turizmi dhe bujqësia**.

Figura 67: Mbivendosja e Analizave



**Burimi:** MetroPOLIS, 2016

Duke ndjekur sa territorin bujqësor dhe atë natyror, një rrjet qendërsish (rurale) synon të specializohet në ekonomi rurale të mbështetura mbi **(eko/agro)turizmin dhe më pak bujqësinë si bazë për zhvillimin rural të këtyre njësive amdinistrative (Ulëz, Macukull, Derjan).**

Këto qendërsi janë porta hyrëse për parqet kombëtare (zonat e mbrojtura), dhe luginën e Lumit të Matit, ku janë përqëndruar edhe të gjithë vendbanimet.

viii) **Industria** zë një vend të rëndësishëm në ekonominë e rajonit dhe bashkëjeton me funksionet e tjera të tij. **Balanca mes industrisë, bujqësisë dhe vlerave natyrore të rajonit është e një rëndësie jetësore për garantimin e aftësive vetëripërtëritëse të tij.** Fasha me gravitet ekonomik industrial ndodhet në pjesën jugore-lindore të sistemit kryesor bujqësor (me fokus industrinë e nxjerrjes dhe përpunimit të mineraleve). Këto territore janë pastruar nga ndotjet industriale të trashëguara nga e kaluara dhe janë në funksion të industrive prodhuese e përpunuese, me teknologji të pastër. Një shembull konkret për këtë është dhe industria e Ferro-Kromit në njesinë administrative Komsi.

## 1.10.2 Analiza SWOT

### Pika të Forta

- Mati shtrihet në një pozicion të favorshëm gjeografik pranë qëndrës së rëndësishme të zhvillimit, metropolit Tiranë-Durrës
- Nga pikëpamja demografike ka një popullatë relativisht të re në moshë pune duke përbërë në këtë mënyrë një potëncial për zhvillimin e mëtejshëm ekonomik

[stamp]

- Bashkia ndodhet ka në territorin e saj një mori pikash të forta turistike, sikurse dhe afërsi me parqe të rëndësishme Kombëtare si ai i Lurës dhe Qafë-Shtamës
- Klima mesdhetare kontinentale, me 1000 orë diell në vit
- Kostoja e ulët e çmimit të tokës
- Ekzistenca e bimëve mjekësore në territor i cili përbën një potencial ekonomik të konsiderueshëm për banorët lokal
- Burimet ujore të bollshme të cilat ofrojnë zhvillim bujqësorë dhe potencial për zhvillimin e turistik peisazhistik si dhe lidhja e forte me tregjet e Bashkise Klos
- Parku Geraldine, historiku, dhe rendesia nga pikepamja e mbartjes se bimeve te rralla
- Vlera historike kulturore të pasura dhe trashëgimia shumë e hershme
- Pasuritë minerare me krom që mund të shfrytëzohen
- Produket blegtorale dhe bujqësore BIO
- Rritja e interesit të investitorëve për të investuar në turizmin malor

Pikat të Dobëta

- Mungesa e Planit të Përgjithshëm Vendor
- Mosfunksionimi i zonës industriale me mjediset dhe objektet e saj për zhvillimin e biznesit të qytetit (ish SMT)
- Mungesa e promovimit dhe marketimit të resurseve natyrore si potencial në zhvillimin ekonomik
- Mungesa e investimeve të huaja të pakta
- Nivel i ultë i punësimit
- Interes i ulët i të rinjëve të arsimuar për tu kthyer në Mat
- Ndërtime të paformalizuara
- Mungesa e specialistëve teknik Vështirësi për nevojat e bizneseve
- Sektorët si shitja me pakicë dhe ai minerar kanë rënie më të madhe dhe në përgjithësi ekonomia vendore është në rënie
- Shërbime mbështetëse të dobët për biznesin
- Mungesa e kredive me interesa të arsyeshme
- Bizneset jo të mirë informuar mbi zyrën e zhvillimit në bashki dhe ofertat zhvillimore
- Kërkesa shpesh të paparashikuara nga zyrtarët vendorë ndaj biznesit
- Mungesa e shoqatave të biznesit që mbështesin zhvillimin dhe diversfikimin e biznesit
- Mungesa e shkollave profesionale
- Cilësia e arsimit para-universitar në rënie
- Mungesa e specialistëve të nevojshëm në sektorin e shëndetësisë
- Niveli i lartë i varfërisë i cili ndikon në mungesën e investimeve për banesa sociale
- Infrastruktura rrugore e qytetit, veçanërisht në periferi, jo e mire, disa lagje pa infrastrukturë rrugore

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANE SEKRETARIA

- Mungesa e planit të menaxhimit mjedisor con në mos njohjen e problematikave mjedisore dhe përshkallëzimin e efekteve negative në territor, të cilat në faza të vonshme kanë kosto të lartë rehabilitimi
- Ndotja e Lumit Mat
- Infrastruktura e ujësjellësit është e amortizuar dhe nuk mbulon të gjithë sipërfaqen e territory me shërbim
- Ujërat e ndotura urbane nuk trajtohen dhe pjesa më e madhe e territorit janë pa sistem kanalizimi (funksionojnë me gropa septike)
- Mungesa e kanalizimeve për ujërat e shiut në zonat urbane
- Infrastrukturë e dobët për menaxhimin e mbetjeve dhe mos-përpunimi
- Mungesa e aktiviteteve të pakta për argëtim
- Promovim dhe përdorim i pakët i vlerave kulturore dhe të trashëgimisë në funksion të zhvillimit

Mundësitë

- Nxitja e punësimit me anë të mbështetjes për sektorët potencialë, si bujqësia, industria e agro-përpunimit, pylltaria dhe turizmi
- Ndërtimi i rrugës së Arbrit dhe investimet e tjera të ndihmojnë në zhvillimin hapësinor dhe përdorimin e zones
- Administrim më i mirë territorial nëpërmjet hartimit te strategjive dhe programeve ne nivel qarku për të siguruar një zhvillim të balancuar midis zonave urbane dhe rurale
- Burime blegtorale në njësitë administrative
- Burimet ujore të shumta si pika turistike të favorshme
- Ferma bujqësore në njësitë administrative të bashkisë që kanë potencialet të furnizojnë bizneset prodhuese dhe tregtuese në qytet
- Bizneset e shohin potencialin turistik të zonës përreth si mundësi për zgjeruar apo diversifikuar biznesin
- Ndërtimi i Rrugës së Arbërit
- Subvencionet qeveritare për bujqësinë në rritje
- Intelektualët Burrelas që jetojnë jashtë Burrelit, kryesisht në Tiranë, sigurojnë dije dhe rrjetëzim për zhvillimin e bashkisë
- Fonde për projekte mjedisore dhe infrastrukturore nga agjencitë qeveritare dhe donator
- Potenciali i madh i trashëgimisë natyrore dhe promovimi i tyre ne harmoni me trashëgiminë kulturore
- Bukurite natyrore, pyjet, liqenet, malet, livadhet, fshatrat, favorizojnë dhe janë një mundësi e mirë për zhvillimin e Turizmit me turistë vendas dhe të huaj.
- Pasuri të shumta pyjore, dhe rritja e shpejtë e pyjeve të reja janë një mundësi e mirë për sigurimin e të ardhurave nga vetë banorët, si me lëndë drusore dhe me prodhimet e dyta të pyllit, si bimë medicinale dhe të tjera

- Pasuritë ujore, janë një mundësi e mirë për ndërtimin e hidrocentraleve të vegjël, që shtojnë të ardhurat në komunë, rritin punësimin dhe sigurojnë energji për zonën.
- Shtimi i krerëve të bagëtisë dhe rritja e prodhimit blegtoral, krijon mundësinë e profilizimit të fermave të vogla dhe rritjen e të ardhurave nga banorët e

Kërcënimet

- Mungesa e politikave të qarta të zhvillimit të shoqëruar me mungesën e investimeve ka rezultuar në emigrim të madh
- një shpopullim i përgjithshëm dhe migrimi rural-urban brenda qarkut
- Rënie e remitancave ne qytet
- Cilësia e mjerueshme e rrugës nacionale me Tiranën
- Ulja e remitancave
- Financim i pakët e qeverisë qendrore ndaj qeverisë Bashkiake, klasifikim i bashkisë si fushore
- Kreditim në ulje, interesi bankar i lartë
- Kriza globale ndikon negativisht investimet e huaja dhe remitanca
- Ulja e nivelit të arsimit
- Akses i vështirë në njësitë administrative për shkak të infrastrukturës së dobët rrugore
- Cilësia e dobët e rrugës nacionale me Tiranën
- Mungesa e planeve turistike dhe evidentimin e të gjithë objekteve kulturore në rreth
- Mungesa e bashkëpunimit ndërbashkiak per maksimizimin e potencialeve te trashëgimisë kulturore ne funksion te zhvillimit te turizmit

### 1.10.3 Rekomandime per Planin

Bazuar në analizën e planeve ekzistuese të niveleve kombëtare, rajonale (qarku dibër) dhe planeve historike të hartuara për Burrelin dallohet qartë një konvergjence midis politikave dhe objektivave të këtyre planeve në sektorë specifikë. Si të tillë mund të thuhet se disa nga prioritetet kryesore të cilat rrjedhin nga kjo analizë për Bashkinë Mat janë:

- Përmirësimi i aksesueshëmrisë në nivel rajonal e kombëtar të bashkisë Mat
- Fokus ekonomik në bujqësi, veçanërisht tek produktet BIO dhe përmirësimi i infrastrukturës mbështetëse për zhvillimin e sektorit
- Bazuar në PPK një fokus të veçantë ekonomik duhet të ketë dhe energjitika. Në këtë kontekst shihen me prioritet hidrocentralet dhe shfrytëzimi i minerareve. Gjithësesi, ky sektor duhet të jetë i kujdesshëm në lidhje me mosdëmtimin e mjedisit.
- Përmirësimi i ndjeshëm i cilësisë së zhvillimit urban
- Fokus në eko-turizëm dhe në turizmin rural, malor
- Fokus në mbrojtjen e burimeve natyrore

Bashkia Mat ka një sërë pontencialesh të rëndësisë së veçantë kombëtare të cilat gjenden brenda territorit të saj. Gjithësesi, këto elementë nuk shfrytëzohen në mënyrën e duhur për të rritur të ardhurat ekonomike të banorëve. Veçanërisht, monumentet e kulturës nuk kanë akses të mirëfilltë dhe i mungon promovimi duke sjellë një mundësi të humbur përsa i përket shfrytëzimit të tyre për vizita nga turistë të shumtë. Gjithashtu, edhe potencialet natyrore nuk kanë një akses të mirë si dhe nuk kanë infrastruktura mbështetëse të cilat të lejojnë zhvillimin e turizmit.

Ndërkohë, përsa i përket shfrytëzimit të energjitikës, Bashkia Mat ka burime të shumta ujore të cilat mund të shfrytëzohen për hidrocentrale ashtu siç sygjerohet në Planin e Përgjithshëm Kombëtar. Gjithësesi, këto hidrocentrale duhet të kenë kujdes të veçantë përsa i përket dëmtimit të mjedisit dhe të ekosistemeve. Po ashtu, edhe përsa i përket mineraleve shfrytëzimi i tyre është i vogël dhe me teknologji të vjetëruara. Një potencial i madhe që duhet të promovohet dhe shfrytëzohet më mirë nga bashkia për të rritur punësimin në këtë zonë. Në këtë kontekst edhe shfrytëzimi i disa pjesëve të territorit për gurrë dekorativë duhet të jetë një nga prioritetet e bashkisë

Sistemi Urban në Bashkinë Mat përbëhet nga Qyteti i Burrelit, Qyteza e Ulzës dhe fshatra fushore, kodrinore e malore. Në përgjithësi kemi të bëjmë me një sistem i cili ka mungesa të theksuara përsa i përket infrastrukturës mbështetëse dhe infrastrukturave sociale. Gjatë viteve të fundit vërehet një tendencë për shpërhapjen e këtij sistemi në territor edhe si rrjedhojë e zhvillimeve informale. Përsa i përket cilësisë së strukturave të sistemit urban mund të thuhet se ka disa problematika veçanërisht për ndërtesat e para viteve 1990. Gjithashtu, edhe nga pikëpamja e efiçiencës energjitike pothuajse të gjitha strukturat nuk janë brenda standarteve. Për përmirësimin e situatës së sistemit urban rekomandohet:

- Konsolidim i zonave të urbanizuara
- Përmirësimi i hapësirave sociale si sheshe, lulishte, objekte social kulturore etj
- Përmirësim i cilësisë së godinave për të arritur standartet e efiçiencës energjitike
- Përmirësim i rrjetit rrugor urban
- Rritje e hapësirave të gjelbërta
- Kufizim i shpërhapjes së zonave urbane në tokat bujqësore dhe natyrore

Sistemi Infrastrukturor është në një gjendje relativisht të dobët në dallime me sistemet e tjera. Infrastruktura rrugore e rëndësisë kombëtare është shumë e pakët dhe duhet të shihen mundësitë për lidhje më të mira e të shpejta me rrugët e rëndësisë kombëtare:

- Burrel- Rrëshen
- Burrel- Ulëz- Milot
- Burrel – Rruga e Arbërit

Gjithashtu, rrjeti rrugor i brendshëm i bashkisë është i dobët. Probleme në akses nga qëndra e Bashkisë Mat (Burreli) me njësitë administrative janë të dukshme veçanërisht për njësitë administrative Derjan, Rukaj dhe Macukull. Ndërkohë në njësitë e tjera administrative, qëndrat e tyre janë të mirëaksesuara, por mungojnë lidhjet e mira dhe aksesi i fshatrave të tjerë me këto zona.

Infrastruktura e furnizimit me ujë të pishëm dhe e kanalizimeve sërish ka nevojë për përmirësimi. Duhen mbuluar me sistem furnizimi me ujë fshatrat e njësive administrative si dhe për qytetin e Burrelit është e rëndësishme që të ngrihet një sistem për trajtimin e ujërave të zeza. Ndërkohë në njësitë administrative të tjera, përsa i përket trajtimit të ujërave të zeza duhet modernizuar sistemi i trajtimit të tyre me gropa septike për të mos shkaktuar dëme mjedisore.

Përsa i përket energjisë elektrike është e nevojshme përmirësimi i infrastrukturës së amortizuar veçanërisht për njësitë administrative malore si Macukull, Derjan dhe Rukaj. Ndërkohë, duhet shtuar dhe një nënstacion elektrik për qytetin e Burrelit.

Bashkia Mat ka sipërfaqe të konsiderueshme tokash bujqësore. Klima e favorshme lejon rritjen e një sërë kulturash si perimet, vreshtat, frutorët etj. Sipërfaqja mesatare e fermave është 1.29ha një sipërfaqe e vogël dhe e krahasueshme me atë në nivel kombëtar. Sipërfaqja e vogël dhe fragmentimi i tokës bujqësore rritin kostot e prodhimit të fermerëve çka ul konkurueshmërinë e produkteve në treg.

Një tjetër problematikë e sistemit bujqësor është dhe gjendja e kanaleve vaditëse e kulluese. Shumë prej tyre janë të amortizuar dhe në nevojë për investime. Gjithashtu në disa zona si në Komsi, Baz e Lis është e nevojshme edhe ndërtimi i disa kanaleve të reja për vaditje. Edhe pse Mati ka pasuri të shumta ujore, paradoksi i mungesës së ujit për furnizimin e tokava bujqësore duhet të gjejë një zgjidhje shumë shpejt.

Bashkia Mat ka një sërë problematikash sociale dhe ekonomike të cilat duhet të adresohen në strategji dhe në Planin e Përgjithshëm Vendor. Bashkia Mat është përballur me një megrim mjaft të madh të popullsisë pas viteve 1990. Kryesisht migrimi ka qënë i drejtuar jashtë vendit dhe drejt qëndrave Tiranë-Durrës. Gjithashtu, një tjetër formë migrimi ka qënë nga zonat rurale në drejtim të qytetit të Burrelit. Është e nevojshme që në përballje me sfidat e mëdha sociale të merren masa për:

- Përmirësimin e cilësisë së shkolla
- Përfshirjen e rinisë në jetën ekonomike e sociale
- Përmirësimin e infrastrukturave sociale
- Rritjen e stokut të banesave sociale
- Zhvillimin e aktiviteteve social kulturore

Përsa i përket zhvillimit ekonomik mund të thuhet se është e nevojshme që ekonomia të ketë një diversifikim më të madh. Potencial shumë i madh për zhvillimin ekonomik të Matit është zhvillimi i turizmit shumëdimensional duke shfrytëzuar pasuritë natyrore, kulturore e territoriale që ofron Mat. Gjithashtu, prioritet mbeten bujqësia e blegtoria si sektorë kryesore. Edhe në këtë rast kemi të bëjmë me një potencial të madh ku mungojnë infrastrukturat mbështetëse:

- Përmirësimi i kanaleve të vaditjes dhe zgjirimi i rrjetit të tyre
- Konsolidimi i tokave bujqësore
- Hapësira të reja për tregje e pika grumbullimit
- Agro-përpunimi

Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar edhe shfrytëzimit të kujdesshëm të burimeve natyrore për qëllime industrial. Një potencial shumë i madh në bashkinë Mat por që duhet shfrytëzuar duke pasur në vëmendje të veçantë mbrojtjen e mjedisit.

Mbështetur në analizat e kryera më sipër dhe identfikimin e pikave të forta, të dobëta, kërcënimeve dhe mundësive rekomandimet për Bashkinë Mat klasifikohen si më poshtë:

Territori dhe Mjedisi

- Promovimi i peizazhit, terrenit malor dhe monumenteve të kulturës me qëllim nxitjen e turizmit në këto zona.
- Kultivimi i bimëve mjekësore në territorin e Bashkisë si potencial i konsiderueshëm i vetëpunësimit për banorët lokalë.
- Vënia në përdorim e potencialit të lartë të prodhimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale si element i rëndësishëm i ekonomisë së Bashkisë.
- Planifikimi I projekteve me përparësi rehabilitimin e lumit Mat së bashku me projekte me Bashkitë e tjera që preken nga Baseni I Matit për manaxhimin e integruar të këtij baseni.
- Ndërmarrja e projekteve që synojnë uljen e ndotjes në lumë si projekte për parandalimin e derdhjes së ujërave të ndotur në lumë, të mbetjeve indutriale dhe të gjitha aktivitetet që ndikojnë në ndotjen e ujërave të tij.

Përdorimi i tokës dhe Infrastrukturave

- Përmirësimi i infrastrukturës së ujësjellësit e cila është e amortizuar dhe zgjerimi i saj në gjithë territorin.
- Rehabilitimi i infrastrukturës bujqësore dhe specifikisht ndërhyrje fizike në sistemin ujërave të ndotur të cilat janë të patrajtuar dhe zgjerimin e tij në gjithë territorin.
- Për shkak të mungesës së rrjetit infrastrukturor rekomandohet sigurimi i fondeve për përmirësimin e infrastrukturës rrugore brenda territorit të Bashkisë e cila konsiston në shtimin e sipërfaqeve të shturara rrugore në zonat e pa aksesueshme.
- Permiresimi i cilesise fizike te infrastruktures rrugore, dhe hapjen e akseve te reja, me qellim lehtesimin e aksesueshmerise ne te gjithe territorin e bashkise.

Zhvillimi Ekonomik dhe Mirëqënja sociale

- Nxitja për krijimin e shoqatave të fermerëve me qëllim nxitjen e bashkëpunimit dhe partneriteteve për ekonomizimin e tokës bujqësore dhe për mundësi të reja të tregtimit të tyre.
- Përmirësimi i kushteve fizike të objekteve ambulancave dhe qendrave shëndetësore si dhe optimizimi i shërbimit që ofrojnë.
- Rekomandohet krijimi i hapërsirave të dedikuara për aktivitete argëtimi.
- Nxitja e krijimit të fermave bujqësore në njësitë administrative të Bashkisë që kanë potencial të furnizojnë bizneset prodhuese dhe tregtuese në qytet.
- Ulja e shkallës së papunësisë duke hapur vende të reja pune.

- Hapja e shkollave profesionale të orjetuara drejt,turizmit, agroturizmit, bujqësisë, blegtorisë etj,. Me qëllim profilizimin dhe rritjen e standarteve arsimore.

Qeverisje dhe Financat Vendore

- Nxitja e bashkëpunimit ndërbshkiak për maksimizimin e potencialeve të trashëgimisë kulturore në funksion të zhvillimit të turizmit si element të rëndësishëm të ekonomisë ne Bashki.
- Thithja e fondeve për projekte mjedisore dhe infrastrukturore nga agjencitë qeveritare dhe donatorë të ndryshëm.

## II. Një vizion për Matin

Vizioni i zhvillimit të Bashkisë Mat ka ardhur si rezultat gjetjeve të analizës së territorit të harmonizuara me mendimet dhe idetë e qytetarëve në takimet dhe dëgjesat publike të zhvilluara gjatë procesit të hartimit të këtij dokumenti. Idetë e ardhura nga diskutimet me grupet e interesit dhe janë integruar në këtë vizion. E rëndësishme është të evidentohet fakti që, vizioni i zhvillimit të Matit mbështetet në parashikimet e Planit të Përgjithshëm Kombëtar të hartuar nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe Agjencia Kombëtare e Territorit në . Zhvillimi i Matit për 15 vitet e ardhme është si mëposhtë:

"Bashkia Mat, synon harmonizimin e zhvillimit ekonomik, infrastrukturor dhe hapësinor nëpërmjet ***mbrojtjes së burimeve natyrore, promovimi i vlerave kulturore dhe historike, zhvillimin bujqësor***, blektoral, ***promovimin e ekoturizmit*** dhe ***fuqizimin e rolit*** të saj ***në rajon*** mbështetur në ***potencialet minerare dhe hidrike*** të saj. Zhvillimi i mëtejshëm i Matit do të ndikojë në ***zbutjen e pabarazive*** sociale dhe promovimin e zhvillimit intelektual të shoqërisë. Mbi këto themele të qëndrueshme, ndërtojmë përfitimet e shoqërisë së sotme dhe garantojmë që komuniteti të trashëgojë në brezat e ardhshëm një ***territor dhe mjedis të shëndetshëm***, të vetëripërsëritshëm krahas një ***zhvillimi ekonomik dhe social të qëndrueshëm***"

Figura 68: Harta e Vizionit të ardhshëm në Bashkinë Mat




**Burimi:** Bashkia Mat dhe Metro POLIS, 2017

2.1 Objektivat dhe programet strategjike të zhvillimit

Për të konkretizuar zhvillimin e Matit duke u mbështetur në parashikimin e vizionit strategjik janë përcaktuar katër objektiva kryesore strategjike. Objektivat e hartuara janë të prekshme, të realizueshme dhe specifike në mënyrë që të monitorohet zbatimi i tyre në periudhën e parashikuar.

1. Zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm duke ruajtur balancat mes sektorëve dhe në mbështetje të zhvillimit bujqësor/blegtoral dhe agropërpunimit.

Zhvillimi i bashkisë Mat shihet ngushtësisht i lidhur ngushtë si me përmirësimin e rrjetit infrastrukturor rrugor ashtu edhe zhvillimin dhe diversivikimin e ekonomisë vendase. Në këtë kontekst, politikat ekonomike të bashkisë janë të lidhura si me karakteristikat e territorit ashtu dhe me "specializimin" apo sektorin dominues të punësimit të popullatës vendase. Aktualisht, bujqësia dhe blegtoria në Bashkinë e Matit, kanë jo vetëm normën më të madhe të të punësuarve, por dhe potencialin e madh ende të pashfrytëzuar të efiçentimit të prodhimit dhe tokës bujqësore. Bujqësia, Turizmi dhe Energjitika janë tre komponentët mbi të cilat Bashkia e Matit do të duhet të mbështesë zhvillimin e mëtejshëm ekonomik. Kjo nënkupton që bashkia duhet jo vetëm të synojë shfrytëzimin e potencialeve natyrore që ka por do të synojë të krijojë qendërsi me infrastruktura mbështetëse për bujqësinë. Në përmbushje të këtij objektivi, janë hartuar programet strategjike të mëposhtme, të cilat zbërthehen në projekte konkrete në Planin e Veprimit të kësaj Strategjie.

- Programi Strategjik O1P1: Intensifikimi i aktivitetit bujqësor dhe blektoral përmes konsolidimit të fermave bujqësore me mbështetjen vendore (dhe më gjerë)
- Programi Strategjik O1P2: Nxitja e aktivitetit agroindustrial për përpunimin e produkteve autentike të Matit si gështjenja, ftoi etj.
- Programi Strategjik O1P3: Rritja e numrit të pikave të grumbullimit dhe tregjeve në Bashki dhe diversifikimi i këtyre të fundit në territorin e Bashkisë së Madhe të Matit.
- Programi Strategjik O1P4: Nxitja e aktivitetit artizanal bujqësor, nëpërmjet promovimit dhe marketimit të produkteve autentike në panairet/ ditët e hapura vendase.
- Programi Strategjik O1P5: Përmirësimi i cilësisë së produkteve bujqësore, nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës mbështetëse bujqësore dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të rrjetit të kullimit dhe vaditjes.

2. Rritja e konkurueshmërisë së Bashkisë Mat, nëpërmjet diversifikimit të ekonomisë së saj në rajon dhe përmirësimit të aksesit dhe rrjetit infrastrukturor rrugor.

Modeli mbi të cilin do të mbështetet zhvillimi ekonomik dhe territorial i Bashkisë së Matit, është ai policentrim, me qëllim decentralizimin e funksioneve të ndryshme në pole të ndryshme gravitacionale në territor. Qendra multifunksionale e Bashkisë së madhe të Matit do të vazhdojë të mbetet qyteti i Burrelit, në të cilin akomodohet dhe pjesa më e madhe e shërbimeve (administrative, juridike, shëndetësore etj). Megjithatë diversifikimi i ekonomive mbështetur në potencialet natyrore dhe karakteristikat autentike të

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TERRITORIAL TIRANË SEKRETARIA

vendbanimeve të ndryshme të Matit, rritin konkurrueshmërinë e tij në Rajon. Në këtë kuadër, dallohen dy pole të rëndësishme të zhvillimit të bujqësisë, blegtorisë dhe agrobiznesit, Njësia Baz dhe Lis, pavarsisht se zhvillimi ekonomik me fokus bujqësinë është prezent thuajse në të gjitha njësitë administrative. Dy qendrat e sipërpërmendura, mbështetin këtë sector nëpërmjet ofrimit të infrastrukturave mbështetëse bujqësore si pikat e grumbullimit dhe magazinimit, pikat frigoriferike, tregjet etj.

Një sektor tjetër përmes të cilit duhet të diversifikohet ekonomia e bashkisë është ai i turizmit. Nga pikëpamja e potencialeve natyrore/peizazhistike, Bashkia e Matit ofron një gamë të gjerë të atraksioneve të kësaj natyre. Nëpërmjet krijimit të infrastrukturës mbështetëse (hoteleri, fshatra ekoturistike, guida turistike etj) dhe përmirësimit të aksesit dhe futjen në guidat turistike të shtigjeve natyrore, njësitë administrative të Macukullit, Derjanit, Rukajt dhe Ulëz kthehen në destinacionet më të rëndësishme turistike të qarkut Dibër.

Përsa i përket industrisë, njësia Komsi do të vazhdojë të akomodojë pikën më të rëndësishme industriale të pasurimit të Ferro-Kromit sipas përcaktimit të lejeve sektoriale përkatëse. Kjo pikë e vetmja në **Rajonin Mat - Bulqizë - Klos**, do të fuqizojë dhe më tej rolin e Bashkisë Mat në këtë ***cluster***. Zhvillimi i mëtejshëm i Infrastrukturës, planifikimi i shtrirjes së rrjetit hekurudhor etj. do të ndihmojnë më tej në shkëmbimin ekonomik të këtij sektori brenda rajonit.

Në sektorin e energjitikës, Bashkia e Matit do të vazhdojë të kryesoje. Në këtë kuadër, dy hidrocentralet e mëdha ai i Ulëzës dhe ai i Shkopetit do të vazhdojnë të operojnë, megjithatë Plani parashikon marrjen e masave strikte për mbrojtjen e lumit Mat, dhe vendos thekst të veçantë në përmirësimin e zonës ripariane përgjatë gjithë rrjedhës së tij.

Nga ana tjetër, në bashkinë Mat ushtrojnë aktivitetin 11 kompani të cilat shfrytëzojnë burimet minerare. Pikat e nxjerrjes së tyre shtrihen përgjithësisht në pjesën Lindore të Bashkisë së Matit, në njësitë administrative Lis dhe Pjesërisht Macukull.

Megjithëse hapja dhe mbyllja e aktivitetev minerare nuk është kompetencë e bashkisë, Bashkia Mat duhet të sigurohet për zbatimin e lejes mjedisore dhe lejes së shfrytëzimit minerar. Sektori i nxjerrjes dhe përpunimit minerar, ka gjeneruar megjithatë vende të reja pune në Bashkinë e Matit.

Me diversifikimin e ekonomisë, dhe potencialet e shumta natyrore dhe hidrike, Bashkia e Matit do të mundet të fuqizojë më tej rolin e saj në Rajonin Mat-Bulqizë- Klos.

Figura 69: Skema e zhvillimit të bujqësisë




**Burimi:** Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2017

- *Programi Strategjik O2P1:* Nxitja e zhvillimit të ekoturizmit nëpërmjet eksplorimit të zinxhirit të vlerave dhe pajisjen me infrastrukturën e nevojshme mbështetëse.
- *Programi Strategjik O2P2*: Nxitja dhe promovimi i turizmit në aspektin grastronomik, natyror dhe historik nëpërmjet krijimit të itinerareve turistike, identifikimit, hartëzimit dhe promovimit të vlerave historiko-kulturore me operatorët e sektorit.
- *Programi Strategjik O2P3*: Rehabilitimi i ish SMT-s në qytetin e Burrelit me qëllim akomodimin e aktiviteteve ekonomike dhe shërbimeve të qytetit dhe kthimin në qendrën ekonomike të Bashkisë Mat.
- *Programi Strategjik O2P4:* Konsolidimi dhe rehabilitimi i zonave industriale, minierave të bakrit e kromit, dhe nxitja e aktiviteteve ekonomike në segmente të caktuara përgjatë rrugës që lidh Rrëshenin me Burrelin.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
SEKRETARIA
TIRANË

Figura 70: Skema e zhvillimit ekonomik




**Burimi:** Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2017

3. Mbrojtja e burimeve natyrore dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit si baza për zhvillimin e turizmit dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve të Matit.

Për të garantuar një zhvillim të qëndrueshëm ndër breza, një nga obejktivat më të rëndësishëm Strategjik të Bashkisë së Matit është dhe mbrojtja e burimeve natyrore. Përmes këtij objektivi bashkia synon përmirësimin e kushteve dhe cilësisë së mjedisit, rehabilitimin e zonave ripariane, shtimin e sipërfaqeve të zonave të mbrojtura, rikuperimin e sipërfaqeve të humbura të pyjeve etj. Përmes këtij objektivi bashkia synon të mbrojë të gjitha asetet e pacmueshme natyrore, si baza për zhvillimin e turizmit si dhe me qëllim krijimin e një mjedisi të shëndetshëm për qytetarët e saj.

Me qëllim përmbushjen e këtij objektivi strategjik, janë hartuar programet e mëposhtme:

- *Programi Strategjik O3P1*: Ngritja dhe vënia në funksion e sistemit të menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta urbane duke stimuluar grumbullimin e diferencuar, reduktimin e tyre, dhe ofruar infrastrukturësn për trajtimin e tyre.
- *Programi Strategjik O3P2*: Mbrojtja e tokës dhe shtimi i sipërfaqeve të gjelbërta për të reduktuar erozionin dhe rrëshqitjet e tokave.
- *Programi Strategjik O3P3:* Menaxhimi strategjik i burimeve ujore dhe rehabilitimi i shtretërve të lumenjëve dhe zonave të tyre ripariane.
- *Programi Strategjik O3P4:* Marrja e masave për pastrimin e vatrave të nxehta mjedisore dhe për uljen e ndikimit të aktivitetev industrial në mjedisin e Bashkisë Mat.

- *Programi Strategjik O3P5*: Shtrirja e rrjetit të KUZ dhe trajtimi mjedisor I ujërave të ndotura urbane
- *Programi Strategjik O3P6*: Menaxhimi strategjik i fondit pyjor dhe kullosor si baza për zhvillimin e turizmit në bashki.
- *Programi Strategjik O3P7*: Nxitja e investimeve publike në lëvizjen e gjelbërt dhe krijimin e itinerareve të gjelbërta në zonat urbane dhe rekreative.

Figura 71: Skema e përmirësimit mjedisor




**Burimi**: Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2017

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
TIRANË
SEKRETARIA

Figura 72: Skema e zhvillimit ekonomik_ turizmi




**Burimi:** Bashkia Mat dhe MetroPOLIS, 2017

4. Orientimi i zhvillimit territorial dhe infrastrukturor me qëllimi zbutjen e pabarazive sociale dhe harmonizimin e nevojave të banorëve ekzistues dhe atyre të pritshëm.

Si rrjedhojë e zhvillimeve të 25 viteve të fundit, në Bashkinë Mat ende dallohen pabarzai të mëdha sociale midis njësisë qëndrore të Burrelit dhe njësive të tjera administrative. Ky objektiv Strategjik adreson ofrimin e shërbimeve të barabarta për të gjithë Matianët me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës. Përmirësimi i strukturave arsimore dhe shëndetësore, rivitalizimi i jetës social-kulturore dhe sportive, do të bëjnë jetesën në Bashkinë e Matit sërisht atraktive. Në përmbushje të këtij Objektivi më poshtë përcaktohen Programet Strategjike:

- *Programi Strategjik O4P1:* Lehtësimi i aksesit të njësive administrative të bashkisë, përmes përmirësimit të cilësisë së infrastrukturës ekzistuese dhe hapjen e rrugëve të reja të cilat shkrutojnë dhe përmirëosjnë cilësinë e udhëtimit mes njëisve administrative dhe lidhjen e tyre me qytetin e Burrelit.
- *Programi Strategjik O4P2*: Nxitja e arsimit profesional për të rritur nivelin e arsimit të popullsisë dhe profilizimin në sektorin bujqësorë me qëllim uljen e nivelit të papunsisë tek të rinjtë.
- *Programi Strategjik O4P3*: Zhvillimi social-kulturor, dhe sportiv i popullsisë nëpërmjet rehabilitimit të infrastrukturave ekzistuese dhe rijetësimin e aktiviteteve tradicionale.

- *Programi Strategjik O4P4*: Përmirësimi i shërbimit shëndetësor nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së strukturave shëndetësore dhe rihapjen e spitalit të Burrelit.
- *Programi Strategjik O4P5*: Mbështetja e familjeve në nevojë dhe grupeve të disavantazhuara nëpërmjet ndërtimit të banesave sociale dhe qendrave sociale në mbështetje të tyre.
- *Programi Strategjik O4P6*: Përmirësimi dhe rehabilitimi i hapësirave publike në qytetin e Burrelit, rijetësimit të qendrave të njësive administrative dhe përfshirja e ndërtesave informale në skemat rigjeneruese të Matit përmes instrumenteve financiare të PPP-ve dhe dizajnit urban
- *Programi Strategjik O4P7*: Përmirësim i infrastruktures së furnizimit me ujë të pijshëm duke siguruar menaxhimin e integruar të ujësjellësve në të gjithë territorin në administrim.

## 2.2 Konsiderata financiare

Bashkia e re Mat, renditet e 55 në vend për nga niveli i të ardhurave të gjeneruara nga burimet e veta , paraqet një nivel të ulët autonomie financiare përgjatë pesë viteve të konsideruara Ndërkohë, të ardhurat nga burimet e veta vendore kanë zënë një peshë të luhatshme nga viti në vit në totalin e të ardhurave të Bashkisë së re Mat (mesatarja për periudhën e konsideruar është rreth 18.1%). Niveli më i ulët u regjistrua në vitin 2010 (11.9%) ndërsa ai më i lartë në vitin 2015 (24.1%). Planifikimi strategjik i investimeve kapitale në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve publike në territoret në administrim rezulton i domosdoshëm dhe një parakusht për zhvillimin ekonomik vendor. Ndaj, vlerësohet thelbësor fuqizimi dhe përmirësimi i performancës financiare në kahun e të ardhurave si dhe racionalizimi në kahun e shpenzimeve (kryesisht ato administrative dhe operative). Ligji ri për buxhetin vendor të viti 2016 solli disa risi në kuadrin nivelit, llojit dhe numrit të taksave. Përgjithësisht, në periudhën afatshkurtër efektet e heqjes së disa taksave dhe futjes/modifikimit të disa të tjera vlerësohet të do të barazpeshojnë njëra tjetrën duke u përkthyer në një efekt pothuajse neutral për buxhetin vendor.

Në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve financiare të veta të bashkisë, përdorimi i instrumenteve financiarë si huaja nga sistemi bankar (në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi dhe pasi të jenë qartësuar asetet në pronësi të bashkisë përdorur në kolateralizimin e kredive); fondet shtetërore nga (FZHR, FSHZH etj) të orientuara kryesisht në mbështetje të zhvillimit të infrastrukturës; fondet nga donatorët e huaj (Banka Botërore, USAID, KfW, WBIF, etj.) për çështje që lidhen me trajtimin i mbetjeve dhe ujërave, asistencë teknike dhe ndërtim kapacitetesh apo edhe format e partneritetit publik-privat, paraqesin një mundësi reale për realizimin e investimeve kapitale. Në këtë drejtim, vlerësohet e domosdoshme rritja e kapaciteteve të bashkisë në drejtim të hartimit, menaxhimit, zbatimit dhe monitorimit të projekteve të investimeve nëpërmjet këtyre formave të financimit.

## III. Plani i veprimit

Programet strategjike të specifikuara për secilin nga 4 Objektivat e kësaj strategjie, janë përkthyer në projekte konkrete zbatimi, mbi të cilat do të mbështetet puna e bashkisë gjatë viteve të ardhshme. Projektet e listuara në këtë strategji, janë ato projekte të identifikuara si strategjike, nga pikëpamja e zhvillimit ekonomik, mirëqenies sociale dhe ofrimit të shërbimeve në mënyrë optimale. Natyrisht që përveç këtyre projekteve strategjike, bashkia ka një listë të gjatë projektesh, kryesisht me karakter mirëmbajtës dhe shërbyes të cilat do t'i zbatojë vit pas viti, që nuk janë pjesë e strategjisë duke qenë që nga pikëpamja strategjike nuk kanë domethënie të veçantë. Projektet e mëposhtme janë në faza të ndryshme të zhvillimit të tyre, si: projekte të plota gati për zbatim, fishë projekte ose projekt-ide. Disa nga projektet janë po ashtu të pajisura me një preventiv paraprak ku përcaktohet kostoja që do të ketë zbatimi i projektit, ndërsa pjesa tjetër e projekteve do të pajisen me këtë preventive paraprak pas hartimit të fishës dhe/ose projektit teknik të tyre. Po ashtu, për secilin nga projektet janë identifikuar edhe mundësitë e financimit, nisur nga lloji i projektit dhe kapaciteti financues i aktorëve aktivë të sektorit në fjalë. Projektet janë parashikuar të zbatohen përgjatë një afati kohor prej 15 vitesh, siç është edhe periudha e zbatimit të PPV-së. Me qëllim menaxhimin e mirë të tyre, në këtë strategji projektet janë ndarë në 4 faza, dy të parat janë projekte të parashikuara të zbatohen në një periudhe afatshkurtër, ndërsa pjesa tjetër janë projekte të cilat kërkojnë më tepër kohë dhe janë planifikuar të zbatohen në periudha afatmesme dhe afatgjata. Kjo ndarje në faza orienton punën e bashkisë, por mund të rishikohet nga ana e saj gjatë zbatimit të planit, në vartësi të mbarëvajtjes së zbatimit të projekteve dhe mundësive për financimin e tyre.

Në tabelën e mëposhtme, janë parashikuar gjithashtu Burimi i mundshëm kryesor i financimi/ Burimi i mundshëm dytësor i financimit . Identifikimi i këtyre burimeve, lidhet drejtëpërdrejt edhe me përgjegjësinë e secilit institucion/instancë për të përmbushur projektin. Burimi i mundshëm dytësor ifinancimit, parashikon përgjithësisht aktorë të tjerë të cilët mund të përfshihen në proces, dhe të cilët mund të jenë krahë mbështetës për përgjegjësin kryesorë (përgjithësisht Bashkia Mat) në realizim e projektit strategjik.

*Strategjia e Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Mat, nëpërmjet identifikimit të projekteve strategjike dhe detajimin në **Planin e Veprimeve** të burimeve njerëzore që nevojiten për secilin projekt, fazën e zbatimit, identifikimin e aktorëve të mundshëm për tu përfshirë në proces dhe identifikimin e indikatorëve të monitorimit, është një instrument i vlefshëm për Bashkinë Mat , jo vetëm si një marrëveshje e brendshme për realizimin e objektivave afatgjatë të bashkisë, por gjithashtu një platformë/instrument me të cilin Bashkia Mat mund të advokojë për thithjen e investimeve nga palë të treta. (Qeveria Qendrore, Donatorë, FSHZH, FZHR etj.)*

## 3.1 Plani i veprimit

| *Objektivi Strategjik 1 : Zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm duke ruajtur balancat mes sektorëve dhe në mbështetje të zhvillimit bujqësor/blegtoral dhe agropërpunimit* | | | | | | *Faza e Zbatimit* | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ***Programet Strategjike*** | ***Projektet*** | ***Vlera*** | ***Burimi i mundshëm kryesor / dytësor*** | ***Burimet njerëzore që nevojiten*** | ***Tregues Vlerësimi*** | *I '17 - '19* | *II '20 - '21* | *III '22 - '26* | *IV '27 - '31* |
| *O1P1* : Intensifikimi i aktivitetit bujqësor dhe blektoral përmes konsolidimit të fermave bujqësore me mbështetjen vendore (dhe më gjerë) | *Hartimi i Planit të menaxhimit për konsolidimin e tokave bujqësore* | *3,000,000* | *Bashkia Mat/ Donatorë* | *Drejtoria e Bujqësisë, Specialistë tëë jashtëm* | *Plani i hartuar dhe prezantuar grupeve të interesit* | | | | |
| | *Hapja e qendrave të informimit bujqësor pranë njësive administrative të bashkisë* | *Për t'u përllogaritur pas hartimit të Fish-Projektit* | *Bashkia Mat/ Shoqatat fermere* | *Minimumi 1 agronom për qendër* | *Ofrimi i shërbimit bujqësor në të gjitha NjA-të* | | | | |
| | *Krijimi i shoqatave të prodhuesve të produkteve frutore* | *1,030,000* | *Sektori privat/ Bankat, Donatorë* | *Perfaqesues fermerë, Agronom të zonës, pronarë të interesuar për skemën* | *Krijimi i të paktën një shoqate dhe vënia në veprim e tyre me një statut juridik* | | | | |
| *O1P2* : Nxitja e aktivitetit agroindustrial për përpunimin e produkteve autentike të Matit | *Ngritja e baxhove dhe fabrikave të përpunimit të produkteve blegtorale në Nj.A-të Macikull, Rukaj* | *Për t'u përllogaritur pas hartimit të Fish-Projektit* | *Sektori Privat, MBZHRAU* | *Perfaqesues fermere, biznesmenë, staf i kualifikuar sipas kapacitetit/ baxho* | *Ngritja e të paktën një pike grumbullimi për produktet blegtorale* | | | | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | *dhe Derjan* | | | | | | | | |
| Qellimi dhe objektivat | Krijimi i minimum dy haneve/bujtinave model për zhvillimin e turizmit në zonat malore. |
| Rezultatet e pritshme | • Krijimi i dy bujtinave/haneve model<br>• Trajnimi i banorëve<br>• Promovimi i turizmit<br>• Rritje e numrit të turistëve |
| Aktivitetet e projektit | • Identifikimi i dy bujtinave të mundshme (mundësisht 2 kulla matiane)<br>• Restaurimi dhe rregullimi i ambjenteve pritëse<br>• Trajnimi i banorëve<br>• Promovimi |
| Faza e projektit | Projekt - Ide |

| **Titulli i Projektit** | **Ngritja e shkollës profesionale në Burrel** |
|---|---|
| Tipi i Projektit | Arsim |
| Vendndodhja e projektit | Burrel |
| Buxheti total I projektit | 60,000,000 |
| Partnerët | • Bashkia Mat<br>• Ministria e Arsimit dhe e Sportit<br>• Donatorët e mundshëm |
| Përshkrimi i projektit | Aktualisht në qytetin e Burrelit mungon një shkollë profesionale, ku mund të mësoheshin zanate të ndryshme për nevojat e tregut.<br><br>Projekti synon hapjen e një shkolle profesionale ku të rinjtë do të kenë mundësi të marrin formim professional në fusha si turizmi, përpunimi i gurëve dekorativë, teknika bujqësore etj. |
| Qëllimi dhe objektivat | Hapja e një shkolle profesionale me parametra bashkëkohore |
| Rezultatet e pritshme | • Rritja e numrit të specialistëve<br>• Plotësimi i nevojave për shkollë profesionale |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT - TIRANË - SEKRETARIA

| | |
|---|---|
| | • Plotësim i kërkesës së tregut me forcë punëtore të përgatitur<br>• Rritja e nivelit arsimor tek të rinjtë |
| Aktivitetet e projektit | • Realizimi i studimit për nevojat e tregut të punës në Bashkinë e Matit.<br>• Hapja e një shkolle profesionale bazuar në studimin.<br>• Përgatitja e kurikulave mësimore<br>• Organizimi i fushatave sensibilizuese me institucionet e ndryshme dhe donatorët për të siguruar mbështetjen e duhur financiare<br>• Krijimi i binjakëzimeve me shkolla simotra. |
| Faza e projektit | Projekt - Ide |

| **Titulli i Projektit** | **Ngritja e terreneve sportive në Komsi, Baz, Lis dhe Macukull** |
|---|---|
| Tipi i Projektit | Social Kulturore |
| Vendndodhja e projektit | NJA Komsi, Baz, Lis, Macukull |
| Partnerët | • Bashkia<br>• FZHR<br>• Donatorë |
| Përshkrimi i projektit | Për këtë arsye, projekti synon zhvillimin e hapësirave sportive në njësitë administrative Komsi, Baz, Lis dhe Macukull të cila do ti shërbejë të gjithë qytetarëve, por me një fokus të veçantë tek të rinjtë. Hapësirat sportive duhet të parashikojnë zhvillimin e disa sporteve të ndryshme si fusha minifutbolli, basketbolli, vollejbolli, tenisi etj. |
| Qëllimi dhe objektivat | Rritja e aktiviteteve sportive si dhe përmirësim i kushteve për zhvillimin e aktiviteteve sportive |
| Rezultatet e pritshme | • Rritja e angazhimit të të rinjve në jetën sportive<br>• Trajnime dhe mundësi për zhvillimin e kapitalit social<br>• Promovimi i stileve të jetesës së shëndetshme |
| Aktivitetet e projektit | • Përgatitja e projektit teknik<br>• Ndërtim i qëndrës/këndit të lojërave dhe hapësirave sportive.<br>• Promovimi dhe zhvillimi i aktiviteteve (kampionate) |
| Faza e projektit | Koncept - Ide |

| **Titulli i Projektit** | **Rikonstruksioni i objekteve të traditës në qytetin e Burrelit** |
|---|---|
| Tipi i Projektit | Social Kulturore |
| Vendndodhja e projektit | Bashkia Mat/ Qyteti Burrel |

| | |
|---|---|
| Buxheti total I projektit | 4x 6,000,000 =24,000,000 |
| Partnerët | • Ministria e Kulturës<br>• Bashkia Mat<br>• Donatorët e Mundshëm<br>• Drejtoria e trashëgimisë Kulturore |
| Përshkrimi i projektit | Në territorin e Bashkisë Mat janë disa godina që përbëjnë (objekt kulturore) të traditës sonë që kanë nevojë për rikonstruksion, duke i ruajtur origjinën e kompozimit të këtij objekti. Në këtë kontekst bëjnë pjesë ish-shtëpia e pritjes, materniteti i vjetër, shtëpia e pionerit dhe kinemaja. |
| Qëllimi dhe objektivat | Rikonstruksioni i ndërtesave historike dhe kthimi i tyre në objekte të vizitueshme |
| Rezultatet e pritshme | • Godina të rikonstruktuara<br>• Shtimin e vizitorëve<br>• Rritja e Funksionalitetit të këtyre objekteve kulturore |
| Aktivitetet e projektit | • Përgatitja e projekteve teknike<br>• Rikonstruktioni fizik i tyre<br>• Emërtimi me tabela identifikuese turistike |
| Faza e projektit | Projekt - Ide |

| **Titulli i Projektit** | **Restaurim i një kulle Matiane si model për promovimin e turizmit familjar** |
|---|---|
| Tipi i Projektit | Kulturë/ Turizëm |
| Vendndodhja e projektit | NjA Macukull |
| Buxheti total i projektit | Për t'u përllogaritur |
| Partnerët | • Bashkia Mat<br>• Donatorë<br>• IMK, FZHR, ChËB |
| Përshkrimi i projektit | Kulla matiane është një ndër simbolet e arkitekturës tradicionale lokale. Edhe pse një element me vlera të jashtëzakonshme arkitektonike e historike, ato janë lënë në mëshirë të fatit dhe në dorë të investimeve private, që shpesh, edhe pse me dëshirën e mirë për të investuar në banesat e tyre, shkaktojnë dëme. Në këtë sens, ky projekt synon restaurimin e një kulle tipike Matiane e cila do të shërbejë për promovimin e turizmit familjar si dhe si model restaurimi për ndërhyrje të tjera. |
| Qëllimi dhe objektivat | Restaurimi i një Kulle Matiane |
| Rezultatet e pritshme | • Restaurimi i një kulle Matiane |

REPUBLIKA E SHQIPERISE AGJENCIA E ZHVILLIMIT TE TERRITORIT TIRANE SEKRETARIA

| | |
|---|---|
| | • Mbrojtje e trashëgimisë arkitektonike<br>• Model për ndërhyrje në objekte të tjera<br>• Rritje e numrit të vizitorëve/turistëve |
| Aktivitetet e projektit | • Evidentimi i një kulle matiane për restaurim<br>• Trajnim i banorëve<br>• Restaurim i Kullës<br>• Përgatije e broshurave mbi restaurimin<br>• Promovim |
| Faza e Projektit | Projekt - Ide |

| **Titulli i Projektit** | **Përmirësimi i infrastrukturës lokale në të gjitha NjA-të** |
|---|---|
| Tipi i Projektit | Zhvillim Infrastrukturor/Rural |
| Vendndodhja e projektit | Bashkia Mat |
| Buxheti total I projektit | • Rruga Ura Ulëz – Ulëz 245,000,000<br>• Rruga Stojan 98,000,000<br>• Rruga Bushkash 47,000,000<br>• Rruga Baz – Rreth Baz – Ura e Karicës 90,000,000<br>• Rruga Baz – Karicë 75,000,000<br>• Rruga German – Karicë 21,000,000<br>• Ndërtim Ura e fshatit Drita 130,000,000<br>• Rruga Kishës – Zall Lepuj 35,000,000<br>• Rruga Frankth – 29,000,000<br>• Rruga German 71,331,461<br>• Rruga Midhë 57,200,000<br>• Rruga lidhëse fshati Batër e Vogël 42,000,000<br>• Rruga Komsi – Qafështamë 950,000,000<br>• Rruga fshati Sekitzë 24,000,000<br>• Rruga lidhëse Burgajet 30,000,000<br>• Rruga lidhëse Lis – Shëlli 36,000,000<br>• Rruga Gjallish 54,000,000<br>• Rruga Myze 48,000,000<br>• Rruga fshati Zenisht 44,800,000<br>• Rruga Mallunxë 12,000,000<br>• Rruga Vinjoll 27,000,000<br>• Rruga Fshati Shoshaj 23,000,000<br>• Rruga Urakë – Rrembull – Derjan 575,000,000<br>• Rruga Derjan – Samaj 20,000,000<br>• Rruga Qafë-Shënkoll – Dukagjin – Gjoçaj 27,500,000<br>• Rruga Urakë – Bruç – Laç<br>• Rruga Qendër – Urakë – Ndrelalak |

| | |
|---|---|
| | • Ndërtim ure mbi lumin Urakë |
| Partnerët | • Bashkia<br>• FZHR |
| Pershkrimi i projektit | Për shkak të pozitës gjeografike, kushteve të territorit, zhvillimeve historike etj, duket se gjendja e infrastrukturës në Bashkinë e Matit është lënë pas dore. Mes vendbanimeve të bashkisë, për shkak të gjendjes së vështirë të infrastrukturave mungon tërësisht ndërveprimi. Ky projekt synon përmirësimin e të gjithë rrugëve locale në territorin e matit, të cilat krijojnë akses më të mirë për të gjithë vendbanimet, shkurtojnë kohën e udhëtimit nga një vendbanim në tjetrin, përmirësojnë ndjeshëm cilësinë e udhëtimit dhe bëjnë të mundur aksesin më të shpejtë drejt potencialeve natyrore dhe turistike të bashkise. |
| Qellimi dhe objektivat | • Përmirësimi i cilësisë së infrastrukturave në të gjithë bashkinë<br>• Përmirësimi i aksesit për të gjithë vendbanimet<br>• Rritja e ndërveprimit mes Matit dhe territoreve të tjera fqinje<br>• Rritja e numrit të vizitorëve në bashkinë e Matit |
| Rezultatet e pritshme | • Permirësimi i infrastrukturës locale<br>• Rritja e aksesit mes vendbanimeve<br>• Promovim i potencialeve natyrore, turistike të Matit |
| Aktivitetet e projektit | • Hartimi i projektit teknik<br>• Buxhetimi i projektit<br>• Zbatimi i projektit |
| Faza e Projektit | Projekt - Ide |

| Titulli i Projektit | Rehabilitimi i sistemit të ujitjes dhe kullimit në të gjitha NjA-të |
|---|---|
| Tipi i Projektit | Zhvillim Infrastrukturor/Rural |
| Vendndodhja e projektit | Bashkia Mat |
| Buxheti total I projektit | • Linja Bushkash - Stojan 60,000,000<br>• Rezervuari Nr.2 "Baz – Karicë" 42,000,000<br>• Linja Baz – Bashkim 18,000,000<br>• Kanali Vaditës German 36,000,000<br>• Rezervuari Midhë 25,000,000<br>• Kanali vaditës Midhë – Burrel – Kosum 48,000,000<br>• Skema vaditëse "Laç" – Rehabilitimi i rezervuarit Nr. 1, Nr. 2 |
| Partnerët | • Bashkia<br>• FZHR |

| | |
|---|---|
| | • Donatorë<br>• Shoqata e fermerëve |
| Pershkrimi i projektit | Pas periudhës së tranzicionit në Bashkinë e Matit, sektori i zhvillimit të bujqësisë pësoi një ulje të ndjeshme në zhvillimin ekonomik vendas. si pasojë pjesa më e madhe e infrastrukturave bujqësore filloi të degradohej. Në situatën e sotme, pjesa më ë madh e e magazinave bujqësore janë të braktisura dhe jashtë kushteve optimale të operimit, kanalet kulluese dhe vaditëse jashtë përdorimit, dhe pjesa më ë madhe e tyre ka nevojë të zhbllokohet nga materialet e akumuluara ndër vite.<br>Me qëllim lulëzimin dhe nxitjen e mëtejshme të sektorit bujqësor në bashkinë Mat, ky projekt synon rehabilitimin e sistemit kullues dhe vaditës në të gjithë tokat bujqësore në bashkinë Mat.<br>Rehabilitimi i këtij rrjeti, ndihmon në zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë, duke rritur ndjeshëm rendimentin e produkteve bujqësore të prodhuara dhe cilësinë e tyre. |
| Qellimi dhe objektivat | • Përmirësimi i cilësisë së infrastrukturave vaditëse në të gjithë bashkinë |
| Rezultatet e pritshme | • Permirësimi i infrastrukturës<br>• |
| Aktivitetet e projektit | • Hartimi i projektit teknik<br>• Buxhetimi i projektit<br>• Zbatimi i projektit |
| Faza e Projektit | Projekt - Ide |

4.1 Ndryshimet e mundshme institucionale dhe ligjore

Në përgjithësi, propozimet paraprake të dhëna nga kjo Strategji, nuk kërkojnë ndryshime në kuadrin ligjor dhe administrativ, së paku jo për periudhën afatshkurtër. sugjerimi kryesor në këtë fazë është që PPV-ja të zbatohet për së paku 2 vjet, periudhë gjatë së cilës Bashkia do të monitorojë jo vetëm zbatimin por edhe vështirësitë e hasura. kjo periudhë zbatimi do të ndihmojë që Bashkia të përpilojë propozime në lidhje me ndryshimet e nevojshme në bazën ligjore dhe/ose administrative për planifikimin, sektorë të tjerë dhe sipas rastit edhe për strukturën administrative në nivel vendor. Megjithatë sugjerohet që Bashkia e Matit të rrisë numrin e specialistëve pranë zyrës së Urbanistikës dhe Zhvillimit të Territorit sikurse dhe të krijojë drejtorinë e Investimeve Strategjike me qëllim vënien më mirë në zbatim të projekteve Strategjike të parashikuara në këtë Strategji.

Sigurisht këto propozime mbeten sugjerime në rast të një procesi të mundshëm ndryshimi të bazës ligjore. Pra në tërësi për peiudhën afatshkurtër, nuk mendojmë se nevojiten ndryshime ligjore dhe/ose administrative në nivel kombëtar.

Megjithatë disa ndryshime paraprake në nivel vendor sugjerohen si më poshtë:

1. Nevojitet të krijohen struktura të reja për monitorimin mjedisor në nivel vendor, ose të përmirësohen ato ekzistuese duke shtuar organikën lokale, në përputhje me ligjin për vetqeverisjen vendore
2. Të rritet numri i inxhinierëve apo planifikuesve që mbulojnë njësitë administrative me qëllim ndjekjen dhe zbatimin e programeve/projekteve të parashikuara për secilën nga NjA-të
3. Të shtohet stafi i drejtorisë së urbanistikës dhe Zhvillimit të Territorit për të zbatuar në kohë dhe me cilësi të gjitha projektet dhe proceset zhvillimore të parashikuara nga Strategjia e Zhvillimit të Territorit dhe PPV-ja
4. Të forcohet bashkëpunimi me ALUIZNI. Në rregulloren e brendshme nevojitet të rregullohet procedura e monitorimit sipas strukturës përkatëse në bashki. Pas miratimit të PPV-së nevojitet të bashkërendohet me raportin e territorit sipas ligjit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit, nr.107/2014

Ndryshime të tjera të mundshme në kuadrin ligjor dhe institucional, do të parashikohen në dokumentin e Planit të Zhvillimit të Territorit për Bashkinë Mat.

## V. Shtojca

**DREJTORIA E URBANISTIKËS, PLANIFIKIMIT DHE MENAXHIMIT TË TERRITORIT**

Adresa: Sheshi "Ahmet Zogu", Burrel Tel.355 (0) 21722421., e-mail: bashkiamat@gmail.com, web:www.bashkiamat.gov.al

***Proces – Verbal***

***Degjesen e pare publike per planin e pergjithshem vendor te territorit***

***të Bashkise Mat***

Me datë 1 dhjetor 2016, në ambjentet e Pallatit të Kulturës, në qytetin e Burrelit u mbajt dëgjesa e parë publike për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor.

Në këtë dëgjesë, morën pjesë përfaqësues të Forumit qytetar këshillmor vendor, administratorët e Njësive Administrative, përfaqësues të Bordit të Kullimit, specialistë të drejtorive të Bashkisë Mat, kryetarë të fshatrave, qytetarë, Krytari i Bashkisë Mat z. Nezir Rizvani, zv.kryetari i Bashkisë z. Rustem Nuzi, drejtues i MetroPOLIS Z.Besnik Aliaj dhe program officer pranë dlgd z. Rikard Luka.

Qëllimi i kësaj dëgjese ishte njohja me procesin e hartimit te Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Mat. Si dhe informimi i qytetarëve matian mbi marrjen e Nismës për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor nga Këshilli i Bashkisë Mat.

Z. Rikard Luka, Program Officer pranë dldp, mbajti hapjen e kësaj dëgjese publike. Ai sqaroi se projekti për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, financohet nga dldp Programi për decentralizim dhe zhvillim lokal.

Gjatë kësaj dëgjese, përfaqësuesja e MetroPOLIS, Znj. Fiona Imami mbajti prezantimin me pikat si më poshtë:

1. Qëllimi i hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor
2. Territori i Bashkisë Mat
3. Dokumentat që përmban PPV-ja
4. Grupi i Punës per hartimin e PPV-së
5. Procesi dhe afatet kohore për hartimin e PPV-së
6. Takimet këshilluese, teknike dhe dëgjesat publike
7. Ngritja e forumit Këshillmor Vendor
8. Buxheti

Në përfundim të këtij procesi fjalën përmbyllëse e mbajti ***kryetari i Bashkisë Mat Z. Nezir Rizvani***, i cili në emër të bashkisë shprehu gatishmërinë për bashkëpunim me studion MetroPOLIS në hartimin e këtij Plani të Përjgjithshëm Vendor për bashkinë e madhe Mat.

***Z. Besnik Aliaj, drejtor i MetroPolis***, nënvizoi rëndësinë e hartimit të Planit të Përgjithshëm vendor. Ky plan do të jetë kushtetuta e territorit të Bashkisë Mat në 15 vitet e ardhshme. Vetem nëpërmjet hartimit të Planit të Përgjithshëm vendor do të mund ti hapim mundësi dhe rrugë investimeve të reja në infrastrukturë, do të përmirësojmë cilësinë e jetesës në qytetet tona dhe do të mund ti japim një hov zhvillimit të ardhshëm ekonomik.

**DREJTORIA E URBANISTIKËS, PLANIFIKIMIT DHE MENAXHIMIT TË TERRITORIT**

Adresa: Sheshi "Ahmet Zogu", Burrel Tel.355 (0) 21722421., e-mail: bashkiamat@gmail.com, web:www.bashkiamat.gov.al

***Proces – Verbal***

***Degjesen e dytë publike per planin e pergjithshem vendor te territorit***

***të Bashkise Mat – Analiza e Thelluar e Territorit***

Dëgjesa publike mbi Analizën e Thelluar të Territorit u mbajt më datë 21 Dhjetor 2016 në ambjentet e Pallatit të Kulturës në qytetin eBurrelit. Në këtë dëgjesë morën pjesë si më poshtë:

Përfaqësues nga MetroPOLIS: Fiona Imami *(Planifikues Urban)*

Besnik Aliaj *(Drejtues i MetroPOLIS sh.pk.)*
Sotir Dhamo *(Team Leader, Universiteti POLIS)*
Ada Lushi *(Arkitekt)*
Kristi Bashmili *(Ekspert Mjedisi)*

Në mbledhje morën pjesë përfaqësues nga: Drejtoria e Urbanistikes, Administratorët e Njësive Administrative, Përfaqesues të Bizneseve, Qytetarë, Specialistë të drejtorisë së Shërbimeve, Specialistë të Transportit Publik, përfaqësues të OSHEE, Agronom etj

Prezantimi nisi në orën **10:$^{00}$** am

Qëllimi i mbajtjes së kësaj dëgjese ishte prezantimi i gjetjeve të analizës së Thelluar të Territorit të Bashkisë Mat, konsultimi i këtyre gjetjeve me qytetarët matianë dhe specialsitët e fushave përkatëse.

Gjatë këtij prezantimi përfaqësuesja e MetroPOLIS Znj. Fiona Imami shpjegoi gjetjet si më poshtë:

1. Pozicionimi i Matit në rajon dhe lidhja me Infrastrukturat Rajonale
2. Elementet e fortë në territor
3. Zhvillimi në kohë i vendbanimeve në Bashkinë Mat
4. Parashikimet demografike
5. Analiza e zhvillimit ekonomik dhe Social (përfshi këtu dhe shpërndarjen e shërbimeve shëndetësore dhe arsimore)
6. Rrjeti Infrastrukturor ekzistues
7. Rëndësia Kombëtare në territor
8. Përdorimi ekzistues i tokës, dhe ndarja e 5 Sistemeve Territoriale
9. Analizimi i Planeve të hartuara më parë
10. Analiza e Metabolizmit të Territorit
11. Analiza Mjedisore
12. Analiza SWOT, Gjetjet dhe Konkluzionet

Në përfundim të këtij prezantimi u shtruan pyetjet dhe diskutimet si më poshtë:

Pyetje: Çfarë metodologjie është ndjekur për të analizuar të dhënat demografike. Pasi dallohet qartë një diferencë e madhe midis dy burimeve nga ku janë marrë të dhënat?

Përgjigjet Z. Besnik Aliaj: Në fakt keni të drejtë një nga problematikat që hasin të gjitha bashkitë është pikërisht mungesa e informacionit të saktë të popullsisë. Në i kemi analizuar të dyja burimet për të parë se ku divergjojnë rezultatet e secilës. Në fund parashikimin demografik e japim duke patur parasysh 3 skenarët: optimis, realist dhe pesimist. Sigurisht që dhe me skenarin realist duket se popullsia e Matit është një popullsi në rënie. Këtë gjë e ndjeni dhe ju vetë dita ditës.

Koment: Ju falenderoj për këte prezantim kaq cilësor dhe të plotë. Keni sjellë tamam një panoramë të Matit me gjithë të mirat dhe të këqijat që ka. Sigurisht të këqijat janë pak, ato cfarë ka dëmtuar dora e njeriut. Unë do të propozoja ta shihnit edhe një herë atë

REPUBLIKA E SHQIPERISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT SEKRETARIA TIRANË

planin që pat bërë Zogu, ku Mati ishte tamam si Budapesti, qyteti që shtrihej në të dy anët e lumit, dhe vetë Lumi Mat përgjatë gjithë rrjedhës së tij ishte i lundrueshëm.

Koment: Mbështets plotësisht atë cfarë tha parafolësi. Madje një kuriozitet lidhet dhe me vetë emrin "MAT" që do të thotë Sy. Pra aq vlera të pacmueshme ka ky territor sa e kanë quajtur pikërisht sy.

Në përfundim të pyetjeve dhe komente, ***kryetari i Bashkisë Mat Z. Nezir Rizvani***, falenderoi të gjithë pjesëmarrësit, dhe i ftoi të gjithë ata të cilit kishin komente, sugjerime dhe informacione të cilat kontribuojnë në psurimin e Analizës së Territorit të Mat. Ai gjithashtu njoftoi se materialet janë publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë, dhe mund të aksesohen dhe në zyrën e Urbanistikës dhe Zhvillimit të Territorit.

**DREJTORIA E URBANISTIKËS, PLANIFIKIMIT DHE MENAXHIMIT TË TERRITORIT**

Adresa: Sheshi "Ahmet Zogu", Burrel Tel.355 (0) 21722421., e-mail: bashkiamat@gmail.com, web:www.bashkiamat.gov.al

***Proces – Verbal***

***Degjesen e katërt publike per planin e pergjithshem vendor te territorit***

***të Bashkise Mat – Strategjia e Zhvillimit të Territorit***

Me datë 13 Shkurt 2017, u mbajt pranë pallatit të Kulturës në qytetin e Burrelit, dëgjesa publike mbi Strategjinë e Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Mat.

Gjatë kësaj dëgjese morën pjesë kryesisht nëpunës të administratës së Bashkisë Mat, përfshi këty dhe kryetarin e Bashkisë Mat, Z. Nezir Rizvani, administratorët e njësive administrative, përfaqësues të shoqërisë civile dhe përfaqësues të bizneseve, përfaqësues nga MetroPOLIS etj.

Gjatë kësaj dëgjese, përfaqësuesja e MetroPOLIS, Znj. Fiona Imami, mbajti prezantimin me pikat si më poshtë:

1. Procesi i hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor
2. Analiza e thelluar e territorit, gjetjet kryesore dhe problematikat e nxjerra
3. Drejt vizionit të Matit 2030
4. Deklarata e Vizionit të Zhvillimit të Matit
5. Objektivat Strategjikë dhe programet kryesore për secilin prej Objektivave
6. Përmbledhje e planit të veprimit të Objektivave Strategjike

Në përfundim të këtij prezantimi, pjesëmarrësit parashtruan pyetje dhe diskutuan çështjet si më poshtë:

Koment Z. Astrit Doçi: Faleminderit për prezantimin. Ka një analizë të mirë e gjithë strategjia, megjithatë do të sugjeroja të shtonit disa pika të rëndësishme në Strategji sic është përfshirja e parkut të Qafë Shtamës. Nyk e di nëse ju e keni shkelur terrenit, dhe nëse jo do të duhet me doemos ta bëni, gjithë territorin e Matit madje, që të keni mundësi të bëni propozime edhe më të mira. Ju duhet të njihni territorin në pëllëmbë të dorës, dhe të sillni ca harta më të sakta me vendodhjen e monumenteve, dhe zonave për zhvillimin e turizmit. Puna e mëtejshme për hartimin e Planit duhet të intensifikohet me më shumë takime në secilin fshat.

Pyetje Z. Agim Selita: Faleminderit për prezantimin. Unë e vlerësoj cdo gjë cka thatë, por do të doja që objektivat Strategjik të jenë disi më të prekshëm, dhe të sqarohen ndoshta më gjatë për të kuptuar përshembull më qartë se cdo të bëhet me tokën bujqësore, apo ku do të jenë zonat ekonomike.

Përgjigjet Znj. Fiona Imami: Faleminderit për komentet. Material i plotë i Strategjisë së Zhvillimit të Territorit është dorëzuar në Bashki 2 javë përpara kësaj dëgjese, madje drejtorisë së urbanistikës, e ka shpërndarë këtë informacion në të gjitha drejtoritë e Bashkisë Mat me qëllim marrjen e komenteve dhe reflektimin e tyre në kohë. Kjo dëgjesë publike është pikërisht për këtë, të dakordësojmë dhe nje herë se fundmi se cilat do të jenë ato opsione strategjike që i ofrohen Matit në mënyrë që të nxisë zhvillimin.

Pyetje Z. Pajtim Ndeu: Cila është zona e propozuar për zhcillium të mëtejshëm ekonomik?

Përgjigjet Znj. Fiona Imami: Zona më e rëndësishme e shërbimeve dhe ekonomike për Bashkinë e Matit është parashikuar të jete zona ish SMT-së. Kjo për shumë arsye, se pari sepse lidhet mjaft mirë me unazën e propozuar të qytetit dhe së dyti kjo zonë ka një mori ndërtesash ish-industriale të cilat mund të rigjenerohen dhe rikualifikohen për tu vendosur në shërbim të ekonomisë.

Koment Z. Kujtim Canameti: Më pëlqen ky vision që keni sjell për Matin. Do të shtoja vetëm një diçka të vogël. Në planet që Mbreti Zog ka bërë për Matin, ka qenë një detaj mjaft i veçantë. Lumi Mat i lundrueshëm, dhe gjatë gjithë lumit kishte ura dhe kalime ku nga të dyja anët e tij do të zhvilloheshin qytetet. Nëse do e rimerrnit këtë concept do të ishte një diçka fantastike.

**DREJTORIA E URBANISTIKËS, PLANIFIKIMIT DHE MENAXHIMIT TË TERRITORIT**

Adresa: Sheshi "Ahmet Zogu", Burrel Tel.355 (0) 21722421., e-mail: bashkiamat@gmail.com, web:www.bashkiamat.gov.al

***Proces – Verbal***

***Degjesen e tretë publike per planin e pergjithshem vendor te territorit***

***të Bashkise Mat – Vlerësimi Strategjik Mjedisor***

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

Përfaqësues nga Co-PLAN: Fiona Imami *(Planifikues Urban)*
Xhesika Hoxha *(Eksperte Mjedisi)*
Kristi Bashmili *(Ekspert Mjedisi)*
Prof. Sherif Lushaj (Drejtues i grupit të punës për VSM

Në mbledhje morën pjesë përfaqësues nga: Bashkia Mat, Prefektura, ARM-Dibër, Drejtoria e planifikimit urban, Profesion i lirë, Shoqëri Civile, Shërbimet Publike, Ujësjellësi, Këshilltarë Bashkiak, Kryetarë të NjA-ve, Përfaqësues nga sektori i Agronomisë dhe Bujqësisë.

Prezantimi nisi në orën 11:30 am

**Prezantim, Pjesa I:** Kristi Bashmili *(Ekspert Mjedisi)*

Prezantimi nis me shpjegimin e proçesit nëpër të cilin kalon hartimi i VSM-së si edhe legjilslacionit ku bazohet hapat e ndërmarra për krijimin e dokumentit të VSM-së, po ashtu edhe detyrimet e metodologjinë e ndjekur. Qartësohen proçeset e ndejkura duke vënë theksin në fazat që tanimë janë konsumuar, fazën aktualen si edhe fazat e ardhshme deri në mbyllje të proçesit. Prezantohet pjesa ku do të përqëndrohet prezantimi. Pikat kryesore do të jenë paraqitja e rezultateve gjeneruar nga analizat mjedisore të kryera për të gjithë territorin e Bashkisë Mat. Elementët e trajtuar në këto analiza janë (Toka, Ndotja, Mbetjet, Akuiferi, Ujërat Sipërfaqësorë, Sistemi Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime, Pyjet, Erozioni, Ajri, etj.

**Prezantim, Pjesa II:** Xhesika Hoxha *(Eksperte Mjedisi)*

Në këtë pjesë të dytë të dëgjesës u bë preantimi i një analize të përgjithshme të Bashkisë së Matit, si pozicioni strategjik gjeografiik por me lidhje jo të mira infrastrukturore, kushtet gjeologjike, relievi dhe analizat e diellëzimit dhe e reshjeve.

Gjithashtu u bë një përmbledhje e shkurtër e analizës së metabolizit për flukset e energjisë, mbetjeve, ujit dhe ushqimit.

Në prezantim u trajtuan në mënyrë të detajuar temat si më poshtë:

- Territori & Tokat Bujqësore Ndarja natyrale e territorit të Bashkisë Mat në zonë fushore, kodrinore dhe malore i jep mjaft lehtësi menaxhimit të truallit. Lartësia mbi nivelin e detit është mesatare, ku mbizotëron zona fushore dhe kodrinore. Sa i përket rreziqeve nga erozioni është evidentuar zona e kodrinore të Macukullit dhe përgjatë zonave fushore të Lumit Mat ku zhvillohet edhe buqësia. Rrezik natyror paraqesin edhe ndotja e përmbytja e fushave nga fryrja e lumenjve. Problematike paraqitet gjendja e tokave nga kultivimi i saj gjatë gjithë vitit, përdorimi i makinerive dhe inputeve bujqësore, shtimi i kulturave bujqësore, etj. Një faktor shqetësues janë dhe përdorimet konfliktuale të tokës si dhe ndërtimi në tokën bujqësore.

- Ndotja e ujërave sipërfaqësore

  Në fillim analizohet gjendja hidromorfologjike e Basenit të Matit si dhe prezantohet monitorimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

  Vihet në dukje se kontribues kryesor të ndotjes në ujërat sipërfaqësore janë përdorimi i pesticideve në bujqësi, shfrytëzimi i lumit për materiale inerte, shkarkimi i ujërave të ndotura urbane dhe industriale, erozioni fundor dhe mungesa e vegjetacionit në zonat ripariane.
- Ujrat Nëntokësore

  Në fillim bëhet një përmbledhje e shkurtër mbi llojet e akuiferëve që shtrihen në Bashkinë Mat. Më tej prezantohen disa nga problematikat që janë evidentuar gjatë analizimit të gjendjes së tyre, ku ndër kryesorët janë: mungesa e monitorimit të cilësisë së akuiferëve, ndotja nga ujërat e lumit Mat, shfrytëzimi i mineraleve etj..

**Prezantim, Pjesa III:** Kristi Bashmili *(Ekspert Mjedisi)*

Pjesa e tretë dhe e fundit e prezantimit konsistoi në paraqitjen e analizave të gjendjes në jedis të disa komponentëve të tjerë.

- Mbetjet

  Problematike shfaqet situata lidhur me Vend-Depozitimin aktual, shllamet e të cilave dekantojnë në kolektorin kryesor vaditës. Mungojnë të dhëna mbi mbetjet e rrezikshme.
- Ajri, mungesa e monitorimit dhe evidentimi i disa burimeve pikësore të ndotjes.
- Fondi Pyjor & Kullusor
- Biodiversiteti: 73 është numri i specieve të rrezikuara në R.Shqipërisë të cilat gjenden edhe në Mat.
- Ndryshimet klimatike
- Shërbimet publike (Furnizimi me ujë dhe kanalizime)
- Presionet mjedisore (vendepozitimi aktual i mbetjeve, pikat e shkarkimit të ujërave të ndotura urbane, gropat septike, aktivitetet e shfrytëzimit të materialeve inerte dhe mineraleve, dampa e depozitimit të mbetjeve të Uzinës të pasurimit të ferro-kromit, etj)

Siç edhe u përmënd më parë, kjo fazë e I e Dëgjesës së VSM trajton gjetjet e deritanishme si edhe fokusohet në zgjerimin dhe saktësimin e njohurive dhe fakteve. Ndërkohë që në fazën e II të Dëgjesës së VSM do të trajtohen impaktet në mjedis të ndërhyrjeve që do të propozohen nga P.P.V

Mbyllje e prezantimit, falenderime dhe ftesa për diskutim!

Prezantimi përfundoi në orën **12:$^{05}$** am

***Në përfundim të prezantimit pjesëmarrësit diskutuan çështjet si më poshtë:***

***Profesor Sherif Lushaj:*** Do të doja të shtoja vetëm dicka në përfundim të prezantimit nga kolegët e mi. Në raportin e VSM, ne, profesionistët jemi shpesh herë të detyruar të përdorim disa terma teknike të cilat ndoshta nuk u kuptuan ose krijuan paksa konfuzion gjatë prezantimit. Qëllimi i kësaj dëgjese të parë është të diskutojmë bashkarisht mbi problemet mjedisore të Bashkisë Mat, të diskutojmë mbi gjetjet e analizave të kryera dhe

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

pse jo ti pasurojmë ato me informacione që do ti ndajmë tani bashkarisht. Sigurisht që në fazën e dytë, ne do të vimë me një listë masash dhe propozimesh për zbutjen e ndikimeve të mundshme të projekteve që do të parashikojë PPV-ja sikundër dhe masat për përmirësimin e cilësisë së jetës në Bashkinë e Matit. Për këtë arsye ju ftoj tanimë në këtë diskutim të madh sëbashku.

*Përfaqësues nga ARM Dibër:* Ju falenderoj për punën tuaj deri tani. Ky vlerësim është mjaft i mirë për Bashkinë e Matit, megjithatë një vlerësim i tillë mjedisor duhet bërë për të gjithë Qarkun e Dibrës. Pika e diskutimit mbi cështjen e menaxhimit të mbetjeve, dhe ndërtimi i landfillit, sigurisht është një cështje që zgjidhet në qark. Për këtë arsye dhe vetë qarku duhet të bëj një vlerësim mjedisor më të hollësishëm

*Administrator i Njësisë Komsi*: Unë kam disa komente dhe përgëzime. Më vjen mirë që folët për Uzinën e Ferrokromit, dhe ndotjet e mundshme që vinë nga ajo. Kërkoj nga bashkia që të bëhet një studim specific i cili llogarit nivelin e ndotjes së kësaj uzine, pasi është një uzinë e cila duhet të funksionojë me standard europiane. Kjo uzinë, dhe të gjithë gazrat që lëshon në atmosferë ndotin në mënyrë të frikshme nga Bazi e deri në Klos.

Një pikë tjetër për diskutim është ajo e mbetjeve. Sot për sot bashkia grumbullon mbetjet vetëm për qytetin e Burrelit, dhe vjen e i depoziton në një pikë fare të paligjshme në njësinë Komsi. Nuk jam për ndërtimin e një landfilli, jam me idene që kryetari duhet ta mbrojë Matin, Mos lejojë të mbushet me plehra port e gjej zgjidhjen më të mirë për ti trajtuar ato, për ti depozituar me standard.

Dhe pika e fundit është për trajtimin eujërave. Me sesben duhet ta propozojmë impiantin.

*Qytetar:* Ju falenderoj nga zemra për cështjet që trajtoni. Në ballkan, në gjuhën e tyre Mat do të thotë "SY", aq gjëra të mira ka, dhe aq pasuri dhe cdo gje tjeter. Duhet me se sbën ti mbrojmë këto territore. Faleminderit.

*Drejtor i Bujqësisë pranë Bashkisë Mat z.Vebi Stana:* Ju përshëndes për hulumtimin e bërë deri tani. Në lidhje me pyjet. Mungesa e planit të mënaxhimit të pyjeve, sikurse e nxirrni dhe ju shihet si një pikë mjaft problematike. Fakti ndryshon si nata me ditën me planet dhe siperfaqet që thuhet se ka Mati.

Sa i përket analizës së tokave bujqësore, mendoj që duhet kryer një analizë e thellësisë së ujërave nëntokësor për cdo njësi. Kjo do të orientonte edhe më mirë fermerët drejt kulturave bujqësore që duhet të kultivojnë.

Boniteti i tokave, mbetet gjithmonë një informacion sa i nevojshëm aq dhe i pamundur për tu marrë.

*Fjala përmbyllëse: Z. Nezir Rizvani (Kryetar i Bashkisë)*

Proçesi i hartimi dhe konsultimit të PPV-së për Bashkinë Mat ka organizuar deri në këtë momenti 2 (dy) degjesa me publikun, ndërkohë sot realizojmë dëgjesën e 3 (tretë) dedikuar Vlerësimit Strategjik Mjedisor e cila është edhe dëgjesa e parë për këtë proçes. Këtu do të paraqiten analiza e gjendjes e secilit prej komponentëve të mjedisit. Bashkia, nga dëgjesa e sotme pret dhe jemi të interesuar që të merrnim mendime dhe qëndrime lidhur me çeshtjet mjedisore, që u trajtuan në këtë dëgjesë.

Falenderoj ekspertët e MetroPOLIS për bashkëpunimin dhe punën e tyre cilësore, duke na sjellë një tablo të plotë të gjithë gjendjes në mjedis për Bashkinë. Duhet të pranojmë se Bashkia Mat ka probleme në një pjesë të madhe të çështjeve që u trajtuan, si mund të përmendim mbetjen urbane, ndërtimin e Hec-eve në trupat ujore, ujërat e ndotura që shkarkohen në lum dhe përrenj, erozionin në toka dhe prerjet e pyjeve.

Hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor do të hartohet mbi bazën e zhvillimit të bujqësisë dhe të agroturizmit. Projektet dhe planet që do të hartohen do të kenë synimin për arritjen e këtyre qëllimeve.

**DREJTORIA E URBANISTIKËS, PLANIFIKIMIT DHE MENAXHIMIT TË TERRITORIT**

Adresa: Sheshi "Ahmet Zogu", Burrel Tel.355 (0) 21722421., e-mail: bashkiamat@gmail.com, web:www.bashkiamat.gov.al

***Proces – Verbal***

***Dëgjesa e pestë publike per Planin e Pergjithshem Vendor te territorit***

***të Bashkise Mat – Rrjeti infrastrukturor i propozuar***

Përfaqësues nga MetroPOLIS: Fiona Imami *(Planifikues Urban)*
Kristi Bashmili *(Eksperte Mjedisi)*
Ada Lushi *(Arkitekt)*

Në mbledhje morën pjesë përfaqësues nga: dldp, AKPT, Drejtoria e Urbanistikes, Administratorët e Njësive Administrative, Përfaqesues të Bizneseve, Qytetarë, Specialistë të drejtorisë së Shërbimeve, Specialistë të Transportit Publik, Specialistë të rrjetit të Ujitjes dhe Kullimit etj.

Prezantimi nisi në orën **11:[15]** am

Prezantimi mbi "Propozimet e rrejtit infrastrukturor" u mbajt në ambjentet e Pallatit të Kulturës në qytetin e Burrelit me datë 27 Mars 2017. Prezantimin e hapi z. Rikard Luka,

perfaqesues i dldp, dhe Program Officer per hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Mat. Ndër të tjera Z. Rikard Luka, nënvizoi rëndësinë e pjesëmarrjes në Dëgjesa Publike gjatë kësaj faze përfundimtare të Planit të Përgjithshëm Vendor, ku kontributi i cdo qytetari Matian është vlerë e shtuar e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Mat.

Ekspertja e MetroPOLIS, Znj. Fiona Imami, prezantoi propozimet e Bashkisë Mat sa i përket rrjetit infrastrukturor, transporti publik dhe infrastrukturave kryesore të UK, dhe Menaxhimit të Mbetjeve.

Materiali i përgatitur për këtë dëgjesë përmbate si më poshtë:

1. Procesin e hartimit të PPV- dhe fazën në të cilën ndodhet PPV Mat
2. Analizën e rrjetit rrugor ekzistues dhe korridoret kryesore
3. Rimarrje e Vizionit Strategjik të Bashkisë përfshi këtu dhe programet e projektet kryesore Strategjike
4. Propozimet mbi rrjetin infrastrukturor rrugor (sipas Funksionit)
5. Propozimet mbi transportin publik në Bashkinë Mat
6. Masat dhe propozimet per shërbimet publike të Ujësjellës Kanalizime dhe Menaxhimit të Mbetjeve

Në përfundim të prezantimit u propozuan dhe u mbajtën diskutime si më poshtë:

Pyetje: Unaza e propozuar per qytetin e Burrelit a kalon në gjurmën ekzistuese të tij? Apo është një propozim i ri i cili devijon nga kjo gjurmë

Përgjigjet Z. Astrit Doci, drejtor i Urbanistikës, Bashkia Mat: Unaza e propozuar kalon mbi gjurmën ekzistuese, megjithatë devijime të vogla janë bërë me qëllim sjelljen sa më harmonike të kësaj rruge. Nëse do ta shihnit këtë hartë më nga afër, do ta kuptonit më qartë.

Koment: Unë kam lexuar materialin e Strategjisë së Zhvillimit të Matit, dhe kam vënë re se ju keni evidentuar mjaft mirë të gjitha pikat me interes turistik dhe ekonomike. Megjithatë do të sugjeroja dhe shtimin e dy pikave të rëndësishme, në Njësinë Administrative Rukaj, sepse realisht duhet të bëjnë pjesë në këto itinerare. Vargu i Kishave në Rukaj, 4 shpellat po në njësinë Rukaj, Kulla Pash në fshatin Laç duhet të evidentohen më qartë edhe në hartë dhe në itinerare.

Koment z. Aurel Palluçi: do të sugjeroja që disa nga linjat e transportit të modifikoheshin, ose të paktën të zgjeroheshin unazat e ofrimit të këtij shërbimi. Psh: Linja Burrel-Komsi-FusheBaz duhet të përfshijë brenda unazës edhe fshatin Karicë, Duhet të shtohen linjat për fshatin Gjoçaj-Dukagjin, Laç-Bruç-Prell dhe Shoshaj-Mallunxë-Gjallish.

## SHENIME DHE REFERENCA

---

[1] Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, "Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku i Dibrës", Tiranë, 2014

[2] SOLARGIS, http://solargis.com/products/maps-and-gis-data/?_ga=1.51973610.2123590409.1477314428

[3] Bruci. E. Climate variability and trends in Albania, Tiranë, 2008

[4] Albania Energy Association , Albania Solar Energy, http://aea-al.org/albania-solar-energy/

[5] Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore

[6] Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, "Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku i Dibrës", Tiranë, 2014

[7] Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, "Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku i Dibrës", Tiranë, 2014

[8] Vlerë e matur në GIS nga analiza e përdorimit të tokës, gjendja ekzistuese, Bashkia Mat 2017

[9] Drejtoria Rajonale Bujqësore Dibër

[10] Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, *Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku i Dibrës*, Tiranë 2014 (Harta Hidrologjike)

[11] Plani i Zhvillimit Lokal, Baz 2009-2014

[12] Plani Strategjik i Zhvillimit, Derjan 2009-2014

[13] Plani i Zhvillimit Lokal, Komsi 2009-2014

[14] Plani Strategjik i Zhvillimit, Rukaj 2009-2014

[15] www.riverwatch.eu

[16] Plani Strategjik i Zhvillimit, Derjan 2009-2014

[17] Sipas të dhënave të OSSHE

[18] Direktiva 2009/28/EC, neni 2

[19] ENER SUPPLY (2015), *Manual për Burimet e Energjie të Rinovueshme*, South East Europe

[20] Ligji Nr. 111/2012 Për Manaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore

REPUBLIKA E SHQIPËRISË AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT TIRANË SEKRETARIA

---

[21] SHGJSH, Drejtoria e Hidrogjeologjisë, Sektori i Monitorimit të Rrjetit Lumor, Monitorimi i dinamikës së shtratit në lumenjtë e Shqipërisë në rrjedhën e mesme dhe të poshtme të rrjedhës dhe propozimi i masave për stabilizimin e gjendjes, Shkurt, 2016

[22] Standardet janë marrë nga Direktiva Kuadër e BE për gjendjen e lartë të lumenjve

[23] Shërbimi Gjeologjik Shqiptar 2014, Gjeoresurset dhe gjeorreziqet në qarqet e Shqipërisë: Qarku Dibër

[24] Studimet e mëparshme të bëra rreth burimeve ujore nëntokësore bazoheshin në sipërfaqen e qarkut të Dibrës sipas ndarjes administrative të territorit përpara reformës së re administrative. Ende nuk ka një studim që përcakton sipërfaqen e akuifereve për çdo bashki.

[25] Shërbimi Gjeologjik Shqiptar 2014

[26] EPA's National Hardrock Mining Frameëork, shtator 1997

[27] EPA's National Hardrock Mining Frameëork, shtator 1997

[28] Demi G. 2000

[29] Bakër

[30] Zink

[31] Plumb

[32] Krom

[33] Nikel

[34] Hekur

[35] Squfur

[36] Shërbimi Gjeologjik Shqiptar 2014

[37] Shërbimi Gjeologjik Shqiptar 2014

[38] Shërbimi Gjeologjik Shqiptar 2014

[39] Ministria e Mjedisit dhe UNDP, Third National Communication of Albania to UNFCCC, Third Draft, March 2016

[40] US EPA, https://ëëë.epa.gov/greenvehicles/greenhouse-gas-emissions-typical-passenger-vehicle-0

[41] INSTAT, 2010

[42] Bëhet fjalë për naftën që përdoret për makina.

[43] Inspektoriati Qëndror Teknik

[44] AKM 2014, Informacion për cilësinë e lëndëve djegëse.

[45] Ministria e Mjedisit dhe UNDP, Third National Communication of Albania to UNFCCC, Third Draft, March 2016

[46] Ministria e Mjedisit dhe UNDP, Third National Communication of Albania to UNFCCC, Third Draft, March 2016

[47] Cit. Ligji Nr. 8906, datë 6.6.2002 "Për Zonat e Mbrojtura" (i ndryshuar)

[48] Ligji Nr. 8906, datë 6.6.2002 "Për Zonat e Mbrojtura" (i ndryshuar)

[49] AKZM, 2016

[50] Ligji Nr 8906, datë 06.06.2002 Për Zonat e Mbrojtura, i ndryshuar me Ligjin Nr.9868, datë 04.02.2008

[51] MM 2009 – 2013

[52] Ligji Nr 9587, datë 20.7.2006 'Për Mbrojtjen e Biodiversitet'

[53] VKM nr 31, dt. 20. 01. 2016, Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.

[54] Libri i Kuq i Florës e Faunës Shqipëtare, 2007

[55] Agjencia Kombëtare e Mjedisit, *Raporti mbi Gjendjen e Mjedisit*, 2013

[56] Agjencia Kombëtare e Mjedisti (AKM), *Raporti i Gjendjes në Mjedis*, 2014

[57] Agjencia Kombëtare e Mjedisti (AKM), *Raporti i Gjendjes në Mjedis*, 2014

[58] Agjencia Kombëtare e Mjedisti (AKM), *Raporti i Gjendjes në Mjedis*, 2014

[59] Agjencia Kombëtare e Mjedisti (AKM), *Raporti i Gjëndjes në Mjedis*, 2014

[60] Gjeoresurset dhe gjeorreziqet, Qarku Dibër, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, 2014

[61] Agjencia Kombëtare e Mjedisti (AKM), *Raporti i Gjëndjes në Mjedis*, 2014

[62] EU Commission, *Overvieë of CAP Reform 2014-2020*, Agricultural Policy Perspectives Brief, N°5* / December 2013

[63] Republic of Albania, Ministry of Environment, Third National Communication of Albania to UNFCCC, draft 2016

[64] The World Bank, Looking Beyond the Horizon

[65] ECN 2008

[66] The World Bank, Reducing the Vulnerability of Albania's Agricultural Systems to Climate Change

[67] SZHT Bashkia Mat, 2016

[68] UNECE

[69] Krom

[70] Nikel

[71] Bakër

[72] Kadmium

[73] Plumb

[74] SHGJSH

[75] SHGJSH

[76] SHGJSH

[77] Siç përcaktohet në metodologjinë e ESPON, Potential of Rural Regions

[78] Densiteti i punësimit shprehet si numri i të punësuarve për njësi hapësinore (kriteret për këtë janë pjesë e metodologjive specifike që mund të përdoren).

[79] Produktiviteti, sipas përkufizimit, është efektiviteti i përpjekjeve produktive i matur në lidhje me normën e prodhimit për njësi të inputit.

[80] Sipas VKM nr. 481

[81] Po aty, pika ë

[82] Po aty

[83] Dokumenti i strategjisë së zhvillimit të arsimit parauniversitar 2014-2020, fq 67

[84] http://data.ëorldbank.org/indicator/SE.PRM.ENRL.TC.ZS

[85] http://data.ëorldbank.org/indicator/SE.SEC.ENRL.TC.ZS

[86] http://healthgrouper.com/documents/4417/Albania_country_report-Final.pdf

[87] http://ec.europa.eu/health/reports/docs/health_glance_2014_en.pdf

[88] Largësia e matur në GIS

[89] Bashkia Mat

[90] https://de.wikipedia.org/wiki/Rruga_shtet%C3%ABrore_SH6

[91] Info e nxjerr nga google map

[92] Ligji nr. 8308, date 18.3.1998 "Per transportet Rugore", i ndryshuar

[93] Ligji nr. 8308, date 18.3.1998 "Per transportet Rugore", i ndryshuar

[94] Ligji nr. 8308, date 18.3.1998 "Per transportet Rugore", neni 9, fq 5

[95] Drejtoria e sherbimeve publike, Bashkia Mat si dhe evidentimi nga ortofoton e vitit 2007 dhe 2015, ASIG

[96] Vlera është nxjerr nga analiza në GIS

[97] Bashkia Mat, 2016

[98] Bashkia Mat, 2016

[99] GoogleEarth

[100] www.financatvendore.al

[101] Të ardhurat nga transfertat ndërqeveritare përfshijnë të ardhurat nga: taksat e ndara, transfertën e kushtëzuar dhe transfertën e pakushtëzuar.

[102] Të ardhurat vendore përfshijnë të ardhura nga: taksa dhe tatime, tarifa, të ardhura nga asetet vendore, dividendë, fonde ose asete të KSHP-ve, donacione dhe hua.

[103] Të dhënat për vitin 2016 janë parashikime sipas projekt – buxhetit 2016.

[104] Transferta e kushtëzuar është tërësisht me destinacion të përcaktur dhe autoriteti vendor nuk ka diskrecion në përdorim.

[105] Numri total i popullsisë së përdorur në këtë analizë është 38,442 banorë.

[106] Shpenzimet e kryera nga njësitë e qeverisjes vendore klasifikohen sipas natyrës ekonomike dhe sipas qëllimit të përdorimit të tyre (funksionit apo programe) në përputhje me standardet ndërkombëtare të zhvilluara nga Organizata për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillimin (OECD), të publikuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara.

[107] Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizim dhe Qeverisje Vendore, 2015, faqe 12.

[108] Projekt-ligji për ligjin e ri Organik për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisë Vendore, aprovuar nga Këshilli i Ministrave, aktualisht në pritje për të kaluar për votim në kuvend.

[109] Në përputhje me Ligjin nr. 115/2014 , datë 31.07.2014 "Mbi Ndarjen territoriale administrative të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë"

[110] Njësi të qeverisjes vendore (bashkitë dhe qarqet sipas legjislacionit në fuqi për ndarjen territoriale dhe administrative)

[111] PLGP/USAID: Sistemi i transfertave ndërqeveritare dhe formula e re e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar

[112] Të dhëna zyrtare nga Bashkia Mat

[113] Organizata të Shoqërisë Civile

[114] Përshtatur nga "Mati: vështrim i shkurtër gjeografik, historic, ekonomik e kulturor", 1998 nga Ramiz Fiçorri

[115]Sipas Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura http://akzm.gov.al/index.php?option=com_k2&view=itemlist&layout=category&task=category&id=4&Itemid=370&lang=en, aksesuar në nëntor 2015.

[116] Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 676 datë 20.12.2002